Republika e Kosovës

Republika Kosovo -Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kuvendi

Në mbështetje të nenit 65 (14) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 40 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen plenare të mbajtur më 11 shkurt 2014, pas shqyrtimit të Planit Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri", mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi e miratoi Planin Hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri".

Nr. 04-V-772
Prishtinë, më 11 shkurt 2014

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Vendimi i dhe Plani hapësinor i dërgohen:

- Qeverisë së Republikës së Kosovës,
- Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor,
- Arkivit të Kuvendit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstovo Sredine i Prostornong Planiranja - Ministry of Environment and Spatial Planning

Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Kosovska Agencia za Zastitu Sredine
Kosovo Environmental Protection Agency

Instituti për Planifikim Hapësinor
Institute for Spatial Planning
Institut za Prostorno Planiranje

PLANI HAPËSINOR

PARKU KOMBËTAR "SHARRI"

PARKU KOMBËTAR
"SHARRI"

PLANI HAPËSINOR



Dokument i hartuar nga Instituti për Planifikim Hapësinor
në bashkëpunim me strukturat relevante të sektorëve të
Qeverisë së Kosovës, qeverive komunale dhe strukturave dhe
niveleve të ndryshme të shoqërisë kosovare.

Vërejtje:
Versioni kompetent i dokumentit është versioni në gjuhën shqipe.

REPUBLIKA E KOSOVËS
QEVERIA E KOSOVËS
MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
AGJENCIONI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS

INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

PARKU KOMBËTAR "SHARRI"

PLANI HAPËSINOR

Prishtinë, Tetor, 2013



FAZAT KRYESORE

I	PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR
II	VIZIONI, PARIMET DHE CAQET
III	KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR
IV	STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM
V	DISPOZITAT PËR ZBATIM

Përmbajtja

Hyrje 7
Gjendja 7
Roli dhe natyra e planit 8
Procesi, fazat, fushat tematike, burimi i të dhënave 9
Baza juridike dhe qëllimet themelore 9
Funksionet themelore të PN "Mali Sharr" 10

I. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR 12
Pozita, kufijtë dhe veçoritë e parkut.... 13
Kufijtë e parkut 15
Veçoritë gjeomorfologjike dhe gjeologjike 16
Veçoritë klimatike 18
Sipërfaqja e parkut dhe mbulueshmëria e territorit të tij... 20
Sipërfaqet dhe veçoritë e tokave pyjore....20
Sipërfaqet dhe veçoritë e kullosave 22
Veçoritë hidrologjike 24
Veçoritë peisazhore 26
Zonat e Parkut sipas shkallës së mbrojtjes 28
Rezervatet strikte natyrore 28
Zonat me vlera të veçanta natyrore 28
Zonat e veçanta të mbrojtura 30
Gjendja mjedisore e Parkut 32
Ndotja dhe degradimi 32
Zonat e rrezikuara nga erozioni 32
Vegjetacioni 34
Flora 36
Fauna 38
Gjendja ekonomike e parkut 41
Turizmi 41
Banimi në Park dhe vendbanimet për rreth tij 46
Gjendja e infrastrukturës 49
Zgjërimi i parkut....52
Komuna e Dragashit ne Park 57
Analiza e gjendjes – SWOT 75
Sfidat e zhvillimit të ardhshëm hapësinor 76

II. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET 88

Vizioni për zhvillimin e ardhshëm të Parkut 89
Parimet e përgjithshme për zhvillim dhe mbrojtje 90
Synimet dhe objektivat 90
Kapacitetet investive 92

III. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR 97
Koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor 98
Struktura, funksionimi dhe zhvillimet e ardhshme në park..101
Zona e parë e mbrojtjes 101
Zona e dytë e mbrojtjes 109
Zona e tretë e mbrojtjes 109
Zona e ndikimit reciprok (vendbanimet përreth Parkut) 111
Infrastruktura teknike në Park 113
Njohja ndërkombëtare 115

IV. STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM.....117
Strategjia e zhvillimit dhe menaxhimit mjedisor 119
Strategjia për Zhvillim ekonomik 129
Strategjia për zhvillimin e Infrastrukturës fizike 137

V. DISPOZITAT PËR ZBATIM 144
Dispozitat e përgjithshme 144
Masat për aplikimin e planit 145
Rregullimi i hapësirës 147
Rezhimi i shfrytëzimit të hapësirës....147
Planifikimi dhe banimi....147
Objektet publike 149
Hapësirat e lira 149
Dispozita për rregullimin e Kampeve 150
Infrastruktura 151

Pjesëmarrësit në hartimin e Planit 154
Literatura dhe burimet 155
Shtojca 1. 157
Shtojca 2. 160
Shtojca 3. 162
Shtojca 4. 177

Hartat

Hyrje

Në vitin 1986 me vendim të Kuvendit të atëhershëm të Kosovës, disa nga hapësirat me vlera të veçanta u shpallën si Park Nacional me emërtim të ri: Parku Nacional "Mali Sharr", dhe nga ajo kohë është provuar që sipërfaqja e cila shtrihet në kuadër të parkut, të trajtohet në mënyrën e cila siguron përmbushjen e kritereve të përcaktuara me rregullativë ligjore dhe plotësimin e kërkesave të caktuara me marrëveshje dhe rregulla ndërkombëtare.

Përkujdesja ndaj vlerave natyrore është kërkesë e domosdoshme, përmbushja e të cilës mundëson që ato të përjetohen nga gjeneratat e tashme dhe të ardhshme. Ky është njëri prej kushteve bazë, plotësimi i të cilit mundëson arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të hapësirës.

Zhvillimi, rregullimi dhe shfrytëzimi i Parkut Nacional "Mali Sharr", kërkon veprim të organizuar dhe të koordinuar të të gjitha strukturave të përfshira, kërkon strategji dhe politika afatgjate të cilat do të bazohen në rezultatet e procesit të hulumtimit dhe planifikimit. Në të kundërtën, zhvillimi dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i këtyre vlerave natyrore, mund të ketë pasoja serioze në pikëpamje të degradimit të mjedisit dhe vlerave të tjera ekonomike.

Gjendja

Funksionimi dhe themelimi i institucioneve të reja që merren me mjedisin, si në nivelin qendror dhe në atë lokal, janë treguar si veprime të qëlluara në drejtim të arritjeve të dëshirueshme, por në të njëjtën kohë, të pamjaftueshme. Momentalisht ekzistojnë dy drejtori që menaxhojnë me pasuritë e Parkut. Njëra e vendosur në Prizren që nuk i zbaton ingerencat në tërë territorin dhe tjetra në Shtërpce që menaxhon vetëm pjesën që është brenda kësaj komune. Ekzistimi dhe funksionimi i drejtorive të përmendura po krijon hapësirë në emër të së cilës po arsyetohen veprimet që po e degradojnë vet parkun.

Vështirësitë më të mëdha janë të lidhura më bazën e shënimeve e cila nuk ekziston fare, pjesa e vetme e shënimeve është e formës së thjeshtë dhe zakonisht furnizimi me një informatë të këtillë, varet nga vullneti i mirë i personit që e posedon. Në ligjin e vitit 1986 për shpalljen e Parkut Nacional "Mali Sharr" thuhet se parku mbulon një sipërfaqe prej 39.000 ha. Analiza e gjendjes ekzistuese është e bazuar në pjesën më të madhe në disa shënime të vjetruara, të cilat për shkaqet e përmendura më lartë nuk ka qenë e mundur të përtërihen. Me metoda të ndryshme të vlerësimit dhe krahasimit është arritur që gjendja e prezantuar të jetë e ngjashme me realitetin dhe në kufijtë të cilët kanë mundësuar vazhdimin e procesit të hartimit të planit për zhvillimin e ardhshëm të parkut.

Me zhvillimin ekonomik dhe rritjen e popullsisë jemi dëshmitarë se po paraqitet nevoja dhe po ndodh zgjerimi dhe rritja e shpejtë e qyteteve, i ashtuquajturi Urbanizim i hovshëm apo urbanizim intensiv (veçori e botës bashkëkohore). Kjo po ndodhë edhe në Kosovë, por e paplanifikuar dhe jashtë normave dhe standardeve të planifikimit hapësinor. Si rrjedhojë e gjithë këtyre parregullsive të shprehura ka qenë faktori dhe situata politike (ndërrimi i rendit shtetëror dhe formimi i shtetit të ri), vonesat dhe vakumet e funksionimit institucional, mungesa e stafit profesional në të gjitha nivelet, mos gatishmëria e komunave për t'u përgjigjur me kohë ndaj kërkesave, moszbatimi i planeve hapësinore dhe urbanistike më parë të aprovuara apo të aplikueshme me të cilat kanë disponuar komunat, etj.

Deri më tash janë të pakta, komunat që veprojnë ose zhvillohen në bazë të planit më parë të aprovuar. Në bazë të ,,Raportit mbi gjendjen e planifikimit dhe menaxhimit hapësinor dhe urban në komunat e Kosovës" të publikuar në janar të vitit 2007 nga MMPH – Departamenti i Planifikimit Hapësinor, ku janë të paraqitura gjendja, të arriturat, ngecjet, problemet me të cilat ballafaqohen komunat në hartimin e planeve hapësinore dhe urbanistike si dhe realizimin e tyre, shihet se cili është niveli i komunave në këtë aspekt dhe sa ato kanë mundësi t'u përgjigjen kërkesave për planifikim dhe ndërtim në territorin e vet.

Edhe për zonën e parkut nacional, mungesa e një plani të tillë ka shkaktuar një gjendje e cila është sjellë në kufijtë e një gjendje normale. Disa nga veçoritë e theksuara dhe të njohura të parkut janë në rrezik të humbjes, një pjese të konsiderueshme të pyjeve të larta i kanoset rreziku permanent nga sëmundjet e ndryshme dhe nga prerja e pakontrolluar e tyre. Sipërfaqe të tëra të përmbajtjeve dhe vlerave natyrore janë nën mëshirën dhe kujdesin e pakoordinuar të disa personave dhe të vet ndërgjegjes së qytetarëve, të cilët shpesh sillen në mënyrë jo të drejtë. Prandaj, hartimi i planit hapësinor për Parkun Nacional "Mali Sharr", është nevojë e ngutshme. Ky plan do të mund të ofronte zgjidhje për shumë dukuri që shkojnë në dëm të njërës nga pasuritë më të mëdha natyrore të Kosovës. Plani i zhvillimit hapësinor të parkut do të ofrojë edhe zgjidhje të paqartësive dhe funksionimin më efikas të menaxhmentit të parkut nacional. Njëra ndër çështjet me rëndësi në dokumentin - Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+, është trashëgimia natyrore dhe kulturore, humbja, shkatërrimi dhe moskujdesi i duhur ndaj saj. Prandaj, qëllimi kryesor i planit do të jetë zhvillimi i kontrolluar hapësinor i parkut duke mbrojtur vlerat e trashëguar natyrore, ambientale dhe pejsazhore dhe duke mbrojtur shumëllojhmërinë si njërën nga karakteristikat që e dallojnë dhe e bëjnë këtë hapësirë të veçantë.

Roli dhe natyra e planit

Hartimi i Planit Hapësinor për PK "Mali Sharr" ka për bazë rregullativen ligjore në fuqi të përbërë nga: Ligji për Planifikim Hapësinor, Ligji për shpalljen e Parkut Nacional "Mali Sharr" Ligji për Tokën Bujqësore, Ligji për Banim dhe Ndërtim, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligji për mbrojtjen e Natyrës dhe Ligji për Ujëra.

Hartimi i Planit duhet të shërbejë si udhëzues:

- për të identifikuar lokacionet me potenciale të zhvillimit hapësinor të parkut;
- për të aprovuar politikat lidhur me vendosjen e zhvillimeve të mundshme në territorin e parkut që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit, ofrimin e shërbimeve të nevojshme gjithnjë duke ruajtur në maksimum trashëgiminë dhe vlerat natyrore dhe kulturore;
- për të identifikuar rolin e vendbanimeve (fshatrave) përreth, si dhe rolin e qyteteve të mëdha që ndodhën në afërsi të parkut, si dhe
- për të identifikuar rolin e infrastrukturës së rëndësishme dhe të lidhjeve me territorin e Parkut

Plani hapësinor i Parkut Kombëtar "Mali Sharr" është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Kosovës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës, por njëkohësisht edhe të mbrojë resurset, trashëgiminë natyrore dhe kulturore. Me vendimet të cilat do të miratohen, plani hapësinor duhet të:

- Udhëzojë sektorët dhe agjencitë e Qeverisë në hartimin dhe implementimin e politikave dhe vendimeve për shfrytëzimin sa më të drejtë të kësaj pasurie natyrore;
- Përcaktojë kategorizimin e hapësirave të cilat: do ti nënshtrohen mbrojtjes nga çdo zhvillim, lokacionet me shkallë të caktuar të zhvillimit, lokacionet për zhvillim si dhe lokacionet me rezhim të caktuar të shfrytëzimit;

Procesi, fazat, fushat tematike, burimi i të dhënave

Puna rreth hartimit të Planit ka filluar me analiza dhe hulumtime për territorin e Parkut të identifikuar me Ligjin e vitit 1986, sipas të cilit në kuadër të Parkut përfshihen katër komuna (Prizreni, Shtërpce, Suhareka dhe Kaçaniku) me një sipërfaqe prej 39.000 Ha. Ky aktivitet ka vazhduar deri në momentin kur dokumenti i përfunduar është nxjerrë në shqyrtim publik, në të cilin kërkesa kryesore ishte zgjerimi përkatësisht përfshirja e territorit të komunës së Dragashit në kuadër të Parkut. Pas kërkesave të vazhdueshme nga Komuna e Dragashit dhe pas diskutimeve, zona e përmendur me vendim të Ministrit, shpallet si zonë nën mbrojtje të përkohshme për një periudhë prej dy vitesh. Ky ishte edhe momenti kur u vendos që dokumenti të plotësohet edhe me analiza dhe informata për territorin në fjalë. Të dhënat dhe planet për zhvillimin e kësaj pjese të Parkut, janë vendosur në kaptina dhe paragrafë përkatës, duke e ruajtur maksimalisht strukturën fillestare të dokumentit.

Sipas kornizës së procesit të hartimit të Planit Hapësinor të Parkut Nacional "Mali Sharr", janë 5 faza gjatë të cilave përgatiten dokumentet si më poshtë :

- Profili i Parkut Nacional "Mali Sharr";
- Vizioni dhe caqet strategjike;
- Korniza e zhvillimit hapësinor;
- Strategjitë për zbatim dhe
- Dispozitat për zbatim.


Faza e parë është hartimi i profilit (gjendja ekzistuese) e Parkut Nacional "Mali Sharr . Në të përshkruhet gjendja e zhvillimeve në hapësirën e parkut nacional, e vështruar në tri fusha tematike: mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës, zhvillimi ekonomiko-social dhe infrastruktura.

Materiali i mëposhtëm është i bazuar në të dhëna të marra drejtpërdrejt nga terreni, katër komunat që e rrethojnë masivin e malit të Sharrit, planit zhvillimor të komunës së Shtërpcës dhe sektorët relevant të ministrive të Qeverisë së Kosovës, dokumentacionit ekzistues për arësyeshmërinë e shpalljes së malit Sharr për park nacional, dokumenteve të agjensioneve zhvillimore ndërkombëtare që kanë punuar dhe punojnë në çështje të ndryshme lidhur me pyjet, zhvillimin rural etj, por ka edhe të dhëna që janë të bazuara në vlerësime të bëra nga profesionistë dhe grupe të sektorit joqeveritar. Disa nga vlerësimet dhe analizat janë bërë edhe nga vetë grupi që është marrë me trajtimin e temave.

Baza juridike dhe qëllimet themelore

Në kuadër të Qeverisë së Kosovës, përgjegjësia për sektorin e planifikimit dhe rregullimit hapësinor i është bartur Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ligji për Planifikim Hapësinor përcakton Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përkatësisht Institutin për Planifikim Hapësinor si subjekt bartës dhe përgjegjës për hartimin e planeve hapësinore për zona të veçanta siç është Parku Nacional „Mali Sharr".



▶ Skema e procesit

Sistemi i planifikimit në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor ndahet në dy nivele:

Për territorin e Kosovës - niveli qendror:

1. Plani Hapësinor i Kosovës
2. Planet hapësinore për zona të veçanta

Për territorin e komunës - niveli komunal:

1. Plani zhvillimor i komunës
2. Plani zhvillimor urban
3. Planet rregulluese urbane

Më sipër është dhënë skema e mobilizimit institucional të pjesëmarrjes në procesin e planifikimit hapësinor.

Plani hapësinor i Parkut Nacional "Mali Sharr" duhet të bazohet në gjendjen ekzistuese sociale, ekonomike dhe mjedisore dhe përpilohet gjatë një procesi gjithëpërfshirës, transparent dhe me pjesëmarrje publike në vendimmarrje.

Pjesëmarrja publike nënkupton involvimin e ministrive të Qeverisë së Kosovës, autoritetet komunale, institucionet shkencore dhe hulumtuese, organizatat e shoqërisë civile, agjencitë e KB-ra, agjencitë e huaja zhvillimore, zyret ndërlidhëse në Kosovë, institucionet e BE-së, etj.

Plani hapësinor i Parkut Nacional "Mali Sharr" bazohet në:

- Parimet e përcaktuara me Ligj,
- Vizionin dhe caqet strategjike,
- Raportet e sektorëve të rëndësishëm,
- Strategjitë zhvillimore të sektorëve të ndryshëm,
- Elemente tjera të përcaktuara me akt te veçantë,

Plani përcakton parimet dhe qëllimet afatgjate të planifikimit hapësinor për periudhën të paktën 10 vjeçare, përcakton afatet kohore reale dhe implikimet buxhetore.

Procesi i planifikimit është i vazhdueshëm. Ai duhet t'i nënshtrohet monitorimit, vlerësimit dhe në bazë të kërkesave edhe ndryshimeve të nevojshme.

Funksionet themelore të PN "Mali Sharr"

Me planin hapësinor të Parkut Nacional "Mali Sharr" si dhe në bazë të ligjit për mbrojtjen e natyrës duhet të sigurojmë:

a) mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve të përtëritshme të natyrës;
b) rivitalizimin e territoreve të dëmtuara të natyrës ose pjesëve të saj dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
c) ruajtjen dhe restaurimin e baraspeshës ekologjike në natyrë;
d) vendosjen e sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim, për mbrojtjen e natyrës;
e) realizimin e qëllimeve, të përcaktuara në politikat e mbrojtjes së natyrës;
f) zvogëlimin e shfrytëzimit tejmase dhe rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe i habitateve të tyre.
g) e drejta për informim publik dhe pjesëmarrje të publikut në lëmin e mbrojtjes së natyrës;
h) sigurimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë.
i) sigurimin e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve të rëndësishme natyrore dhe llojeve me rëndësi të florës dhe faunës në statusin e favorshëm të ruajtjes.

Sipas ligjit për mbrojtjen e natyrës, parku nacional është territor natyror me funksione për:

a) mbrojtjen e tërësisë ekologjike, të një apo më shumë ekosistemeve, për brezat e sotëm dhe të ardhshëm;
b) përjashtimin e shfrytëzimeve apo uzurpimet me qëllim të ndryshimit dhe dëmtimit të natyrës;
c) sigurimin e bazave për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative, kulturore dhe mundësi vizitash, në pajtim me parimet e mbrojtjes së mjedisit, përderisa ai duhet të menaxhohet me qëllime të cilat janë:

1. mbrojtja e territoreve natyrore me rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare për qëllime shpirtërore, shkencore, arsimore, rekreative dhe turistike;
2. ruajtja e gjendjes burimore, të shembujve reprezentativ të zonave fiziografike, bashkësive biotike, resurseve gjenetike dhe llojeve për sigurimin e biodiverzitetit dhe të stabilitetit ekologjik;
3. sigurimi i shfrytëzimit në aspektin inspirues, shkencor, arsimor, kulturor dhe rekreativ që ta mbajë zonën në gjendjen natyrore ose afërsisht natyrore;
4. përjashtimi i shfrytëzimeve ose i vizitave të cilat mund të shkaktojnë ndryshime dhe dëmtime të natyrës;
5. mbajtja e veçorive ekologjike, gjeomorfologjike dhe estetike për të cilat territori është shpallur i mbrojtur.

Funksionet e parkut nacional përcaktohen në atë mënyrë që ato të sigurojnë në radhë të parë mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave themelore të parkut nacional, e pastaj rregullimin dhe shfrytëzimin e këtyre vlerave:

- Ruajtja dhe mbrojtja e vlerave dhe rariteteve natyrore prezente burimore dhe pjesërisht të ndryshuara,
- Mbrojtja dhe përparimi i pejzazhit të rajonit në tërësi,
- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturo-historike,
- Zhvillimi dhe përparimi i vlerave natyrore dhe të krijuara, si dhe zhvillimi i aktiviteteve prezente dhe të reja,
- Ekonomizimi dhe përparimi i vlerave natyrore dhe ekonomike,
- Shfrytëzimi i vlerave të parkut nacional me qëllim të hulumtimeve shkencore, arsimore, edukative dhe kulturore,
- Shfrytëzimi i vlerave të parkut nacional për nevojat e ekonomisë, para së gjithash për nevojat e veprimtarive turistike-rekreative, pastaj për shfrytëzimin e pyjeve, kullosave malore, tokës bujqësore dhe tjera,
- Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për vlerat e natyrës,



I PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

1. PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR DHE ANALIZA E GJENDJES

1.1 Pozita, kufijtë dhe veçoritë e parkut


Parku Nacional "Mali Sharr" sikur edhe Kosova shtrihet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, përfshihet në kryqëzimin e rrugëve në drejtimin lindje – perëndim ndërmjet Detit të Zi dhe atij Adriatik si dhe në drejtimin veri – jug ndërmjet Evropës së Mesme dhe Detit Egje (Mesdheut).

Në kuadër të Maleve të Sharrit, Kosovës i takojnë pjesët veriore që përfshijnë hapësirën prej rreth 1100km² ose rreth 1/10 e hapësirës së Kosovës, ndërsa pjesa e mbetur apo ajo jugore e maleve të Sharrit me sipërfaqe prej 500 km² shtrihet në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Vija që përshkon kuotat e larta nëpër majat malore te Sharrit përcakton kufirin ndarës, që është pjesë e kufirit ndërshtetëror, në mes të Kosovës dhe IRJ të Maqedonisë. Përmes luginës se lumit Lepenc (Siriniq) lidhet me Fushën e Kosovës ndërsa përmes Luginës së Lumëbardhit të Prizrenit (Sredska) lidhet me Rrafshin e Dukagjinit.



Parku Nacional është i shpallur që në vitin 1986 me ligj sipas të cilit sipërfaqja e Parkut është 390km² ose 35,4% nga sipërfaqja e përgjithshme e maleve të Sharrit që shtrihen në territorin e Kosovës. Kjo përbën 3.58% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të Republikës së Kosovës. Parku Nacional „Mali Sharr" është shpallur për të mbrojtur biodiversitetin bimor dhe shtazor sikurse edhe bukuritë e peizazheve natyrore të pyjeve, majave të maleve, lumenjve dhe liqeneve malor. Biodiversiteti i malit Sharr ka karakteristika të Ballkanit dhe Mesdheut duke e bërë atë të pasur në florë e faunë në kuptimin e llojeve endemike e të rralla.

Kosova në kuadër të ish Jugosllavisë ishte nënshkruese e konventës ndërkombëtare mbi mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore botërore ("F1. zyrtare e RSFJ". Nr.57/74), si dhe Deklaratës së Konferencës të OKB të Stockholmit, në vitin 1972). Nga kjo, rrjedhin obligimet për begatitë natyrore të tokës, posaçërisht "ekzemplarët reprezentativë të sistemeve natyrore" që pa tjetër duhet të mbrohen për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme. Poashtu edhe për "monumentet natyrore që përbëhen nga formacionet fizike dhe biologjike, e të cilat kanë vlerë të jashtëzakonshme universale nga aspekti shkencor dhe ai i ruajtjes", prej të cilave ka pasuar obligimi për zhvillimin e hulumtimeve dhe studimeve shkencore



▶ Harta: Pozita e PN "Mali Sharr" në Kosovë dhe rajon

dhe teknike, si dhe përsosjen e metodave të punës në bazë të të cilave në një vend do të ndermirën masa për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe natyrore.


Informatat shkencore lidhur me Parkun në përgjithësi bazohen në të dhënat-vlerësimet e viteve të 80-ta dhe fillimit të viteve të 90-ta të orientuara më shumë drejt studimit shkencor e më pak në atë të menaxhimit dhe ruajtjes. Ekzistojnë nevojat për të vlerësuar llojet dhe mjedisin e tyre me metodologji të pranuar ndërkombëtare, në kuptim të përhapjes së biodiversitetit, efikasitetit në menaxhim si dhe angazhimit të komunitetit. Në vitin 2001 vlerësimi nga ana e SIDA-s propozonte procesin për krijimin e planit menaxhues të Parkut së bashku me vlerësimet për kufij, zhvillimin e sistemit të zonimit dhe krijimin e strukturës menaxhuese.

Në kuadër të Sistemit të Zonave të Mbrojtura të vendit, duke nënkuptuar një park nacional, 38 monumente natyrore dhe dy pejzazhe të mbrojtura - sipas klasifikimit dhe kritereve të IUCN-së, Kosova ka më pak se 5% sipërfaqe të mbrojtur nga sipërfaqja e tërësishme e Kosovës. Shumica e kësaj sipërfaqeje është territor i Parkut Nacional "Mali Sharr". Me shpalljen e "Bjeshkët e Nemura" (siç është propozuar) për Park Nacional, do të zmadhohej sipërfaqja me zona të mbrojtura për dy herë, duke arritur kështu kriterin apo normën e dëshirueshme ndërkombëtare (raporti prej 10% me sipërfaqe të mbrojtur natyrore ndaj sipërfaqes së tërësishme të një shteti).

Kufijtë e parkut

Kufiri i parkut sipas ligjit të vitit 1986 për shpalljen e Parkut Nacional "Mali Sharr" në pjesën jugore dhe juglindore përputhet me kufirin në mes të Maqedonisë dhe të Kosovës i cili shkon përtej kotës, përkatësisht të majave më të larta të Sharrit duke filluar nga maja e Lubotenit (2.499m) mandej përtej Kullës (2.314m), Livadicës (2.491m), Cukës së Liqenit (2.604m), Bistrës (2.640m), Majës së Zezë (2.584m), Koblicës (2.526m), dhe deri tek kota Kara Nikolla (2.106m).

Pjesëmarrja e zonave të mbrojtura natyrore në sipërfaqen e përgjithshme të një shteti (në përqindje)



▶ Raporti sipërfaqe e mbrojtur - sipërfaqe e shtetit

Në drejtim të jugperëndimit ku lëshohet kufiri me Maqedoninë dhe kufiri i parkut nacional kthehet në veriperëndim deri te kota (1.626m). Nga kjo kotë kufiri kthehet në lindje mbi fshatin e Manastirit dhe del në kotën 1.671m dhe pastaj shkon deri te kota 1.310m.

Kufiri i parkut mandej kthehet në verilindje deri te kota 1.435m (Javoravicë), nga e cila kthehet në lindje deri te kota 1.765m. (Mlakë), nga e cila vazhdon në verilindje nëpër malet e Misos deri te kota 1.522 .

Mandej kufiri kthehet në veriperëndim deri te kota 1.271m duke u shtrirë mbi fshatin Gormjasellë, ku kufirin e parkut nacional në vazhdim e përbën rruga Prizren - Brezovicë deri te Oborri mbretëror dhe kota 1.120m.

Nga kjo kotë kufiri shtrihet në perëndim mbi Kishën e Virgjëreshë së Shenjtë (S.Bogorodica) dhe izohipsën 1.212m deri te kota 1.130m dhe prej këtu në perëndim përtej kotës 931m, del në kotën 1.507m. Nga kjo kotë kufiri kthehet në verilindje deri te kota 1656m duke përfshirë Pishën e Madhe (Golem Borin) nga ana perëndimore dhe del nga ana veriore në kotën 1.509m dhe nga këtu shtrihet në verilindje dhe del në kotën 1.598m (Granzon). Pastaj vazhdon në veri deri te kota

1.931m, dhe më pas deri te kota 1.710m dhe nga këtu në veriperëndim deri te kota 1.456m. (Rusenicë). Në vazhdim kufiri lëshohet deri te kota 841m duke përfshirë Manastirin e Tre të Shenjtëve ku kufiri kthehet në lindje në kotën 1.498m mbi fshatin Delloc dhe shtrihet në veri nga Bollovan Kamen e duke përfshirë Ujin e Mbretit dhe Baçillën e Bukoshit në lindje deri te kota 1.654m.

Nga kjo kuotë kufiri shtrihet në drejtim juglindor deri te kota 1.441m mbi fshatin Biti e Epërme, Popovc dhe Biti e Ultë, prej nga kthehet në jug dhe del në kotën 1.276m (Çukë). Më tutje kufiri lëshohet mbi Orliçevë dhe del në kotën 1.150m e pastaj në kënd të drejtë në jug ngjitet deri te kota 1.516m (Malo Borçe) dhe kthehet në perëndim deri te kota 1.440m. (Svedske Livade). Prej këtu lëshohet në jug ku e pret lumi Lepenc, pastaj ngjitet në Kokën e Begut deri te izohipsa 1.600 m., Ndërsa nga këtu kufiri kthehet mbi fshatin Sevcë dhe del në kotën 1.312m. e më tutje shkon në lindje dhe del në kotën 1.232m. (Burli) duke e prerë rrugën Brezovicë - Prizren, pastaj kthehet në juglindje deri te kota 1.453m. Nga këtu vazhdon në verilindje deri te kota 1.485m. dhe më tutje në drejtim të njëjtë deri te kota 1.541m. pastaj vazhdon në lindje deri te Maja e Zezë (1.562m) dhe kota 1.712m. duke përfshirë Tupanin, Baçillën, kthehet në jugperëndim deri te pika fillestare në përshkrimin e kufirit Luboteni ku mbyllet rrethi[1].

Veçoritë gjeomorfologjike dhe gjeologjike – Territorin malor të Sharrit i cili është në kuadër të parkut nacional, në pjesën jugore të tij e përbëjnë malet e larta të cilat njëkohësisht përfaqësojnë edhe majat më të larta të Sharrit.
Pamja e fundit morfologjike e trevës së Sharrit, është para se gjithash rezultat i lëvizjeve tektonike me të cilat janë krijuar tërësitë kryesore gjeomorfologjike dhe më vonë i forcave të jashtme që kanë ndikuar, akullnajave, rrjedhjeve ujore etj. Kështu p.sh. për shkak të veprimit të akullnajave me të cilat kanë qenë të mbuluara pjesët e larta të Sharrit gjatë kohës së akullnajave janë krijuar një numër i madh i të ashtuquajturave thellime akullnajore ose cirqe, valëve si dhe sasive të mëdha të morenave (materialit akullnajor). Në një përmasë këto thellime (cirqe) më vonë janë krijuar liqej të akullnajave, ndër të cilët më të njohurit janë liqejt tejet atraktiv të Livadicës dhe Jazhincës.

Numri më i madh i thellimeve akullnajore ndodhet në rrëzën e majave më të larta, në pjesën më jugore të territorit të parkut nacional, të Bistrës, Livadicës, Çukës së Liqeve, ndërsa grupi më numerik është nën majën e Piribregut (2.522m'), e njohur me emrin Vrima e Berevcit.


Pastaj theksohen thellimet cirkore te Çuka e liqejve dhe Livadica. Nga këto cirqe nisen valet, përkatësisht ultësirat e dikurshme të akullnajave. Posaqërisht duhet të theksohet vala Demir Kapija e cila shkon nga cirku i dikurshëm ku sot është Liqeni i Livadicës. Vala e Demir Kapisë që është me fund të gjerë dhe anët plotësisht të pjerrëta përfaqëson formën më të njohur fosile të ultësirës akullnajore në Sharr, i gjatë është rreth 1,5 km.

Në formën morfologjike të Sharrit në një përmasë më të madhe ndikojnë rrjedhjet lumore. I tërë territori i Sharrit është i ndërprerë me luginat e panumërta të lumenjve dhe përroskave, të cilat kryesisht derdhen në Bistricën e Prizrenit dhe në Lepenc.

Në pjesët jugore të parkut nacional, përkatësisht në rrjedhat e sipërme të lumenjve: Muzhicë, Bollonjskë, Bllateshticë, Suva etj, luginat janë të prera thellë (250m' gjer 400 m'), të ngushta dhe me anë të pjerrëta thuaja se kanë pamje të grykave ose kanjoneve. Kësisoj veçorish kanë kryesisht të gjitha luginat mbi 1.200m' deri 1.400m. të l.m.[2], ndërsa në pjesët më të ulta luginat kanë pamje normale.

[1] Sipas Ligjit (1986) ky kufij mbulon sipërfaqen prej 39,000 Ha, e cila me asnjë metodë të matjes të njohur deri më tash nuk paraqitet e saktë. Sipas analizave sipërfaqja e Parkut Nacional ekzistues është 22,750 Ha - pra për rreth 17,000 Ha më e vogël se sa ajo që është deklaruar me aktin e shpalljes.

[2] I.A. gjeomorfologjia e pjesës së malit Sharr të vënë nën mbrojtjen e natyrës, dorëshkrim, faqja 28.



▶ Harta: Shtrirja e formacioneve gjeologjike.

Në ndërtimin gjeologjik të Sharrit marrin pjesë shkëmbinjtë e përbërjes dhe vjetërsisë së ndryshme. Përhapje më të madhe kanë rasat paleozoike, pastaj shkëmbinjtë karbonat të mermerit dhe serpentinët si dhe formacionet diabaz, sedimentet e liqejve neogjenë dhe aluvionet lumore në pjesët më të ulta si formacion më i ri gjeologjik. Formacionet e paleozoikut kanë një shtrirje më të madhe dhe pikërisht kjo e bënë diferencimin themelor prej pjesëve të tjera malore të Kosovës. Formacionet e paleozoikut të përfaqësuara me filitet dhe rreshpet sercite, në formë të brezit të ngushtë, shtrihen prej majës Bistra (2.640 m), duke vazhduar përgjatë kufirit të Kosovës me Maqedoninë. Krahas tyre, në mënyrë fragmentare janë paraqitur formacionet e mesozoikut, përkatësisht kretakut dhe dolomitit në Shtërpcë dhe në lindje të majës Luboten[3]. Në afërsi të Brezovicës është grumbulluar materiali morenik i procesit akullnajor.

Veçoritë klimatike –Parku Nacional "Mali Sharr" sipas klasifikimit klimatik të Kosovës hynë në klimën lindore kontinentale. Kurse, në vet Parkun Nacional dominojnë klimat alpke dhe ajo kontinentale, e cila herëpashere ndikohet nga klima e mesme kontinentale. Faktorët kryesor që ndikojnë në klimën e një rajoni janë elementet dhe dukuritë meteorologjike. Në hapësirën e Parkut Nacional, është vetëm një vend-matje (apo stacion meteorologjik) në Brezovicë, me lartësi mbidetare 860 m, i cili daton që nga viti 1949. Ndërsa, stacioni tjetër më i afërt, është ai i Jazhincës me lartësi mbidetare të vend-matjes 950 m dhe gjendet në Republikën e Maqedonisë, i cili ka raportuar të dhëna meteorologjike gjatë viteve 1949 - 1991. Nga analiza e bazës së të dhënave në sektorin e meteorologjisë në IHMK, për këto dy stacione (vend-matje) rezulton që temperatura mesatare vjetore shumë vjeçare është 8.4 gradë celsius. Muaji me i ftohtë është Janari me -1.8 dhe -1.3 gradë celsius, kurse vlerat ekstreme të temperaturës në të dy vend-matjet janë ato të vitit 1963 me -33 dhe -34 °C dhe se temperatura mesatare ditore luhatët nga 18 – 20°C. Vlera mesatare e lagështisë relative është 67-70 % për dy vend-matjet. Erërat arrijnë shpejtësinë nga 1-16 m/s, dominojnë drejtimet e erës nga ana e Jugut, jugperëndimit dhe juglindjes. Sasia e reshjeve si vlerë mesatare në Shtërpcë dhe Jazhincë varirojnë nga 670 deri në 1200 mm. Në muajin shkurt dhe mars shpesh herë shkaktohen edhe ortekët e borës ku si pasojë kanë humbur jetën edhe disa qytetar. Ditë me diell në ketë rajon janë 220 deri në 280. Vranësirat dhe lidhshmëria me rrezatimin e diellit dukshëm mund të ndikojnë në valorizimin turistikë të ndonjë territori e sidomos malor. Mirëpo, për shkak të paraqitjes së inverzionit të temperaturës si dhe paraqitjet e shpeshta të mjegullës në luginat rreth e rrotull, rrezatimi diellor në Malin Sharr zgjat me tepër gjatë dimrit, sidomos në pjesët e ekspozuara kah diell.

Ky rajon rrallë herë goditet nga breshëri. Numri i pa mjaftueshëm i vend-matjeve sipas lartësisë mbidetare mbi 1000 metra tregon se sasia e reshjeve nuk është reale për reshjet që bien në zonat malore me klimë lindore kontinentale. Niveli i borës në ketë rajon ka arrit lartësinë deri në 3 metra në vitin 1956. Numri i ditëve me reshje bore dhe lartësitë më të mëdha të bores, pas asaj të vitit 1956, janë realizuar ne vitin 1981, në Jazhincë kemi 117 ditë me lartësi 89cm dhe në Shtërpcë 108 ditë me lartësi 90 cm.

Është karakteristikë e përgjithshme së klima e këtij territori ofron mundësi të jashtëzakonshme për valorizimin turistik si gjatë dimrit ashtu edhe për stinët e tjera vjetore. Vlerat e temperaturës së malit Sharr për dallim prej territorit që e rrethon, janë shumë të ulëta, nga kjo edhe gjatësia e periudhës me temperatura të ulëta, gjegjësisht periudhës dimërore është me e madhe, përkatësisht zgjatë deri në 4 muaj, e që kushtëzon krijimin e mbulesës së trashë të borës dhe mundësinë e valorizimit turistik për sportet dimërore. Po ashtu, duhet cekur dukurinë meteorologjike - inverzionin e temperaturës, i cili krijohet për shkak të nxehjes jo të barabartë të shpateve malore dhe ultësirave, e që përfaqëson përshtatshmërinë për valorizim turistik. Gjatë kësaj kohe në viset më të larta (territori shtëpisë së Stojkut, Piri bregu, Jelovaniku), temperaturat e ajrit mund të jene per disa gradë me te larta se ne rrafshin e Kosovës gjatë sezonës së dimrit. Kjo situatë kilamtike është e përshtatshme për qendrimin e skitarëve. Gjatë verës vlerat e lëkundjes se temperaturës në Malin Sharr nuk janë të larta që po ashtu shkon në favor të zhvillimit të turizmit rekreativ veror.

[3] Dr. Riza I. Çavolli, Gjeografia regjionale e Kosovës, Prishtinë 1997, Fq.14.




▶ Foto: Klimë e përshtatshme për rritjen e vegjetacionit

Sipërfaqja e parkut dhe mbulueshmëria e territorit të tij

Parku Nacional „Mali Sharr", është evidentuar në listën ndërkombëtare, dhe bënë pjesë në kategorinë e dytë (parqet nacionale) të zonave të mbrojtura sipas IUCN[4].: Në ligjin e vitit 1986 për shpalljen e PN "Mali Sharr" thuhet se parku ka sipërfaqe prej 39000 hektarësh, mirëpo nga matja në hartë ka rezultuar se sipërfaqja që gjendet brenda kufirit i cili është vijëzuar sipas përshkrimit në ligjin e lartpërmendur, është rreth 23000 hektarë dhe shtrihet në pjesët e territoreve të të katër komunave:1) Prizrenit merr pjesë me 41 % (ose rreth 9200 ha), 2) Shtërpcës me 47 % (ose rreth 10700 ha), 3) Suharekës me 10 % (ose 2300 ha) dhe 4) Kaçanikut me 2 % (ose 400 ha).


Komuna	Në hektarë (ha)	Pjesëmarrja në përqindje
Prizreni	9200	41%
Shtërpca	10700	47 %
Suhareka	2300	10%
Kaçaniku	400	2%
Gjithsej	Rreth 22.600	100%



▶Harta: Sipërfaqja e PN "Mali Sharr" sipas komunave pjesëmarrëse.

[4] 1990 – IUCN United Nations List of National Parks and Proteceted Areas

Siq shihet në diagramin e mbulueshmërisë së territorit, pjesa më e madhe e sipërfaqes së Parkut është e mbuluar kryesisht nga pyjet me 48 % dhe kullosat 49 % si dhe tokat bujqësore (ara dhe livadhe) me 1.6 % gjegjësisht shkrepa 1.4 %.



▶Fig. Sipërfaqja në PN "Mali Sharr" sipas mbulueshmërisë vegjetative.

Sipërfaqet dhe veçoritë e tokave pyjore – Shpërndarja e këtyre sipërfaqeve është më theksuar në komunën e Shtërpcës me mbi 5,400 Ha, e cila përcillet nga ajo e Prizrenit me mbi 3,800 Ha. Kurse, në komuna e Suharekës sipërfaqe me pyjet zënë rreth 1,600 Ha si dhe në komunën e Kaçanikut janë të përfshira në rreth 75 Ha.


Pyjet dhe tokat pyjore në parkun nacional zënë rreth 41% të sipërfaqes së përgjithshme. Rreth 80-85% të tokës së parkut është pronë shoqërore dhe 15-20% pronë private.

Sipas disa të dhënave të marra nga ekspertë të fushës, shtimi vjetor për Ha në Park është 5 m³, që në fakt për të gjithë sipërfaqen pyjore të Parkut (48%) shtimi vjetor është afërsisht 100,000 m³/Ha.

- Pyjet e ahut (Fagion moesiacae illyricum): 3067.09 ha (68 %)
- Pyjet e përziera të ahut dhe rrobullit: 98.80 ha (2.2 %)

- Pyjet e përziera të ahut, bredhit dhe hormoqit: 95.30 ha (2%)
- Pyjet e rrobullit (Pinetum heldreichi): 450.52 ha (10 %)
- Pyjet e bredhit (Abietum alba): 30.70 ha (0.7 %)
- Pyjet e hormoqit (Picetum excelsae): 5.80 ha (0.1 %)
- Pyjet e përziera të halorëve: rrobulli, bredhi, hormoqi, arneni, hartina: 32.80 ha (0.7 %)
- Kulturat e pishës së zezë dhe të bardhë: 132.62 ha (3 %)
- Kulturat e hormoqit: 6.65 ha (0.1 %)
- Pyjet dhe shkurret e mullezës dhe frashnit të zi (Orno Ostryetum carpinifoliae): 499.15 ha (11 %)
- Vegjet. shkurror i hartines (Pinetum mughi): 73.10 ha (1.6 %)
- Shkurret e verrit dhe lajthisë: 28.96 ha (0.6 %)

Gjithsej: 4521.49 ha (100 %)




▶ Fig: Shpërndarja e pyjeve në ha/për komuna

Mbi 90 % e sipërfaqeve pyjore të territorit të parkut nacional që shtrihet në komunën e Prizrenit dhe Suharekës i takon pronës shtetërore.

Nga analiza e strukturës së pyjeve mund të konstatohet:


- Në territorin e parkut nacional (të komunës së Prizrenit dhe Suharekës) dominojnë pyjet e ahut (Fagion moesiacae illyricum) me 68 %, gjë që është pasojë e kushteve bioekologjike të rajoneve ku ato gjenden.
- Pyjet më të rëndësishme janë të rrobullit (Pinetum heldreichi) për shkak të karakterit endemo-relikt. Këto pyje me sipërfaqe prej 10 % radhiten pas pyjeve të ahut. Pyjet e rrobullit gjenden në malet Oshlak, Koxha Ballkan dhe Pashalare .
- Sipërfaqja e kulturave pyjore (pyjet artificiale të ngritura me anë të pyllzimeve) është e ulët (vetëm 3 %) që nënkupton se në territorin e Parkut Nacional (K. Prizren dhe K. Suharekë) dominojnë (me 97 %) pyjet e llojeve autoktone. Shumica e kulturave pyjore i takojnë llojeve të pishës së zezë dhe të bardhë të cilat janë mbjellur në fillim të viteve të 80-ta në pjesën jugore të Oshlakut të rrezikuara nga erozioni.
- Në aspektin e përbërjes së pyjeve dominojnë pyjet e pastërta (83.5 %) ndaj pyjeve të përziera (16.5 %).



▶ Harta: Mbulueshmëria vegjetative nëpër komuna

Sipërfaqet dhe veçoritë e kullosave - Vegjetacionet barishtore të Parkut Nacional e mbulojnë rreth 50 % të sipërfaqës së tij, nga e cila sipërfaqe shumica është e përshtatshme për kullotjen e bagëtive. Pasi që territori i Parkut gjendet mbi 800 m të lartësisë mbidetare, të gjitha kullosat janë malore, në kuadër të të cilave veçohen dy lloje:

- Kullosat pyjore (kullosat në tokat pyjore deri në 2,000 m)
- Kullosat e maleve të larta (kullosat mbi vegjetacionin pyjor)



▶ Fig.: Shpërndarja e kullosave në ha/për komuna.

Kullosat karakterizohen me mbulesën e pasur barishtore dhe burimet ujore të cilat krijojnë kushte të volitshme për zhvillimin e blegëtorisë. Kullosat nga aspekti i prejardhjes diferencohen në primare dhe sekondare

Kullosat primare kanë karakter të përhershëm dhe nënkuptojnë sipërfaqet e kullosave të cilat janë pasojë e ndikimit të faktorëve klimatik gjatë historisë së zhvillimit të vegjetacioneve në periudhat e ndryshme gjeologjike. Këto kullosa shtrihen mbi vegjetacionin pyjor deri të majet më të larta ku gjendet mbulesa barishtore. Për këtë shkak quhen edhe kullosat e maleve të larta apo kullosat alpike. Këto kullosa përbëhën nga bimët barishtore në kuadër të të cilave dominojnë bashkësitë e barit (*graminae*).

Kullosat primare, gjëgjësisht kullosat e maleve të larta gjenden në terrenet ku mund të zhvillohen vetëm bimët barishtore dhe për shkak të lartësisë së madhe mbidetare dhe kushteve klimatike ato shfrytëzohen vetëm gjatë sezonës verore (prej 15 maj deri 15 shtator). Kufiri i poshtëm i kullosave të maleve të larta nuk është me një nivel të caktuar të lartësisë mbidetare në gjithë territorin e Parkut, por ai dallon varësisht nga relievi, klima, ekspozicioni, veçorive të tokës dhe ndikimi të faktorit njeri. Ky kufi vende-vende fillon prej 1,600 – 2,000 m dhe në disa raste arrinë deri në 2,300m të lartësisë mbidetare. Nga kjo konstatohet se amplituda (apo diferenca) e lartësisë mbidetare të këtyre kullosave është shumë e madhe (afro 700 m) është pasojë e shfrytëzimit ekstenziv të kullosave në këto rajone të Parkut që ka ndikuar në shtyerjen e kufirit të poshtëm të kullosave në dëm të vegjetacionit pyjor.

Kullosat e maleve të larta të Parkut Nacional janë mjaft të pasura me lloje bimore, në kuadër të të cilave veçohen llojet e shumta endemike. Bimët barishtore që gjenden në pjesët e poshtme të këtyre kullosave i takojnë familjeve: Veratrum, Senecio, Aquilegia, Trolius, etj. Ndërsa në pjesët më të larta në zonën e livadheve alpike gjenden llojet e familjeve: Ranunculus, Primula, Androsace, Saxifraga, Silene, Gentiana etj. Llojet më të rëndësishme shkurrore në kullosat e Parkut janë boronica (Vaccinium myrtillus), dëllinja e rëndomtë (Juniperus communis) dhe dëllinja e Siberisë (Juniperus sibirica).



▶ Foto: Kullosat primare

Kullosat sekondare janë sipërfaqet barishtore të cilat janë zhvilluar si pasojë e ndikimit natyror dhe faktorit njeri. Këto janë kryesisht kullosa që banorët i kanë krijuar në tokat pyjore duke shkatërruar pyjet në favor të krijimit të tokave bujqësore (kullosave). Kullosat sekondare shtrihen nën 2,000m lartësi dhe kreysisht shfrytëzohen për kullotjen e bagëtive të banorëve lokal.

Dallimi midis kullosave primare dhe sekondare qendron në faktin se kullosat sekondare kanë destinim të përkohshëm sepse sipas nevojave shoqërore mund të transformohen në pyje apo sipërfaqe të urbanizuara dhe turistike. Kullosat sekondare (kullosat pyjore) janë me sipërfaqe më të vogël dhe me kualitet më të dobët të mbulesës barishtore në krahasim me kullosat primare (kullosat e maleve të larta) si pasojë e shfrytëzimit intenziv nga bagëtitë e banorëve lokal. Kapaciteti i kullosave të maleve të larta është 3 bagëti/ha, ndërkaq 2.5 bagëti/ha për kullosat pyjore. Momentalisht ky kriter nuk plotësohet. Në kullosat e maleve të larta në territorin e Parkut Nacional, gjatë sezonit veror, kullosin afërsisht 2,000 bagëti (dele), si pasojë e zvoglimit të numrit të bagëtive pas vitit 1999.


Pejsazhet natyrore me pyjet dhe kullosat janë karkteristikë e këtij regjioni.

Pasuri e madhe e PN "Mali Sharr" edhe prezenca e disa liqejve glacial në lartësi mbidetare mbi 1,900 m, të cilët përfaqësojnë vlera të veçanta natyrore te Sharrit.

Lumenjtë Lepenc dhe Lumëbardhi i Prizrenit burimet e veta i kanë ne Parkun Nacional dhe paraqesin nje rrejt karakteristik hidrogarfik të pasur me ujë të pastër. Të gjitha këto përbëjnë një pasuri me vlera të larta turistike, kulturore, shkencore dhe edukative.



▶ Foto: Kullosat sekondare



▶ Foto: Rrjedhë lumore


Veçoritë hidrologjike – PN 'Mali Sharr" e karakterizojnë sasitë e mëdha të reshjeve atmosferike të cilat i japin atrakcion këtij territori. Karakteristikë e përgjithshme është se rrjedhjet e ujrave sipërfaqësore, nga burimi deri në grykëderdhje, janë shumë të shpeshta.

Pos rrjedhjeve të shpeshta dhe të pasura, me ujë të përrenjve dhe lumenjve malorë, me numër të shprehur të ujvareve dhe rrjedhjeve të rrëkeve, këtë territor e presin në të gjitha drejtimet. Rajoni i Malit Sharr është i pasur edhe me disa liqej akullnajorë (glacial).

Pothuajse i tërë territori i parkut nacional i takon dy pellgjeve të lumenjve më të mëdhenj – Lepencit dhe Lumbardhit të Prizrenit. Për nga atraksioni i vet dallohet Lepenci përkatësisht degët e djathta të tij të cilat njëkohësisht kalojnë edhe nëpër pjesët më të bukura dhe shtigjet kryesore të skijimit të Malit Sharr.

Lepenci buron dhe krijohet me bashkimin e rrjedhjeve të cilat burojnë nga malet e Cerevës dhe Jezercit. Në rrjedhjen e vetë nëpër territorin e Parkut Nacional atij i bashkangjiten disa degë nga ana e majtë dhe e djathtë. Posaqërisht janë të rëndësishme degët e djathta të përrenjëve dhe lumenjëve siq janë lumi i Thatë, Murzhica me degët e veta tejet atraktive Proska e Dulës, Bllateshtica, lumi i Bollonjskës dhe Kallugjerica. Këta lumenj, degët burimore të të cilëve vijnë nga malet më të larta në pjesët më jugore të parkut nacional, janë të shpejta me një numër të ujvareve dhe rrjedhjeve të rrëkeve.

Derisa rrjedhja e Lepencit zë pjesën më të madhe verilindore të Parkut Nacional, derdhja e Lumbardhit të Prizrenit mbulon pjesët jugperëndimore të tij. Pjesën më të madhe të këtij pellgu lumor, janë degët e majta, të cilat burojnë nga malet e larta të Majës së Zezë, Kobilicës, Kara Nikollës etj, dhe si të tilla rrjedhjet e sipërme të tyre janë shumë të shpejta dhe atraktive. Posaçërisht dallohet dega e proskës së Lubinit me degët e veta.



▶ Harta: Rrjeti hidrografik

Liqenet glaciale paraqesin njërën nga bukuritë më të mëdha të Malit Sharr. Në lartësinë mbidetare mbi 1,900 m ka disa liqej të cilët posaqërisht dallohen sipas bukurisë dhe madhësisë. Këtu vlenë të përmenden para së gjithash Liqeni i Livadicës dhe Liqeni i Jazhincës e pastaj edhe të tjerë si: Liqenet e Gornjasellës, Karanikollës, Miskovës, Bezdankës etj.

Liqeni më i madh është ai i Livadicës, i cili shtrihet nën majën malore me po të njëjtin emër në l.m. prej 2,173 m. Ka formë të zgjatur, me gjatësi prej 230 m, gjerësi 120 m, dhe thellësinë më të madhe prej 7.3 m. Në kohën e verës temperatura e ujit ndonjëherë arrinë edhe deri në 20°C.

Liqeni i Jazhincës shtrihet në pjesën shkëmbore të Sharrit – nën majen e Bistrës. Është më i vogël se Liqeni i Livadicës, ka gjatësinë prej rreth 120m, gjerësinë 80m dhe thellësi deri në 11m.

▶ Foto: Liqeni i Jazhincës i rrethuar me shkëmbinj silikat



- Liqenet e Gornjësellës (i Epërm dhe i Poshtëm), shtrihen mbi burimin e Bistricës së Prizrenit dhe është i madh – gjatësia 100 m, gjerësia 53 m ndërsa thellësia 1.5 m. Ngjyra e ujit liqenor shkon prej të kaltrës deri në të gjelbërt.

Veçoritë peisazhore. – Hapësira e Parkut Nacional përmban tërësinë cilësore dhe tejet të rëndësishme peisazhore të cilën e karakterizojnë një sërë lokalitetesh në viset e larta dhe të mesme malore. Pejsazhet e këtyre viseve paraqiten nëpërmjet faktorëve më cilësor të bukurisë së madhe natyrore sikur që janë malet e larta, kodrat, luginat, lumenjt, ujvaret, shkëmbinjët shkrepor, thellimet e akullnajave, etj. Ndërsa në viset më të ulta të parkut – regjionin e Sredskës dhe Siriniqit, bazën e peisazhit e përbëjnë kulturat e bimëve bujqësore dhe kopshtore.

Por, gjithsesi tërësi më atraktive peisazhore janë sipërfaqet e mbuluara me pyje, barë, livadhet, kullosat dhe formacionet e tjera barishtore, të cilat zënë sipërfaqet ndërmjet lartësive mbidetare mbi 999 dhe 1,500 m. Këtu formacionet e pyjeve (të ahut, arnenit, molikës, bredhit, hormoqit, etj) ndërrohen me formacionet e barishtoreve duke u paraqitur në të gjitha nuancat e ngjyrës së gjelbërt që shkaktojnë përjetim jashtëzakonisht të bukur dhe vizuel të bukurisë natyrore. Përveç asaj ndarja tejet e madhe e reliefit që është krijuar me prerjen e një sërë luginave të lumenjve dhe përrockave në formë të kanioneve dhe grykave me ujvaret e numërta dhe liqenet e shumtë e plotëson përjetimin e plotë të kësaj natyre autentike të bukur dhe të paprekur.

Përveç kësaj në pjesët e uëlta të Sharrit, gjatë verës në livadhe lulëzojnë lulet malore me ngjyra të ndryshme duke i dhënë peisazhit atraksion dhe bukuri të jashtëzakonshme e hapësirës aromë dhe freski të posaçme të natyrës së pastër.



▶ Foto: Pejsazh në stinën e vjeshtës

Përjetim të jashtëzakonshëm vizuel të bukruisë natyrore Mali Sharr ofron në stinën e vjeshtës – në kohën e krijimit të peisazhit kalues malor kur i tërë territori mbulohet me të gjitha ngjyrat e spektrit, si dhe në pranverën e vonshme kur në viset e ulta harliset vegjetacioni bimor duke e mbuluar tërë territorin në gjelbërim, ndërsa majat e larta të Lubotenit, Bistrës dhe maleve tjera edhe më tutje janë nën mbulesën e bardhë të borës.

1.2. Zonat e Parkut sipas shkallës së mbrojtjes[5]

Sipërfaqja e parkut nacional sipas shkallës së mbrojtjes së zonave ndahet në:

I. Zona e parë e mbrojtjes

Zona e parë përfshinë pjesët e territorit të parkut me veçori natyrore të jashtëzakonshme, me lloje të rralla, të rrezikuara të bimëve dhe shtazëve dhe tipave të vendbanimeve në kushte të natyrës së egër. Kjo zonë gëzon karakterin e mbrojtjes strikte.

II. Zona e dytë e mbrojtjes

Zona e dytë - menaxhimi aktiv përfshinë pjesët e territorit të parkut që karakterizohen me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes

III. Zona e tretë e mbrojtjes

Zona e tretë – e shfrytëzimit të qëndrueshëm përfshinë pjesët e territorit të parkut ku mund të bëhet : ndërtim, rindërtim, mbrojtje të objekteve tradicionale dhe rekreacion, turizëm dhe nevoja të banorëve në territorin e parkut si dhe shfrytëzim të kullosave dhe shfrytëzim ekonomik i të mirave të natyrës sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës si dhe në harmoni me ligjet përkatëse dhe Planin Hapësinor të parkut.

1.2.1. Rezervatet strikte natyrore

Brenda territorit të Parkut Nacional „Mali Sharr" ekzistojnë këto zona me status të rezervatit të mbrojtur: Koxhaballkani (Pisha e madhe), Oshlaku, Maja e Arnenit (Prevalla) dhe Rusenica.

Maja e Arnenit (ish Popovo prase) - përbëhet nga pyjet e pastërta të Rrobullit (*Pinetus heldreichii*), gjendet në Prevallë (pjesa lindore e Oshlakut). Është vënë nën mbrojtje në vitin 1960 me sipërfaqe prej 30 ha. Në këtë lokalitet gjenden pyjet e llojit endemik dhe relikt terciar të rrobullit (*Pinus heldreichii*). Ky rezervat kërkon trajtim adekuat për ruajtjen e vlerave (pas zjarrit të disa viteve më parë), përndryshe do ta humbë vlerën si rezervat natyror i mbrojtur me ligj.

Oshlaku - është i pasur me pyje të pastërta të rrobullit (*Pinetum heldreichii*). Mali Oshlak është i pasur me bimë të shumta endemike. Karakteristikë e veçantë në kodrën e Oshlakut është lloji stenoendemik i Achillea alexandri - regis që gjendet kryesisht në pjesët e larta malore. Vlenë të përmenden me këtë rast bashkësitë bimore: *Achilleo – Pinetum mugo* (*Pinetum mugo calcicolum*) dhe *Achilleo alexandri – regis*. Nga fauna e begatshme veçohet dhia e egër (*Rupicapra rupiapra*), e cila gjendet në kullosat më të larta të Oshlakut, ndërsa nga kafshët e egra që kanë përhapje më të madhe janë: ariu i murrmë, ujku, kaprolli, shpendë të ndryshëm grabitqar etj. Ky rezervat është vënë nën mbrojtje në vitin 1960 me sipërfaqen prej 20 ha.

Pisha e Madhe - është lokalitet ku ndodhen pyje të pastra të rrobullit (*Pinetum heldreichii*). Ky rezervat shtrihet në shpatijet juglindore të Koxha Ballkanit ku gjenden pyjet e vjetra të rrobullit të cilat formojnë bashkësinë bimore Seslerio autumnalis– Pinetum heldreichi, të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të arnenit në Gadishullin Ballkanik. Ky rezervat natyror është shpallur në vitin 1960.me sipërfaqe prej 35 ha.

Rusenica është vendbanim i rrëqebullit ballkanik (*Lynx Lynx balcanicus*) i cili është lloj i rrallë dhe i rrezikuar. Me qëllim të mbrojtjes së vendbanimit të rrëqebullit, i cili në vitet e 90 – kanë numëruar rreth 13 copë, Rusenica është rezervati më i vjetër natyror i shpallur që në vitin 1955 me sipërfaqe të mbrojtur rreth 300 ha. Ky lokalitet është i rëndësishëm edhe nga aspekti peisazhor dhe floristik ku veçohet lloji i panjës malore (*Acer heldreichii).*

1.2.2. Zonat me vlera të veçanta natyrore

Në kuadër të Parkut Nacional "Mali Sharr" ekzistojnë disa zona me vlera të veçanta natyrore, të cilat meritojnë të hyjnë në kategorinë e rezervateve natyrore strikte:

[5] Arësyeshmëria shoqërore e shpalljes së pjesës së Malit Sharr në Kosovë për park nacional, Enti për Mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë, 1982

Pashallarë (Ostrovica) – lokalitet i maleve të larta (1,600m-2,092m), në serpentinë me pyje të pastërta të rrobullit, arnenit dhe pyjet e ahut. Ky masiv malor veçohet me fondamentet gjeologjike nga serpentina në të cilën zhvillohen vegjetacionet e rralla dhe specifike të maleve të larta. Në shpatijet veriore dhe veriperëndimore të Pashallarës, gjenden bashkësitë e rralla pyjore, ku në pjesët e ulëta veçohen bashkësitë me rrobull: *Junipero – Pinetum heldreichii (Bruckenthalio – Pinetum heldreichii), Pinetum – heldreichii serpentinicolum, Pinetum – heldreichii peucis scardicum* si dhe bashkësitë e ahut në serpentinë. Mbi këtë bashkësi e deri te majet më të larta, gjendet vegjetacioni specifik në serpentinë i hartinës *Pinetum mugo serpentinicum*. Këtyre bashkësive të lartëpërmendura vlerë të posaçme u jep lloji endemik *Bornmuellera–dieckii*. Pyjet e rrobullit në serpentinë paraqesin fenomen të veçantë natyror në vegjetacionin e Ballkanit, ndërkaq edhe bashkësitë e hartinës në serpentinë janë shumë të rralla.

Koplica është rajon gëlqeror i maleve të larta, me florë dhe faunë mjaft të rrallë. Masivi gëlqeror me vegjetacion të rrallë kalcifil dhe hezmofitë (bimë të adaptuara për jetë në tokë të varfër dhe të pazhvilluar) ku veçohet lloji *Hieraacium kabilicanum*.

Rajoni i burimit të Lumbardhit është Cirku silikat akullnajor i maleve të larta dhe me dy liqej të vegjël. Ky regjion karakterizohet me vlera të posaçme ekologjike, gjeologjike, biologjike dhe peisazhore. Në kuadër të këtij rezervati gjendet rrjedha e epërme e Lumbardhit të Prizrenit, dy liqej (të Gornjasellës) me gjurmë të qarta glaciale dhe me florë të pasur endemike ku veçohen llojet: *Pinguicla balcanica, Alysum scardicum, Crocus scardicus* dhe reliktet glaciale *Anemone narcissiflora* dhe *Draba doerfleri* etj.

Luboteni është maja më e lartë në pjesën lindore të Maleve të Sharrit në lartësi mbidetare 2,496 m. Është karakteristike se përbërja gjeologjike e saj është kryesisht gëlqerore, e që kjo e bënë të dallohet nga pjesët tjera zingjirore me përbërje gjeologjike nga silikati. Në kuadër të florës këtu gjenden dhe janë konstatuar 649 lloje të bimëve vaskulare të grupuara në 81 familje në mesin e tëcilave ka edhe lloje të rralla. Ndërsa, sa i përket vegjetacionit janë konstatuar 21 asociacione bimore.

Livadhi i mbretit – Liqeni i Jazhincës - shtrihet në pjesën shkëmbore të Maleve të Sharrit nën Majën e Bistrës. Përveç Liqenit (me gjatme gjatësi 120 m, gjërësi 80 m dhe thellësi 11 m), në këtë zonë gjinden këto bashkësi bimore: *Fagetum Montanum, Seslerio automnalis – Pinetum heldreichii, Ajugo – pinetum peucis etj*. Në pjesët më të larta të këtij lokaliteti gjenden këto bashkësi: *Rhododendron – Pinetum peucis*, një lloj dëllinje (*Juniperus sp.*) etj. Ndërsa në pjesët e epërme bashkësitë e bimëve barishtore si *Ranunculetum crenati scardicum* dhe *Potentillo doerfleri – Juncetum trifidi*. Këto bashkësi kanë vlera shkencore dhe edukative.

▶Foto: Maja e Lubotenit



1.3. Zonat e Veçanta të Mbrojtura

Janë kategori hapësinore të cilat në detaje janë të përshkruara në Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Ligji në fjalë është pjesë përbërëse e Pakos së Ahtisarit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës në qershor të vitit 2008. Sipas Ligjit, në territorin e Kosovës janë identifikuar 45 zona të tilla që kryesisht i përkasin trashëgimisë kulturore ortodokse.

Këto zona janë me kufij të ndryshëm, të ndara në tri grupe, të cilat janë me karakteristika të ndryshme.


1. Në Grupin I-rë bëjnë pjesë zonat kufiri i të cilave është caktuar me anë të hartave.
2. Në Grupin II-të bëjnë pjesë zonat të cilat kanë një bufer zonë prej 100m' nga perimetri i tyre.
3. Në Grupin III-të bëjnë pjesë zonat të cilat kanë një bufer zonë prej 50m' nga perimetri i tyre.

Këto zona kanë të caktuara kriteret sipas të cilave përcaktohen:


Aktivitetet e ndaluara brenda tyre - të cilat kanë të bëjnë kryesisht me: ndërtimet e objekteve industriale, digave (pendave), centraleve elektrike, furrave, fabrikave, rrugëve tranzite në zonat rurale dhe ndërtimeve që bëjnë shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit të asaj zone.

Aktivitete të kufizuara brenda ZVM - kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimet e objekteve eventuale me etazhitet më të lartë se monumenti që duhet mbrojtur, ndërtimet e rrugëve, punëtorive, restoranteve, hoteleve, klubeve të natës, pompave me karburante të naftës, riparimet e automjeteve, vetëshërbimet, tubimet publike dhe urbanizim të tokës bujqësore.





Në kuadër të territorit të PNMSH-së kemi vetëm Manastirin e Treshit të Shenjtë, si zonë e veçantë e mbrojtur. Kjo zonë i takon komunës së Suharekës, në afërsi të fshatit Mushtisht. Në bazë të ligjit për ZVM, Manastiri i takon grupit të dytë me bufer zonë prej 100m'. Të gjitha aktivitetet e kufizuara dhe të ndaluara do t'i referohen Ligjit për ZVM dhe PH për PNMSH.




1.4. Gjendja mjedisore e parkut

1.4.1 Ndotja dhe degradimi – Në territorin e PN nuk ka monitorim të mjedisit, për këtë arsye kemi mungesë të informatave, sa i përket shkalles së ndotjes të elementeve mjedisorë (ajrit, ujit dhe tokës) brenda Parkut.

Degradimi i pyjeve, është më e shprehura si dukuri negative, ku si shkaktar kryesor janë prerja ilegale dhe djegëjet. Kështu pyjet e rrobullit që shtrihen në pjesën e Oshllakut, Koxhaballkan dhe Pashallare me siperfaqe prej 10 %, janë të dëmtuara si pasojë e zjarrit pyjor të vitit 2000 dhe zhvillimit intenziv të insekteve dëmtuese që janë shfaqur në mënyrë masive pas djegëjes. Në kuadër të saj tërësisht të dëmtuara janë 4.5 %. Ndërsa sipërfaqet me pyje të ulta dhe shkurre janë të dëmtuar për rreth 45 % si pasojë e prerjes së pakontrolluar. Nga kjo dukuri, në komunën e Suharekës, në rajonin e Dellocit dhe Mushtishtit, janë degraduar pyjet e ahut me rreth 20 ha.

Degradimi i tokës është i shprehur në disa pika në kuadër dhe përreth Parkut, në formën e grryerjës së sipërfaqës së tokës dhe përpunimit të mëtutjeshëm të këtij materiali. Kjo formë e intervenimit është shumë e dëmshme për shkak se: dëmton konfiguracionin e terrenit, e shkatrron pejsazhin dhe cka është më e rëndësishmja për shkak të zhurmës së krijuar, ndikon në largimin dhe zhdukjen e florës dhe faunës. Në bazë të hulumtimit u vërtetua se në kuadër ose në afërsi të Parkut (sipas shënimeve të mbledhura të vitit 2002, 2004 dhe 2007) ekzistojnë trembëdhjetë gurëthyes që dallojnë për nga madhësia dhe teknika e shfrytëzuar. Momentalisht pjesa më e madhe e tyre e kanë shuar aktivitetin duke i përjashtuar dy prej tyre që ende funksionojnë. Fjala është për gurëthyesin që ndodhet në pjesën veriore të Rezervatit të Rusenicës (fillimi Grykës së Rusenicës), në largësi prej 1.5 km në JP të fshatit Mushtisht që si territor i takon komunës së Suharekës. Dhe, gurëthyesi tjetër që gjendet rrëzë malit Oshlak, në afërsi të fshatit Gornjasella, në të majtë të rrugës Prizren – Shtërpcë, në largësi prej 250 metra nga rruga në brendi të Parkut dhe si territor i takon komunës së Prizrenit.




▶ Harta – Pozita e gurthyesve aktiv

1.4.2. Zonat e rrezikuara nga erozioni.- Harta erozive e Kosovës tregon se në Parkun Nacional përfshihen disa sipërfaqe nga erozioni me shkallë të ndryshme të intenzitetit. Sipërfaqet me erozion shumë të fortë prej 1.400 ha (ose 6%) dhe erozion të fortë me 5.600 ha (ose 24%) janë zonat më të rrezikuara, në të cilat sasia më e madhe e materialit eroziv është gjithsej 16.100.000m³/vit.

Zonat që nuk janë të mbuluara me vegjetacion bien nën ndikim të faktorëve ekzogjen nga alterimi fizik, kimik dhe biologjik dhe në këtë mënyrë shkaktohet rritja e shkalles së erozionit.

Bartja dhe akumulimi i materialit eroziv ndahet ne dy pellgje kryesore lumore: Lepenci në drejtim të Rrafshit të Kosovës dhe Lumbardhi i Prizrenit në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit.

Në bazë të të dhënave në tabelë ne shkallë te lartë janë të rrezikuar ¼ e territorit të PN "Mali Sharr" ose 25% e sipërfaqes së përgjithshme.



Kategoria e erozionit	Produkti mesatar i erozionit m³/km²/vit	Siperfaqja ha	%	Sasia e eroduar m³/vit
Shumë e fortë	3.500	1.400	6	4.900.000
E fortë	2.000	5.600	24	11.200.000
E mesëm	1.000	7.700	35	7.700.000
E dobët	400	8.000	35	3.200.000

▶ Harta :Kategoritë erozive në Parkun Nacional "Mali Sharr"

1.4.3. Vegjetacioni - Territori i Parkut Nacional "Mali Sharr" dallohet me begati të florës dhe me shumë breza vegjetativ të cilët janë në pajtim me ndërrimin e lartësive mbidetare, me begati në bashkësi të rralla endemike të pyjeve dhe livadheve. Këtu hasen lloje të ndryshme si dushku *Quercus*, ahu *Fagus moesiaca,* bredhi, hormoqi, pisha e bardhë, pishat endemike dhe relikte të maleve të larta: rrobulli (*Pinus heldreichi*) dhe arneni i bardh (*Pinus peuce*) si dhe pisha e maleve të larta kërleka (*Pinus mugo*). Në kuadër të këtyre përbërjeve pyjore përveç numrit të madh të llojeve drunore të cekura haset edhe panja malore endemike (*Acer heldreichii*), si dhe lloji drunor, tejet i rrallë dhe gati i zhdukur nga këto male, bresheu i rëndomtë (*Taxus baccata*) dhe shumë lloje tjera të rëndësishme drunore dhe barishtore.

Vegjetacioni i PN "Mali Sharr" në përhapjen vertikale përputhet me llojshmërinë e përgjithshme të verifikuar dmth. se përbërja e saj ndërron me ndërrimin e lartësive mbidetare me ç'rast diferencohen brezat vegjetativë:

Territori kodrinor termofil i pyjeve të dushkut - *Quercus troyana (Bulgri), Q. Conferta (Shpardhi), Q. Cerris (Qarri), Q. Pubescens (Bungbuta), Carpinus orientalis (Shkoza e zez*ë), etj.


Territori kalues termofil i bungut - *Quercus petrea (Bungu) dhe Carpinus betullus* etj. pjesërisht është përfshirë në kuadër të Parkut Nacional. Në kuadër të këtij territori dominojnë pyjet e bungut qarrit dhe shkozëbardhës, një numër i madh i llojeve të tjera drunore si: murrizi, dardha e egër, shikakuqi, etj.

Territori mezofil i pyjeve të ahut (*Fagus moesiaca*) – Në kuadër të territorit të vet të përhapjes paraqitet në dy grupe asociacionesh dhe atë: bashkësia kodrinore e ahut (*Fagetum montanum*) dhe bashkësia e bredhit dhe ahut (*Abieto-fagetum*), ndërkaq në viset më të larta paraqitet hormoqi. Bashkësitë e ahut janë të zhvilluara gati në tërë territorin e parkut duke përfshirë lartësitë mbidetare ndërmjet 900 – 1500 m, kurse në disa vende nuk është sa duhet i përfaqësuar siq është rasti në ekspozicionin jugperëndimor të masivit të Oshlakut.

Vegjetacioni halor pyjor frigorifil i lartë malor – Ky territor vegjetativ i kësaj lartësie në PN "Mali Sharr" përbëhet prej bashkësive endemike të pishave malore endemo-relikte të molikës (*Pinus peuce*) dhe rrobullit (*Pinus hedreichii*), të cilat nga shumë aspekte janë të rëndësishme. Këto bashkësi më mirë janë ruajtur në Shtëpia e Stojkut dhe në Koxha Ballkan (ose Pisha e Madhe), Ujërat e Humbura (Gine Vode), Maja e Arnenit (Popovo Prase), Oshlak, dhe Pashallarët (Ostrovicë).

▶ Foto: Quercus petrea (bungu)





▶ Harta :Vegjetacioni i pyjeve (i lartë) dhe kullosave (i ulët) në Park.

Vegjetacioni kalues shkurror i kërlekës së maleve të larta – Përbërjet e kërlekës (Pinus mugo) janë të ruajtura vetëm në Koxha Ballkan, Oshlak dhe Ostrovicë, ku kjo pishë malore tejet interesante paraqitet në formë të bashkësisë, ndërsa në pjesët tjera ku nuk është kërleka, janë prezente llojet e tjera shkurrore, e në mes tyre dëllinja e Siberisë (Juniperus nana) dhe një lloj i rëndësishëm Rhodrodendron ferrugineum (Rododendroni ngjyrëndryshku), Bruckhenthalia spiculifolia, Erica carnea etj. Kësisoj kjo zonë është tejet e pasur me bashkësi të rëndësishme në mes të cilave cekim bashkësinë endemike Bruckhenthalion etj.



▶Foto: Nardus stricta (Xhufka)

Vegjetacioni barishtor dhe shkurror i maleve të larta – Ky territor vegjetativ i livadheve dhe kullosave malore dhe kullosave të larta me sipërfaqe prej 16.170.00 ha, është tejet i pasur me bashkësi të rëndësishme bimore. Në kullosat e larta malore, duke marrë parasysh mënyrën ekstenzive të shfrytëzimit, dominojnë bashkësitë e xhufkës (Nardus stricta), si pasojë e sukcesionit negativ. Posaqërisht janë të rëndësishme bashkësitë e bimëve të cilat janë zhvilluar në lartësi më të mëdha, ku më tepër dominojnë elementet e florës sarkto-alpike. Për nga aspekti fitocenologjik, në kuadër të kullosave të PN "Mali Sharr", duhet të diferencohet territori i livadheve dhe kullosave malore sepse, pikërisht në këtë zonë faktori antropogjen historikisht me prerjen e pyjeve e ka ndërruar përbërjen e mëparshme të bashkësisë, në esencë është ndërruar përbërja fitocenologjike.



Foto: Telekia speciosa (Tekelia)


1.4.4. Flora

Për nga aspekti floristik, PN "Mali Sharr" bën pjesë në malet më të begatshme të Gadishullit Ballkanik. Këtu vërehet prezenca e një numri të llojeve drunore endemike dhe relikte, siç janë arneni i bardh (Pinus peuce) rrobulli (Pinus heldreichii), panja malore (Acer heldreichii), bresheu i rëndomt (Taxus baccata), kërleka (Pinus mugo), lloj i rëndësishëm për pyllëzimin e sipërfaqeve të eroduara si dhe Rododendra ferrigineum (Rododendroni ngjyrëndryshku).

Në rajonin e lartë malor, duhet të përmenden llojet e rëndësishme të maleve të larta, areali i të cilave është i lidhur, kryesisht për malet e larta të Europës jugore dhe të mesme (Alpe, Apenine, Karpate, Pirinej, Tatra). Kështu prej këtyre llojeve do të ceken: Trollius europaeus (Troli europian), Ranunculus montanus (Zhabinorja malore), R. Thora (Zhabinorja tora), R. Crenatus (Zhabinorja ura-ura), R. Oreophylus (Zhabinorja maledashëse), Dianthus sylvestris (Karafili pyjor), Daphnea alpine (Xërxelja alpine), Rhodondrendron ferrugineum (Rododendroni ngjyrëndryshku), Draba retush (Draba e cunguar), Salix retush (Shelgu i fletëtopitur), S. Reticulate (Shelgu i rrjetëzuar), Empetrum hermafroditum (Empetri), Dryas octopetala (Driada tetëpetalëshe), Geum reptans (Mlaka zvarranike), G. Montanum (Mlaka malore), Saxifraga oppositifolia (Iriqëza gjethekundrejtë), S. Marginata (Iriqëza arëtore), S. Aizoon (Iriqëza si thonjë), S. bryoides, S. tymosa, Gentiana verna (Genciana pranverore), G.

Nivalis (Genciana), Junkus trifidis (Kulmaku i çarë tresh), Elyna myosuroides, Carex rupestris (Presja), Carex curvula, Craex foetida, carex tigra (Presja e zezë), Poa minor (Flokëza e vogël), Avena versicolor (Tërshëra) dhe shumë lloje tjera.

Llojet bimore mjekësore janë: Achillea millefolium (barpezmi mijëfletësh), Arctostaphilos uva – ursi (rrush arushe), Atropa beladona (helmarina), Hypericum perforatum (lulebalsami), Thymus serpyllum (zhumbrica), Veratrum album (shtara e bardhë), Gentiana punctata (lloji i sarëzës) etj.



▶ Foto; Ahillea millefolium (Barpezmi mijëfletësh)

Përkundrejt llojeve bimore që janë banorë të viseve të larta, ku bimët zhvillohen thuaja se në borë, në pjesët e ulta, si pasojë e veprimit të mesdheut, përgjatë Lumbardhit të Prizrenit, respektivisht Grykës së Kaçanikut, në po këtë mal jetojnë edhe lloje të tjera siç janë: Salvia officinalis (Salvia officinalis), Ruta divaricata (Ruta), Teucrium podium (Arrësi barëmajasëlli), Asparagus acutifolius (Ferrëmiu), Pistacia terebinthus (Bafra), Koeleria splendens (Këleria e shëndritshme), Asineuma limonifolium, Stipa mediterannea (Pendëkaposhi mesdhetar), Parentucella latifolia (Parenticella gjethegjërë), Linaria pelliseriana (Linaria e peliserit), Thesium divaricatum (Armiza e stërhapur), convolvulus elegantissimus (Derdhja), Centaurea deusta (Kokoçelli), Linaria annua (Linaria) e tjera.

E gjithë kjo që është cekur me specifitetet dhe begatinë e florës së PN "Malit Shar", flet për rëndësinë e jashtëzakonshme të tij në aspektin floristik. Sigurisht, është për të besuar se regjistri mbi llojet bimore do të jetë shumë më i pasur dhe i plotësuar krahas me përparimin e hulumtimeve të ardhshme të botës bimore në PN "Mali Sharr".



▶ Foto: Arctostaphyllos uva-ursi (Rrush arushe)

Disa lloje bimore karakteristike në PN "Mali Sharr":
Llojet e karafilëve: Dianthus scardicus, D. integer, D. gracilis
Llojet e zhabinoreve: Ranunculus incomparabilis
Llojet e minuartes: Minuarta graminifolia, M. bosniaca, M. verna
Llojet e sileneve: Silena saxifraga, S.schuckerii, S.asterias
Llojet e groshlave: Cardamine carnosa, C.barabaroides
Lloji Arabis alpina
Lloji i kripshtit: Alysum corymbosum. Alysum scadicum
Llojet e drabave: Drbakorabensis, Draba scardica
Llojet e vjollcave: Viola grisebachiana, V.gracilis, V.orphanidis
Llojet e krimbsit: Sedum macelense, S.flexuosum, S.grisebachii gurshpueset: Saxifraga scardica, S.porophylla, S.glabella tërfilët: Trifolium pseudomedium, T.pingnathii, T.velenovsky
Lloji: Panicica serbica
Lojet e kromave: Knautia drymeia, K.dinarica
Llojet e rrillpeshkut Verbascum scardicollum, Verbascum longifolium ramonda: Ramondia serbica
Trumëzat: Thymus albanus, Th.rohlenae, Th.jankae
Lule zambaku: Lilium albanicum etj.



▶ Foto: Draba e Korabit (draba korabensis) - bimë stenoendemike

Një gjendje kësisojë floristike e Malit Sharr obligon që seriozishtë të mendohet rreth mbrojtjes më efikase të gjithë këtyre llojeve të rëndësishme bimore në të.

1.4.5. Fauna (më gjërësisht për llojet në Shtojca 1)

Territori i Sharrit me biotopet e ndryshme është shumë i pasur në pikëpamje faunistike. Në të janë prezentë lloje të veçanta të shtazëve, të cilat ekskluzivisht janë të lidhura për biotope specifike, që d.m.th. se përhapja e tyre është e ngushtë dhe i përkasin llojeve endemike. Ndërsa llojet e tjera që hasen në biotope të ndryshme janë të përhapjes së gjerë. Fauna e Sharrit dhe në përgjithësi fauna e Kosovës deri sot nuk është hulumtuar sa duhet., deri më tani janë evidentuar: 7 lloje peshqish, 9 lloje amphibie, 10 lloje reptil, 154 lloje shpend dhe 30 lloje gjitarësh.

Peshqit (Pisces) - Territorin e Sharrit e karakterizojnë rrjedhjet e proskave dhe lumenjve malor që i takojnë lumenjve te pellgut te Adriatikut. Në bazë të njohurive të gjertanishme në këto rrjedhje jetojnë këto lloje të peshqve trofta e proskave (Salmo trutta m.faro L.), mustaku i proskave (Barbus fluviatilis Ag.), ngjala (Anguilla vulgaris), mlyshi (Esox lucius), krapuliqi, krapi (Cyprinus carpio), perka (Perca fluviatilis).

Ujëtokësorët (Amphibia) - Në rajonin e Sharrit prezantohen me llojet: Picrraku(Salamandra maculosa), picrraku i zi (Salamandra atra), tritoni i zakonshëm (Triturus vulgaris), thithëlopa (Bufo bufo), thithëlopa e gjelbër (Bufo viridis), gargaliqi (Hyla arborea), bretkoca e pyllit e kuqërremët (Rana temporaria), bretkoca kërcimtare (Rana dalmatina), bretkoca e përrenjëve (Rana graeca)

Zvarranikët (Reptilia) - breshkujza (Emys orbicularis), breshka tokësore (Testudo graeca), hardhuca e gjelbër (Lacerta viridis), hardhuca e mureve (Lacerta muralis), hardhuca e përhimë (Lacerta agilis), gjarpri i madh i ujit (Natrix natrix), gjarpri i vogël i shiut (Natrix tesselata), nepërka (Vipera ammodytes), neperka e malit (Vipera berus), kokëzogëza (Anguis fragilis)

Gjitarët (Mammalia) - Fauna e gjitarëve të Rajonit te Sharrit është e përfaqësuar gati me të gjitha llojet të cilat jetojnë në Kosovë, si dhe ca lloje të cilat me ekologjinë e tyre janë të lidhura ekskluzivisht me biotopet e viseve të larta malore, ndërsa llojet tjera janë të përhapjes së gjerë. Kështu mund të konstatohet se Sharrin e karakterizojnë edhe lloje endemike të gjitarëve.

Insektngrenes (Insectivora) - iriqi (Erinaceus europeus), urithi (Talpa europae), rrëmihësi i randomët (Sorex araneus). Brejtës (Rodentia): lepuri i fushes(Lepus europaeus), miu bizam (Ondatra zibethica), miu i fushes (Arvicola terrestris), miu i shtepisë (Mus musculus), miu me vija (Apodemus agrarius), miu i pyllit (Apodemus silvaticus), gjeri i madh (Glis glis), gjeri i lajthive (Muscardinus avellanarius), ketri (Scirius vullgaris), qeni i verbër (Spalax monticola) , Cricetus vulgaris, Cricetus cricetus, Castor fiber.

Mishngrënës (carnivora) - Rrëqebulli (Lynx lynx), ariu i murrme (Ursus arctos), ujku (Canis lupus), dhelpra (Canis vulpes), macja e eger (Felis silvestris), baldosa (Meles meles), zardafi (Martes martes), fishnjari (Martes foina), lundërza (Lutra lutra), bukla e vogel (Mustela nivalis), qelbesi (Putorius putorius).



▶ Foto: Rrëqebulli (Lynx lynx)

Jopërtypësit: derri i egër (Sus scrofa), Ripërtypësit: kaprolli (Capreolus capreolus), dhia e egër (Rupicapra rupicapra). Duhet thënë se lakuriqët (Chiroptera) të cilat jetojnë në këtë territor deri tani askush nuk i ka studiuar, prandaj nuk dihet numri i llojeve të cilat aty jetojnë.


Shpendët (Aves) – Shpendët e Sharrit paraqiten në të gjitha biotopet, ndërsa numri i llojeve dhe populacioneve të tyre i tejkalon të gjitha klasat e tjera të faunës me përjashtim të insekteve.

▶ Tabela: Përbërja e ornitofaunës së Sharrit

Rendi	Fam	Lloje
FALCONIFORMES	2	26
GALLIFORMES	1	6
CHARADRIFORMES	3	6
COLUMBIFORMES	1	5
CUCULIFORMES	1	1
STRIGIFORMES	2	8
CAPRIMULGIFORMES	1	1
APODIFORMES	1	1
CORACIFORMES	4	4
PICIFORMES	1	10
PASSERIFORMES	22	86
Gjithsej: 11	39	154



▶ Foto: Gypaetus barbatus (cofëtinëngrënësi me mjekër)


Suhareka
Gryka e Rusenicës
Shtërpca
Lepenci
Golem Bor
Oshllaku
Maja e Arnenit
Prizreni
Bistrica e Prizrenit
Dragashi
Ferizaj
Kaçaniku
Lumi i Kaqanikut
Lumi i Bladnes
Regebulli
Skifteri i përhirtë
Ariu i Murrmë
Turtulli
Pupëza
Pula e pyjeve
Dhia e egër
Kaprolli
Huti i madh
Gyps fulvus
Shlliga
(Gjarpër helmues)
Skifteri i maleve
0 1.5 3 6 9 12 Km
VERIU
PLANI HAPËSINOR I PARKUT NACIONAL "MALI SHARR"
PROFILI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR
Harta: Fauna
MINISTRIA E MJEDISIT DHE E PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA
Instituti për Planifikim Hapësinor Institut za Prostornog Planiranje Institute for Spatial Planning
LEGJENDA
Parku Nacional "Mali Sharr"
Rezervat natyror
Kufi komunal
Kufi ndërshtetëror
Lumë
Shtrirja e llojit të veçantë të faunës

1.5. Gjendja ekonomike e parkut

Me shpalljen e Malit Sharr si park nacional, është kontribuar në mbrojtjen e organizuar dhe gjithashtu shfrytëzimin e vlerave të parkut, para së gjithash për turizëm. Ekspertët e Organizatës Evropiane mbi bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik (OECD, 1968) hulumtuan mbi mundësitë e zhvillimit të turizmit dimëror në ish Jugosllavi.

Në Parkun Nacional zhvillohet një numër i aktiviteteve në të mirë ekonomike. Disa nga aktivitetet të cilat do të kenë ndikim më të madh në shfrytëzimin, rregullimin dhe planifikimin e territorit të parkut do të trajtohen.

1.5.1. Ekonomia turistike – Kjo ekonomi ngërthen në vete gjithë veprimtarinë që është në funksion të zhvillimit të turizmit në zonën e parkut nacional. Në kuadër të hapësirës e cila hyn në Parkun Nacional "Mali Sharr" zhvillohen aktivitete të llojllojshme turistike – rekreative në sezonën dimërore dhe verore.

1.5.2. Veprimtaria bujqësore dhe blegtorale – Një pjesë e sipërfaqes së territorit të parkut nacional shfrytëzohet për veprimtari bujqësore dhe blegtorale, sidomos pemëtaria dhe prodhimi i bulmetit. Këto veprimtari kultivohen në masë më të madhe për konsum familjar. Shumica e banorëve merren me veprimtari jobujqësore, kurse bujqësia dhe blegtoria për shumë familje është vetëm ekonomizim plotësues. Djathi dhe qengji i malit Sharr njihen si specialitete joshëse të këtij territori.

Sipërfaqja e kullosave përfshin 35.4% nga sipërfaqja e përgjithshme e parkut nacional. Pjesa më e madhe e tyre është pronë shoqërore.

Sipërfaqja e përgjithshme e tokës së kultivuar përbën 18.1% nga sipërfaqja e përgjithshme e parkut nacional. Pjesa më e madhe e saj është në pronësi private (93.3%) dhe pjesa tjetër në pronësi shoqërore (6.7%). Pjesa më e madhe e këtyre sipërfaqeve i përket livadheve (58.8%), pastaj arave dhe kopshteve (38.2%) ndërsa vreshtave dhe pemishteve u takon 3%.

1.5.3. Veprimtaria pyjore – Një pjesë e pyjeve të pronarëve privat përdoret për dru zjarri. Lënda drusore e këtyre anëve shfrytëzohet në mënyrë të pakontrolluar për përfitime ekonomike vetanake. Shfrytëzimi i pakontrolluar i pyjeve ka ndikuar edhe në zbritjen e kufirit të sipërm pyjor.

Pyjet private, në të shumtën, janë pyje të ulëta, të llojeve të bungut, të mbetura në terrene të pjerrëta.

Para vitit '99, disa sipërfaqe të vogla të cilat dallohen dhe janë të rëndësishme për nga aspekti shkencor dhe - arsimor janë shfrytëzuar për aktivitete shkencore - hulumtuese dhe edukative të punëtorëve shkencorë, studentëve dhe nxënësve (studime të bimëve mjekuese, këpurdhave dhe pemëve të tjera pyjore).

1.5.4. Turizmi

Turizmi është një nga veprimtaritë më komplekse të shoqërisë së sotme moderne. Në vendet e zhvilluara ai ka marrë formën e një industrie të plotë me të cilën ndër-veprojnë dhe janë të lidhura ekonomia, politika, kultura dhe të gjitha veprimtaritë njerëzore.

Llojet e turizmit të cilat zhvillohen në masivin e Sharrit janë: turizmi malor, dimëror, veror, rural, aktivitetet në natyrë, turizmi shëndetësor, turizmi alpinist, ekskursionet turistike.

Zona turistike e Sharrit është policentrike, Prizreni, Ferizaji, Shtërpca, Kaçaniku, Dragashi dhe Suhareka, që kanë pozitë të përshtatshme komunikimi në pikat e rëndësishme turistike.

Ndërmjet këtyre tri hapësirave kemi hapësira me mundësi të shijimit të natyrës së paprekur, ekskursione ditore të vizitorëve.

Para vitit '99 - Kosova me sakrifica të mëdha krijoi potencialet e ekonomisë turistike në Brezovicë. Ajo në Brezovicë ndërtoi kapacitete kapitale hoteliere – turistike, duke plotësuar infrastrukturën e nevojshme përkatëse turistike dhe për këto qëllime orientoi gati 1/5 e investimeve të përgjithshme të parapara për ndërtimin e bazës ekonomike të turizmit në Kosovë. Mirëpo si pasojë e zgjatjes së procesit të privatizimit të ndërmarrjeve publike, këto kapacitete nuk mund te shfrytëzohen me kapacitete të plota hoteliere – turistike për ti përmbushur kërkesat e numrit të turistëve në rritje.

Në Brezovicë është investuar dhe krijuar baza materiale turistike, përderisa ekspertët e OSCE-së, lokalitetin e Prevallës e kanë ranguar lartë si qendër të turizmit dimëror-sportiv. Brezovica disponon me 1112 shtretër, prej të cilëve 690 në hotele të

kategorisë 'A' dhe 'B', me teleferikë, ski ashensorë dhe përmbajtje të tjera përcjellëse. [6]

Nr.	Lloji i objektit dhe emri	Numri i dhomave	Numri i shtretërve
A	Objektet në përbërje të Inex		
	Hotel "Breza", kat-"B"	30	70
	Hotel "Narcis", kat- "A"	115	320
	Hotel "Molika", Kat.- "B"	120	300
	Hotel" Centar"	12	30
A	**Gjithsejt A**	**277**	**720**
B	Objektet e shoqatave dhe ndërmarrjeve ekonomike		
	Federata e skitarëve të Kosovës	65	150
	Shoqata e Pensionistëve të Kosovës	35	70
	Shoqata e kulturës fizike-Prishtinës	14	50
	"Agrokomerci"	20	40
	Ekonomia e Gjuetisë së Kosovës	12	30
	Fabrika e gypave- Ferizaj	4	12
	Ministria e punëve të Brendshme Federale	10	40
B	**Gjithsejt B**	**160**	**392**
A+B	**Gjithsejt**	**437**	**1112**

▶Tab: Kapacitetet ekzistuese hoteliere në qendrën turistike-rekreative "Brezovica

- Në periudhën 1960 – 1970, janë ndërtuar objektet hoteliere- turistike: pushimorja „Shtëpia e Gurit", „Baqilla", „Shtëpia e Stojkut", „Hotel Breza" dhe teleferiku.
- Në periudhën 1975 - 1976 është bërë rekonstruimi i Hotelit "Breza", është ndërtuar restoranti "Livadica", janë ndërtuar dy ski-ashensorë, është blerë rrahësi i dëborës dhe janë adaptuar disa kafene në fshatra në rrethinën e Brezovicës.
- Periudha 1976 - 1980 është periudha e investimeve më të rëndësishme për zhvillimin e turizmit, fillon me ndërtimin e hotelit të kategorisë "A"- "Narcis", teleferikut me kapacitet 850 udhëtarë në orë dhe përfundon ndërtimi i rrugës prej 9km' gjatësi Brezovicës – Shtëpia e Stojkut.

Në qendrën e skijimit në Brezovicë, me vite të tëra nuk investohet në mënyrë të organizuar, përderisa numri i vizitorëve është në rënie. Gjithnjë e më pak mysafirë ka në kapacitetet hoteliere në Brezovicë. E tërë sezona e skijimit konsiston në grupe mysafirësh vendorë, punëtorë të organizatave ndërkombëtare, kryesisht turistë ditor apo ata të fundjavës.

Hotelet, teleferikët, dhe objektet e tjera përcjellëse nuk punojnë me kapacitet të plotë, janë të amortizuara dhe turistët vështirë mund të kënaqen me sporte të ndryshme dimërore, për dallim nga kohërat e mëparshme kur ka qenë e vizituar nga mijëra turistë nga ish Jugosllavia dhe më gjerë.

Hotelet Narcis, Molika dhe të tjerat nuk kontribuojnë në BKK. Investimet janë të kufizuara për faktin se objektet turistike janë pronë shoqërore, në pritje të privatizimit.


Viteve të fundit pas konfliktit, shfrytëzimi i kapaciteteve në hotele sillet deri në 30%. Sot për nevojat e turizmit në Qendrën e skijimit Brezovicë shfrytëzohen hotel "Molika", "Shkolla e skijimit", restoranet, pushimoret dhe objektet përcjellëse turistike. Prej Brezovicës e deri te hotel "Molika"- (te terrenet e skijimit) ka restorante të cilat kryejnë shërbime hoteliere për mysafirë. Në kuadër të zonës e cila mbahet me Brezovicën - Treshnje (ku edhe fillon kufiri i parkut nacional) si dhe në afërsi të hotel "Molika" gjinden vikend shtëpizat të cilat shfrytëzohen për pushime gjatë sezoneve të ndryshme, e gjithashtu edhe për dhënie në shfrytëzim (sipas zyrtarëve komunal të komunës Shtërpce numri i vikend-shtëpive sillet rreth 270)[7].

Në kuadër të kësaj zone ekzistojnë edhe pushimore të cilat nuk janë të shfrytëzuara për vizitorë: "Pushimorja e ish punëtorëve të Elektro-ekonomisë"(sot-qendër kolektive), "Pushimorja e ish SPB-Federale", "Pushimorja e pionierëve", "Pushimorja e pensionerëve të Kosovë", etj.

[6] Informatë e shkurtër mbi resurset turistike të Kosovës, gjendja aktuale të ekonomis turistike të Kosovës-MTI-Prishtinë, 2001

[7] Koha ditore11.03.2007

▶ Fig: Shtigjet e skijimit në Brezovicë




Në PN "mali Sharr", mundësitë për të pranuar skijatorë janë shumë më të mëdha se sa ofertat reale.
Qendra e skijimit "Brezovica" është 12km larg fshatit me po të njëjtin emër në komunën e Shterpcës. Qendra e skijimit në Brezovicë shtrihet në një territor prej 2500ha, në lartësinë prej 1718 deri në 2522 metra mbi nivelin e detit.

Gjatësia e shtigjeve të rregulluara për skijim në Brezovicë është 40 kilometra. Statistika e lakueshmërisë mesatare të këtyre shtigjeve është 38%, gjë që entuziazmon edhe më profesionistët e skijimit.

Si pasojë e mosfunksionimit të të gjitha kapaciteteve të ski ashensorëve dhe teleferikëve, nuk mund të zhvillohet skijim efikas. Mungesa e mirëmbajtjes ndikon në funksionimin e tyre me vështirësi dhe me numër të vogël të kapacitetit.

No	Kateg.	Emërtimi	Gjatësia e stazës	Gjatësia e teleferikut	Kota	Diferenca në lartësi
1		Karaula	2600	1186	1731-2190	459
2		Piribregu	3500	521+1186	1718-2522	804
3		Berevac	800	731	2099-2285	168
4		Qafa e Ortegut	2500	1428	1718-2147	429
5		Baçilë	301	301	1729-1803	73
6		Munika	454	454	1734-1830	94
7		Livadhi grek	500	429	1772-1885	113
8		Karpa e kuqe	3000	1269	1891-2264	491

▶ Tab: Shtigjet e skijimit në Brezovicë



▶ Harta: Shtrirja e shtigjeve në Qendrën e skijimit Brezovicë

Numri i i vizitorëve sillet rreth 1000/ditë[8] (gjatë sezonës). Çështje tjetër me rëndësi është çështja e privatizimit, shtyrja e të cilës ka ndikuar në stagnimin e arritjes zhvillimit më të hovshëm të kësaj qendre.


Si lokalitet tjetër që ka vlera të larta për zhvillimin e turizmit është Prevalla, një pjesë e së cilës i takon komunës së Prizrenit e që hyn në kufirin e Parkut Nacional „Mali Sharr". Llojet e turizmit të cilat zhvillohen në zonën e Prevallës janë: turizmi malor, dimëror, veror, aktivitetet në natyrë, turizmi shëndetësor, ekskursionet turistike.

Në Prevallë nuk ekziston infrastruktura adekuate turistike, dhe se çdo gjë është e improvizuar dhe krijuar për t'u shfrytëzuar "përkohësisht" (ndërtimi i vikend shtëpive, restoranteve, moteleve, tendave). Ofrimi i shërbimeve për vizitorë bazohet në shërbime hoteliere të nivelit te ulët, të paplanifikuar dhe jo sipas kritereve të turizmit të qëndrueshëm.

Nga ana e Kuvendit komunal të Prizrenit është hartuar „Plani Rregullues Urban" për zonën e Prevallës me të cilën është parashikuar zhvillimi i kësaj zone.

Zonat me vlera të posaçme në kuadër te masivit të Sharrit që i përkasin komunës së Suharekës shtrihen në pjesën verilindore dhe juglindore të Mushtishtit, si dhe në zonën e bjeshkëve të Caralevës.

Këto anë vizitohen nga turistët e vendit, kryesisht ata të cilët shkojnë për vikend-piknik dhe qëndrim në natyrë përderisa ka grupe turistësh të cilët për shkaqe shëndetësore qëndrojnë më gjatë dhe vendosen në stanet e barinjve.
Bukuritë natyrore, vegjetacioni i pasur bimor, ujor, lartësia mbidetare 1500m – 2400m, krijojnë mundësi të shëtitjes, shijimit dhe qëndrimit për rehabilitim të pacientëve me sëmundje kronike të frymëmarrjes.
Infrastruktura në këtë zonë është e nivelit të dobët, e cila pamundëson qëndrimin komod për si dhe do të tërhiqte numër më të madh të vizitorëve.



▶ Foto: Prevalla në dimër

[8] Sipas deklarimit të personelit hotelier, 2007



▶ Foto: Brezovica në dimër

1.6. Banimi në park dhe vendbanimet për rreth tij

Me këtë Plan, me banimin brenda parkut nënkuptojmë, hotelet, pushimoret, shtëpitë e vikendit, si në lokacionet Tërshenje – Brezovicë dhe Prevallë, përderisa me banim jashtë parkut nënkuptojmë fshatrat përreth parkut nacional (me ndikim ne park) me tendencë të analizave për ndikim të ndërsjellë në mes të parkut dhe vendbanimeve brenda dhe jashtë parkut.

1.6.1. Vendbanimet brenda parkut

Numri i përgjithshëm i vikend shtëpive në lokacioni Tërshenje – Brezovicë është 270. Fillet e banimit të planifikuar daton që nga vitet e 80', me vikend shtëpitë (vilat) e ndërtuara sipas Planit Rregullues Urban të Qendrës Turistike në Brezovicë.
Dukuria e ndërtimeve dhe zgjerimeve në këtë lokacion vendbanim turistik është për brengosje dhe çështje për t'u trajtuar. Pas vitit 2000 ndërtimi i hovshëm i vikend shtëpive, të paplanifikuara dhe të pakontrolluar është dukuri e cila është duke ndodhur në vazhdimësi.



▶Foto - Brezovica

Për lokacionin Prevallë është hartuar Plani Rregullues Urban për fshatin Turistik – Prevallë, nga KK e Prizrenit (2006). Edhe përkundër kësaj një numër i madh i objekteve është në kundërshtim me planin e aprovuar, që do të thotë se trendi i ndërtimeve të pakontrolluara është në rritje.

Ndërtimet e pa planifikuara, pakontrolluara në kuadër të Parkut, rezultojnë me probleme të ndryshme: furnizimi me ujë të pijshëm, shkarkimi i ujërave të zeza, grumbullimi i mbeturinave dhe shërbimeve tjera, përdorimi i materialeve ndërtimore jo adekuate dhe karakteristike për viset malore, ndërtimi i gardheve-rrethojave etj.



▶Foto - Prevalla

1.6.2. Vendbanimet për rreth parkut

Gjithsejt janë 54 vendbanime-fshatra (38+16 të komunës së Dragashit) të cilat gjinden në distancë 4km' prej kufirit të parkut, të cilat kanë ndikim direkt dhe indirekt në park dhe anasjelltas. Në këto vendbanime jetojnë mbi 50.000 banorë. Karakteristikë e tyre është se akoma kemi të bëjmë me familje tradicionale, familje të mëdha me mbi 8 anëtarë për familje dhe i takojnë tipit të grumbulluar të banimit. Sa i përket mënyrës së ndërtimit këto vendbanime kanë pësuar transformime. Deri në vitet e pesëdhjeta ka dominuar tipi i shtëpive një katëshe dhe dy katëshe, të ndërtuara nga materialet ndërtimore natyrore: guri, balta-lloçi, qerpiçi, druri, pullazet me kashtë ose me rrasa të gurit. Sot hasim në një ndryshim, si për nga ana e përdorimit të materialeve për ndërtim, po ashtu edhe nga ana funksionale. Këto ndryshime fillojnë nga vitet e '60-'70-ta e sidomos pas viteve '99. Edhe lufta e vitit 99' ka pas ndikim të madh në humbjen e vlerave tradicionale, dhe kështu sot, ka mbetur një numër shumë i vogël pothuajse simbolik i këtyre ndërtimeve.

Kur është fjala për vendbanimet-fshatrat për rreth Parkut, territori i të cilave shtrihet në kullosat e larta të Maleve të Sharrit, pikërisht, në kufirin ndërmjet arave të bjeshkës dhe kullosave të larta, i gjejmë vendbanimet sezonale verore, stanet e bjeshkës, të cilat popullata vendase i quan edhe "koliba". Këso stanesh hasim në: Zaplluzhë, Pllajnik, bjeshkët e Mushtishtit dhe Grejkovcit etj. Ndërhyrja e teknologjisë moderne, materialet e reja ndërtimore, kanë pasur ndikim të madh në humbjen tradicionale të të jetuarit, të ndërtuarit dhe të traditave tjera karakteristike për viset rurale. Ndikim të madh në këtë çështje kanë të punësuarit në diasporë, të cilët kanë sjellë frymën e ndërtimit nga vendet e perëndimit. Vendbanimet tradicionale kanë humbur vitalitetin e tyre me ndërhyrjen e teknologjisë moderne të ndërtimit, e njëherit edhe ndikim në stagnim të veprimtarive bujqësore. Viset rurale po e humbin dita më ditë funksionin primar të tyre.



▶ Foto: Gornjasellë, 2008

Vendbanimet të cilat gjenden në afërsi të kufirit me Parkut, gjithmonë kanë pasur kushte të mira për zhvillimin e blegtorisë, bletarisë, pemëtarisë, dhe që njihet si veprimtari primare e këtyre banorëve, me prodhimin karakteristik të "Djathit të Sharrit". Krahas rënies së fondit të blegtorisë në këto vendbanime gradualisht ka rënë edhe interesimi për përpunimin e bulmetit, momentalisht në funksion janë vetëm një numër i vogël i blegtorëve. Edhe ata pak blegtorë që gjenden në stane, kanë ndryshuar zakonet tradicionale dhe mënyrën e jetës. Sot në stane qëndrojnë dy vetë, bariu dhe një anëtar tjetër i cili e përcjell bulmetin stan-shtëpi dhe anasjelltas. Të paktë janë ata të cilët prodhimet i përdorin për përfitime komerciale.



▶ Foto: Struzhë, 2008

Efekti i ndryshimeve shoqërore, ngritja e interesimit për turizmin rural, për eko-turizmin ka filluar të ndikojë në ndryshimin e qasjes së vet popullatës së këtyre vendbanimeve. Kanë filluar ofertat simbolike të turizmit rural që është një rast i mirë që kjo qasje të përkrahet edhe nga autoritetet vendimmarrëse. Një numër i këtyre vendbanimeve, duke ju referuar gjendjes momentale, kanë predispozita për të ofruar kushte për të zhvilluar turizëm fshatar, duke ofruar shërbime tradicionale. Vendbanimet të cilat e rrethojnë parkun dhe kanë lidhje automobilistike direkte me PN si: Delloc, Gornjasellë, Struzhë, Brezovicë, Sevce, Zapluzhë, Brod, Restelicë, etj, mund të ofrojnë shërbime tradicionale për vizitorët e parkut si eko-turizëm dhe në këtë mënyrë përfitimet janë të shumanshme.

Afërsia me Parkun, pozita e mirë, dhe jeta tradicionale janë disa nga predispozitat kryesore për investime në këtë fushë.



▶Foto: Zaplluzhë, 2008



▶Foto: Kullosat në Park, 2008


1.7. Gjendja e infrastrukturës

1.7.1. Transporti dhe infrastruktura e tij

Zonën e Parkut Nacional „Mali Sharr" e përshkon rruga regjionale R115 në relacionin Doganaj (komuna e Kaçanikut) - Shtërpc - Prevallë - Prizren. Kjo rrugë është renovuar pas vitit 2000 dhe është në gjendje të mirë fizike. Nga qendra turistike Brezovica deri tek terrenet e skijimit në afërsi të saj shkon rruga regjionale R210. Kjo rrugë është poashtu në gjendje të mirë fizike. Rruga regjionale R116 në relacionin Doganaj - Glloboqicë (kufiri me Maqedoninë) gjendet në afërsi të drejtpërdrejt të zonës së parkut nacional. Kjo rrugë është në gjendje të mirë fizike dhe shumë e rëndësishme për zonën e Parkut Nacional sepse e lidhë atë në një distancë të shkurtër me Maqedoninë fqinje. Rruga tjetër regjionale, shumë e rëndësishme për këtë zonë sepse mundëson qasjen nga një drejtim tjetër, është rruga R118 në relacionin Shtërpc - Vërbeshticë (komuna e Shtërpcës) - Mushtisht (komuna e Therandës) - Therandë. Rruga R118 nuk është në gjendje shumë të mirë fizike, ndërkaq në segmentin nga Vërbeshtica deri në Mushtisht në një pjesë të madhe është e paasfaltuar. Rëndësia e kësaj rruge qëndron në faktin se e lidhë territorin e komunës së Therandës drejtpërdrejtë me zonën e Parkut Nacional dhe ua shkurton ndjeshëm distancën banorëve të kësaj komune në qendrën turistike të Brezovicës.

Linja kryesore hekurudhore e Kosovës në relacionin Mitrovicë - Fushë Kosovë - Hani i Elezit kalon jo shumë larg nga zona e këtij Parku. Stacioni më i afërt hekurudhor, ai i Ferizajt është 30 km larg zonës kurse Aeroporti i Prishtinës është rreth 60 km larg zonës së Parkut Nacional.

Sa i përket transportit, në rrugën regjionale R115 zhvillohet transporti i udhëtarëve me vetura individuale, kurse në sezonin e skijimit zhvillohet edhe transporti publik me ç'rast bartin vizitorët nga qendrat e ndryshme të Kosovës në drejtim të Qendrëns së skijimit të Brezovicës dhe anasjelltas. Afër Parkut kalon rruga tjetër regjionale R116 në të cilën zhvillohet transporti i rregullt publik në drejtim të Maqedonisë fqinje dhe natyrisht transporti me vetura individuale.



▶ Foto: Rruga drejtë qendrës turistike

1.7.2. Infrastruktura ujore

Zona e Parkut Nacional „Mali Sharr" është e pasur me burime ujore nga të cilat furnizohen me ujë vendbanimet përreth parkut përmes ujësjellësve lokal që ujin e sjellin me rënje të lirë.

Të gjitha vendbanimet e komunës së Shtërpcës që janë në afërsi të Parkut Nacional kanë ujësjellësit e tyre lokal që ujin e sjellin me rënje të lirë. Ujësjellësi lokal të disa vendbanimeve të Komunës së Shtërpcës si të Brezovicës, Jazhincës, Shtërpces, Berevces, Bitisë së Poshtme dhe Bitisë së Epërme janë lidhur dhe kanë formuar një ujësjellës grupor publik.

Vendbanimet e komunës së Prizrenit që furnizohen me ujë nga burimet e Parkut Nacional dhe kanë një pjesë të ujësjellësve të tyre lokal brenda zonës së parkut janë Lubinja e Epërme, Mushnikova, Gornje Sello dhe ish karaulla te Guri i Zi, ndërkaq vendbanimet e komunës së Therandës me ujësjellës të këtillë janë Mushtishti dhe një lagje e Grekocit. Pika turistike - rekreative e Prevallës që është brenda zonës së Parkut Nacional „Mali Sharr" në kuadër të komunës së Prizrenit gjithashtu ka ujësjellësin e saj lokal që furnizon me ujë objektet e pakta shërbyese hoteljere që ndodhen aty.


1.7.3. Infrastruktura e energjisë elektrike

Lokaliteti i Prevallës në zonën e Parkut Nacional furnizohet me energji elektrike nga largpërquesi 10kV Dalja e Zhupës, i cili është i vjetër dhe shumë i amortizuar. Në Prevallë ekziston vetëm një trafostacion me fuqi instaluese 250kVA. Konsumatorë të përhershëm këtu janë tre restorante, dy motele dhe 40 konsumatorë të amvisërisë. Rrjeti i tensionit të ultë është i dobët, kurse gjatë kohës së vikendeve, elektriciteti bartet edhe me kabllo PVC me ç'rast në rrjet lidhen edhe rreth 30 konsumatorë të tjerë. Në pjesën e komunës Shtërpce ,vikend shtëpizat në lokalitetin "Tërshenje" në zonën e Parkut Nacional furnizohen me energji elektrike nga TS 35/10kV Shtërpce drejtimi hotel "Breza" përmes kabllove ajror në shtylla të drunjta që janë në gjendje solide. Në lokalitetin "Tërshenje" janë 6 trafostacione: TTSH Tërshevina 50kVA, TSB Tërshevina 100kVA, TSB Tërshevina 250kVA, Tërshevina 100kVA, MBTS Lahor 630 kVA dhe MBTS KEK 630kVA. Nga katër të parët furnizohen vikend shtëpizat. Ndërkaq "Qendra e skijimit Brezovica", "Shkolla e skijimit", hoteli „Molika", vikend shtëpizat te „Shtëpia e Stojkut" dhe repetitori, që të gjitha në zonën e Parkut Nacional, furnizohen me energji elektrike nga TS 35/10kV Shtërpce drejtimi Sharri përmes kabllove ajror në shtylla rrjetore. Trafostacionet që furnizojnë objektet e lartpërmendura janë: MBTS Crvena karpa 1x630kVA, MBTS Shkolla e skijimit 630kVA, MBTS Molika 2x100kVA, TSM Kulla 160kVA, TTSH Repetitori 50kVA dhe MBTS Piri breg 2x630kVA(jashtë funksionit). TS 35/10kV furnizohet nga TS 110/35kV Bibaj(komuna e Ferizajt).

1.7.4. Telekomunikimi

Rrjeti i telefonisë fikse mbulon vetëm një pjesë të territorit të Parkut Nacional që është brenda komunës së Shtërpcës. Ky rrjet është i telekomit të Serbisë, ndërkaq telekomi i Kosovës nuk ka rrjet të telefonisë fikse në këtë zonë. Në qendrën komunale të Shtërpcës është PTT centrali me kapacitet prej 1500 numrash. Nga ky central përquesi kryesor shkon në drejtim të Brezovicës dhe qendrës së skijimit. Ekziston edhe një përques kabllovik i pavarur që shkon tek e ashtuquajtura ish "pushimorja e SUP-it" në zonën e vikend-shtëpive në Rexhina Tërshenja, ndërkaq përquesi kryesor, në afërsi te "Brvnara", ndahet dhe me këtë rast njëra degë shkon në hotelin „Narcis" kurse tjetra në drejtim të qendrës së skijimit, në Rexhina Tërshenja dhe në hotelin „Molika"

Mbulueshmëria e Parkut Nacional nga valët e telefonisë mobile është e vogël. Zonat e Parkut Nacional dhe ato në periferi të tij që mbulohen nga Vala (ku ka sinjal GSM) shihen në hartën e mëposhtme ku mbulohet Prevalla dhe në periferi të parkut mbulohen disa vendbanime. Sinjal GSM ka edhe në disa zona të Parkut Nacional që janë në territorin e komunës së Shtërpcës. Këtë sinjal në zonën e qendrës së skijimit afër Brezovicës dhe në disa zona përreth e mbulon telekomi i Serbisë.



▶ Harta: Shtrirja e infrastrukturës teknike

1.8. Zgjërimi i parkut

Me këtë Plan definohet kufiri i territorit të Parkut Nacional "Mali Sharr" e poashtu edhe përkufizimi i rezervateve strikte natyrore.

Në bazë të vëzhgimeve në terren gjatë hartimit të planit hapësinor të Parkut Nacional "Mali Sharr" dhe imazheve satelitore e ortofotove, janë vërejtur shumë ngjashmëri të pasurive natyrore brenda kufirit të parkut me ato pasuri jashtë kufirit. Kjo i referohet sidomos pyjeve, të cilët për këtë arësye do të duhej të ishin brenda kufirit të parkut, që do të thotë se parku do të duhej të zgjerohet. Arësye tjetër për zgjerim është që vlerat e njëjta të parkut të kenë status të njëjtë të mbrojtjes. Ka patur poashtu kërkesa të vazhdueshme nga autoritetet e komunës së Sharrit që edhe një pjesë e territorit të kësaj komune të hyjë brenda kufinjve të parkut. Ekspertët e kanë bërë një vlerësim (shtojca 2) të kësaj pjese dhe kanë konstatuar se ka vlera të mjaftueshme që kjo t'i shtohet sipërfaqes së parkut. Kështu për arësyet që u përmendën, është vendosur që të përcaktohen kufinjtë e ri duke e zgjeruar parkun, i cili daton nga viti 1986 kur me ligj është shpallur park nacional. Drafti i ligjit të ri, Ligji për Parkun Kombëtar "Sharri" ku tregohet kufiri i ri i parkut pas zgjerimit të tij, tani më është hartuar. Pjesa më e madhe e sipërfaqes që i është shtuar parkut ose 24,206 hektarë i takon komunës së Sharrit. Tani, pas zgjerimit, parku ka një sipërfaqe prej 53,469 hektarësh. Përcaktimi i vijës së re kufitare është bërë duke u bazuar në disa kritere që janë dhënë në vazhdim.

1.8.1. Kriteret e definimit të kufinjëve për zgjerim

Hapësira gjeografike për nga peisazhi ndahet kryesisht në dy lloje kryesore të peisazhit, në peisazh natyrorë dhe në peisazh human. Bazuar në këtë ndarje peisazhore edhe hapësira gjeografike e parkut të Sharrit është ndarë në këto dy lloje të peisazheve. Në këtë propozim, për zgjerimin e këtij parku jemi bazuar kryesisht në vlerat peisazhore për shkak që hulumtimet e tjera shkencore, si inventarizimi I faunës dhe florës, migrimet e shtazëve, shpezëve dhe florës, hulumtimet gjeohidrologjike dhe të tjera janë të kushtueshme në kohë dhe mjete financiare dhe si rezultat caktimi i kufirit të ri të PNMSH nuk do të ishte pjes e PHPNMSH. Siq e cekëm edhe më lartë, janë marrë për kriter dy kategori peisazhore si struktura gjenerale hapësinore me elemente të tyre.

Si elemente të peisazhit natyrorë në caktimin e kufirit janë marrë këto elemente:

N1. Vegjetacionin (Si kufi ndarës është marrë: kufiri i poshtëm i pyjeve).
N2. Hidrografia (Si kufi ndarës janë marrë: kufijtë e pellgjeve lumore, rrjedhat lumore, etj.)
N3. Gjeomorfologjia e terrenit (Si kufi ndarës janë marr; kurrizet malore, qafat malore, majet malore, etj.)

Si elemente të peisazhit human në caktimin e kufirit janë marrë këto elemente:

H1. Infrastruktura rrugore (Si kufi ndarës është marrë skaji I rrugës në drejtim të kufirit ekzistues të PNMSH)
H2. Pronat private (Si kufi ndarës është marrë kryesisht kufiri I sipërm I arave të punuara, kultivuara)
H3. Vendbanimet (Si kufij ndarës është marrë kufiri natyrore mes vendbanimit dhe pyjeve apo livadheve).

1.8.2. Kufiri i ri i Parkut Kombëtar "Sharri"

Kufiri i ri i parkut, i cili siq u tha, tani sipas ligjit quhet Parku Kombëtar "Sharri", fillon në pjesën lindore te gryka e Kepit të Kurtës (1050 m.) në kufirin shtetëror të Republikës së Kosovës me Republikën e Maqedonisë dhe vazhdon në drejtim të perëndimit dhe jug-perëndimit përgjatë kufirit shtetëror duke shkuar përtej kuotave, përkatësisht majave më të larta të Sharrit, majës së Lubotenit (2499 m.), Kulla (2314 m.), Livadhi (2491 m.), Çuka e Liqenit (2604 m.), Bistra (2604 m.), Maja e Zezë (2584 m.), Kobilica (2526 m.), Vërtopi (2555 m.), Kara Nikolla (2106 m.), Bardhaleva (2334 m.); Tërpeznica (2610 m.); Qelepina (2554 m.); Rudoka (2658 m.); Vraca e Madhe (2582 m.); deri të pika kufitare e tri shteteve (Kësula e Priftit), Kosovës me Maqedoninë dhe Shqipërinë. Nga këtu kufiri vazhdon në veri-perendim deri të kota Kallabak (2174 m.), nga ku e merr drejtimin e veriut, gjithnjë duke u përputhur me kufirin shtetëror me Republikën e Shqipërisë, nëpër majën Murga (2025 m.) pret lumin e Restelicës, pastaj lumin e Plavës deri të kuota 1702 m në malin Koritnik.




Kufiri pastaj kthehet në veri-lindje, kalon nëpër Lugin e Keq dhe del në rrugën pyjore kuota 1343 m, për të vazhduar përgjatë kësaj rruge duke futur brenda Kodrën e Erës, duke kaluar nëpër Rrasa pranë Arës së Bajrakit nëpër kuotën 1273 m, kështu duke mbërthyer kodrën Gollina deri te kuota 1246 m tashmë në brendi të territorit të komunës së Dragashit. Nga këtu kufiri merr drejtimin e jug-lindjes deri pranë kodrës Kopriva (1493m) duke lënë jashtë kufirit pyjet e Rronzës. Prej këtu shkon deri te Bunari i Hamitagës më astaj merr drejtimin e lindjes duke rënë shpatit të Ahishte rreth 1 kilometër në lindje të fshatit Buçe. Pastaj kufiri merr drejtimin e jugut për në Brinja duke i lënë jashtë kufirit Brinjën dhe Arën e Rexhës duke shkuar në drejtim të pyjeve të Çestakut e duke rënë deri tek rruga për në fshatin Kërsteci i Madh duke kaluar kuotën 1407 m gjithnjë duke shkuar në drejtimin jug-perëndim thuajse duke mbërthyer të tërin malin e Koritnikut, deri te përroi i Pjetrit për të marr më pastaj drejtimin e lindjes nëpër kuotën Çula (1201m) e për të rënë deri në rrjedhën e lumit të Plavës në përroin tjetër pa emër. Nga këtu vija kufitare shkon duke ndjeg rrjedhën e lumit Plava deri 250 afër kufirit me Shqipërinë. Pastaj nga këtu kufiri merr drejtimin e jugut duke shkuar thuajse paralelisht me kufrin shtetëror në lindje të fshatit Orçushë. Kufiri shkon gjithnjë në drejtim të jug-jug-lindjes nëpër pyjet duke ndjekur rrugën malore që i ndan pyjet e Gosit me Majën e Zezë (1581 m), e duke ju ofruar fshatit Gllobоçicë në lindje rreth 700 metra larg. Vija pastaj ndjek përroin që kalon nëpër Rudce për të rënë poshtë deri te rrjedha e lumit të Restelicës. Nga këtu vija ndjek gjithnjë rrjedhën e lumit në drejtim tashmë të jugut duke kaluar kuotën 1107 m. Pastaj viaj kufitare merr drejtimin e lindjes për të dal në rrugën që shpie për në fshatin Krushevë. Kjo vijë e ndjek rrugën deri pranë varreve të fshatit të Krushevës, për të këputur sërish rrjedhën lumore të Restelicës e duke u ngjitur përpjetë shpatit duke kaluar nëpër kuotat 1390 m. pastaj kuotën Kolenica (1489 m.). Nga këtu vija kufitare merr drejtimin e veriut duke mbërthyer pyjet e Jellakut. Më pas vija del në rrugën për në Restelicë duke ju afruar në perëndim të fshatit Restelica te kuota 1426 m., prej nga vija merr drejitmin e shtrirjes në perëndim gjithnjë duke i kufizuar në vete pyjet në lindje të Restelicës duke kaluar nëpër urën e Kadiut pastaj kuotën 1644 metra. Më pastaj kufiri fillon të merr drejtimin e jugut me zigzake deri te përroi Çopur. Më pastaj vija kthehet kah jug-perëndimi nëpër rrjedhën e lumit për t'u lidhur me rrugicën tjetër të anës së djathtë të lumit. Nga këtu vija e kufirit shkon përgjatë vijës që ndanë pronën private nga ajo publike në drjetim jug-lindjes deri te rruga kryesore Restelicë - kufi me Maqedoninë. Vija kryesisht e ndjek rrugën deri afër fshatit Restelicë gjithnjë duke ndjekur kufirin në mes të tokave private dhe publike. Nga rruga që vija e tangon në jug të fshatit, vija kufitare merr drejtimin e lindjes përgjatë lumit të Restelicës duke u ngjitur përpjetë deri tek kuota 1581 metra prej nga pastaj kufiri merr drejtimin e veriut përkatësisht veri-perëndimit derit te kuota 1818 si dhe kuotën tjetër 1887 duke bërë një gjysmë rreth për ta lënë jashtë kufirit majën Kërstilla prej 1907 metra. Nga këtu vija kufitare tashmë arrin të mbërthen në vete majën e lartë malore Ovçinec (2177 m) pastaj duke shkuar përskaj majës tjetër Maja e Zezë (2063 m). Prej këtu vija merr drejtimin e perëndimit kah fshati Zlipotok duke ju afruar rrëzë shtëpive të fshatit. Gjithnjë duke ndjekur perëndimin vija kufitare tangohet me rrugën kryesore për në fshatin Zlipotok tek kuota 1414 metra përkatësisht tek varrezat e fshatit. Prej kësaj pike vija merr drejtimin e veri-lindjes përskaj varrezave duke mbërthyer në vete majën malore Popovica (1567 m), pastaj majën tjetër Bigor duke shkuar në drejtim të pyjeve Leska përmbi hidrocentralin e Dikancës deri tek lumi i Brodit. Nga këtu vija kufitare ndjek lumin e Brodit në drejtim të burimit të tij deri afër fshatit Brod kur fillon dhe i shmanget fshatit duke u ngjitur vija përpjetë shpatit të Rudinës deri tek kuota 1483 metra, pastaj kufiri merr drejtimin e lindjes duke kapërcyer lumin tek Ura e Shollës përkatësisht tek bashkimi i rrjedhave të lumenjve Lleva dhe Dushkaja. Më pastaj vija kufitare ndjek kufirin e tokave të "Sharr-Prodhimit" duke kaluar nëpër kuotat 1790 m. më pastaj te kuota 1432 m. në degën e djathtë të lumit Brod pranë varrezave të fshatit Brod. Kufiri vazhdon të bëjë rrethin e çrregulltë nëpër kuotat 2081 m përkatësisht 1680m duke mbështjellë thuajse të tërë fshatin Brod dhe duke lënë fshatin jashtë kufirit. Më pastaj vija kufitare del deri tek rruga kryesore Dikancë - Brod duke ndjekur deri afër fshatit Dikancë. Më pastaj kufiri vazhdon të marr drejtimin e

veriut përkatësisht veri-lindjes duke kaluar pranë kuotave Virje 1602 metra, përkatësishti 1598 duke ju afruar fshatit Lleshtan nëpër Baçillishtë, Shillovicë deri tek lumi i Radeshës tek kuota 1436 metra. Nga kjo kuotë vija merr drejtimin e jug-lindjes nëpër përroin e Zagrejcit duke mbërthyer shpatiet e rrëpijta të Zagrejcit pas 1500 metrash vija merr drejtimin e veri-lindjes duke u ngjitur bjeshkës së Livaxhës pranë kuotës 1900 metra, përfundi Gurit të Shqiponjës pastaj nga këtu merr drejtimin teposhtë drejtë përroit të Srednicës përfundi kuotës 1722 metra. Nga këtu vija kufitare ndjek rreth 500 metra shtratin e përroit për t'u kthyer pastaj sërish në drejtim të veriut nëpër malet e Bogdanicës deri te kuota Guri Marushan në shtratin e përroit të Pllajnikut. Vija kufitare vazhdon të ndjekë drejtimin e veriut deri tek Kroi Obçinove, pastaj kuota 1572 pranë kodrës Sumllar prej nga merr drejtim veri-lindje deri tek përroi Ropuha në veri-perëndim të fshatit Kuk. Vija kalon përroin duke marrë drejtimin thuajse krejtësisht të lindjes duke kaluar përskaj kodrës së Shullanit e për të rënë deri tek lumi Reka e Shehit të Madh tek kuota 1628 metra. Prej këtu vija sërish merr drejtimin e veri-lindjes duke kaluar Gurin e Torishtes e duke zbritur tek lumi Reka e Shehit të Vogël. Më pastaj kufiri merr drejtimin e veriut duke bërë zigzage duke përfshirë në vete vendet Guri i Korbit, Gurin e Grihes e pastaj Brezhdën deri tek shpatiet e Dridzës, një kilometër në jug - lindje të fshatit Zaplluzhë. Nga këto shpatie vija takon kuotën 1367 metra, pastaj kuotën 1680 metra në Ugar, kuotën tjetër 1609 për të mbërritur tek Qafa e Dhelpnës pranë kuotës 1625 metra. Nga kjo kuotë kufiri kthehet në lindje dhe zbret deri te rruga për të vazhduar përrockës pa emër deri të lumi i Manastircës nga ku e merr drejtimin e jugut përgjatë lumit deri të përrocka tjetër pa emër. Kufiri pastaj ngjitet përrockës në drejtim të jug - lindjes dhe duke kaluar kuotën Guri i Pishës (1192 m.) del të kuota Guri i Qelit (1669 m.). Nga këtu kufiri zbret luginës në drejtim të lindjes deri të lumi Pubenica të cilin e ndjek në drejtim të veri-lindjes deri të izohipsja 1050 m. te Kosa e Gjerë (vend derdhja e përrockave në lumin Pubenica) nga ku kthehet në lindje nëpër kuotën 1093 m deri të kuota Brod (1048 m.). Nga kjo kuotë kufiri merr drejtimin e veri-lindjes, ngjitet deri te kurrizi i Stërgës së Kumançit dhe vazhdon përgjatë rrugës së livadheve të Lubinjës së Epërme (nën vendin Smig) deri të kuota 1401 m. Mëtej kufiri shtrihet në veri-lindje nëpër kuotën Livadhet e Epërme (1430 m.) dhe zbret luginës deri te kuota 1107 m. (lumi Petreshnica) për të vazhduar në drejtim të veri-lindjes duke u ngjitur kurrizit deri të përrocka e Marës (izohipsa 1230 m.). Nga kjo pikë kufiri kthehet në veri - perëndim dhe e ndjek izohipsën 1230 m. deri të kuota 1227 m. nga ku vazhdon në veri-lindje deri te shpatiet e Gropës (1192 m.). Kufiri pastaj shtrihet në lindje nëpër kuotën (1195 m.) përgjatë shpatieve Çuka deri të përrocka e Mahallës së Epërme (lagje e fshatit Katundi i Epërm.) (izohipsa 1300 m.) nga ku në drejtim të veri-lindjes ngjitet deri të Llanishta (izohipsja 1400 m.) për të vazhduar në veri-perëndim mbi fshatin Katundi i Epërm dhe del në rrugën rajonale Prizren - Shtërpcë mbi shpatiet e Stërnjigarit (500 m në lindje nga kuota Prisoj 1330 m.). Nga kjo pikë kufiri e ndjek rrugën në drejtim të perëndimit deri të „Kthesa e Gjashtë", pastaj vazhdon nëpër kuotat Gabar (1195 m.), (1257 m.) (1056 m.) deri te përrocka e fshatit Pllanjan nga ku zbret në drejtim të jug - perendimit duke kaluar nëpër kuotat 1084 m, 928 m. 803 m. për të zbritur në Lumbardhë (550 m.) të cilin e ndjekë deri te kuota 532 m. Pastaj e merr drejtimin e perëndimit, e pret rrugën rajonale (Prizren-Shtërpcë) dhe kalon nëpër kuotat 867 m. dhe 974 m. nga ku zbret kurrizit në veri - perendim deri tek përrocka e Katërdhjetë Bunarëve të cilen e përfshinë. Nga këtu kufiri e merr drejtimin e veri - lindjes, e kalon Lumbardhin, rrugën rajonale, dhe ngjitet kurrizit të shkëmbinjve të Vërtopit, duke e përfshirë pjesën lindore të shkëmbinjve, e mer drejtimin e jug - lindjës, kalon nëpër kurrizin malor të Dullos, dhe pasiqë e mbërthen grykën e përrockës së Vërbiçanit, lidhet me kurrizin Tociv në izohipsen 900 metra. Nga këtu vazhdon kurrizit në drejtim të lindjes deri tek kuota Maja (1567 m.), nga ku kthehet në veri-lindje dhe përgjatë vegjetacionit pyjor del te rruga pyjore për në fshatin Novosellë duke futur brenda kufirit livadhet e kodrinës së Bullecit. Kufiri pastaj zbret nën rrugë deri te izohipsa 1500 m. të cilen e ndjekë deri te Kroni i Aliut (që gjendet në rrugën pyjore), duke i futur brenda kufirit Ujërat e Gropuara. Pastaj kufiri vazhdon përgjatë rrugës në drejtim të veriut deri te kuota 1500 m. (Ravenj), nga ku zbret kurrizit deri tek Guri i Mullinit. Nga kjo



pikë kufiri kthehet në veri-lindje dhe ngjitet përgjatë kurrizit malor, kuotat 1052 m dhe 1569 m deri të Livadhet e Sulës nga ku zbret kurrizit në veri-perëndim deri të përrocka (në lindje të kuotës Tepe 1271 m.) për tu ngjitur pastaj kurrizit në drejtim të veri-lindjes deri tek Shkrepi duke mbërthyer brenda kufirit Ashtën. Kufiri pastaj e përcjell izohipsën 1700 m nëpër Shpatin Padhe deri të qafa Bubrrec (1709 m.) që gjendet mbi Grykën e Rusenicës. Kufiri mëtej zbret kurrizit malor në drejtim të veri-perëndimit deri të kuota Guri i Livadhit (1448 m.) dhe vazhdon kurrizit në veri - lindje deri të hyrja në Grykën e Rusenicës (750 m.), nga ku kthehet në jug-lindje për të vazhduar pastaj në veri-lindje përgjatë vegjetacionit pyjor (kufirit të malit me livadhet) deri të kuota 830 m (pjesa e poshtme e Lleshçicës). Nga kjo kuotë kufiri përputhet me izohipsen 850 metra dhe e ndjekë atë deri te kuota 768 metra (Kulla) duke përfshirë Llokmën dhe Arën e Selimit. Pastaj kufiri kalon përgjatë përrockës dhe Grykës së Matozit deri te qafa e Përsllap (kuota 1089 m.) nga ku e merr drejtimin e jug-lindjes dhe kalon përreth pjesëve të poshtme të Grykës (Klisurës) dhe Gurit të Përgjakur deri të kuota 1212 m. Nga këtu kufiri kthehet në veri-lindje dhe duke përcjellur izohipsen 1200 m. del të çesma e Imerit dhe vazhdon nëpër koutën 1335 deri të Kroni i Mbretit. Kufiri pastaj zbret kurrizit malor të Malit të Mbretit deri të kuota 1068 m., nga ku kthehet në jug-lindje dhe përtej kuotave Tëbanat e Bukoshit (1546 m.) dhe 1655 m. del të kuota Rrafshina e Epërme (1443 m.) gjithnjë duke ndjekur kufirin natyror (përrockat, luginat dhe kurrizet malore). Nga kjo kuotë kufiri vazhdon në drejtim të jugut dhe jug-lindjes nëpër kuotën 1084 m deri tek kuota Çuka (1216 m.), nga ku kthehet në perëndim dhe nëpër majën e Vishevicës (1230 m.) dhe Kryqit del në kuotën Presllap (1291 m.). Kufiri pastaj zbret në jug -perëndim deri të përrocka Zashtica (1000 m.) dhe vazhdon përgjatë përrockës në drejtim të jug - lindjes deri të derdhja e përrockës Vasil (pjesa e poshtme e Gurit të Vardishit) nga ku kthehet në jug - perëndim dhe ngjitet kurrizit malor të Llaçeishtës deri të kuota Pisha e Vogël (1495 m.) për të vazhduar në drejtim të perëndimit deri tek kuota Rudina (1536 m.). Nga kjo kuotë kufiri vazhdon në drejtim të jugut përgjatë kurrizit malor dhe kuotës Tumba (1382 m.) deri tek derdhja e lumit Tisi në Lepenc (1119 m.) nga ku kthehet në jug-lindje mbi fshatin Sevcë nëpër kuotat Gobelinc (1297 m.); Kuk (1251 m.); Çuka e Poshtme (1260 m.) deri të kuota Guri i Prushit (1375 m.) nga ku zbret kurrizit deri te ura e Lumit të rrugën rajonale Prizren-Shtërpcë. Pastaj kufiri vazhdon në veri-lindje përgjatë kësaj rruge dhe nëpër kuotat Borja e Poshtme (1232 m.); lumi Muzhnica (1036 m.); kuota (1086 m.); Penjarupa (1169 m.); Shkëmbi i Boçkës (1228 m.); Llazovi (Vlak) (1100 m.); Barojca, Glava (1228 m.); Uji i Bardhë (1100 m.); Lumi Klisura (1031 m.); Zmijaica mbi Drajkovc (1126 m.); Krividell mbi Firajë (1080 m.); Krena (904 m.); Përrocka e Madhe mbi Mallahën e Elezëve (780 m.) (lagje e fshatit Brod) deri të pjesët e poshtme të Jasikës mbi Mahallën e Ceklarëve (850 m.). Nga kjo pikë kufiri kthehet në jug-lindje deri të izohipsa 900 mbi Mahallën e Elezëve të cilën e ndjek në jug deri të kuota 900 m. për të vazhduar kurrizit malor deri te kuota mali Shulan (1154 m.) nëpër Përronin e Shpatit. Pastaj kufiri kthehet në jug-lindje deri të kuota 941 m. në rrugën pyjore të cilën e ndjek deri të rruga rajonale Shtërpcë – Doganaj - Gllobojçicë. Kufiri mëtej vazhdon në jug përgjatë rrugës rajonale deri te kthesa e Kepit të Kurtës nga ku në drejtim të jug-perëndimit ngjitet grykës së Kepit të Kurtës për tu përmbyllur në pikën fillestare izohipsa 1050 në kufirin shtetëror Kosovë - Maqedoni.



▶Kufiri para dhe pas zgjerimit të Parkut Kombëtar "Sharri"

1.9. Komuna e Dragashit në Park

1.9.1. Veçoritë dhe fenomenet natyrore

1.9.1.1. Veçoritë gjeologjike

Pjesa e Maleve të Sharrit që gjendet në territorin e komunës së Sharrit formn kufirin midis Kosovës dhe Maqedonisë. Malet e Sharrit u formuan në fazën e njëjtë gjeologjike si Alpet dhe Dinaridet. Gjysma e territorit të Dragashit është formuar nga lloje të ndryshme të shkëmbinjve metamorfike. Dy zona janë të dominuara nga lloje të ndryshme të cilat kanë pësuar proceset metamorfike. Këto zona janë Koritniku dhe pjesët e maleve rreth Brodit dhe Restelicës.

Ndërhyrje të Magmatites janë gjetur kryesisht në pjesën qendrore të Dragashit në mes të Kërstecit, Dragashit, Pllajnikut, Brodit, Zlipotokut dhe Krushevës. Sipërfaqet më të mëdha me ranor mund të gjenden më shumë në jugperëndim të maleve (Kesula e Priftit), sipërfaqe më të vogla janë të shpërndara në të gjithë zonën.

Afërsisht 20% e tokës në komunë është formuar nga sedimentet kuaternare të origjinës fluviatile ose akullnajore. Fushat kryesore janë në veri ndërmjet Breznës dhe Bresanës rreth Dragashit dhe përgjatë luginave në malet e larta në jug të komunës. Burime minerale hasen ne hapësirat:


- Tri vendburime të mineralit të hekurit shtrihen rreth Zlipotokut;
- Një vendburim me bakër dhe merkur gjendet afër Mlikës;
- Një vendburim me bakër, plumb dhe kallaj ndodhet pranë Dikancit;
- Një vendburim me bakër, plumb, kallaj, molibden, wolfram dhe arsenik ndodhet pranë Bačkës;
- Dy fusha me gurore ndodhen pranë Restelicës dhe Lubovishtë.

1.9.1.2. Veçoritë klimatike[9]

Temperaturat - Komuna e Dragashit ka një klimë subalpine me temperatura vjetore mesatare prej 8.6 °C. Stinët e ngrohta të vitit janë te shkurta, me temperaturë mesatare 18.1°C, kurse ato te ftohtat janë te gjata dhe me temperaturë të ultë mesatare prej -0.4°C.

Temperaturat me te larta janë në luginat lumore ku janë te vendosura shumica e vendbanimeve. Temperaturat këtu janë 10 °C me te larta se në zonat e larta malore. Me rritjen e lartësisë mbidetare në parkun kombëtar ato zbresin në çdo 100 m lartësi 0.6°C.


Në viset e ulëta temperaturat mesatare gjatë periudhës vegjetative prill-shtator janë 15 °C. Temperaturat më të larta prej 36.5°C janë regjistruar në korrik, ndërsa me te ultat prej -21.5°C janë regjistruar në janar.



Periudha e vitit 1960-1984


Erërat - Era fryn në përgjithësi nga verilindja dhe jugperëndimi. Të dhënat e mëposhtme për shpejtësinë e erës janë për rajonin e Prizrenit dhe për shkak të afërsisë së këtij rajoni me komunën e Dragashit, ato mund të konsiderohen si të përafërta me ato për rajonin e Dragashit.
Erërat jugperëndimore kanë shpejtësi 3.8m/s, ato jugore dhe veriperëndimore 1.9 m/s. Shpejtësia maksimale e erës në këtë rajon ka arritur 18.9 m/s .
Lagështia e ajrit - Lagështia mesatare vjetore e ajrit është 76%. Lagështia maksimale e ajrit prej 83.15% është në nëntor, kurse ajo minimale prej 67.6% është në gusht.

[9] Të dhënat për klimën janë marrë nga draftdokumenti i planit zhvillimor të komunës së Dragashit të hartuar nga UNDP.





Reshjet – Komuna e Sharrit si tërësi regjionale ka një nivel të lartë të reshjeve me shi dhe me borë.
Reshjet e shiut janë të theksuara gjatë muajit qershor 101mm dhe muajit shtator 82mm reshje .



Periudha e vitit 1950-2008

Muajt me më pak të reshura janë janari, shkurti, marsi dhe gushti. Përafërsisht 50% e totalit vjetor të shiut bie nga prilli në shtator. Sasia mesatare vjetore e reshjeve është 807mm. Më shumë reshje bien mbi majat në veriperëndim (Koritniku) dhe juglindje, malet Shutman. Reshjet mesatare në viset e ulta arrijnë në 800mm në vit, kurse mbulushmëria e borës 120 ditë ne vit. Në viset e larta malore reshjet mesatare arrijnnë 1370mm në vit, kurse mbulushmëria e borës 280 ditë në vit.

1.9.1.3. Veçoritë hidrologjike

Lumenjt - Regjioni i Dragashit përkatësisht zona ku shtrihet Parku Kombëtar "Sharri" është e pasur me burime ujore dhe rrjedhje ujore te përrockave, përrenjve dhe lumenjve të vegjël. Zona i takon dy pellgjeve detare: Adriatikut që derdhet përmes lumit kryesor Drini i Bardhë dhe Egjeut që derdhet përmes Vardarit (Maqedoni).

Lumenjt e ujëmbledhësit të Detit Adriatik që i kanë burimet në këtë zonë janë: lumi i Zaplluzhës, lumi i Shehut të Vogël, lumi i Shehut të Madh, lumi i Kukut, lumi i Pllajnikut, lumi i Srednicës, lumi i Brodit, lumi i Dushkajes, lumi i Restelicës dhe lumi i Plavës.


Sa i përket ujëmbledhësit të Detit Egje, në këtë zonë burimin e ka lumi i Gurit të Zi (Crni Kamen)

Sipërfaqes ujëmbledhëse të Detit Adriatik i takon 84% të territorit të komunës së Sharrit, kurse asaj të Detit Egje 16%.

Liqenet paraqesin njërën nga bukuritë e mëdha të Parkut Kombëtar "Sharri". Ata shtrihen ne lartësi të mëdha mbidetare. Për nga madhësia dhe bukuria natyrore dallohet liqeni i madh i Shutmanit që ka shtrirje në mes të fshatrave Brod dhe Restelicë. Liqenet tjera janë liqeni i vogel i Shutmanit, liqeni në malin Çemeriq, tri liqene në malin Gorni Def dhe liqeni i Kautovës.

1.9.1.4. Vegjetacioni

Pjesa e Parkut Kombëtar "Sharri" që gjendet në territorin e komunës së Sharrit karakterizohet me hapësira që paraqesin tërësi të rëndësishme me lokalitete të rralla natyrore, me biodiversitet të pasur me lloje të bimëve vaskulare dhe endemike. Këtu gjenden sipërfaqet më të bukura të vegjetacionit barishtor në Kosovë që përbën rreth 20% të florës brenda Ballkanit. Gamën e gjërë të Sharrit me lartësi mbidetare 750 – 2.650 metra, e mundëson gërshetimi i klimave mesdhetare dhe kontinentale që ka si rezultat paraqitejen e shumëllojshmërisë së elementeve floristike të periudhës akullnajore.



Në këtë zonë janë prezente këto bashkësi jetësore: Caricetum rostratae salicetosum, Caricetum rostratae - vesicariae, Caricetum nigrae, Carici - Narthecietum scardici, Vaccinion with V. gaultherioides, Senecio - Rumicetum alpini, Shrubland, Arctostaphylo - Juniperetum nanae, Vaccinio - Empetretum hermaphroditi, Coryletum avellanae, Juncetum trifidi, Drypetum spinosae, Saxifrageto - Potentilletum apenninae, Saxifrageto -

Rumicetum nivalis, Carici - Seslerietum latifoliae, Deltoideo - Nardetum, Nardetum strictae, Diantho – scardici - Festucetum, Amerio - Festucetum variae, Xerobromion, Echinario - Convovuletum althaeoides, Edraiantho - Elynetum, Gentiano - Dryadetum octopetalae, Gladiolo - Sanguisorbetum officinalae, Helianthemo - Globularietum bellidifoliae, Abietum albae koritniensis, Abietum borisii - regis, Pinetum heldrechii typicum, Fago - Pinetum heldrechii, Alnetum glutinosae, Betuletum verrucosae koritniensis, Lembotropo - Quercetum cerris,

Quercetum trojanae dukagjini, Fagetum moesiaca montanum, Ostryo - Fagetum, Seslerio autumnalis - Fagetum, Colurno-Ostryetum carpinifolia, Dioscoreo - Carpinetum orientalis.

1.9.1.5. Flora

Bota bimore dhe vlerat e veçanta të natyrës në këtë pjesë në përgjithësi paraqesin një potencial për zhvillimin e aktiviteteve shkencore - hulumtuese dhe kërkimore për vizitorët e ndryshëm. Këtu janë prezent llojet e bimëve që i takojnë elementeve floristike: mezofile, kserofile, frigorifile dhe arko – alpike, në kuadër të të cilave, rëndësi të veçantë kanë bimët endemike.
Pjesa e maleve e cila lidhet me malin e Koritnikut paraqet një zonë me vlera të rralla natyrore dhe konsiderohet si rezervat për disa lloje të bimëve.[10]

1.9.1.6. Fauna

Për faunën në komunën e Sharrit nuk ka studime sistematike shkencore. Megjithatë të dhënat e mbledhura nga OJQ-të, komunitetet e fshatrave, literatura dhe nga vëzhgimet e ekspertëve të UNDP-së ofrojnë një pasqyrë në lidhje me llojet e fuanës që gjenden në këtë zonë. Sipas OJQ "Finches" gjenden 11 vende të rëndësishme në komunë për habitate të shpendëve. Rreth një e treta janë të shënuara në anekset e BE-së të Direktivës së shpendëve. Dyzet lloje të fluturave janë identifikuar, rreth një e treta janë të shënuara në anekset II ose IV të Direktivës së Habitatit në BE apo janë vlerësuar si "Të rrezikuara" nga IUCN.

Gjitarët (Mmmalia) – Gjitarët prezent në pjesën e parkut brenda komunës së Sharrit janë: Lynx lynx (Rrëqebulli), Ursus arctos (Ariu i murmë), Capreolus capreolus (Kaprolli), Rupicapra rupicapra(Dhia e egër), Scirius vulgaris (Ketri).
Ujëtokësorët (Amphibia) - Ujëtokësorët prezent në pjesën e parkut brenda komunës së Sharrit janë: Bombina variegata (Bretkoca barkverdhë), Hyla arborea (Bretkoca e drunjve-gargaliqi), Rana dalmatina(Bretkoca e pyllit), Rana graeca (Bretkoca greke), Salamandra salamandra(Salamandri zi e verdhë).
Zvarranikët (reptilia) - Zvarranikët prezent në pjesën e parkut brenda komunës së Sharrit janë: Anguis fragilis (Kokëzogëza), Lacerta muralis (Hardhuca e mureve), Lacerta viridis (Hardhuca e gjelbër), Natrix natrix (Gjarpri i barit, bollujca, bollujësa), Testudo hermanni (Breshka e pyllit), Vipera ammodytes (Neperka).[11]


1.9.1.7. Shfrytëzimi i tokës


Në pjesën e parkut nacional që është pjesë e territorit të komunës së Sharrit (24804.64 ha) dominojnë kryesisht barishtet natyrale me 14230.39 ha (57.37%) dhe zona me vegjetacion të rrallë me 961.32 ha (10.84%). Kullosat ekstenzive pa shkurre marrin pjesë me 5.05%, kurse kënetat me 5.56%. Në strukturën e pyjeve të sipërfaqes së parkut të komunës së Dragashit, dominojnë pyjet halore me 3.8%, pyjet e përziera përfshijnë 3.31% të sipërfaqes, ndërsa pyjet gjetherënëse 1.76%. Shkëmbinjtë e zhveshur marrin pjesë me 3.13% të sipërfaqes.


[10] Conservation of Biodiversity and Sustainable Land Use Management in Dragash. Sustainable Development Atlas to ensure comprehensive and balanced rural development for the Municipality of Dragash , Kosovo - Volume V: Data, April, 2012

[11] Conservation of Biodiversity and Sustainable Land Use Management in Dragash. Sustainable Development Atlas to ensure comprehensive and balanced rural development for the Municipality of Dragash , Kosovo - Volume II: Baseline, April, 2012

Kategoritë e shfytëzimit të tokës në pjesën e parkut nacional që i takon territorit të komunës së Sharrit	Ha	%
Barishte natyrale	14230.39	57.37
Copë toke pyjore	13.52	0.05
Cungishte	352.3	1.42
Kalimi nga vendi malor/shkurre	593.89	2.39
Këneta	1378.74	5.56
Kullosa intensive me gardhe shkurrore	40.61	0.16
Kullosa intesive pa gardhe shkurrore	125.37	0.51
Kullosë ekstensive me shkurre/drunj	60.28	0.24
Kullosë ekstensive pa shkurre	1253.43	5.05
Kultivimi kompleks – pa brez shkurresh	24.53	0.10
Kultivimi kompleks-me breze shkurresh/drunj	63.72	0.26
Njësitë industriale apo komerciale	1.25	0.01
Përfshirja e bagëtisë dhe kapacitetet e barinjëve (zonat malore)	8.27	0.03
Pyje halore	943.43	3.80
Pyje të përziera	821.24	3.31
Pyjet gjetherënëse	436.12	1.76
Shkëmbinjë të zhveshur, rrëpirë, shkrepë, shkëmbinjë	775.79	3.13
Struktura e pavazhdueshme urbane	0.05	0.00
Struktura e vazhdueshme urbane	0.12	0.00
Toka të lagështa të brendshme/zona të tokave të lagështa	8.54	0.03
Tokë e punueshme e paujitur	1.63	0.01
Vegjetacioni i shqopishteve (përfshirë kënetat)	961.32	3.88
Zona me vegjetacion të rrallë	2690.04	10.84
Zonë pyjore afër bregut	20.06	0.08
Gjithsej	**24804.64**	**100.00**








1.9.1.8. Zonat e rrezikuara nga erozioni

Harta erozive e Kosovës tregon se në pjesën e parkut kombëtar që është në komunën e Sharrit, disa sipërfaqe përfshihen nga erozioni me shkallë të ndryshme të intenzitetit. Sipërfaqet me erozion shumë të fortë dhe erozion të fortë janë zonat më të rrezikuara, në të cilat alterohet, bartet dhe akumulohet sasia më e madhe e materialit eroziv.

Zonat që nuk janë të mbuluara me vegjetacion bien nën ndikimin e faktorëve ekzogjen nga alterimi fizik, kimik dhe biologjik dhe në këtë mënyrë shkaktohet rritja e shkallës së erozionit. Bartja dhe akumulimi i materjalit eroziv ndahet ne dy pellgje kryesore lumore: në pellgun e Vardarit në drejtim të Republikes së Maqedonisë dhe në atë të Lumbardhit të Prizrenit në drejtim të Rrafshit të Dukagjinit.

Në bazë të të dhënave në tabelë, në shkallë të lartë është rrezikuar me erozion shumë të fortë 16% e teritorit të PK "Sharri", kurse me erozion të fortë 27%. Karakteristikë e kësaj zone është se viset e larta malore janë te zhveshura.




Erozioni	ha	%
Erozion shumë i fortë	3,530.49	16
Erozion i fortë	6,101.57	27
Erozioni i mesëm	7,431.69	33
Erozion i dobët	5,322.32	24

1.9.1.9. Rreziqet nga natyra

Termetet - Në përgjithësi Kosova konsiderohet zonë aktive sizmike që shtrihet në mes të dy zonave sizmike, atë të bregdetit të Adriatikut dhe atë të luginës së Vardarit me shkallë merkali VII-VIII.
Në zonën e Dragashit nuk janë regjistruar tërmete të fuqishme por ka patur dridhje të tokës edhe ne këtë zonë me ç'rast epiqendra ka qenë larg zonës. Këto tërmete kanë qenë me shkallë nga 2.7 - 4.8.

Ortiqet - Janë fenomene që paraqiten në këtë zonë dhe shkatërrojnë të mirat materiale e fatkeqësisht ata kanë marrë edhe jetë njerëzish. Zona e malit Sharr afër vendbanimeve njihet si zonë e zhveshur nga bimësia ku ortiqet janë dukuri e shpeshtë dhe karakteristikë e zonës.
Një ortek bore me thellësi 10 m dhe me gjërësi 500m, në shkurt të vitit 2012 ka goditur 15 shtëpi në fshatin Restelicë me ç'rast e kanë humbur jetën 9 persona.





1.9.2. Trashëgimia kulturore e komunës së Dragashit

Territori i komunës së Dragashit është i pasur me objekte të tarshëgimisë kulturo – historike që nga periudhat më të lashta të saj. E kaluara historike e Komunës së Dragashit të sotëm nuk mund të shikohet e ndarë nga Prizreni dhe rrethina e tij, për shkak të lidhjes së ngushtë me qytetin dhe ka qenë si pjesë përbërëse e tij. [12]

Në Opojë dhe në Gorë ka mjaft gërmadha të vendbanimeve të vjetra, disa prej të cilave u kanë humbur gjurmët e disa prej tyre u ka mbetur vetëm emri si p.sh. "Zinova" si qytet i lashtë, në afërsi të Bellobradit gjenden gjurmët e lokalitetit të lashtë "Gostil" dhe gjurmë të ngjashme hasim edhe në afërsi të fshatit Brut. Rëndësi të veçantë ka pasur rruga e ndërtuar në periudhën romake Tetovë – Shkodër – Lezhë, e cila ka kaluar nëpër malin Sharr dhe qyteti antik "Zinova" supozohet të ketë pasur rolin e qendrës regjionale tregëtare.

Në periudhën e mesjetës Opoja, Gora dhe Zgatari kanë qenë si qendra të rëndësishme tregtare dhe zejtare. Në periudhën osmane shumë vendbanime kanë fituar fizionominë e qendrave të fuqishme ekonomike, edhe ate duke ndërtuar një numër të madh të objekteve fetare, rrugëve, ujësellësve, kanalizimeve, spitaleve etj.

Kukli begu (në shek.XVI) ishte personalitet i cili ndikoi në zhvillimin ekonomik dhe kulturor të kësaj treve. Ai ndërtoi xhaminë dhe tyrben, sarajin, ujësjellësin "Qeshmja e sarajit", tunelin nëntokësor, namazxhahun, hamamin e shumë objekte tjera të cilat janë shkatërruar dhe janë në shkatërim e sipër.

Sot monumentet me trashëgimi kulturore pothuaj se janë haruar në tërësi. Nuk ka kurfarë mbështetje nga institucionet relevante lidhur me ruajtjen, mbrojtjen dhe konservimin e vlerave që i ka kjo anë dhe promovimin e tyre. Kërkesë nga niveli komunal është që të themelohet një muze komunal historik, kulturor dhe etnografik.

Sipas këtyre të dhënave, dominojnë kryesisht xhamitë 27, tyrbe 5, gërmadha të kalave 3 dhe objekte tjera (tuma, kroje, mullinjë etj).






Foto – Xhamia e Kukli Beut

KOMUNA E DRAGASHIT				
Nr.	objekti / tërësia	vendbanimi	viti i shpalljes	komente
1	**Mbeturinat e kalasë në kodër "Hisarlishte"** shek.II-V, nr.V.E.K.924/67	Krushevë (I - 162)	1967	
2	**Xhamia e Kukli Beut** shek.XVI, nr.V.E.K.925/67	Bresane(I - 163)	1967	Mirëmbahet nga njerëzit që jetojnë në afërsi të saj. Rruga nuk është e asfaltuar dhe çasja jo e përshtashme.
3	**Gërmadhat e objektit fetar (Namazxhah)** shek.XVI, nr.V.E.K.926/67	Buzez (I - 164)		Namazgjahu – i pa mirëmbajtur, të cilit mund t'i humbasin gjurmët me kohë.

[12] Nga Mr. Hajriz Meleqi, Opoja dhe Gora – Vështrim gjeografik (Komuna e Dragashit)

1.9.2.1. Monumentet që kanë status të mbrojtjes në komunën e Dragashit

Nga lista e trashëgimisë kulturore me mbrojtje të përkohshme, e aprovuar në MKRS (2012), janë propozuar këto objekte/ monumente për komunën e Dragashit:

1. Kalaja mesjetare në Hisar të Brutit - Brut;
2. Valavicë – Mulli, shek.XIX – Bellobrad;
3. Mulliri i vjetër, shek XIX – Dragash;
4. Tyrbja e Selim Dedës, shek XVIII – Restelicë;
5. Tyrbe, shek. XVII – Dragash;
6. Xhamia e fshatit (Berat xhamia), shek.XX – Zlipotok;
7. Xhamia e fshatit, shek.XIII – Mlikë;
8. Xhamia e fshatit, shek.XX – Kapre;
9. Varri i madh sallatash, shek.XVIII – Kapre.

Për mundësinë e zhvillimit të turizmit kulturor problem kryesor janë rrugët të cilat nuk janë të asfaltuara dhe mundësia e arritjes në monumente të caktuara është e vështirë.

1.9.2.2. Trashëgimia shpirtërore si pjesë e trashëgimisë kulturore është e shprehur në shkallë më të lartë në trevën e Opojës dhe të Gorës. Etnografia e kësaj ane karakterizohet me një kolorit dhe origjinalitet që kultivohet edhe sot e kësaj dite (Me rastin e festave të motmotit, fejesave, martesave etj).
Këto veshje përdoren më shpesh dhe janë unikate për të gjitha trevat e rajonit dhe më gjerë, p.sh. veshjet e burrave (tirqi, këmishat, brezi, xhamadani etj.), veshjet e grave (këmisha, dimi, xhamadan, përparëse, çorape, shami të verdhë me theke etj.)[13]
Identitetin shpirtëror të Opojës e kompletojnë traditat shumë të ruajtura muzikore, folklorike, këngët e djepit, lindjes, dasmës, këngët dyshe, vallet në rreth, lojërat nëpër ndeje pas darke, hudhja e gurit nga krahu, kërcimi trehapësh, vrapimi i kuajve, sporti i pelivanëve etj.[14]



Foto. - Dasma Opojane



Foto. - Sporti i pelivanëve

[8] Nga revista mujore e K.K.Dragash, Tetor2004 - Buletini
[14] Hajriz Meleqi - Opoja - studim kompleks gjeografik

Ritet[15]

Ritet si dukuri kulturore e shprehur në këto anë përmbanë praktika të një pjese të shoqërisë, me karakteristika të veçanta të një veprimi me qëllim të caktuar, të cilat kanë një histori dhe përcillen gjeneratë pas gjenerate. Ritet e motmotit në të kaluarën tonë, paraqesin një thesar vlerash të cilat ruajnë besimet dhe bestytnitë të lidhura ngushtë me natyrën, gjithnjë në mbarëvajtje të një grupi apo rrethi më të gjërë të shoqërisë. Këto vlera kulturore të organizuara me ceremoni të riteve të motmotit në këto anë mund t'i veçojmë: Riti i Verzës, Shëngjergjit dhe Thirrjes së shiut.

Riti i Verzës (ardhja e stinës së verës) – në Opojë është njëri ndër ritet e motmotit dhe që bëhet me një përkushtim të veçantë. Organizohet në natën e 13 Marsit deri në lindjen e diellit të 14 Marsit. Riti është i përmbushur me shumë elemente të karakterit magjik me synim spastrimi, plleshmërie, shëndeti, që i kushtohet individit, familjes, farefisit, fashatit etj. Organizimi bëhet në kodrinat në këtë rast të fshatit Bresanë, ku secila lagje ndez zjarr (me degë të mbledhura nga të rinjtë), gjithnjë në garë me lagjet tjera për zjarrin më të madh, e cila simbolizon rritjen e mbarësisë së familjes, lagjes dhe fshatit. Gjatë natës së ritit vajzat e fshatit i dekorojnë vezët të cilat i marrin në shporta të veta dhe me veprime magjike i kushtojnë shëndetit dhe mbarëvajtjes gjatë vitit. Spastrimi nga mëkatet bëhet përmes kapërcimit të zjarrit tri herë (në shuarje e sipër), të cilat përcillen me veshje ceremonial, muzikë dhe valle, me larje të fytyrës dhe flokëve në lum në orët e mëngjesit, dhe ceremonia përfundon me një drekë rituale të pregatitur nga zonja e shtëpisë.



Foto. - Riti i Verzes

Identiteti shpirtror dhe kulturor i trevës së Gorës karakterizohet me një folklor të pasur dhe tradita kulturore, me veshje specifike folklorike dhe vallezime. Në aspektin kulturor, dasmat e tyre janë unike duke u dalluar nga ato të pjesës tjetër te rajonit. Ata gjithashtu i festojnë disa festa në ditë të caktuara, siq është Dita e Shën Gjergjit e cila i perket traditave pagane qe jane specifike te të gjithë popujt në këtë rajon. Muzika tradicionale tipike e goraneve zakonisht përfshinë vallen dytaktëshe të quajtur "Kolo" ('rreth'), që është një valle në rreth me përqendrim tek lëvizjet e këmbëve dhe gjithmonë fillon me këmbën e djathtë dhe lëvizë në drejtim të kundërt të lëvizjes së akrepave të orës. Vallja "kolo" zakonisht shoqërohet me muzikë instrumentale (daulle dhe zurla) dhe rrallë përcillet me këndim[16].

[15] Rite dhe Aktualiteti, Dhjetor 2011

[16] Malet e Dragashit, Kosovë: Udhëzues për Turizëm Natyror dhe shetitje



Foto. - Meshkuj goranë në ceremoni dasmore

Brodi, është njëri nga fshatrat kryesor të Gorës. Ky fshat i vogël tradicional ende ka shumë objekte tradicionale nga periudha osmane dhe shtëpi guri përgjatë lumit.

Karakterizohet me traditat shpirtërore dhe kulturore që kultivohen edhe sot. Këtu shohim ndërtime të shtëpive tradicionale prej guri dhe, sikur edhe në disa fshatra tjera, ekziston një traditë e ngjitjes së bajgave të kafshëve në muret e shtëpive të cilat kryejnë funksionin e izolimit të murit.



Foto. - Ndërtesë e gurit nga koha osmane në fshatin Pllajnik

Brenda kufijve të territorit të Parkut që përfshihet në kuadër të komunës së Dragashit, nuk kemi objekte, lokalitete apo monumente me trashëgimi kulturore. E gjithë trashëgimia kulturore e cekur më lartë, përfshihet me vendabanimet që e rrethojnë parkun dhe do të kenë ndikim në zhvillimin ekonomik si të parkut, të komunës së Dragashit dhe fshatarëve të këtyre anëve. Një zhvillim i tillë do të realizohej përmes zhvillimit të turizmit rural dhe shërbimeve turistike të shtëpive fshatare me ofrimin e bujtinave, ushqimit tradicional dhe organik, vizitës së monumenteve me trashëgimi kulturore, duke e fuqizuar promovimin e trashëgimisë shpirtërore.

1.9.3. Gjendja ekonomike e vendbanimeve përreth parkut

Në pjesën e territorit të Sharrit (Dragashit) që përfshihet në kuadër të hapësirës së Parkut Kombëtar "Sharri" nuk ka aktivitete të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Të gjitha aktivitetet zhvillohen në fshatrat përreth parkut. Duke patur për bazë bizneset e regjistruara, veprimtaria ekonomike që dominon në komunën e Sharrit është tregëtia e përcjellur nga industria përpunuese dhe veprimtaria hoteljere. Natyrisht që bujqësia, pylltaria dhe peshkimi janë veprimtari prezente nëpër vendbanime, por ato, në numrin e bizneseve të regjistruara marrin pjesë vetëm me 1%. Verprimtaritë ekonomike kryesisht bëhen për konsum familjar. Mungon mënyra e organizuar e plasimit të prodhimeve në treg.

Disa nga aktivitetet të cilat do të kenë ndikim më të madh në shfrytëzimin, rregullimin dhe planifikimin e territorit të parkut do të trajtohen.

1.9.3.1. Veprimtaria bujqësore dhe blegtorale

Një pjesë e territorit të parkut kombëtar shfrytëzohet për veprimtari bujqësore dhe blegtorale. Prodhimet bujqësore dhe blegtorale të prodhuara në vendbanimet përreth parkut, kryesisht shfrytëzohen për nevojat familjare e nganjëherë tepricat plasohen në treg. Në të gjitha vendbanimet kultivohen pemët dhe perimet. Njihet kultivimi i qenit të Sharrit (pastori ilir), deleve dhe kuajve. Mjalti dhe djathi i Sharrit njihen si produkte karakteristike të këtij territori e poashtu këtu mbahen pulat për prodhimin e vezëve.

Regjioni i Opojës dhe Gorës është shumë i pasur me bimë mjekësore, aromatike dhe bimë të tjera të rëndësishme për industrinë farmaceutike, ushqimore dhe kozmetike.

Sipas të dhënave nga "Axhenda e Zhvillimit të Komunës 2004-2006", tradita e qumështit, grumbullimi i frutave dhe përpunimi i tyre është një biznes joformal.

1.9.3.2. Veprimtaria pyjore

Një pjesë e pyjeve të pronarëve privat përdoret për dru zjarri. Në strukturën e vegjetacionit, dominojnë kullosat, ndërkaq pyjet mbulojnë sipërfaqe më të vogla. Livadhet shtrihen në afërsi të vendbanimeve, pa marrë parasysh lartësinë mbidetare.

1.9.3.3. Ekonomia turistike

Kjo ekonomi ngërthen në vete të gjitha veprimtaritë që janë në funksion të zhvillimit të turizmit në zonën e parkut kombëtar.

Pavarësisht pasurive natyrore, pasurive në florë, faunë dhe tradita kulturore që zona disponon, nga qeveria e ish Jugosllavisë nuk u investua për zhvillimin e turizmit. Ndonëse kanë kaluar mbi dhjetë vjet nga intervenimi i NATO-s, rajoni vazhdon të jetë relativisht i panjohur për turistë[17].

Territori i Dragashit i cili përfshihet në kuadër të hapësirës së zgjeruar të Parkut Kombëtar "Sharri" ka potencial për aktivitete të llojllojshme turistike, por "parqet dhe zonat e mbrojtura kërkojnë objekte dhe shërbime për tu akomoduar dhe përdorur nga vizitorët, stafi në park dhe të tjerët"[18], e të cilat për fat të keq mungojnë.

Në vazhdim do të flitet për gjendjen ekzistuese dhe potencialet e zonës së Sharrit (Dragashit) në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri".

Vargu malor i Maleve te Sharrit është një lokacion ideal për aventura të panumërta në natyrë, ekskursione, hulumtime shkencore dhe shijim të produkteve tradicionale, ku çdo stinë ofron një cilësi të veçantë. Nga fundi i muajit prill, atëherë kur fillon të shkrihet bora, e deri vonë në tetor, malet e Dragashit janë një vend ideal për shetitje. Në pranverë, fushat dalin në pah me ngjyra dhe mbulohen me lulëzim. Në verë, bora shkrihet nga malet e larta duke krijuar pamje atraktive. Vjeshta eshte e ftohtë dhe e freskët, kjo stine krijon pamje madhështore të maleve me llojllojshmërinë e ngjyrave, ndërsa dimri ofron mundësi të skijimit malor dhe ecjes në borë.

Komuna e Sharrit aktualisht nuk ka qendër informative turistike. Komuna është duke hartuar planin zhvillimor të komunës dhe në kuadër të tij parashihet edhe strategjia për zhvillimin e turizmit. Nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), në bashkëpunim dhe me përkrahjen e ngushtë të Qeverisë së Kosovës, komunës dhe popullatës së Dragashit është përpiluar dokumenti "Malet e Dragashit, Kosovë: Udhëzues për turizëm

[17] Malet e Dragashit, Kosovë: Udhëzues për Turizëm Natyror dhe Shetitje
18 TOURISM IN NATIONAL PARKS ANDPROTECTED AREAS Planning and Management

natyror dhe shetitje". Ky është udhëzuesi i parë për Dragash, me qëllim të promovomit të vlerave natyrore, të Kosovës dhe për të nxitur një turizëm të qëndrueshëm[19]. Ky udhëzues përmban hartën me 14 shtigje te parapëlqyera për shetitje, 4 shtigje për çiklizëm malor, vende për kampim dhe ka udhëzime të hollësishme se si dhe ku të shkohet. Ndonëse ka kaluar një kohë nga identifikimi i këtyre shtigjeve për ecje dhe çiklizën, ende nuk ka hapa konkret të shenjëzimit dhe tabelave iformative në teren.

1.9.3.4. Zona e Dragashit në kuadër të PK"Sharri"

Qasja për në Dragash dhe zonat përreth mundësohet me rrugën e cila në fshatin Zhur lidhet me rrugën Prizren - Kukës. Nuk ka qarkullim të trenit në këtë pjesë të Kosovës dhe stacioni më i afërt i autobusëve është në Prizren. Nga aty mund të shfrytëzohet linja ditore e autobusëve që qarkullojnë për në Dragash.

Zonat me vlera të posaçme në kuadër të masivit të Sharrit që i përkasin komunës së Dragashit janë Opoja dhe Gora me vendbanimet karakteristike, të cilat janë jashtë territorit të parkut kombëtar. Kur flitet për ekonominë turistike duhet të parashikohet ndikimi indirekt i vendbanimeve, vendbanim - park dhe anasjelltas. Ne bazë të hulumtimeve dhe vlerësimeve, kjo hapësirë disponon me kushte shumë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit. Faktorët që mundësojnë zhvillimin e turizmit janë: peizazhet e bukura, klima e përshtatshme, ajri i pastër, numri i madh i burimeve dhe gurrave të ftohta, numri i madh i lumenjve dhe luginave atraktive, pyjet, flora dhe fauna, liqenet, traditat, zakonet dhe folklori.

Hulumtimet dhe vlerësimet e shumta që janë bërë në lidhje me potencialet natyrore tregojnë se në komunën e Sharrit ekzistojnë predispozita për zhvillimin e turizmit si:

1.9.3.5. Turizmi malor - Kushtet për zhvillimin e këtij lloji të turizmi janë ideale. Këtu vlen të veçohen terrenet me pjerrtësi të lehtë dhe shtigjet ekzistuese të cilat i përdorin blegtorët për bagëtitë e tyre e të cilat paraqesin parakusht dhe mundësi reale për alpinizëm, ecje dhe shëtitje malore me biçikleta.

[19] Inicuespwr hartimin e dokumentit Todd Wassel/Punonjës i Kombeve të Bashkuara, shetitës malor i pasionuar.

Malet e Brodit, Restelicës, Radeshës e Zaplluzhës janë shumë të përshtatshme për skijim, të cilave iu nevojitet një shtresë e hollë e borës dhe mundësia e shfrytëzimit për skijim mund të zgjasë deri 6 muaj gjatë sezonit dimëror. Sipas vlerësimeve, kapacitet e terreneve të skijimit të këtyre qendrave mund të përballojnë deri në 30000 skijatorë. Karakteristikë e këtyre shtigjeve është edhe mundësia për skijim në bar, sidomos në pjesën e Zaplluzhës.



Gjatë sezonit dimëror nga Federata e Skitarëve të Kosovës organizohen gara në ski. Mungesa e infrastrukturës dhe shërbimeve adekuate pamundësojnë zhvillimin e masivitetit të këtyre aktiviteteve sportive.

1.9.3.6. Turizmi edukativ - Në bazë të të dhënave aktuale, zona është ndër qendrat më të pasura të biodiversitetit në Ballkan, me shumë specie endemike, relikte, të rëndësishme dhe të rralla të kafshëve dhe bimëve. Në bazë të të dhënave nga hulumtimet e mëparshme, ekzistojnë rreth 2000 specie të bimëve shëruese apo më tepër se 20% e të gjithë florës së Ballkanit. Fauna në Malin Sharr përfshin afërsisht 50 specie të gjitarëve, 17 specie të zvarranikëve dhe ndërmjet 129 dhe 200 specie te zogjëve varësisht nga burimi i informatave. Me mbi 147 specie te fluturave, zona ofron një mundësi për hulumtime shkencore.

Bota bimore dhe shtazore, hidrografia dhe natyra e komunës së Sharrit, në përgjithësi paraqesin burim potencial për zhvillimin e aktiviteteve hulumtuese të nxënësve, studentëve dhe shkencëtarëve të ndryshëm brenda Kosovës por edhe të huaj.

1.9.3.7. Turizmi i peshkimit - Lumenjt dhe përrockat e pjesës së parkut kombëtar që i takon territorit të komunës së Sharrit, janë shumë të pasur me trofta malore. Edhe përkundër mungesës së infrastrukturës ato vizitohen nga të pasionuarit për sportin e peshkimit.

Produktet unike turistike vizitohen nga një numër shumë i vogël i vizitorëve, për shkak të mungesës së promovimit të vlerave natyrore, kulturore dhe mungesës së infrastrukturës .

1.9.3.8. Akomodimi - Në zonë nuk ka objekete hoteliere, ndërsa në fshatrat përreth kufirit të parkut ekziston një numër i kufizuar i tyre. Sharri (Dragashi) ende e ka në nivel relativisht të ultë mundësinë e akomodimit. Akomodimi më i zakonshëm i ofruar është në formë të hoteleve me shërbime themelore apo bujtinave private shtëpiake. Në Brod ndodhet qendra rekreative turistike "Arxhena" dhe një shtëpi private e adaptuar për bujtinë e cila ka nevojë për renovim për t'u prezantuar me një cilësi më të lartë turistike. Në fshatin Zaplluzhë, një hotel është mbyllur për shkak të numrit të vogël të vizitorëve. Ata që kërkojnë akomodim më specifik, mund të shkojnë në Sharr ku gjendet hotel Meka dhe në Prizren ku ofrohen një mori zgjedhjesh.

1.9.3.9. Vendbanimet përreth parkut

Komuna jugore e Kosovës, Sharri është një oazë e bukurisë së paprekur natyrore dhe fshatrave tradicionale, të cilat shtrihen përreth Parkut Kombëtar "Sharri", i cili me një pjesë të tij merr pjesë në territorin e kësaj komune. Prej këtyre fshatrave, më afër me parkun janë: Restelica, Brodi, Zaplluzha, Pllajniku, Radesha, Leshtani, Dikanci, Baçka, Zlipotoku, Krusheva, Gllboçica, Orçusha, Kërsteci, Rapça, Buça dhe Brezna. Këto së bashku kanë rreth 17000 banorë.

Restelica – Prej këtyre fshatrave më i madhi është Restelica me 4700 banorë. Fshati, të cilin e përshkon gryka e lumit, ndodhet në male me pjerrtësi të rrëpira. Hyrja ne Restelicë është po aq interesante sa dhe shetitja rreth saj deri në fushat, rrafshnaltat e larta në jug, pa u larguar shumë nga fshati. Kjo shetitje të shpie në maje te malit Karpa me lartësi mbidetare 2125m, prej nga shihen pamje mbresëlënëse mbi fushat jugore të Dragashit dhe të Shqipërisë. Rruga e pa asfaltuar që shpie në jug të Restelicës është shteg ideal për çiklizëm malor. Rruga shpie deri te kufiri me IRJ të Maqedonisë, Parku Nacional i Mavrovës dhe në disa nga zonat më të largëta të Dragashit.

Veprimtaria ekonomike në këtë vendbanim është e fokusuar në prodhimin e produkteve natyrore siq janë djathi dhe mjalta dhe në kultivimin e perimeve, pemëve, pemëve të egra dhe barishteve. Restelica njihet për prodhimtarinë e lartë të qumështit të deles dhe të lopës e për më pak prodhime bujqësore që është si rezultat i terreneve të pjerrta dhe lartësisë mbidetare më të madhe. Ajo është qendër kulturore e goranëve dhe me bjeshkët e luginat e lumenjve, ka një potencial të madh për zhvillimin e turizmit. Tiparet tjera të këtij vendi që zgjojnë interesimin janë qeni i Sharrit, artizanatet, festivalet dhe ritualet martesore.

Përkundër madhësisë që ka, në Restelicë shërbimet janë të limituara: nuk ka qendër shëndetësore, nuk ka zyrë postare, nuk ka bankë, nuk ka stacion policor, nuk ka shkollë të mesme, nuk ka barnatore, nuk ka hotel, nuk ka kablla nëntokësor dhe as pompë të benzinës. Restelica i ka 95 biznese të regjistruar, më shumë se çdo fshat tjetër në komunën e Sharrit. Në to janë të punësuar 107 persona. Nga numri i dyqaneve, 25% janë bare dhe restorante. Një numër i madh i banorëve të Restelicës punojnë jashtë vendit që të mund t'i mbajnë familjet e tyre.

Brodi i ka 1544 banorë. Ai është një fshat i banuar me goranë dhe gjendet në anën lindore të territorit të komunës së Sharrit, i ndarë nga male mbresëlënëse në afërsi të fshatit Restelicë. Brodi shtrihet rrëzë Maleve të Sharrit, i rrethuar me monumente të natyrës duke filluar nga malet, shkëmbinjtë e deri te lumenjt e rrëmbyeshëm. Nga fshati Brod mund të arrihet me lehtësi deri në malin Çule nëpër shtigjet e këmbësorëve të cilat janë renovuar së voni dhe tani kanë edhe tabela informuese. Këtu tani shetitjet janë ndër më të shpejtat. Në periferi të fshatit janë fushat malore me dëllinje dhe bimë tjera barishtore. Këtu kultivohen shumë frutat dhe perimet. Ky fshat poashtu karakterizohet me prodhimin e djathit dhe prodhime tjera prej qumështi, rritjen e kuajve. Banorët lokal kanë rreth njëqind krerë lopë, ku edhe me tutje vazhdohet tradita e gjatë e prodhimit të kosit, djathit dhe qumështit, kurse djathi i këtushëm

konsiderohet si një nga më të mirët në Kosovë. Korriku dhe gushti karakterizohen me mbledhjen e boronicave të egra. Brodi i ka 30 biznese të regjistruar në të cilët janë punësuar 32 persona. Me veçoritë e natyrës, pejsazhet mbresëlënës dhe shtigjet për ecje që i ka, Brodi ka potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit.



Foto. - Fshati Restelica

Vendbanimet Zaplluzhë, Pllajnik, Radeshë, Leshtan, Kërstec, Rapçë dhe Brezne karakterizohen me një infrastrukturë dhe rrjet të komunikimit përgjithësisht të dobët. Në to kultivohen frutat dhe perimet e poashtu banorët merren me blegtori, ndonëse nuk ka shumë produkte që ato të plasohen edhe në treg, por janë kryesisht për nevoja familjare. Sikurse Brodi, edhe këto fshatra, me mundësitë që i ofrojnë për ecje në natyrë dhe pejsazhet mahnitëse, e kanë një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit. Përveq maleve të Sharrit, këtu është edhe mali Koritnik. Mali Koritnik një nga malet kryesore në komunën e Dragashit, me biodiversitetin e pasur ofron pamje mahnitëse të Maleve të Sharrit në lindje dhe të Bjeshkëve të Nemuna në Shqipëri në drejtim të perëndimit.

Vendbanimet Dikanc, Baçkë, Zlipotok, Krushevë, Glloboçicë, Orçushë dhe Buçe janë vendbanime ku numri i banorëve është nën 1000 dhe në vitet e fundit ky numër ka qenë në rënje për shkak të braktisjes së fshatrave nga popullata. Diferenca në mes të numrit të banorëve gjatë stinës së verës dhe atij gjatë dimrit, në këto vendbanime është e madhe sepse shumë banorë qëndrojnë vetëm gjatë verës atje. Midis 70% dhe 90% të këtyre banorëve, të ardhurat e tyre i sigurojnë jashtë komunës. Kjo është një prej arësyeve që në këto fshatra ka më pak prodhime blegtorale dhe bujqësore. Në këto vende ka probleme domethënëse me rrjetat e komunikimit, infrastrukturën e sidomos me menaxhimin e mbeturinave. Niveli i zhvillimit të shërbimeve publike në këto fshatra është i ultë. Me gjithë vështirësitë ekonomike, vlera e këtyre vendbanimeve pasqyrohet në trashëgiminë e pasur natyrore, por edhe shpirtërore të tyre.

Opoja është një trevë në pjesën veriore të komunës së Sharrit, në kufi me komunën e Prizrenit. Kjo trevë karakterizohet kryesisht me tokë bujqësore dhe me kodrina të rrethuara me male të larta që shkojnë përgjatë kufirit me IRJ të Maqedonisë. Lugina e Opojës me një numër të fshatrave përreth lidhen me një rrjet rrugor ideal për çiklizëm të lehtë. Në zonë gjendet një numër i lumenjve të vegjël dhe pyje ku mund të mbledhen kërpudha të freskëta në pranverë, në fund të verës dhe në fillim të vjeshtës.

Lartë në mal fshati Zaplluzhë ka të vetmen shtëpi malore në këtë zonë, të përshtatshme për grupe që kërkojnë rehati derisa qëndrojnë në malet e larta. Pak më lart në mal gjendet nje shteg skijimi por pa një infrastrukturë adekuate.



Foto. - Dëgjimi i pëshpëritjes

Në këtë zonë ndodhet shpella "Dëgjimi i pëshpëritjes", e cila arrin madhësinë e një stadiumi të vogël futbolli dhe e cila nuk ka ndonjë përkujdesje institucionale. Këtu thuhet se nëse dikush dëshiron ta mësojë gjininë e një foshnjeje, duhet ta hedhë një gur në shpellën "Dëgjimi i pëshpëritjes".

Shtegu i ecjes prej Gurit të Zi deri te Sytë e Malit shpie deri te dy liqene postglaciale në kufi me IRJ të Maqedonisë. Duke filluar nga fshati Zaplluzhë, shtegu është i definuar mirë dhe i lehtë për t'u ndjekur deri lart. Ky është i përshtatshëm edhe për makina speciale (4x4) për zonat malore.



Foto - Sytë e Malit

1.9.4. Gjendja e infrastrukturës

1.9.4.1. Transporti dhe infrastruktura e tij

Rruga regjionale R113 në pjesën jugore të saj shtrihet në perëndim të territorit të komunës së Sharrit. Tek fshati Gllobočicë kjo rrugë afrohet fare pranë kufirit të Parkut Kombëtar "Sharri" gadi sa takohet me të. Duke vazhduar kah jugu për tek fshati Restelicë, i cili gjendet mu pranë kufirit të parkut, rruga R113 në një segment fare pranë fshatit Krushevë dhe në një segment midis fshatrave Krushevë dhe Restelicë, kalon nëpër vijën kufitare të parkut. Rruga regjionale R114 që fillon në Sharr (Dragash) dhe vazhdon të shtrihet kah juglindja për tek fshati Brod, afër fshatrave Dikanc dhe Bačkë bashkohet me vijën kufitare të parkut dhe vazhdon nëpër atë vijë deri në Brod, i cili gjendet mu pranë kufirit të parkut. Rruga regjionale R 222 lidhet me R 113 afër fshatit Pllavë dhe shtrihet kah lindja deri tek fshati Zaplluzhë. Kjo rrugë në një segment midis fshatrave Blaç dhe Zaplluzhë i afrohet më së shumti vijës kufitare të parkut, rreth 1.4 km në vijë ajrore. Asnjëra prej rrugëve regjionale nuk hyn brenda në territorin e parkut, por në vazhdim të këtyre tri rrugëve janë rrugët lokale, të cilat hyjnë në parkun kombëtar. Rrugët regjionale në fjalë janë në gjendje relativisht të mirë fizike, sidomos rruga R 114.

Brenda territorit të parkut nuk ka vendbanime, prandaj tani për tani nuk ka transport publik që do t'ua mundësonte udhëtarëve shkuarjen në park. Transporti publik me furgonë që realizohet nga operatorët privat, të cilët nuk kanë leje komunale dhe as orar të caktuar të qarkullimit, ua mundëson qytetarëve të shkojnë në të gjitha fshatrat që janë më afër parkut. Siq është thënë më lart, disa nga këta fshatra janë mu pranë kufirit të parkut kombëtar. Transporti i organizuar me autobus ku operatori ka leje komunale, realizohet vetëm në relacionin Sharr – Zaplluxhë. Zaplluxha është fshat në afërsi të parkut. Operatori është ndërmarrja transportuese "Edi Tours" me seli në Zaplluxhë. Qarkullimi realizohet një herë në ditë me ç'rast nisja nga Zaplluxha është në orën 6 e 40, kurse për kthim, nisja nga Sharri është në orën 15 e 10.

1.9.4.2. Infrastruktura ujore[20]

Meqenëse brenda territorit të parkut kombëtar nuk ka vendbanime, sa i përket infrastrukturës ujore (hidroteknike), këtu do të flitet për vendbanimet përreth parkut, që janë më afër parkut ku ndikimi midis tyre dhe parkut është i ndërsjellë. Asnjëri nga 16 vendbanimet përreth parkut, për të cilët flitet këtu nuk

[20] Të dhënat për infrastrukturën ujore janë marrë nga draftdokumenti i planit zhvillimor të komunës së Dragashit të hartuar nga UNDP.

furnizohet me ujë nga ndonjë sistem qendror i furnizimit. Ata furnizohen nga sisteme private që e marrin ujin qoftë nga puset, krojet apo nga ujrat mbitokësor. Nga këto vendbanime, përqindjen më të ultë të banorëve që furnizohen me ujë e kanë fshatrat Brezne dhe Rapçë me vetëm rreth 20% të banorëve që furnizohen me ujë të cilin e marrin nga puset. Në fshatrat Restelicë dhe Kërstec 80% e banorëve furnizohen me ujë nga sistemet private, me ç'rast në Restelicë uji merret nga ujrat mbitokësor, kurse në Kërstec nga puset. Në vendbanimet tjera përreth parkut, me ujë furnizohen 100% të banorëve. Në Zaplluzhë, Pllajnik, Leshtan, Dikanc, Baçkë, Brod, Zlipotok, Krushevë, Glloboçicë dhe Buçe uji merret nga ujrat mbitokësor, kurse në Radeshë dhe Orçushë nga krojet.

Sa i përket sistemeve të kanalizimit të ujrave të zeza, ata janë instaluar në vendbanimet Zaplluzhë, Radeshë, Leshtan, Baçkë, Zlipotok, Restelicë dhe Krushevë, kurse pjesërisht në Pllajnik, Kërstec dhe Rapçë. Vendbanimet tjera përreth parkut pra nuk kanë sisteme të tilla.

1.9.4.3. Infrastruktura e energjisë elektrike[21]

Elektriciteti në Sharr ka arritur në vitin 1957 kur ndërtohet rrjeti elektrik dhe fillon prodhimin hidrocentrali i Dikancit. Ky rrjet është edhe sot në përdorim, ndërkaq hidrocentrali, nga viti 2000 është jasht funkcionit. Energjia elektrike me të cilën furnizohen vendbanimet e komunës së Sharrit prodhohet në termoelektranat A dhe B që janë afër Kastriotit (Obiliqit). Ato furnizohen përmes largpërçuesit 35 kV i cili vjen nga Prizreni. Rrjeti i shpërndarjes në komunë menaxhohet dhe mirëmbahet nga Distribucioni Prizren – Njësia Punuese Sharr. Kjo njësi e menaxhon infrastrukturën në vazhdim:

1. Trafostacioni bazë në Sharr – TS 35/10kV me dy transformator /transmetues të energjisë me fuqi instaluese Sn=8MVA+4MVA= 12 MVA dhe hidrocentrali i Dikancit me fuqi Sn=2.5 MVA
2. Rrjeti i tensionit të lartë 10kV :

a) Rrjeti ajror 10 kV me gjatësi L=86 km me përçues Al-Fe
b) Rrjeti i kabllove nëntokësor 10 kV me gjatësi L=1 km

3. Rrjeti i tensionit të ultë 04 kV:

a) Rrjeti ajror 04 kV me gjatësi L=140 km me përçues Al-Fe
b) Rrjeti i kabllove nëntokësor 04 kV me gjatësi L=0.5 km
c) Rrjeti ajror me kabëll gërshetë 04 kV me gjatësi L=2.43 km

4. Trafostacionet 10/04 kV në lokacionet në qytezën e Sharrit dhe në fshatra

Në total janë 88 transmetues të energjisë elektrike me një fuqi instaluese Sn=20.02 MVA prej të cilëve:


a) TS 10/04 kV Piramidë (nga druri), 6 transmetues të energjisë
b) TS 10/04 kV kulla, 11 transmetues të energjisë elektrike
c) TS 10/04 kV objekte të blinduara, 7 transmetues të energjisë
d) TS 10/04 kV shtylla nga çeliku, 64 transmetues të energjisë

Tetëmbëdhjetë prej këtyre trafostacioneve nuk janë pronë e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), por privat.

Shumë nga këto vendbanime përreth parkut e kanë një problem të përbashkët që është tensioni i ultë i elektricitetit. Rrjeti i rrymës elektrike në komunën e Sharrit është i vjetruar. Transmisioni i elektricitetit është i shoqëruar me humbje teknike. Rritja e popullësisë dhe e vendbanimeve ka bërë që sistemi i transmisionit dhe ai i shpërndarjes të mbingarkohen. Mirëmbajtja e rrjetit nuk është në nivelin e duhur në çka, përveq tjerash, ka ndikuar edhe terreni i vështirë në shumë vende.

[21] Të dhënat për infrastrukturën e energjisë elektrike janë marrë nga draftdokumenti i planit zhvillimor të komunës së Dragashit të hartuar nga UNDP.

1.9.4.4. Telekomunikacioni[22]



[22] Të dhënat për telekomunikacionin janë marrë nga draftdokumenti i planit zhvillimor të komunës së Dragashit të hartuar nga UNDP.

Njësia e Postës dhe Telekomit të Kosovës (PTK) që është në qytezën e Sharrit siguron shërbimet postare dhe ato të telefonisë fikse edhe në disa nga vendbanimet përreth parkut. Vendbanimet me shërbimet postare janë: Zaplluzha, Leshtani, Dikanci, Baçka, Brodi, Zlipotoku, Restelica, Krusheva, Gllboçica, Rapça dhe Brezna. Sa i përket telefonisë fikse, rrjeti i kësaj telefonie është i shtrirë vetëm në dy nga vendbanimet përreth parkut, në Brod dhe Gllboçicë. Signali i telefonisë mobile i mbulon të gjitha vendbanimet përreth parkut por jo me të njëjtin kualitet. Vendbanimet Buçe, Orçushë dhe Radeshë kanë problem me signalin shumë të dobët të kësaj telefonie, kurse signali më i fortë është në Zaplluzhë dhe Kërstec. Të gjitha vendbanimet përreth parkut kombëtar janë të lidhura në Internet.

1.10. Analiza e gjendjes - SWOT

Përparësitë

1. Ekzistenca e institucioneve të planifikimit hapësinor;
2. Ekzistenca e autoritetit të parkut që është drejtoria e parkut
3. Veçoritë natyrore (relievore, klimatike dhe hidrologjike);
4. Biodiversiteti – florë alpine në vende të larta dhe faunë e pasur;
5. Florë endemike;
6. Fond i pasur me pyje dhe kullosa;
7. Qasje e mirë rrugore në park;
8. Largësia relativisht e vogël nga qendrat më të mëdha të Kosovës;
9. Afërsia territoriale dhe rrugore me Maqedoninë;
10. Afërsia me aeroportin e Prishtinës dhe Shkupit;
11. Potencialet për zhvillimin e turizmit;
12. Ekzistimi i tregut të klasës turistike;
13. Privatizimi në proces i kapaciteteve hoteliere

Mundësitë

1. Përfshirja në iniciativat ndërkombëtare, shfrytëzimi i projekteve të ndryshme;
2. Shfrytëzim i përvojave të vendeve të zhvilluara;
3. Aktivitete hulumtuese-shkencore dhe edukativo-arsimore;
4. Bashkëpunimi ndërkufitar në përcaktimin e zhvillimeve;
5. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe qasje në shumë institucione monetare ndërkombëtare;
6. Konkurrimi i Kosovës në rajon dhe më gjerë me kapacitetet turistike të parkut;
7. Zhvillimi i turizmit rural-eko turizmit

Dobësitë

1. Mungesa e planit hapësinor, planit menaxhues te parkut;
2. Menaxhimi i dobët dhe jo i koordinuar i parkut nga tri subjekte;
3. Moszbatimi i legjislacionit;
4. Buxhet jo i mjaftueshëm
5. Shfrytëzim joracional i resurseve natyrore;
6. Degradimi i pyjeve si pasojë: zjarri, sëmundjet dhe prerjet e pakontrolluara;
7. Mungesa e pyllëzimit dhe ripyllëzimit;
8. Shkalla e lartë e erozionit;
9. Mungesa e impianteve për trajtimin e ujrave të zeza;
10. Niveli i ulët i shërbimeve publike (hapësira për parkim, transporti publik, energjia elektrike, telefonia mobile);
11. Mungesa e shtigjeve për vizitorët;
12. BKK nuk përfiton nga të hyrat e kapaciteteve ekzistuese turistike;
13. Rënia e numrit të turistëve në krahasim me vitet e 80-90-ta

Rreziqet

1. Mospërfshirja në konventa, iniciativa dhe organizata ndërkombëtare (IUCN, WTO, RIO etj);
2. Vendet fqinje më atraktivi për investime;
3. Vonesa në zgjidhjen e çështjes së menaxhimit të parkut nacional;
4. Mosinteresimi i deritashëm i institucioneve përgjegjëse për parkun;
5. Mosarritja e standardeve të kërkuara evropiane për turizëm;
6. Moskoordinimi i investimeve (infrastruktura teknike dhe të shërbimeve)

1.11. Sfidat e zhvillimit të ardhshëm hapësinor

Ajo që u tha më sipër, tregon se zona që mbulon Parku Kombëtar „Sharri" ballafaqohet me probleme dhe çështje të shumta të trajtuara në fushat si: mjedisi, zhvillimi ekonomik dhe infrastruktura. Të gjitha këto në njëfar mënyre janë të ndërlidhura dhe ndikojnë në njëra tjetrën. Menaxhimi, infrastruktura teknike e pamjaftueshme, lëvizja e lirë, prona, investimet, papunësia janë vetëm disa nga çështjet për të cilat duhet të ofrohen zgjidhje.

Ballafaqimi me qështje që kanë të bëjnë me mjedisin, momentalisht është njëra ndër sfidat kryesore në shoqërinë kosovare. Mungesa e planeve hapësinore, si në nivelin qëndror dhe posaqërisht në atë lokal në të shumtën e rasteve është me ndikim negativ në mjedis. Zhvillimet që po ndodhin në hapësirë, pjesa më e madhe e tyre janë në kundërshtim me normat dhe standardet mjedisore. Edhe zona e parkut, megjithëse jo në të njëjten masë po ballafaqohet me zhvillime të ngjashme. Prandaj pjesëmarrësit të përfshirë në procesin e hartimit të planit hapësinor kanë identifikuar një numër të madh sfidash, prej të cilave janë veçuar ato me prioritet më të lartë.

Sfida 1

Administrimi dhe menaxhimi i parkut.

Cila është mënyra më e mirë dhe më e përshtatshme për menaxhimin dhe administrimin e drejtë të parkut?

Pse dhe çka është sfiduese?

Territori i Parkut Kombëtar "Sharri" ka vlera natyrore të rëndësisë së jashtëzakonshme për Kosovën. Prandaj, mbrojtja, ngritja dhe shfrytëzimi i këtyre vlerave janë të interesit të gjerë shoqëror. Kjo krijon nevojën që problemit të udhëheqjes, në pajtim me specifikat e territorit të parkut, kërkesat dhe interesin e subjekteve të shumta si shfrytëzues të vlerave në parkun kombëtar, t'i ipet një rëndësi e veçantë.

Momentalisht ekzistojnë disa subjekte që kanë "hise" në menaxhimin me pasuritë pyjore të Parkut. Është drejtoria e Parkut me seli në Prizren; është Agjncia e pyjeve, e cila praktikisht i menaxhon të gjitha pyjet e Kosovës; dhe në fund janë komunat, të cilat sipas Ligjit për Pyjet janë përgjegjëse për menaxhimin e pyjeve në territoret e tyre komunale.

Ekzistimi dhe funksionimi i subjekteve të përmendura dhe moskoordinimi i tyre, po krijojnë mundësi dhe hapësirë për veprime dhe për arësyetimin e veprimeve që po e degradojnë parkun.

Menaxhimi dhe administrimi i një pjese të parkut nga autoritetet jokompetente, e pengojnë funksionimin dhe zhvillimin e tërësishëm të PK "Sharri".

Tani me të drejtë shtrohen disa pyetje: A është më mirë që parkun ta menaxhojë një subjekt apo më shumë? Nëse do të ishte një subjekt si do të mund të pajtoheshin të tre subjektet për këtë? Çfarë qasje duhet të ketë ndaj drejtorisë së parkut në Shtërpce? Nëse do të ekzistonin më shumë subjekte që e menaxhojnë parkun, si do të stimulohej bashkëpunimi midis tyre? Si do të koordinohej veprimtaria e tyre?

Cilat janë mundësitë e identifikuara?

1. Si mundësi e parë do të ishte menaxhimi i të gjitha pasurive të parkut kombëtar vetëm nga një subjekt.

Përparësitë e kësaj zgjidhjeje janë se në këtë rast nuk do të mund të lindnin konflikte eventuale midis subjekteve të ndryshëm në çështjet e menaxhimit, subjektet nuk do të mund t'i hidhnin përgjegjësinë njëri tjetrit për mosmbarëvajtjen eventuale të punëve dhe nuk do të kishte nevojë për ndonjë trup koordinues që do të koordinonte veprimtarinë e tyre. Gjasat janë që për këto shkaqe, menaxhimi i parkut të jetë më i lehtë, më praktik.

2. Si mundësi e dytë do të ishte menaxhimi i parkut kombëtar nga subjekte të ndryshëm.

Dobësitë e kësaj zgjidhjeje janë se në këtë rast do të mund të lindnin konflikte eventuale midis subjekteve të ndryshëm në çështjet e menaxhimit, subjektet do të mund t'i hidhnin përgjegjësinë njëri tjetrit për mosmbarëvajtjen eventuale të punëve dhe do të kishte nevojë për ndonjë trup koordinues që do të koordinonte veprimtarinë e tyre. Gjasat janë që për këto shkaqe, menaxhimi i parkut të jetë më i komplikuar, më pak praktik.

Lista e çështjeve të identifikuara

- Mungesa e Planit Menaxhues të Parkut
- Mosbashkëpunimi dhe mungesa e koordinimit të punëve në mes të subjekteve që sot e menaxhojnë parkun;
- Mungesa e bazës së të dhënave;

Sfida 2

Mbrojtja e mjedisit, biodiversitetit dhe resurseve natyrore.

Si mund të parandalojmë degradimin e pyjeve, rrezikimin e biodiversitetit, rreziqet natyrore dhe ndotjen e ujit, ajrit dhe tokës?

Pse dhe çka është sfiduese?

PK "Sharri" posedon një pasuri të gjerë natyrore të llojshmërisë së madhe në të cilin dallohen katër rezervate: Maja e Arnenit, Koxhaballkani, Oshlaku dhe Rusenica, si dhe lokalitete me specifika të veçanta natyrore siç janë: Luboteni. Gryka e Dulës, Livadhi i mbretit – Liqeni i Jazhincës, Lumi i Bukuruvaqës dhe Ostravica.

Kjo pasuri po rrezikohet nga veprimtaria njerëzore, në shumë pjesë faktori njeri dhe ata natyror (djegiet dhe sëmundjet e pyjeve në kohën e fundit) janë shkaktarët kryesor të shkatrrimit.

Sfiduese në PK "Sharri" janë mundësitë dhe mënyra e mbrojtjes së parkut nga degradimet antropogjene dhe natyrore, ndotja e ekosistemeve me fjalë të tjera mundësia e shfrytëzimit të pasurive të parkut për zhvillimin e sotëm, duke mbajtur përgjegjësi për ardhmërinë e parkut edhe për gjeneratat e ardhshme.

Prerja ilegale e pyjeve - brenda parkut dhe zonës buferike në pronën shoqërore dhe atë private janë dukuri aktuale në park. Ruajtja e resurseve pyjore ka rendësi te madhe për një zhvillim te qëndrueshëm i cili ndikon pozitivisht edhe në ruajtjen e botës shtazore.

Dëmtimi i biodiverstetit – sjell deri te reduktimi i numrit te llojeve bimore kryesisht të atyre endemike që si pasojë kanë shkatërrimin e atyre llojeve. Ruajtja e biodiversitetit, e posaçërisht e llojeve endemike te bimëve është e nevojshme për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik. Keqpërdorimi i botës bimore dhe shtazore (llojet e bimëve endemike dhe llojeve të shtazëve të egra) që janë prezent në PK „Sharri'' sjell deri te zvogëlimi i numrit të tyre që si rezultat ka humbjen e llojeve dmth humbjen e vlerave natyrore.

Fatkeqësitë natyrore – të cilat paraqiten në forma të ndryshme, si gërryerje sipërfaqësore e tokës, sëmundje të pyjeve, zjarreve, ortiqeve etj. si dhe faktorë antropogjen dhe natyror, rrezikojnë begatitë e krijuara dhe të planifikuara. Si mund të parandalohen dhe cilat janë mundësitë? Cilat janë masat paraprake që do të ndikojnë në zvogëlimin, parandalimin apo mundësinë e eliminimit të pasojave nga fatkeqësitë natyrore, erozionin, vërshimet, zjarret, sëmundjet e pyjeve, ortiqet? etj.

Ndotja e ujit, ajrit dhe tokës – nga zhvillimet momentale kjo dukuri po merr përmasa gjithnjë më të mëdha. Menaxhimi jo i drejtë dhe i komplikuar dhe mosadministrimi i plotë me parkun janë shkaktarët indirekt të shfaqjes së kësaj dukurie. Kontrolli i zhvillimeve në shumë raste është i pamundshëm që në mënyrë direkte ndikon në rritjen e këtij problemi, afër zhvillimeve të tilla hapen deponi të mbeturinave dhe derdhja e pa kontrolluar dhe e patrajtuar e ujërave të zeza.

Çfarë thonë konventat dhe direktivat në lidhje me mbrojtjen e mjedisit?

- Konceptet themelore të UNESCO-s thonë që secili send i trashëgimisë kulturore dhe natyrore është unik dhe zhdukja e cilitdo send përbën një humbje definitive dhe varfërim të pakthyeshëm të trashëgimisë. Trashëgimia natyrore është pronë e përgjithshme që duhet të shfrytëzohet nga të gjithë dhe të mbrohet ashtu që t'i dorëzohet gjeneratave të ardhshme.
- Unioni botëror për Ruajtjen dhe Konservimin e Natyrës (shkurt në anglisht IUCN) ka bërë kategorizimin e zonave të mbrojtura të natyres. Menjëherë pas kategorisë së parë – Rezervateve strikte natyrore vjen kategoria e dytë – Parqet Nacionale. Parku Kombëar „Sharri", meqë është evidencuar në listën ndërkombëtare të zonave të mbrojtura, duhet te mbrohet me ligj dhe si i tillë të zërë vendin meritor në këtë familje.
- Në Samitin për Tokën, të mbajtur në vitin 1992 në Rio de Zhaneiro, liderët botëror u morën vesh për një strategji gjithëpërfshirëse për „zhvillimin e qëndrueshëm". Njëra prej marrëveshjeve kryesore që kanë dalë nga Samiti ka qenë Konventa për Diversitetin Biologjik. Kjo konventë i obligon shtetet që e kanë ratifikuar atë që të nxjerrin ligje dhe akte të tjera juridike përmbajtjesore për mbrojtjen e mjedisit dhe të aplikojnë sistematikisht përgjegjësinë ndaj shkatërruesve dhe përgjegjësve për mjedisin jetësor.
- Konventa e Espoos e vitit 1991 që ka hyrë në fuqi në vitin 1997 e që ka të bëjë me vlerësimin e ndikimit në mjedis në kontekstin ndërkufitar, i obligon shtetet që e kanë ratifikuar atë, që ta bëjnë këtë vlerësim për aktivitete të caktuara qysh në fazat e hershme të planifikimit. Shtetet duhet ta njoftojnë njëra tjetrën dhe të konsultohen nëse implementimi i ndonjë projekti do të mund të kishte ndikim të pafavorshëm në mjedisin e hapësirës ndërkufitare.
- Konventa e Lluganos e vitit 1993 për detyrimet civile për dëmet që rezultojnë nga aktivitetet e rrezikshme për mjedisin jetësor i obligon ratifikuesit e kësaj konvente për kompensimet që palët dëmtuese duhet t'ua bëjnë palëve të dëmtuara për dëmet në mjedisin jetësor e gjithashtu i obligon për sigurimin e mjeteve për mbrojtje dhe për kthimin në gjendjen e mëparshme.
- Direktiva e Këshillit të Evropës për ruajtjen e habitateve natyrore dhe florës e faunës së egër e vitit 1992 i përcakton masat që duhet t'i ndërmarrin shtetet anëtare të Këshillit të Evropës në mënyrë që të ruhen habitatet natyrore, flora dhe fauna e egër.

Sipas koncepteve të UNESCO-s, konventave dhe standardeve të BE-së, zhdukja e llojeve bimore dhe shtazore si dhe prerjet ilegale të pyjeve janë humbje e trashëgimisë, pra në këtë rast të PK „Sharri".

Në drejtim të mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të një trashëgimie të pasur natyrore, autoritetet duhet të punojnë në rritjen e vetëdijes për vlerat e saj.

Ligji për Planifikim Hapësinor përmban parimin për zhvillimin e qëndrueshëm dhe tani është koha që të gjitha parimet që përmban ky ligj, pastaj standardet, konventat dhe agjendat e ndryshme të përkthehen në veprime konkrete dhe të reflektohen në menaxhim.

Nga Kuvendi i Kosovës për mbrojtjen e natyrës janë aprovuar këto ligje:



- Ligji për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji për mbrojtjen e natyrës
- Ligji për Parkun Kombëtar "Sharri"
- Ligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"
- Ligji për pyje
- Ligji për mbrojtjen e tokave bujqësore
- Ligji për mbrojtjen e ujërave
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji për mbeturina
- Ligji për kimikate
- Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes
- Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis
- Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor
- Ligji për mbrojtje nga rrezatimi jo-jonizues, jonizues dhe sigurinë nukleare
- Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësive tjera
- Ligji për mbrojtje nga zjarri

Aplikimi dhe zbatimi i ligjeve ne fuqi si dhe përmbajtja e konventave ndërkombëtare kontribuon në zvogëlimin apo edhe eliminimin e problemeve mjedisore në Parkun Kombëtar ,,Sharri''.

Moszbatimi i ligjit për parkun paraqet rrezik për te ardhmen e parkut sa i përket mbrojtjes, ruajtjes dhe zhvillimit të trashëgimisë natyrore.

Cilat janë mundësitë e identifikuara?

Konteksti i ngushtë – Mundësitë për përmirësim të gjendjes do të duhej të jenë prioritete apo hapa konkret për t'u ndërmarrë menjëherë:

- Ndarja e përgjegjësisë për menaxhim të parkut;
- Përpilimi i planit menaxhues të parkut;
- Hulumtimet për gjendjen aktuale të biodiversitetit, prerjeve ilegale, fatkeqësive, ndotjeve në park;
- Nënshkrimi i konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës;

Konteksti i gjerë - PK ,,Sharri'' dallohet në zona me vlera të veçanta natyrore, hidrografi, pyje, kullosa, livadhe dhe biodiversitet jo vetëm ne Kosovë por edhe me gjerë.

Zonat e ndjeshme natyrore dhe zonat tjera të vlefshme nuk mund të trajtohen në izolim, meqë ndikimi i këtyre zonave është më i gjërë.

Përveç trendeve lokale nga komunat ku ka shtrirje, Parku Kombëtar ,,Sharri'' dhe dinamikës rajonale (shtrirja e maleve te Sharrit edhe në shtetin fqinj të Maqedonisë), ndryshimet globale (në Ballkan dhe më gjërë) gjithashtu ndikojnë në mjedisin e hapur, si dhe menaxhimin e mbrojtjen natyrore në veçanti në zonën a parkut.

Si do t'i qaset Kosova ndryshimeve globale me ndryshimin fiziko-gjeografik, biologjik etj. dhe si do të mund të ndihmojë në përpjekjet ndërkombëtare për të trajtuar këtë problem, është sfidë në kontekst më të gjërë?

Lista e çështjeve të identifikuara

- Degradimi i pyjeve; ndalimi i prerjeve të pakontrolluara;
- Rrezikimi i biodiversitetit;
- Fatkeqësitë natyrore (erozioni, ortiqet, zjarri, smundjet), parandalimi dhe sanimi i tyre;
- Shfrytëzimi joracional i kullosave;
- Gjetja dhe shfrytëzimi i masave hidroteknike, bujqësore dhe biologjike si mundësi;
- Ndotja e ujit në zonat me potencial të zhvillimit të turizmit;



Foto – deponi ilegale e mbeturinave

Sfida 3

Banimi në park dhe ndikimi i vendbanimeve për rreth tij.

Cilat janë mundësitë dhe cili është përfitimi i parkut dhe banorëve që jetojnë në park dhe vendbanimet përreth parkut?

Banimi brenda Parkut Kombëtar "Sharri", në kuptimin e rindërtimeve dhe ndërtimeve të reja të vikend shtëpizave, është intensifikuar pas vitit '99. Viken shtëpizat janë ndërtuar kryesisht në zonën e Brezovicës dhe Prevallës. Pjesa më e madhe e tyre nuk i përshtatet kërkesave dhe kushteve që duhet të plotësohen në kuadër të zonave, si kjo e Parkut Kombëtar "Sharri". Këtë konkludim e fuqizon edhe fakti që trendi i ndërtimeve të reja në kundërshtim me të njëjtat kërkesa po vazhdon edhe sot.

Në përgjithësi i gjithë banimi individual në vikend shtëpizat në zonën e Parkut Kombëtar "Sharri' nuk e ka të zgjidhur çështjen afatgjate të ujit të pijes apo edhe përdorimi i ujit nuk bëhet sipas parimit të shpenzimit racional në parqe, pastaj nuk e ka të zgjidhur çështjen e deponimit dhe trajtimit të ujërave të zeza, mbledhjes dhe trajtimit të mbeturinave, pra infrastrukturës në përgjithësi. E tëra kjo përcillet me probleme të shumta, ndër më kryesoret mungon përgjegjësia, si institucionale dhe ajo individuale për (mos)ndotjen dhe degradimin e mjedisit.

Përveç banimit në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri", është e nevojshme të trajtohet edhe banimi në vendbanimet të cilat e rrethojnë parkun për shkak të ndikimit të ndërsjelltë me zhvillimet dhe aktivitetet në PK "Sharri", atraktivitetit që mund të ofrojnë arkitektura dhe kultura e jetës në këto vendbanime. Duke pasur parasysh ndikimin negativ prezent dhe atë eventual të ardhshëm që manifestohet me shkatërrimin e pyjeve të pronës shoqërore, prerjen e pakontrolluar të pyjeve në pronësi private në zonën e parkut, është parë si e domosdoshme që të merren parasysh vlerat dhe ndikimet e vendbanimeve përreth parkut.

Në afërsi të kufirit me parkun gjenden 54 vendbanime, me përafërsisht mbi 50,000 banorë.

Në fakt, shumica e këtyre vendbanimeve të cilat gjenden në afërsi të kufirit me parkun, gjithmonë kanë pasur kushte të mira

për zhvillimin e blegtorisë. Territori i tyre shtrihet në kullosat e larta të Sharrit. Pikërisht në kufirin ndërmjet arave të bjeshkës dhe kullosave të larta i gjejmë vendbanimet sezonale verore, stanet e bjeshkës, të cilat popullata vendase i quante edhe koliba. Këso stanesh hasim në: Zapllush, Pllajnik, bjeshkët e Mushtishtit dhe Grejkovcit etj.

Krahas rënies së fondit të blegtorisë në këto vendbanime gradualisht bie edhe numri i staneve të bjeshkës. Sot shumë vështirë se mund të gjendet ndonjë blegtor gjatë verës në stan. Edhe ata pak blegtorë që gjenden në stane kanë ndryshuar zakonet e vjetra dhe kanë ndryshuar mënyrën e jetës. Sot në stan qëndrojnë dy vetë, bariu edhe një anëtar tjetër i cili e përcjell bulmetin stan-shtëpi dhe anasjelltas [23] . Cilat janë mundësitë që këto vendbanime të ndikojnë në zhvillimin e parkut? Cilat do të ishin kufizimet me të cilat duhet të ballafaqohen këto vendbanime? Si do të shfrytëzohet prona që gjendet brenda kufinjve të parkut?

Pse dhe çka është sfiduese për banimin brenda PK "Sharri" dhe ndikimin e vendbanimeve për rreth tij?

Sfiduese në rastin e banimit brenda PK "Sharri" dhe ndikimit të vendbanimeve për rreth tij, është ofrimi i kualitetit, infrastrukturës së nevojshme dhe shërbimeve për banim si dhe shfrytëzimi i mundësive atraktive të vendbanimeve përreth parkut për turizëm fshatar, kulturë tradicionale, gjithënjë duke patur parasysh qëllimin parësor, ruajtjen e mjedisit në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare për parqet nacionale.

Ndërtimi i paplanifikuar i hoteleve, shtëpive, vikend-shtëpizave sot dhe në të ardhmen janë poashtu sfidë, sepse aktivitetet ndërtimore të paligjshme dhe të paplanifikuara kanë shkaktuar plandosje urbane në park duke ndikuar në peizazhin e hapur e po ashtu edhe në strukturën e vendbanimeve për rreth tij.

Sfidë tjetër është edhe sensibilizimi i popullatës lokale për veprimtari turistike në atë mënyrë që të ofrojë shërbime për fjetje dhe ushqim, buajtje të tipit fshatar, restorante dhe shërbime të tjera në ambiente fshatare tradicionale.

[23] Mr. sc. Hajriz Meleqi, Opoja – studim kompleks gjeografik, Disertacion i doktoraturës, Prishtinë 2000.

Cilat janë mundësitë e identifikuara?

Konteksti i ngushtë – Mundësitë për ofrim të kushteve bazë për kualitet të jetës në pjesën banimore të PK "Sharri" janë të hapura, vetëm se nevojitet një menaxhim i suksesshëm. Kjo e tëra varet nga kontrolli i zhvillimeve krahas standardeve dhe ligjeve në fuqi.

Konteksti i gjërë - Veprimtaritë njerëzore brenda parkut janë të kufizuara në atë masë që mos të shkojnë në dëm të natyrës. Vendbanimet rurale duhet të revitalizohen, duhet të sensibilizohet popullata lokale për veprimtari turistike në atë mënyrë që të ofroj shërbime për fjetje dhe ushqim, buajtje të tipit fshatar, restorante dhe shërbime të tjera në ambiente fshatare tradicionale. Çdo gjë që është folklorike tradicionale duhet të prezantohet dhe komercializohet në të mirë të përfitimit ekonomik dhe duke arritur qëllimin për mbrojtjen e natyrës.

Zonat përreth parkut duhet të jenë në funksion të tij dhe ky parim është në pajtim me mendimin e Federatës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (kjo vepron si agjenci në kuadër të UNESCO-së), sipas të cilës duhet të shfrytëzohen kapacitetet jashtë zonës së parkut të cilat gjenden në afërsi, gjithmonë kur kushtet e lejojnë. Kështu në kuadër të kësaj, parku do të ketë mundësinë të jetë baza e zhvillimit, në mënyrë që popullata që atakon apo gjendet në afërsi të forcohet ekonomikisht në mënyrë indirekte. Kjo mënyrë e zhvillimit dhe ngritjes është si rezultat i përvojave të shumë vendeve në botë. Shumë hulumtime shkencore kanë treguar mundësitë e realizimit të zhvillimeve të tilla. Mirëpo një zhvillim i tillë duhet të jetë gjithmonë në interes të popullatës së atjeshme, në të kundërtën nuk do të mund të ishte i realizueshëm. Për t'u arritur kjo, duhet të bëhen disa intervenime apo edhe ndryshime, gjithashtu duhet të bëhen hulumtime se cilat janë ato vendbanime të cilat janë më të përshtatshme dhe ofrojnë kushte për një zhvillim të mundshëm.

Në përgjithësi, ruajtja e vendbanimeve rurale mund të arrihet me një program të konceptuar mirë të revitalizimit i cili duhet të bazohet në:

- Ruajtjen e ambientit burimor të zonës,
- Kultivimin e asaj që është tradicionale duke iu adaptuar asaj që është moderne,

- Zhvillimin e turizmit selektiv (fshatar, ekologjik, ambiental, agrar etj.)
- Rritjen dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe edukimin e banorëve sipas kërkesave (sipas nevojave të cilat diktohen nga zhvillimet)

Një mënyrë e tillë e organizimit do t'i përgjigjej shfrytëzimit të këtyre viseve për zhvillime të reja dhe do të zgjonte interes për të jetuar dhe vepruar duke parandaluar migrimin e popullësisë.

Shansi jetësor për këta banorë do të bëhej më i realizueshëm me lidhjet rrugore të kualitetit të lartë, me të ardhurat nga turizmi fshatar, pastaj me garantimin e plasimit të prodhimeve të tyre në treg etj. Të ardhurat kryesore do të mund të siguroheshin nga zhvillimi i turizmit fshatar dhe vikend turizmit kur do të mund të plasoheshin prodhimet e tyre vendore karakteristike për atë zonë: pijet e ndryshme, prodhimet e qumështit, bimët mjekuese, prodhimet drusore, mjaltin, thurjet e ndryshme, etj.

Lista e çështjeve të identifikuara

- Niveli i ulët i shërbimeve (shëndetësore, edukativo-arsimore, mjedisore)
- Ndërtimi i paplanifikuar, si dhe humbja e traditës së ndërtimit tradicional;
- Humbja e interesimit për prodhime tradicionale nga blegtoria (bulmeti etj.)
- Niveli i ulët apo mungesë e linjave të trafikut ndërurban;
- Mungesë e marketingut për vlerat e PK;

Sfida 4

Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore, në dobi të ngritjes së ofertës turistike në park.

Si të ngritët oferta turistike në dobi të zhvillimit ekonomik të parkut?

Pse dhe çka është sfiduese?

Meqë është evident fakti se mjedisi është çështje fundamentale në prosperitetin e Kosovës, njohja e vlerave të Parkut Kombëtar "Sharri" është e rëndësisë së madhe. Në rastin e kundërt mosnjohja ka për pasojë, mosrespektimin e normave dhe standardeve kryesore për konservim të natyrës me ç'rast në vazhdimësi humben vlerat natyrore. Në rastin konkret prerja e pakontrolluar e pyjeve, ndërtim i egër, shfrytëzim i pakontrolluar i peizazheve për aspekte komerciale, ndotja me ujëra të zeza, etj, kanë për pasoja serioze degradimin e mjedisit i cili mund të kenë ndikime dhe pasoja serioze në zhvillimin e ardhshëm të Parkut. Kjo bëhet edhe më serioze kur merret parasysh momenti i respektimit të normave dhe standardet ndërkombëtare për konservim të parqeve, të cilat në fund të fundit përpos degradimit kanë dhe do të kenë edhe më shumë për pasoja humbjet e mundësive për përfitime ekonomike e sociale.

Parqet nacionale janë të dedikuara për konservimin dhe kultivimin e bukurive natyrore si trashëgimi; për të promovuar mundësitë ekonomike dhe të mirëqenies për komunitetet edhe pse shumë shpesh konservimi perceptohet si limitim i zhvillimit.

Cilat janë mundësitë e identifikuara?

Konteksti i ngushtë – Të vlerësuarit e saktë të Parkut Kombëtar "Sharri" do të ndihmonte vendimmarrësit që të identifikojnë saktë kontributin e konsiderueshëm të parkut në ekonominë e komunave përreth parkut por edhe të gjithë ekonomisë së Kosovës.

Ruajtja e vlerave të parkut kombëtar është kusht për zhvillimin e parkut sikurse që edhe punësimi varet nga kualiteti i mjedisit (psh. turizëm dhe rekreacion), mbrojtja dhe përmirësimi i mjedisit (konservimi).

Mbrojtja e mjedisit zë vend të rëndësishëm dhe është e mundur të vetë mbështetet financiarisht kur ka zhvillim ekonomik. Me

turizëm do të mund të kontribuohej në rritje ekonomike me ç'rast duhet të bëhet promovimi i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm duke nënkuptuar turizmin jo konsumues, eko-turizmin, për të rritur përfitimet nga resurset turistike dhe mirëmbajtur integritetin kulturor dhe mjedisor me kultivimin e zonave të mbrojtura ekologjike dhe trashëgiminë natyrore.[24].

Konteksti i gjerë – Ndikimi ekonomik i Parkut Kombëtar "Sharri" në ekonominë e Kosovës do të duhej të vlerësohej me të hyrat në BPV-në e Kosovës si dhe gjenerimin e punësimit në përgjithësi të cilat mund të kategorizoheshin në punësim: i) direkt në park; ii) indirekt në park dhe iii) indirekt jashtë parkut.

Parku ofron punësim direkt të vogël mirëpo ndikimi i saj në punësimin indirekt brenda dhe jashtë kufijve të tij është i madh. Shembuj specifik janë prodhimet vendore dhe mikpritja tradicionale e cila rrit ofertën turistike.

Parqet kombëtare (nacionale) bazohen në ruajtjen e pjesëve të caktuara natyrore nga eksploatimi ose dëmtimet e tjera nga shfrytëzuesit, në mënyrë që aktivitetet e turizmit, ose edhe të veprimtarive të tjera, të mos dëmtojnë vlerat kryesore të parkut. Aktivitetet e varura nga kualiteti i mjedisit siç është turizmi dhe rekreacioni, janë shfrytëzues intensivë të mjedisit. Në turizëm dhe bujqësi është punësimi dominant brenda dhe përreth parkut kombëtar.

Qëllimi kryesor i rregullimit dhe shfrytëzimit të parkut kombëtar duhet të jetë që në mënyrë sa më të organizuar dhe të menaxhuar të ofrohet qarkullimi i sa më shumë vizitorëve me qëndrim sa më të shkurtër, bazuar në qëllimet e planifikimit hapësinor të parkut, duke mundësuar vizita të shumta gjithënjë në pajtim me rregullat e aplikueshme për zonat e ndryshme të mbrojtjes në kuadër të parkut dhe me synimin e përhershëm për ruajtjen e vlerave të parkut.

Parqet nacionale nuk duhet të jenë pjesë e industrisë turistike, por mund të jenë pjesë kualitative e ofertës turistike. Parqet nacionale dhe parqet natyrore janë hapësira të vlerave dhe potencialeve të larta brenda një shteti, prandaj nuk duhet trajtuar si pjesë të zhvillimit të nivelit lokal.

[24] Johanesburg, 2002; www.world-tourism.org/sustainable/wssd/final-report.pdf

Oferta turistike mund të rritet nëse zhvillimet kanë kahje dhe qasje të planifikuar duke e ditur se:

- Parqet kombëtare janë ikona të turizmit brenda dhe jashtë kufijve shtetëror,
- Parku krijon imazhin apo shenjën identifikuese kombëtare,
- Përfitimi ekonomik është shumë më i madh jashtë parkut,
- Parku mbështet jo vetëm ekonomitë lokale por të Kosovës në tërësi.

Mundësitë për shfrytëzimin e tezave të tilla do të kishte qenë shumë më e mundur nëse parku nacional do të njihej nga organizma ndërkombëtarë për mbrojtjen e vlerave natyrore, të cilat në të njëjtën kohë ofrojnë mundësi për mbështetje financiare nga po të njëjtit organizma financiarë.
Për të joshur tregun më të gjerë dhe të ri në një frymë më konkurruese të turizmit botëror është një sfidë e cila duhet të zhvillohet përmes ofertës më të specializuar si: Turizmi malor-dimëror dhe veror, ekoturizmi, turizmi rural, turizmi kulturor, turizmi shëndetësor, turizmi për mirëqenie, turizmi aventurier, turizmi konvencional, golf turizmi, turizmi i xhirove të çiklizmit, etj.

Lista e çështjeve të identifikuara

- Mungesa e derdhjes së mjeteve financiare në BKK, mosadministrimi i kapaciteteve turistike,
- Mungesa e planit hapësinor të përbashkët për tërë malet e Sharrit (nga të dy anët e kufirit Kosovë-Maqedoni), si mundësi për bashkëpunim,
- Mosinvestimet e koordinuara (infrastruktura rrugore, infrastruktura fizike teknike, telekomunikimit).
- Privatizimi i hoteleve dhe arritja e standardeve të kërkuara evropiane për turizëm në të ardhmen,
- Konkurrimi i Kosovës me resurset e veta natyrore për ofert turistike, në raport me rajonin,
- Papunësia si pasojë e strukturës së pazhvilluar ekonomike
- Mungesa e shpeshtë e rrymës elektrike,
- Rënia e numrit të vizitorëve, (me qëndrim më të gjatë);
- Kapacitetet e vogla për t'a pranuar numrin e madh te vizitorëve ditor.
- Kaosi i trafikut në afërsi të qendrave turistike, mungesa e parkingjeve të mjaftueshme,
- Mungesa e linjeve të rregullta të transportit,

Sfida 5

Njohja ndërkombëtare e parkut dhe bashkëpunimi ndërkufitar.

Si të arrihet nënshkrimi dhe respektimi i konventave ndërkombëtare për konservim të biodiversitetit; për bashkëpunim ndërkufitar dhe rajonal?

Pse dhe çka është sfiduese?

Parku Kombëtar "Sharri" nuk është i pranuar nga institucionet ndërkombëtare për konservim te natyrës siç është IUCN (Unioni botëror i Konservimit apo Unioni ndërkombëtar për konservim të natyrës dhe resurseve natyrore). Kjo mund të ketë për pasojë indirekte humbjen e vlerave natyrore me kohë për arsye se nuk ekziston obligimi i nënshkruar për konservim apo edhe mbështetje financiare për zhvillimin e aktiviteteve për konservim të natyrës dhe të hulumtimeve në park.

Mos nënshkrimi i konventave ndërkombëtare për konservim të natyrës, implikon mosnjohjen e parkut nga organizatat botërore për konservim të natyrës, për të vazhduar në fund me humbjet në aspektin ekonomik për shkak të lëshimit të mundësive për zhvillim të turizmit të qëndrueshëm. Marketingu nuk do të jetë i qëndrueshëm, meqë resurset natyrore dita më ditë do të humbin vlerat e tyre, bashkëpunimet rajonale dhe ndërkufitare për çështje të posaçme do të jenë të limituara nëse jo të pamundshme.

Cilat janë mundësitë e identifikuara?

Konteksti i ngushtë - Nënshkrimi dhe ratifikimi i konventave lidhur me konservim të natyrës nga ana e Kosovës, (shih tabelën e mëposhtme) do të jetë kushti nismëtar për fillim të aplikimit të normave dhe standardeve për konservim të natyrës, biodiversitetit, trashëgimisë natyrore.

Konservimi i natyrës, biodiversitetit dhe pjesëmarrjes aktive në iniciativat ndërkombëtare për mjedisin janë dy nga 5 objektivat sektoriale mjedisore në kuadër të Strategjisë dhe Planit zhvillimor të Kosovës 2007-2013:

Objektivi 3 - Mbrojtja e llojllojshmërisë biologjike, trashëgimisë dhe vlerave natyrore si dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i resurseve me masat specifike:

- Mbrojtja e llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës;
- Zhvillimi i strategjisë nacionale për shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve natyrore;
- Sigurimi i menaxhimit të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe

Objektivi 4 - Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja proaktive me iniciativat mjedisore Evropiane dhe globale ndërkombëtare në sektorin e mjedisit me masat specifike:

- Zhvillimin e parakushteve për ratifikimin e të gjitha konventave dhe protokolleve për mjedisin;
- Pjesëmarrje aktive në iniciativat ndërkombëtare për mbrojtje të mjedisit;
- Hartimi i projekteve me qëllim të zvogëlimit të ndotjes ndërkufitare dhe menaxhimit ndërkufitar të llojeve biologjike.

Konteksti i gjërë – Për më tepër, nënshkrimi dhe ratifikimi i konventave lidhur me konservim të natyrës nga ana e Kosovës do të jenë kusht për aplikim në programet e bashkëpunimit rajonal apo ndërkufitar në institucione ndërkombëtare financiare.

Sipas raportit të Organizatës për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara për gjendjen mjedisore në vendet e Evropës Juglindore, del se Kosova në raport me rajonin është shumë larg në procesin e nënshkrimit dhe ratifikimit të konventave ndërkombëtare.

Misioni i IUCN-së është: të influencojë, të jep kurajë dhe të ndihmojë shoqëritë kudo në botë, për konservimin e integritetit dhe llojllojshmërisë së natyrës dhe të sigurojë që çdo shfrytëzim i resurseve natyrore është i drejtë, i paanshëm dhe në aspektin ekologjik i qëndrueshëm. Unioni Botëror për konservim të natyrës përmban komponentën e anëtarësimit (vendet nënshkruese - anëtare të organizatës) dhe hulumtimet (ka 6 komisione tematike shkencore)[25].

[25] Komisioni për Menaxhimin e Ekosistemeve(CEM)[1]; Komisioni për Arsim dhe Komunikim(CEC)[2]; Komisioni për Mjedis, Ekonomi dhe Politika Sociale (CEESP)[3]; Komisioni



Në tabelën e mëposhtme është paraqitur gjendja e shteteve të regjionit të ngushtë të Evropës Juglindore në nënshkrim dhe ratifikim të marrëveshjeve mjedisore multilaterale, të cilat Kosova do të duhej t'i ratifikojë, nënshkruajë.

Ratifikimi i marrëveshjeve mjedisore multilaterale							
	Shqipëria	B&H	Kroacia	FYRoM	Mali i Zi	Serbia	Kosova
Konventa Aarhus	2000		Ratifikuar 2006	Ratifikuar 1999	-	Në proces	
Protokoli në lirimin dhe transferin e regjistrave të ndotësve	2006	Nënshkruar	Nënshkruar	Nënshkruar	-	Në progres	
Konventa Espoo në VNM konteksti ndërkufitar	1991 2006		Ratifikuar 1996	Ratifikuar 1999	-	Nënshkruar	
Protokoli në VSNM	2005	Nënshkruar	Nënshkruar	Nënshkruar 2003	Nënshkruar	Në proces	
Konventa në mbrojtjen dhe shfrytëzimin e lumenjve dhe liqeneve ndërkufitare	1994		Ratifikuar 1999		-	Nënshkruar, 2003	
Konventa në efektet ndërkufitare të aksidenteve industriale	1997		Ratifikuar 1999		-		
Konventa në ndotjen ndërkufiater të ajrit	2005	1992 Me ndarjen	Ratifikuar 1993	Ratifikuar 1986 (1991), jo të gjitha protokollet	Ratifikuar 2001 (vetëm Konventa dhe EMEP Protokolli)	-	
Konventa e Stockholmit ndotësit organik	2004	Nënshkruar	Ratifikuar 2006	Nënshkruar-jo e ratifikuar	Nënshkruar		
Konventa e Rotterdamit			Do të ratifikohet në 2007		-	Në proces, Nënshkruar ?	
Konventa mbi Llojllojshmërinë biologjike	1996	2002	Ratifikuar 1996	Ratifikuar 1997	Ratifikuar 2001	Në progres	
Protokoli i Kartagjenas në Bio mbrojtjen.			Ratifikuar 2002	Ratifikuar 2006	Ratifikuar 2006	Ratifikuar 2001	
Konventa e Bazelit mbi kontrolin e transportit ndërkufitar të mbetjeve të rrezikshme	1997	2000	Ratifikuar 1994	Ratifikuar 1997	Ratifikuar 2006		
Konventa mbi mbrojtjen e shtresës së ozonit	1999 2006	1992 Me ndarjen	Ratifikuar 1993	Ratifikuar 1994	Ratifikuar 2006	N/A	
Konventa mbi ndryshimin e klimës (UNFCCC)	1994	2000	Ratifikuar 1996	Ratifikuar 1998	Ratifikuar 2006	Ratifikuar 1990	
Konventa në Bon mbi mbrojtjen e shtazëve të egra, llojeve migruese	2000		Ratifikuar 2000	Ratifikuar 1999	-	Ratifikuar 1997	
Konservimi i natyrës së paprekur dhe habitateve të natyrshme (Bern)	1998		Ratifikuar 2000	Ratifikuar 1999	Në progres	Në progres	
Konventa RAMSAR mbi tokën moçalore	1996	1992	Ratifikuar 1993	Ratifikuar 1977	2001	Në progres	
Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore			Ratifikuar 1993	Ratifikuar 1974	2001	Ratifikuar 1977	

Sfida 6

Zhvillimi i infrastruktures teknike në park.

Çka duhet të bëhet dhe cilat do të ishin prioritetet investuese të infrastrukturës rrugore, energjetike, ujore, telekomunikimit dhe shërbimeve që do të ndikojnë në përmirësimin e shërbimeve?

Funksionimi fizik i parkut në masë të madhe varet nga infrastruktura e nevojshme teknike, rrugët e asfaltuara, rrjeti i shpërndarjes së energjisë elektrike, rrjeti i ujësjellësit, kanalizimit dhe telekomunikimit, të cilat në pjesën më të madhe janë të zhvilluara në pjesën e parkut nacional që hyn në komunën e Shtërpces e më pak në pjesët tjera të parkut. Kjo infrastrukturë teknike nuk është në nivelin i cili mundëson që aktivitetet e tanishme të zhvillohen pa pengesa dhe atyre të planifikuara në të ardhmen: psh. numri i ski lifteve dhe i teleferikëve nuk përmbushë kërkesat e skiatorëve, ka mungesë të furnizimit me energji elektrike të kapaciteteve turistike, mungon qasja adekuate rrugore në park nga territori i komunës së Suharekës, mungojnë shtigjet për këmbësorë për vizitorët brenda parkut, ka mungesë të vendparkimeve si dhe të valëve të telefonisë mobile.

Pse dhe çka është sfiduese?

Plani hapësinor për zonën e parkut kombëtar është në procesin e përpilimit dhe zhvillimi i infrastrukturës teknike në park paraqet një sfidë të veçantë për faktin se Kosova ka një ekonomi të dobët me mundësi të kufizuara për investime.

Çka duhet të bëhet dhe cilat do të ishin prioritetet investuese të infrastrukturës rrugore, energjetike, ujore, telekomunikimit dhe shërbimeve, është sfidë me të cilën do të përballemi në të ardhmen e afërt.

a) Infrastruktura rrugore - Cilave rrugë ekzistuese duhet t'u jipet përparësi për investim? A ka nevojë për ndërtim të rrugëve të reja që nuk e dëmtojnë parkun dhe ku? Ku duhet të vendosen parkingjet e automjeteve, a guxojnë ato të futen brenda në zonën e parkut apo duhet të mbeten diku jashtë? Kah duhet të shtrihen shtigjet për këmbësorët vizitorë?

b) Infrastruktura energjetike - Furnizimi i rregullt i parkut kombëtar dhe vendbanimeve rreth tij me energji elektrike është sfidues për faktin se kërkohen investime të mëdha. Si të mbulohen kërkesat ekzistuese dhe ato të parashikuarat për energji elektrike në Parkun Kombëtar "Sharri"? A mund të mendohet në opsione alternative për gjenerimin e energjisë për parkun? A mund të shfrytëzohen lumenjtë që kalojnë nëpër park në funksion të zgjidhjes së këtij problemi? Po nga era? Ku duhet të përqendrohen investimet fillimisht?

c) Infrastruktura ujore - Është sfidues furnizimi i rregullt në park i vendbanimeve brenda dhe përreth parkut si dhe atyre me ujë të pijshëm, meqë mungon rrjeti i ujësjellësit dhe ai i kanalizimeve? Si dhe sa mund të shfrytëzohen lumenjtë në park për këtë qëllim? Si dhe sa është niveli i racionales në shfrytëzim të ujit? A do të duhej të mendohej në zgjidhje alternative me burime nëntokësore? Çka me kanalizimet, ndotjet, rikthimet e ujit prapë në natyrë? Cilat janë mundësitë për një investim më afatgjatë në gjetjen e furnizimit me ujë të pijshëm dhe eliminimit të ujërave të zeza në favor të mbrojtjes së mjedisit? Ku duhet të përqendrohen investimet fillimisht?

d) Telekomunikimi - Zhvillimit të telekomunikacionit në parkun kombëtar do të duhej t'i jipet rëndësia e duhur, meqë është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e turizmit me nivel të sotëm në botë. Telefonia fikse, mobile dhe lidhja e internetit do të duhej krahas infrastrukturës tjetër fizike të parashihej nën prioritete për investime së bashku me zhvillimin e infrastrukturës së shërbimeve. Ku duhet të përqendrohen investimet fillimisht?

e) Shërbimet – Krahas zhvillimit të infrastrukturës fizike teknike do të duhej të planifikohej edhe zhvillimi dhe sigurimi i shërbimeve të cilat janë pjesë e pandashme e zhvillimit të turizmit. Cilat shërbime fillimisht do të ofrohen në park për qëllime turizmi, duke nënkuptuar se shërbimet publike do të duhej të jenë prioritare: mirëmbajtja e rrugëve, ndriçimi, mbeturinat, etj.

Përgjigjja në pyetjen e parashtruar më lartë lidhur me caktimin e prioriteteve për investime qëndron në planifikimin e kahjes së zhvillimit të ekonomisë së parkut në përgjithësi apo kahjes së zhvillimit të turizmit në veçanti, përmbushjes së kushteve për kualitet të jetës në vendbanime brenda dhe jashtë parkut.

Cilat janë mundësitë e identifikuara?

Mundësitë për gjetjen e zgjidhjeve në sfidat e listuara më lartë sigurisht që varen nga financat, mirëpo duke marrë parasysh se investimet e tilla janë kthyese dhe me leverdi të shumtë, do të duhej të merreshin parasysh si të tilla.

Në përgjithësi me vendosjen e parimeve për qeverisje dhe menaxhim të parkut, do të mundësohej që një pjesë e mjeteve për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtutjeshëm për infrastrukturë fizike të sigurohen nga të hyrat e vet parkut.

a. Rruga ekzistuese regjionale që lidh Therandën (Suharekën) me parkun dhe qendrën turistike të Brezovicës përmes fshatit Mushtisht, është dukshëm më efikase dhe më e shkurtër për pjesën qendrore dhe veriore të Kosovës. Ky relacion shumë pak përdoret, për shkak të gjendjes teknike shumë të keqe që momentalisht ka kjo rrugë. Qka është e dobishme në këtë rast? Cilat janë përfitimet dhe rreziqet nëse ky aks do të shëndërrohej në lidhje të rëndësishme?!

b. Në njërën prej grykave të përshtatshme të malit Sharr alternativë do të ishte ndërtimi i pendës për akumulim të ujërave nga lumenjtë e parkut për gjenerim energjie elektrike. Ekonomia e parkut me të gjitha komponentat e saj varet kryesisht nga energjia elektrike prandaj ndikimi pozitiv do të ishte i madh. Uji i akumuluar do të mund të shfrytëzohej për furnizimin e parkut dhe vendbanimeve përreth parkut dhe kjo do të nxiste investimet në zhvillimin e rrjetit të ujësjellësve. Zhvillimi i infrastrukturës ujore apo furnizimi i pandërprerë me ujë të pijshëm, do të kishte ndikim pozitiv në ekonominë e parkut, nga mjetet e gjeneruara do të mund të mirëmbahej dhe zhvillohej më tutje rrjeti. Trajtimi i ujërave të zeza duhet të bëhet kusht për zhvillimet e reja dhe të gjenden mënyra që e njëjta të aplikohet edhe te vendbanimet ekzistuese.

Lista e çështjeve të identifikuara

1. Niveli jo i kënaqshëm i zhvillimit të infrastrukturës rrugore – Rrugë të dëmtuara dhe të paasfaltuara; mungesë e parkingjeve për automjete; mungesë e shtigjeve për vizitorët e parkut;
2. Furnizimi i pamjaftueshëm i parkut dhe i vendbanimeve përreth tij me energji elektrike;
3. Kapacitetet e pamjaftueshme në infrastrukturën e turistike – Mirmbajtja dhe mungesa e infrastrukturës rekreative (ski ashensor, teleferi, etj);
4. Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurisë ujore të parkut kombëtar;
5. Niveli jo i kënaqshëm i zhvillimit të telekomunikacionit – Valët e telefonisë mobile mbulojnë një pjesë jo të madhe të parkut; rrjeti i telefonisë fikse shtrihet në një pjesë të vogël të parkut.

II VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

2. VIZIONI, PARIMET DHE CAQET

2.1. Vizioni për zhvillimin e ardhshëm të Parkut Kombëtar "Sharri"

Në vazhdim të procesit dhe në përputhje me kornizën e planifikimit janë organizuar një sërë takimesh me përfaqësues të sektorëve të ndryshëm të Qeverisë së Kosovës. Pjesëmarrësit, sipas fushave tematike, janë ndarë në tri grupe punuese, me të cilat në fakt janë mbuluar të gjitha qështjet, problemet dhe sfidat e identifikuara. Takimet kanë qenë të rregullta dhe të karakterit punues, në të cilat janë diskutuar të gjitha materialet që paraprakisht janë punuar dhe kanë qenë të formës fillestare. Diskutimet e zhvilluara nëpër grupe, në mënyrë përmbajtësore kanë ndikuar në përmirësimin e dokumentit në përgjithësi.

E ardhmja e parkut ka qenë njëra ndër temat kryesore, e cila është trajtuar në tri forma të sajë: mbrojtja e parkut – sipas të cilës, e gjithë ajo që mund të ndodhë, është ruajtja me çdo kusht e gjendjes momentale dhe zhvillimi minimal dhe shumë i kontrolluar; forma tjetër më radikale – zhvillimi i parkut, që në këtë rast, mbrojtja është në plan të dytë, duke i dhënë përparësi të gjitha formave të zhvillimit; dhe forma e tretë si formë më e moderuar e cila në mënyrë paralele parasheh zhvillimin dhe mbrojtjen e planifikuar të parkut.

Diskutimet në grupe dhe takimet me komunat pjesëmarrëse, ndikuan që vizioni për të ardhmën e parkut të modifikohet me përmbajtje të të tri formave të prezantuara.

Deklarata e vizionit

Park i menaxhuar me kujdes për gjeneratat e ardhshme, me llojllojshmëri biologjike,
veçori peizazhore, vendbanimet përreth dhe mënyrën e jetesës tradicionale,
që vlerësohen, mbrohen dhe zhvillohen.

Park, ku përfitimet nga aktivitetet ekonomike, do të jenë
në favor të mbrojtjes së mjedisit dhe të komunitetit.

Park me qasje të mirë, që vizitorëve në çdo kohë u krijon kënaqësi
dhe mundësi për aktivitete rekreative, sportive, kulturore dhe hulumtuese-shkencore.

2.2. Parimet e përgjithshme për zhvillim dhe mbrojtje

Parimet kryesore

- Zhvillimi i qëndrueshëm
- Inkorporomi i politikave sektoriale dhe komunale për një zhvillim të dëshiruar hapësinor;
- Zvogëlimi i konflikteve potenciale;
- Harmonizimi i qëllimeve afatgjata me zhvillimet përgjithshme në Kosovë;
- Subsidiariteti.

2.3. Synimet dhe objektivat

Synimi 1: Administrim i plotë dhe menaxhim efikas i parkut;

Objektivat:

- Emërimi dhe ndarja e përgjegjësisë një trupi të vetëm për menaxhim të tërë hapësirës së parkut;
- Hartimi i planit menaxhues për tërë territorin e parkut;
- Përfitim financiar për BKK nga kapacitetet hoteliere

Synimi 2: Mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në park dhe vendbanimet përreth;

Objektivat:

- Vetëdijësimi dhe informimi për parkun kombëtar;
- Mbrojtje e pyjeve nga faktorët natyror dhe antropogjen;
- Mbrojtje dhe ruajtje e biodiversitetit të parkut;
- Monitorim për mbrojtje dhe shfrytëzim të resurseve natyrorë në park;
- Sigurimi i ekzistencës fizike dhe ruajtja e autenticitetit të plotë të zonave dhe objekteve të TK;
- Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zonat dhe objektet e TK;
- Vetëdijësimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore (TK);.
- Bashkëpunimi ndërinstitucional i nivelit qendror dhe lokal;
- Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë shpirtërore

Synimi 3. Ndikimi pozitiv i ndërsjellë mes parkut dhe vendbanimeve brenda dhe përreth tij;

Objektivat:

- Zhvillime të planifikuara dhe kontroll të zhvillimeve për zonat brenda dhe përreth parkut;
- Bashkëpunim ndërkomunal për zhvillim rural në mes të komunave në të cilat shtrihet PK "Sharri",
- Mbështetje vendbanimeve përreth parkut për të ofruar ofertë turistike; ofrimin e eko - prodhimeve tradicionale dhe marketingun e tyre,
- Ofrim të shërbimeve publike cilësore për banim të përkohshëm brenda parkut dhe në vendbanimet përreth parkut,
- Vetëdijësim për ruajtjen e kulturës tradicionale të komuniteteve që jetojnë në zonat përreth parkut, veprimtaritë që ndikojnë në zhvillimin e eko-turizmit,

Synimi 4: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i parkut

Objektivat:

- Partneritet publiko-privat për ofrim të kushteve për investime të reja në kapacitetet rekreative,
- Ngritje të objekteve përcjellëse kontrolluese dhe afariste në funksion të parkut,
- Përfitime nga shfrytëzimi ekologjik i parkut,
- Plotësim të planprogrameve arsimore për Industrinë e turizmit.

Synimi 5: Park i njohur dhe i pranuar në aspekt ndërkombëtar; Bashkëpunim ndërkufitar dhe ndërkombëtar në mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut

Objektivat:

- Propagandim të vlerave natyrore, pejzazhore e turistike të parkut;
- Ratifikim të konventave ndërkombëtare (RIO, Kyoto, ESPOO, Llugano etj) dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga konventat,
- Bashkëpunim për PK "Sharri" mes Kosovës dhe shteteve fqinje si dhe me shtetet në rajon e më gjërë,
- Konkurrim për fondet ndërkombëtare me projekte të përbashkëta të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë për zonën ndërkufitare të malit Sharr.

Synimi 6: Zhvillim i infrastrukturës fizike;

Objektivat:

- Qasja e mirë përmes rrugëve dhe shtigjeve në të gjitha zonat e parkut që janë me interes të vizitohen;
- Sigurimi i transportit publik dhe vendparkimeve të nevojshme;
- Sigurimi i transportit të skiatorëve deri tek pikat nga të cilat e fillojnë lëshimin;
- Sigurimi i furnizimit të rregullt të parkut dhe vendbanimeve përreth tij me energji elektrike;
- Zhvillimi i sistemit publik të ujësjellësit dhe kanalizimit në park dhe vendbanimet rreth tij;
- Zhvillimi i shërbimeve postare dhe të telekomunikacionit në tërë parkun dhe në vendbanimet rreth tij;
- Menaxhimi efikas i mbeturinave;



2.4. Kapacitetet investive

Vlerësimi i kapaciteteve investive është hulumtim i potencialit dhe burimeve të mundshme për financim të planeve dhe politikave zhvillimore për Parkun Kombëtar "Sharri".

Vlerësimi i kapaciteteve investive duhet të përdoret si bazë e të dhënave e cila mund të konsultohet më vonë pas identifikimit të llojeve dhe madhësisë së resurseve që janë të nevojshme për zbatimin e projekteve dhe programeve specifike.

Kapacitetet investive i përbëjnë: kapacitetet e sektorit privat, atij publik, kreditë dhe grandet, fondet ndërkombëtare, donacionet, etj.

2.4.1. Investimet e realizuara para vitit 1999

Investimet janë komponentë themelore për zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi. Niveli, efikasiteti dhe struktura e investimeve determinojnë dinamikën e rritjes ekonomike të një vendi. Kosova në periudhën e viteve të 80-ta kishte një rritje të shpejtë të investimeve.

Regjioni turistik i Sharrit është njëri ndër regjionet më atraktive të regjioneve të Kosovës dhe shtrihet në territorin e këtyre komunave: Prizren, Suharekë, Shtërpce, Kaçanik, Ferizaj, Dragash, me lokalitetet më atraktive: Prevalla, Brezovica, Brodi, Radesha, Lubinja, Brodosavci, Restelica, Shtërpca, Oshlaku, Kara Nikolla. Nga të gjitha këto lokalitete vetëm në Brezovicë është investuar dhe krijuar baza materiale turistike edhe përkundër faktit se edhe lokalitetet tjera kanë vlera të larta për ndërtimin e qendrave turistike.

Kosova me sakrifica të mëdha krijoi potencialin e ekonomisë turistike në Brezovicë, me ndërtimin e kapaciteteve kapitale hoteljere-turistike dhe infrastrukturës së nevojshme përkatëse turistike, për çka është ndarë 1/5-ta e buxhetit të paraparë për ndërtimin e bazës së ekonomisë së turizmit në Kosovë.

Në vazhdim është dhënë një pasqyrë e shkurtër e gjendjes së bazës materiale të turizmit në Brezovicë, llojeve të objekteve dhe burimeve financiare:

- Në periudhën 1960-1970 ndërtohen objekte hoteliere turistike: "Shtëpia e Gurit", "Baqilla", "Shtëpia e Stojkut", "Hotel 'Breza", një teleferik dhe adaptohen kampshtëpizat ekzistuese.
- Në periudhën 1971-1975 ndërtohen dy ski-ashensorë, restoranti "Livadica", janë adaptuar disa kafene në fshatrat në rrethinën e Brezovicës si dhe është blerë rrahësi i dëborës.
- Në periudhat 1976-1980 dhe 1981-1989, dinamika e investimeve vazhdon me ndërtimin e hotelit "Narcis", teleferikut për 850 shfrytëzues në orë, ndërtimin e rrugës 9km' deri te "Shtëpia e Stojkut", largpërçuesit 35kW, rregullimin e shtigjeve të skijimit, ndërtimin e hotelit "Molika", kompletimin e sistemit të teleferikëve, skiashensorëve si dhe furnizimin me makinat për rregullimin e terreneve për skijim.

Mund të konkludohet se në periudhën 1971- 1991 janë bërë investimet më të mëdha kapitale sa i përket infrastrukturës turistike në krahasim me rajonet tjera të turizmit në Kosovë.

Burimi kryesor i financimit për ndërtimin e kapaciteteve të qendrës turistike të Brezovicës, ishte "Fondi i Federatës për kreditimin e republikave të pazhvilluara". Mjetet e fondit ishin të favorshme, ngase kushtet e kreditimit lejonin afatin e kthimit prej 18 deri 22-vjet, me kamatë vjetore prej 3-4% dhe greis periudhën prej 2 vjetësh.

2.4.2. Investimet pas 99'

Pavarësisht nga gjendja e vështirë e pasluftës, rritja e kërkesës turistike e krijuar si nga vendorët ashtu edhe nga komuniteti ndërkombëtar që punon në Kosovë, ka ndikuar në shtimin e investimeve në kapacitetet hoteliere dhe restorante, por jo edhe me investime në kapacitetet përcjellëse të cilat do t'ua rrisnin qarkullimin këtyre lokaliteteve.

Një investim i rëndësisë së madhe është riparimi i rrugës Prizren-Prevallë-Brezovicë që është bërë me ndihmën e KFOR-it gjerman. Janë realizuar edhe investime private me çka janë ngritur restorante dhe motele të ndryshme në mënyrë të paorganizuar, pa ndonjë plan biznesi afatgjatë të hartuar me profesionalizëm, me të cilin do të analizoheshin faktorët që do të garantonin efektivitetin e investimit. Në vitin 2007 kanë filluar punimet në fshatin turistik në Prevallë/Prizren me investim publiko privat.

2.4.3. Vlerësimi i kapaciteteve investive 2010-2028

Turizmi është veprimtari komplekse e shoqërisë së sotme moderne, të cilën e ndihmojnë edhe komunikacioni, bujqësia, shëndetësia dhe veprimtaritë tjera të cilat formojnë ofertën konkrete. Prandaj zhvillimi i turizmit kërkon kapacitete më bashkëkohore në komunikacion, tregti, infrastrukturë komunale, zejtari dhe në veprimtari të tjera shërbyese.

Bazuar në resurset natyrore, pozitën e përshtatshme gjeografike, kushtet klimatike, infrastrukturën ekzistuese, etj., ekziston një interesim i madh për investime në zonën e Sharrit, por mungesa e planit hapësinor, planeve rregulluese urbanistike, planit të menaxhimit, pastaj ngadalësimi i procesit të privatizimit, dalin si pengesa në këtë drejtim.

Kjo gjendje bën që edhe shumë projekte të mos realizohen e njëherit kanoset rreziku që investimet, sidomos ato të huaja, të dedikohen për vendet tjera. Për përmbushjen e nevojave shumë të mëdha që i ka kjo zonë për investime, si në infrastrukturën teknike, në atë të resurseve njerëzore, mbrojtjes mjedisit etj., është i domosdoshëm koordinimi i të gjithë sektorëve të cilët marrin pjesë direkt dhe indirekt në arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm.

Mungesa e një koordinimi të sektorëve nga një trup i vetëm drejtues bën që investimet kapitale të mundshme të jenë shumë të vogla dhe vetë mënyra për ti hulumtuar ato është e vështirë. Disa nga investimet apo më saktësisht projektet që parashihen deri në vitin 2028 janë dhënë në vazhdim.

"Projekti për Zhvillimin e Qendrës Turistike Brezovica"

Në funksion të zhvillimit të turizmit në zonën e Brezovicës, Qeveria e Kosovës në vitin 2011 e ka inicuar "Projektin për Zhvillimin e Qendrës Turistike Brezovica". Zhvillimi i kësaj qendre është konsideruar një projekt i rëndësisë kombëtare, i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të komunës së Shtërpcës dhe më të gjerë në ekonominë kombëtare. Zona e parashikuar e zhvillimit planifikohet të ofrohet nga Qeveria e Kosovës, me një qira afatgjatë të tokës apo koncesion dhe do të përfshijë objektet ekzistuese të skijimit e edhe pronat përcjellëse.

Rrjedhimisht, në funksion të realizimit të këtij projekti, hapësira për zhvillimin e Projektit Brezovica, me këtë plan hapësinor është caktuar si zonë e tretë e mbrojtjes me qëllim të lejimit të investimeve nga investitorët potencial, të cilët në pajtim me legjislacionin në fuqi do të propozojnë master planet për realizimin e këtij projekti. Të gjithë hapat dhe procedurat e parapara në këtë plan hapësinor që ndërlidhen apo ndikojnë në hapësirën për zhvillimin e Projektit Brezovica duhet të zhvillohen në koordinim dhe pajtim të plotë me Komitetin Ndër-Ministror të Projektit si dhe objektivat dhe synimet e "Projektit për Zhvillimin e Qendrës Turistike Brezovica" si projekt me interes kombëtar.

Projektet e parapara nga komuna e Kaçanikut

Nr	Emri i Projektit	Investimet sipas territorit të parkut		Komuna	Afati i parapar për investime	Burimi I investimeve			Shuma totale - Euro
		Brenda kufirit	Jashtë kufijve			Sektori Publik %	Sektori Privat %	Donacion % KONCESION	
1	Hartimi i planeve rregulluese urbanistike për qendrën turistike "Luboteni"	po		Kaçanik	2010-2020	50%		50%	20,000
2	Ndërtimi i infrastrukturës për qendrën turistike" Luboteni"	po		Kaçanik	2010-2020	80%		20%	4,000,000
3	Qendra turistike "Bushi" Luboten	po		Kaçanik	2010-2020		100%		257,000,000
					Gjithsej	1%	98%	1%	**261,020,000**

Projektet e parapara nga MI dhe komuna e Dragashit

Nr	Emri i Projektit	Investimet sipas territorit		Komuna	Afati i paraparë për investime (vitet)	Burimi I investimeve			Shuma totale - Euro
		Brenda kufirit	Jashtë kufijve			Sektori Publik %	Sektori Privat %	Donacion % KONCESION	
1	Hartimi i planeve rregulluese urbanistike për qendrën turistike "Guri I Zi"		Jashtë kufijve të parkut	Dragashit		10%	50%	40%	20,000
2	Hartimi i planit rregullues urban		Jashtë parkut	Dragashit		100%			50,000
3	Rruga Zaplluxhe-Preslop	brenda parkut	Jashtë parkut	Dragashit				100%	80,000
4	Elektrifikimi i qendrës turistike		Jashtë parkut	Dragashit		100%			60,000
					Gjithsej	55%	5%	40%	**210,000**

▶ Tabela: Projektet e parapara nga MI dhe K. e Dragashit

MI / Departamenti i infrastrukturës rrugore/Projektet për vitet (2015 -2018)

Nr	Emri i Projektit	Investimet sipas territorit të parkut		Komuna	Afati i paraparë për investime	Burimi I investimeve			Shuma totale - Euro
		Brenda kufirit	Jashtë kufijve			Sektori Publik %	Sektori Privat %	Donacion % KONCESION	
1	Mirëmbajtja verore e rrugëve Regjionale te cilat shtrihen ne këtë zone	po	jo	Prizrenit Suharekës dhe Shterrpces	çdo vit	100%	-	-	34,000
2	Mirëmbajtja dimërore e rrugëve regjionale te cilat shtrihen ne këtë zone	po	jo	Prizrenit Suharekës dhe Shterrpces	çdo vit	100%	-		25,500
3	Sinjalizimi horizontal dhe vertikal	po	jo	Prizrenit Suharekës dhe Shterrpces	çdo vit	100%			17,000
4	Hartimi i Projektit të rrugës regjionale R-118	po	po	Suharekë-Shterrpce	2015-2016	100%			90,000
5	Ndërtimi i rrugës Regjionale R-118 Mushtisht-Verbeshtic- Faza I	po	po	Suharekë-Shterrpce	2016-2017	100%			1,800,000
6	Ndërtimi i rrugës Regjionale R-118 Mushtisht-Verbeshtic-Faza II	po	po	Suharekë-Shterrpce	2017-2018	100%			2,000,000
					Gjithsej	100%	%	%	**3,966,500**

▶ Tabela: Projektet e parapara nga MI

Projektet e parapara nga komuna e Therandës (Suharekës)

Nr	Emri i Projektit	Investimet sipas territorit		Komuna	Afati i paraparë për investime (vitet)	Burimi I investimeve			Shuma totale - Euro
		Brenda kufirit	Jashtë kufijve			Sektori Publik %	Sektori Privat %	Donacion % KONCESION	
1	Ndërtimi i qendrës rekreative – rehabilituese në Parkun Kombëtar „Sharri''	po		Suharekë	2013-2028	100%			7,600,000
2	Zhvillimi i eko-turizmit në fshatin Delloc (projekt ideor)	po		Suharekë	2013-2015	40%		60%	441,000
					Gjithsej	96%		4%	**8,041,000**

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të përmbledhura të gjitha projektet e parapara për periudhën 2010-2028 realizimi i të cilëve kërkon shumën prej rreth 270 Milion Euro, të cilat siç shihet parashikohet të jenë nga sektori privat dhe publik.

Nr	Projekti	Investimet sipas territorit		Afati i paraparë për investime	Burimi i investimeve %			Shuma totale - Euro
		Brenda kufirit	Jashtë kufijve		Sektori Publik	Sektori Privat	Donacion	
1	Projektet e MI	po	po	2015-2018	100%	0%	0%	3,966,500
2	Projektet e Komunës së Therandës			2013-2028	96%		4%	8,041,000
3	Projektet e Komunës së Kaçanikut			2010-2020	1%	98%	1%	261,020,000
4	Projektet e Komunës së Dragashit		po		55%	5%	40%	210,000
Shuma e investimeve totale				**2010-2028**				**~ 270 mil.**

▶ Tabela: Tabela e investimeve totale



III KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR


3. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

3.1. Koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor

Koncepti i zhvillimit hapësinor të Parkut Kombëtar „Sharri", shprehë kornizën themelore të mundësive hapësinore të zhvillimeve brenda tij dhe njëherit mundëson thjeshtësimin e marrjes së vendimeve lidhur me zhvillimet e ardhshme në te. Me këtë koncept synohet, që me veprimet e duhura në kuadër të zhvillimeve të ardhshme, të përmbushet vizioni i përcaktuar për parkun kombëtar, përmes arritjes së caqeve të synuara dhe objektivave specifike që janë theksuar më parë.

Koncepti i ofruar për parkun kombëtar - Parku i Llojllojshmërisë - trajton çështjet nga tri fushat tematike: mjedisi dhe shfrytëzimi i tokës, zhvillimi socio - ekonomik dhe infrastruktura. Këto tri fusha përfshijnë të gjithë spektrin e aktiviteteve të nevojshme për ekzistimin dhe funksionimin e parkut.

Fakti që territori për të cilin hartohet plani hapësinor, është zonë e mbrojtur dhe e shpallur park kombëtar, kushtëzon që trajtimi i tij të orientohet sa më shumë në mbrojtje. Pra, koncepti kryesisht merret me mbrojtjen e vlerave të veçanta të biodiversitetit, llojeve endemike dhe stenoendemike të florës dhe faunës, kurse në anën tjetër dhe shumë të vogël ky koncept merret me zhvillime që mundësojnë qëndrueshmërinë e parkut si vlerë. Këto vlera dhe pasuri janë të shpërndara në gjithë territorin e parkut dhe varësisht nga përmbajtja dhe rëndësia ndahen në zona, të paraqitura si në figurën më lartë.



Pjesa e këtij koncepti që ka të bëjë me mjedisin bazohet në parimet themelore të mbrojtjes së parqeve nacionale dhe të mbrojtjes së natyrës në përgjithësi. Hapësira e parkut konsiderohet si një zonë me mundësi reale dhe shumë të mirë për hulumtim, mbrojtje, ruajtje dhe zhvillim të llojllojshmërisë biologjike si dhe të llojllojshmërisë së aktiviteteve për një zhvillim të qëndrueshëm brenda dhe për rreth parkut. Shumica e veprimtarive ekonomike, të cilat do të zhvillohen në park, janë të ndërlidhura drejtpërdrejt me shfrytëzimin racional të resurseve

dhe atraksioneve të natyrës me emërues të përbashkët – hulumtim, mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim.

Koncepti i zhvillimit ekonomik është i bazuar parimisht në mbrojtjen e parkut si kusht i domosdoshëm, me orientime për zhvillime të mëtutjeshme rreth kapaciteteve ekzistuese dhe potencialeve tjera turistike. Këto zhvillimet kryesisht konsistojnë në përgatitjen e ofertës dhe promovimin e turizmit rural dhe të eko turizmit duke shtuar mundësinë e shfrytëzimit të fshatrave përreth parkut kombëtar si kapacitete turistike.

Edhe koncepti i zhvillimit të infrastrukturës teknike, në thelb e ka mbrojtjen me intervenime sa më të vogla në natyrë deri në masën e funksionimit normal të aktiviteteve që kryesisht ndikojnë në mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të parkut.

3.1.1. Zonat e Parkut Kombëtar "Sharri"

Këtu, në mënyrë skematike, është prezantuar koncepti i zhvillimit hapësinor për Parkun Kombëtar "Sharri", i bazuar në ndarje zonale sipas kategorive apo nivelit të mbrojtjes dhe të zhvillimit dhe si të tilla janë faktor kryesor që ndikojnë në idenë e konceptit.

Si rezultat i përmbajtjes, strukturës dhe funkcionalizimit të zhvillimeve, territori i parkut ndahet në tri zona:

- **Zona e mbrojtjes rigoroze** (zona ose shkalla e parë e mbrojtjes;
- **Zona për menaxhim aktiv** (zona ose shkalla e dytë e mbrojtjes);
- **Zona për shfrytëzim të qëndrueshëm** (zona ose shkalla e tretë e mbrojtjes).
- **Zona me ndikim të ndërsjelltë** (zona e katërtë)

Ky koncept përfshinë dhe trajton edhe vendbanimet përreth parkut, që paraqet zonën e katërt të mbrojtjes, gjegjësisht zonën e ndikimit reciprok (të ndërsjellë), e cila me përmbajtje dhe potencialin e saj ka ndikim të theksuar në funksionimin dhe zhvillimin e ardhshëm të parkut.


Kryesisht zhvillimi ekonomik i parkut bazohet në parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky zhvillim do të bazohet në shfrytëzimin racional të resurseve dhe ofrimin e llojeve të ndryshme të turizmit, me karakteristika dhe specifika që ofron parku. Gjithmonë duke synuar në grumbullimin e të hyrave nga vizitorët për mbrojtjen e tij.

Me qëllim të mbrojtjes së vlerave natyrore, në vitin 2007 është hartuar[26] dhe realizuar projekti për zonimin e parkut që ka konsistuar në konfirmimin ose rivendosjen e vijave kufitare për të katër rezervatet strikte (Maja e Arnenit, Oshlaku, Pisha e Madhe dhe Rusenica) si dhe për dhjetë zonat me vlera të veçanta natyrore. Ekipi i ekspertëve që ka marrë pjesë në realizimin e këtij projekti, pas vëzhgimit të kujdesshëm në teren ka konstatuar se zonat me vlera të veçanta natyrore mund të shpallen rezervate të natyrës.

Në hartën e zonimit vërehen qartë të tri zonat e mbrojtjes brenda parkut si edhe ajo e katërta përreth tij, për të cilat mund të konkludojmë që:

- Territoret që i përkasin zonës së mbrojtjes rigoroze (ose të parë të mbrojtjes), janë të paraqitura me ngjyrë të gjelbërt dhe zënë 17.5 % të hapësirës në kuadër të sipërfaqes së tërësishme të parkut. Ato janë të shpërndara nëpër territorin e parkut e shumë prej tyre janë përgjatë kufirit me Maqedoninë dhe Shqipërinë.
- Sipërfaqet e zonës për menaxhimit aktiv (ose të dytë të mbrojtjes), janë paraqitur me ngjyrë të verdhë dhe zënë hapësirë më të madhe. Me pjesëmarrje prej 75.4 % të sipërfaqes së parkut dhe shtrihen në tërë hapësiren e tij, përveç aty ku është zonë e parë dhe e tretë.
- Kurse territoret e zonës së tretë të mbrojtjes (ose shfrytëzimit të qëndrueshëm), të shprehura me ngjyrë portokalli dhe me 7.1 % pjesëmarrje, janë të shpërndara nëpër hapësirën e parkut dhe iu përkasin të gjitha komunave pjesëmarrëse.
- Zona e ndikimit të ndërsjelltë (ose zona e katërt), është zona e vendbanimeve që shtrihet përreth parkut dhe varësisht nga përmbajtja, struktura dhe aktivitetet socio-ekonomike dhe kulturore ndahen në ato me ndikim më të theksuar (më të lartë) dhe në ato me ndikim më të zbutur.

[26] Projekti ,Zonimi i Parkut Nacional" Mali Sharr" , Maj 2007, MMPH.



▶ Harta: Zonimi sipas shkallës së mbrojtjes

3.2. Struktura, funkcionimi dhe zhvillimet e ardhshme sipas zonave në park

'Parku i llojllojshmërisë', në të njëjtën kohë është edhe - 'park rezervat natyror' - për nga llojllojshmëria (diversiteti) i jetesës biologjike por edhe - 'park shumë funksional' - për shkak të llojllojshmërisë (diversitetit) të aktiviteteve që zhvillohen në te. Aktivitetet që duhet të zhvillohen në park dhe përfshihen në këtë koncept mund të përmblidhen dhe të shprehen në tri forma themelore të funksionalizimit, ose si veprime dhe zhvillime në:

- funksion shkencor;
- funksion edukativo-arsimor;
- funksion turistiko-rekreativ.

Mirëpo, struktura dhe funksionalizimi i zhvillimeve në përgjithësi shprehet me orientimet që kryesisht ndërlidhen me mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut. Përderisa mbrojtja shprehet me masa dhe veprime strikte, zhvillimet e parapara, kryesisht shprehen me aktivitete dhe veprimet të cilat nuk e shqetësojnë dhe degradojnë mjedisin, botën bimore dhe shtazore, hidrografinë, gjeomorfologjinë, gjeologjinë dhe vlerat me rëndësi pejsazhore.

Bazuar në idenë për funksionalizim të këtij koncepti, pra të ndarjes së territorit të parkut në zona sipas nivelit të mbrojtjes, elaborohen edhe struktura, funkcionimi i zonave sikur edhe zhvillimet e ardhshme në park.

3.2.1. Zona e parë e mbrojtjes

Zona e mbrojtjes rigoroze, në strukturën e saj krejtësisht natyrore (llojllojshmëria biologjike, gjeomorfologjike dhe speleologjike) përfshin rezervatet strikte dhe zonat me vlera të veçanta si dhe merr 9363.51 ha (17.5 %) të territorit të parkut. Në përbërjen e saj karakterizohet me ekosistemet me potenciale autentike të pandryshuara ose pak të ndryshuara si rezultat i praktikave tradicionale të menaxhimit. Kjo zonë karakterizohet me dendësi të lartë të llojeve tipike, të rralla dhe endemike të bimësisë, me dendësi të lartë të bimëve që janë vënë nën mbrojtje, me dendësi të lartë të tokave nën ujë (rrjedha ujore, liqene, ligatina, këneta, sipërfaqe të mbytura në ujë dhe burime), me shkëmbinj të veçantë dhe është zonë me rëndësi të madhe për linjat e migrimit të dhive të egra, arinjve dhe rrëqebujve. Këtu, jeta e lirshme e habitateve të botës bimore (flora me speciet pyjore, barishtore, etj) dhe shtazore (fauna me speciet e sisorëve, rrëshqitësve, shpezëve, etj), duhet të zhvillohet në kushte krejtësisht natyrore.
Për shkak të vlerave të jashtëzakonshme natyrore (biodiversiteti, pejsazhi, konfiguracion terreni etj.) dhe verifikimit në teren përcaktohen për rezervate strikte dhe të mbrohen me ligj këto zona:

Rusenica – Kjo zonë shtrihet në pjesën veriore të parkut me sipërfaqe rreth 270 ha dhe ka veçori të veçanta floristike dhe faunistike. Kjo zonë paraqet vendbanimin e reqebullit dhe kafsheve të tjera të egra (ariu i murrmë, kaprolli, dhija e egër etj.), si dhe shumë bimëve endemike si: Bornmullera dieckii, Potentila argentea, Pilygala doerfleri, Ramonda serbica, Acer heldreichi, Achillea holysolicea, Hieraceum weldsteini, Galium rupestre, Daphne oloeides, Pinus heldreichii, Scrophularia bosniaca, Minuartia baldaci, Achillea ageratifolia, Erysimum silvestre, Aetionema saxatile, Eryngium palmatum, Sylibum marianum, Camapnula secundiflora, Onosma echioides, Alyssum repens, Lamium garganicum, Coridalis oreoluca, etj. Në këtë zonë paraqiten shumë fitocenoza (bashkësi bimore), ndërsa më të përhapura janë: pyjet e ahut dhe bredhit (Abieti-fagetum), pyjet e ulëta të mëllezës dhe frashnit të zi (Qrno-carpinetum), dhe dy bashkësi të rrala dhe specifike: bashkësia e bornmulleres me rrobullin (Bornmullero-Pinetum heldreichii) dhe Daphno-juniperetum oxicedri, (bashkësia në gelqeror-dolomit e cila deri më tani është e paverifikuar në shkencën e botanikës). Pjesa më e madhe e kësaj zone, është e shpallur rezervat strikt natyror që në vitin 1955, me një sipërfaqe prej 300 ha, si vendbanim i reqebullit. Mirëpo, pas zbulimit të shumë llojeve endemike bimore dhe bashkësive të tyre, vlera shkencore e këtij rezervati akoma është rritur. Poashtu, në brendësinë e kësaj zone është Shpella e Matosit dhe monumenti kulturo-historik "Dhomat e Rusenicës". Ndërsa, për të ardhmën ngelet, që statusi i këtij rezervatit strikt natyror, të pranohet dhe konfirmohet ndërkombëtarisht.

Pisha e Madhe – Shtrihet në shpatijet jug-lindore të Koxhaballkanit, gjegjësisht në pjesën perëndimore të parkut kombëtar me sipërfaqe prej rreth 44 ha. Ka vlera të veçanta floristike dhe është lokalitet me pyje të vjetra të vjetra të rrobullit

të cilat formojnë bashkësinë bimore Seslerio autumnalis – Pinetum heldreichii,. Ky Rezervat paraqet kompleksin më të bukur dhe më interesant të Rrobullit në Ballkan. Një pjesë e madhe e tij, me një sipërfaqe prej rreth 35 ha, është e shpallur për Rezervat që në vitin 1960 dhe në literatura të ndryshme mund të gjendet me emrin 'Golem Bor'. Në rezervat dhe afërsinë e drejtperdrejt gjenden edhe dukuri e objekte interesante hidrografike. Në anën lindore shtrihet ujëndarësi detar, në mes Detit Egje dhe Adriatik, perkatësisht pellgut të lumit Lepenc dhe atij të Bistricës së Prizrenit. Potezi i ujëndarësit njihet me emrin lokal Virovi dhe cilësohet me pejzazhe të bukura të kullotave alpine dhe me shumë burime të ujit që edhe në periudhen më të thatë të vitit kanë ujë.

Oshlaku - Me pozitën e tij qendrore në park, Mali i Oshlakut shtrihet prej pjesës perëndimore kah ajo qendrore dhe me sipërfaqe rreth 550 ha ka vlera të rralla bimore dhe shtazore. Pjesa e tij me rreth 20 ha, me emrin Rezervati Natyror "Oshlak" me pyje të pastra të Rrobullit (Seslerio – Pinetum heldreichii,), që gjendet në pjesën perëndimore të këtij Mali, është shpallur që në vitin 1960. Krahas pyjeve të rrobullit, në rezervatin e Oshlakut ndodhen edhe disa lloje të rëndësishme të florës endemike dhe relikte. Këtu ndodhet lloji endemorelikt i periudhës glaciale Driada tetëpetalëshe (Dryas octopetala). Ky lloj zakonisht shoqërohet nga lloji Alchemila alpigena, që së bashku me llojin Pinus mugho, përbëjnë fitocenozën Dryado-Alchemilo pinetum mughi. Pastaj llojet me karakter endemik, endemorelikt dhe llojet mjekësore sikur janë: Manaferra e gurit (Rubus sacsatile), Heliantema e thinjur (Helianthemum canum), karafili (Dianthus integer), karafil pyjor (Dianthus sylvestris), karafil me balluke (Dianthus superbus), sanëza (Gentiana lutea), gentianët (Gentiana utriculosa, Gentiana ascleptiadae, Gencianella bullgarica), lisa shqiptare (Thymus albanus), zambaku shqiptar (Lilium albanicum), edraiant gjethebari (Edreianthus graminifolia), iriqëza veshëve e gjelbër (Saxifraga sempervivum), nejcë e përdredhur (Polygonum bistorta), rrushë arushe (Archtostaphilus uva ursi), esparatë mali (Onobrychis scardica), aguliqe e vërtetë (Primula officinalis), brinjëkau në trajtë kose (Bupleurum falcatum), brinjëkau i Karglit (Bupleurum karglii), Alkana e Sharrit (Alcanas scardica), Zorrëca malazeze (Potentilla montenegrina), Vingjëra e livadhit (Lathyrus pratensis), Iriqëza



tregishtore (Saxifraga trydactilides), Pratishi i Dimonieit (Soldanella dimoniei) etj.

Nga llojet drunore halore përveç rrobullit (Pinus heldreichii) dhe kërlekës (Pinus mugho), janë të pranishme edhe llojet: hormoqi (Picea exelca), bredhi (Abies alba) dhe arneni i bardhë (Pinus peuce) ndërsa nga llojet drunore gjetherënëse janë: shelgu i egër (Salix caprea), vojsa e egër (Sorbus aocuparia), lajthia (Coryllus avellana) etj.

Rezervati i Oshlakut, ka rëndësi të madhe edhe në aspektin ornitofaunistik sepse është habitat i disa llojeve të rëndësishme të zogjve që gjenden në Aneksin I të Direktivës së Zogjve. Të dhënat flasin se në pjesën gurore të rezervatit sidomos gjatë stinës së pranverës këtu e haset Pulegra e madhe (Tetrao urogallus) dhe thëllëza e gurit (Alectoris graeca), që gjenden në Aneksin I të Direktivës së zogjëve, dhe Pula e pyjeve (Tetrastes bonasia) që gjenden në Listën e Kuqe të IUCN-së. Poashtu nga kjo listë, nga zogjtë grabitqarë, në këtë rezervat është e pranishme Shqiponja minjngrënëse (Buteo buteo).

Ky rezervat i propozuar, që shtrihet kryesisht në pjesët më të larta të malit Oshlak, përmban këto bashkësi bimore: Pyje të pastra të

rrobullit në ekspozicionin jugor (mbi fshatin Mushnikovë), të cilët janë të ruajtura dhe paraqesin habitat për shumë lloje të kafshëve të egra, në veçanti të dhijes së egër, kaprojve, ariut të murrmë dhe shqiponjës së përhimtë.

Pyje të hormoqit që paraqesin vegjetacionin më të lartë pyjor në ekspozicionin verior të Oshlakut. Bashkësitë e kërlekës që gjenden në ekspozicionin verior të cilët, përveç vlerave natyrore, e kanë rolin e mbrojtjes së tokës nga erozioni.

Bashkësitë e llojeve barishtore të pasura me bimë endemike (veçohet bashkësia Achileo-Onobrichys scardica) që i mbulojnë pjesët më të larta të Oshlakut mbi vegjetacionin pyjor.

E veçantë e rezervatit të propozuar është prania e llojit stenoendemik barpezmi i mbretit Aleksandër (Achillea alexandri – regis) që gjendet kryesisht në pjesët e larta malore ku formon dy bashkësitë të rëndësishme bimore: Achilleo – Pinetum mughi (Pinetum mugho calcicolum) dhe Achilleo-Onobrychis scardica.

Rezervati i është i pasur edhe me lloje të tjera të rëndësishme bimore, siç janë: Senecio vagneri, shmanga shqiptare (Crepis albanica), antilidë e verdhë (Anthyllis vitelina), antilidë e praruar (Anthyllis aurea), syviç i Kretës (Anthemis montana), barpezmi gjethe karajpel (Achillea tanacetifolia), eufrazi i Roskovit (Euphrazia roskoviana), kokoqel i pyllit (Centaurea montana), këmashua (Hieracium aurantiacum), karafil ngjurë gjaku (Dianthus cruenthus), lisra shqiptare (Thymus albanus), këmashnat (Hieracium villosum, Hieracium alpicolum), asteri shqiptar (Aster alpinus), esparceta e Sharrit (Onobrychis scardica), sanëz (Gentiana lutea), knautie gjethe gjatë (Cnautia longifolia), panja e Heldraihut (Acer heldreichii), sarusha e sharrit (Stashys scardica) etj.


Në aspektin faunistik, rëndësia e kësaj zone qëndron në atë se në kullosat e majave të rajonit të Oshlakut haset dhia e egër (Rupicapra rupicapra), sipas vëzhgimeve në këtë zonë janë të pranishme rreth 60 krerë të dhive të egra, tri qifteve të shqiponjës minjngrënëse dhe shumë individëve të thëllëzës së gurëve.

Në propozimin e ri të zgjeruar të rezervatiti të Oshlakut, përveç këtyre llojeve të lartë cekura, janë të pranishme edhe shumë lloje të tjera të rëndësishme të ornitofaunës dhe kafshëve të egra, siç janë: skifteri malor (Falco biarmicus), shqiponja e përhimtë (Aquila chrysaetos), huti pyjor, ariu i murrmë (Ursus arctos), ujku (Canis lupus), kaprolli (Capreolus capreolus). dhelpra (Canis vulpes), derri i egër (Sus scrofa), macja e egër (Filis sylvestris), vjedulla (Meles meles), shqarthi i artë (Martes martes), fishnjari (Martes foina), lepuri i fushës (Lepus europeus), etj. Shumë prej këtyre llojeve të faunës janë të rrezikuara si pasojë e mungesës së mbrojtjes adekuate të zonës nga prania njerëzve, në veçanti gjahtarëve ilegal. Me shpalljen e rezervatit strikt natyror të „Oshlakut" do të krijohen kushtet e volitshme për mbrojtjen dhe zhvillimin e mirëfilltë të faunës.

Sidomos me stenoendemitin Achilea alexandri Regis (që gjindet vetëm në këtë pjesë të parkut dhe askund tjetër në botë),

Maja e Arnenit – Me shtrirjen e saj qendrore dhe me 145 ha është zonë me pyjet më të ruajtura endemorelikte të rrobullit (Pinetum heldreichii). Një pjesë prej 30 ha ka qenë e shpallur si rezervat strikt natyror që në vitin 1960. Këto pyje me vlera të jashtëzakonshme natyrore shtrihen në shpatijet jugore të malit Oshlak. Në kuadër të këtij rezervati strikt natyror gjenden të ekosistemeve endemorelikte pyjore të rrobullit dhe të ahut ku është verifikuar biodiverziteti i theksuar i llojeve drunore: endemoreliktet Pinus heldreichii dhe Pinus peuce si dhe llojet tjera si Fagus moesaicae, Fraxinus ornus, Acer pseudoplatanus, Pinus nigra, Picea excelsa, Lonicera xilosteum, Juniperus communis, J. nana, Daphne mezereum, Rosa canina, Rhamnus cathartica, Salix caprea, Salix arenaria, Sobus aucuparia, S. austriaca, Betulla pubescens, Alnus glutinosa, si dhe dhjetëra lloje barishtore.

Hulumtimet në këtë rajon kanë treguar se kjo zonë e parkut ka vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe shkencore. Në kuadër të biodiverzitetit të pasur veçohen llojet e shumta endemike bimore: stenoendemiti Vrbascum scardicolum (gjendet vetëm në rajonin e Prevallës dhe askund tjetër në botë!), Pinus heldreichii (lloj endemorelikt), Pinus peuce (lloj endemik i Ballkanit), Gentianella bulgarica var. albanica, Dianthus cartusonarum, Dianthus integer, Lazerpitium siler, Campanula albanica, Thymus albanus, Campanula foliosa, Verbascum nikolai, Stachys scardica, Viola zoisii, Viola grisebachii, Ephilobium anagallidifolium, Buplenium subthorpianum, Phytenua pseudoverbiculare, Trifolium velenovskyi (lloj endemik i Ballkanit), Carex leavis, Anthemis carpatica, Onobrychis scardica, Anthyllis aurea, Doronicum



orphanidis, Campanula spatulata, Campanula epigea, Scabioza dubia, Potentilla speciosa, Cynanchum huteri etj.

3.2.1.1. Zonat e propozuara për rezervate

Zonat me vlera të veçanta natyrore, me këtë plan hapësinor propozohet të shpallen rezervate natyrore. Propozimi mbështetet në hulumtimet e bëra në terren dhe rekomandimet nga hulumtuesit.

Pashallare – zona me vlera të jashtëzakonshme natyrore në kuadër të cilëve veçohet biodiverziteti i theksuar i florës dhe faunës të karakterit endemo-relikt, pejsazhet e bukura dhe përbërja e rrallë gjeologjike nga serpentiniti. Bashkësitë më të rëndësishme të pyjeve që janë verifikuar në këtë zonë janë: Roso-Pinetum heldreichi serpentinicum dhe Lilio-Pinethum mugho serpentinicum të cilët deri me tani janë të pakonstatuar në shkencën e botanikës. Nga bashkësitë e tjera veçohen: pyjet e ahut (Fagetum montanum serpeniticum), vegjetacioni shkurror i hartinës (Pinethum mughi serpentinicum) dhe pyjet e përziera të rrobullit, arnenit, bredhit, hormoqit dhe hartinës. Kjo zonë është e pasur me mbi 100 lloje të bimëve endemike, ndër të cilët veçohen: Bornmuellera dieckii, Cerastium neoscardicum, Lazerpitium siler, Lilium albanicum, Pinus heldreichii, Pinus peuce, Pinus mugho, Taxus bacata, Campanula albanica, Campanula foliosa, Stachys scardica, Cnautia dinarica, Ranunculus incomparabilis, Cicerbita pancici, Salix herbace, Rumex scutatus, Silene pusila var. albanica, Barbarea longolostris, Cardamine carnosa, Alysum scardicum, Sedum flexiosum, Pancicia serbica, Bupleurum karglii, Carum rupestre var. albanicum, Centaurea kosanini, Campanula moesiaca, Dianthus gracilis, Dianthus integeri, Sedum serpenicum, Antylis vitelina, Onobrychis pindicola, Lamium pictum, Thymus rohlenae, Pinguicula balcanika, Pinguicula lanceolata, Asperula doerfleri, Saxifraga serpervivum, Saxifraga taygetea, Linaria peleponisiaca, Melanpyrum scardicum, Pedicualris grisebachii, Scrophularia aestivalis, Lunaria teleciana, tj.

Lendina e Gjatë - zonë e pasur me llojin stenoendemik Bornmuellera dieckii e cila formon dy bashkësi endemike me dëllinjën (Bornmuelo-juniperetum interemedie) dhe me polygallën (Bornmuellero-Polygonetum amarae). Nga llojet e tjera endemike që janë të pranishme në këtë zonë veçohen: Pinus heldreichi, Stachys scardica, Erisimum pectenatum, Polygala doerfleri, Pinus mugho, Gencianela bulgarica, Petrorhargia ilirica.

Koplica - Kopilica me rreth199 ha shtrihet në kufirin jugor- të PK "Sharri", në kufi me Maqedoninë, mbi fshatin Lubinja e Epërme. Sipërfaqa e rezervatit të propozuar natyror gjendet në ekspozicionin verior në lartësinë mbidetare prej 2000 - 2528 m.

Kopilica paraqet zonën me bimë të rrallë kalcifite dhe hezmofite që janë të përshtatur habitatit me kushte të vështira klimatike dhe pedologjike (tokat e varfura dhe të pa zhvilluara), ndër të cilët veçohet lloji stenoendemik me rëndësi ndërkombëtare Hieracium kobilicanum.

Zona është e mbuluar me vegjetacion barishtor i pasur me bimë të shumta endemike siç janë: Hieracium kobilicanum, Silene schmucheri, Rumex nivalis, Salix herbacea, Dinathus superbus, Viola grisebachiana, Erigeron uniflorus, Saussurea alpine, Lilium albanicum. Kurse nga llojet e faunës që gjenden në këtë zonë veçohet dhia e egër.

Livadhet e mbretit - Liqeni i Jazhincës (Bistra) - Kjo zone, me sipërfaqe prej 975 ha, shtrihet në pjesën juglindore të Prevallës dhe i përfshin lokalitetet: Livadhi i Mbretit, Ujrat e Humbur, Bistra dhe Çuka e Liqenit. Kufiri jugor i zonës përputhet me kufirin

shtetëror të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Maqedonisë, me lartësi mbidetare 1500 - 2640m. Kjo zonë karakterizohet me vlera të veçanta floristike, faunistike, fitocenologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike dhe hidrologjike. Emri i rezervatit natyror është dhënë në bazë të majes malore Bistra (2640 m) e cila paraqet majen më të lartë në Parkun Kombëtar "Sharri" dhe të dytën (pas Gjeravicës me 2656 m) në Republikën e Kosovës. Specifikat më të rëndësishme të zonës janë bashkësitë pyjore të rrobullit, arnenit, pishës së bardhë, hormoqit, panjës malore dhe rododendrës, ekosistemet shkurrore dhe barishtore të maleve të larta në silikate, liqeni akullnor i Jazhincës etj.

Në pjesët më të ulëta të zonës, në lokalitetet Livadhi i Mbretit dhe Ujrat e Humbur (Gine vode), duke filluar prej 1500 m të lartësisë mbidetare, gjendet bashkësia Fagetum moesiacum, ndërsa në lartësinë mbidetare prej afro 1700 m në ekspozicionet jugore gjendet bashkësia Seslerio-Pinetum heldreichii.

Në ekspozicionet veriperendimore është bashkësia Ajugo - Pinetum peuces, ku përveç molikës në katin dominant të bimëve barishtore është lloji alpik Ajugo piramidalis. Pastaj bashkësia e arnenit, rrobullit dhe pishës së bardhë (Pineto- Pinetum peucis mixtum), që lokalitetit të Ujrave të Humbur i jep vlerë të veçantë. Pastaj, bashkësia e arnenit dhe drandafilit alpik (Rhododendro-Pinetum peucis) deri në 2000 m, bashkësia shkurrore e maleve të larta (Juniperus nana-Bruckenthalia spiculifolia) mbi vegjetacionin pyjorsi dhe bashkësitë barishtore të maleve të larta në pjesët të ashpra shkëmbore të lokaliteteve Quka e Liqenit dhe Bistra: Ranunculetum crenati, Potentilo doerfleri-Juncetum trifidi, Carex laevis-Sesleria comoza etj. të cilët karakterizohen me florën e pasur endemike Alpiko-Karpate dhe arktike.

Zona e Bistrës veçohet me shumëllojshmërinë e bimëve endemike, nga të cilët veçohen: Rrobulli (Pinetum heldreichii), Arneni (Pinus peuce), Dredhaku (Pinus mugo), Panja malore (Acer heldreichii), Drandafili alpik (Rhododendron ferugenum), Vaccinium ulignosum, Draba korabensis (stenoendemit), Potentilla doerfleri (stenoendemit), Dianthus scardicus (stenoendemit), Dinathus superbus, Phyteuma confusiumi, Narthecium scardicum, Lilium albanicum, Carex foetida, Diphasium alpinum, Empetrum hermaphroditum, Salix herbacea, Salix reticulate, Rumex nivalis, Silene waldsteini, Silene



rupestris, Silene asterias, Hesperis dinarica, Rhodiola rosea, Saxifraga bryoides, Saxifraga cymosa, Saxifrage androsacea, Geum reptans, Epilobium anagallidifolium, Veronica alpine, Cryptograma crispa, Veronica aphylla, Potentilla montonegrina, Pancicia serbica, Plantago gentianoides, Sanëza (Gentiana punctata) -bimë mjekuese e rrezikuar, etj.

Zona është e pasur me lloje të shumta të kafshëve të egra (mamalia),më të rëndësishme janë: dhia e egër (Rupicapra rupicapra), ariu i murrmë (Ursus arctos), ujku (Canis lupus), kaprolli (Capreolus capreolus), dhelpra (Canis vulpes), derri i egër (Sus scrofa), macja e egër (Filis sylvestris), vjedulla (Meles meles), shqarthi i artë (Martes martes), fishnjari (Martes foina), lepuri (Lepus europeus)

Mandej shpendët (ornitofauna) më të rëndësishme janë: pulegrës së madhe (Tetrao urogallus), thëllëzës së gurit (Alectoris graeca), pula e pyjeve (Tetrastes bonasia), skifteri malor (Falco biarmicus), shqiponja e përhimtë (Aquila chrysaetos), shqiponjës minjngrënëse (Buteo buteo), huti pyjor etj.

Zona karakterizohet me specifika të veçanta hidrologjike. Vlerë të veçantë kësaj zone i jep liqeni glacial i Jazhincës i cili gjendet nën pjesën shkëmbore të Çukës së Liqenit në lartësinë mbidetare mbi 2000 m. Dimenzonet e liqenit janë: gjatësia 120 m, gjërsia 90 m dhe thellësia 11 m (është liqeni më i thellë në Sharr). Burimet e shumta të ujit derdhen në lumin e Jazhincës, ndërsa fenomen të veçantë hidrologjik paraqet edhe humnera e disa prrockave në brendësi të tokës që grumbullohen në lokacionin gelqëror Ujrat e Humbur.

Zona karakterizohet me veçori të veçanta geomorfologjike dhe peisazhore të cilët këtë zonë e bëjnë akoma më interesante në aspektet e vlerave natyrore, shkencore dhe edukativo-arsimore.

Sipas një analize të territorit të një zone ku sot gjenden terrenet e skijimit të Brezovicës dhe rreth tyre, në këtë territor janë propozuar pesë lokacione si alternativa të mundshme ku do të realizohej një projekt për ndërtimin e një qendre të re të skijimit me të gjitha përmbajtjet e nevojshme. Analiza është bërë nga firma "ecosign" me seli në Austri dhe është financuar nga Komisioni Europian. Realizimi i projektit që është quajtur projekti për zhvillimin e Malit Sharr-Brezovicës, është përkrahur nga Qeveria e Kosovës e cila e ka shpallur projekt me interes të përgjithshëm publik. Zona ku janë propozuar lokacionet e lartpërmendura dhe rreth tyre, sipas vendimit nr. 02/2013, datë 25.01.2013 të Komitetit Drejtues Ndërministror për Projektin e Zhvillimit të Brezovicës që këtë zonë ua lë në dispozicion investitorëve potencial, me këtë plan hapësinor bëhet pjesë e zonës III të parkut. Kjo zonë hyn me një pjesë, me 333 hektarë në pjesën lindore të zonës Bistra të propozuar për rezervat, kështuqë ky rezervat tani është më i vogël dhe i ka 642 hektarë.





Luboteni - paraqet majen fillestare malore të Malit Sharr në pjesën lindore të tij. Zona e propozuar për mbrojtje strikte ka sipërfaqen prej rreth 200 ha dhe shtrihet në kufirin me Republikën e Maqedonisë. Përfshinë pjesët më të larta malore të mbuluara me ekosistemet barishtore dhe shkëmbij gëlqeror me lartësi mbidetare1800-2499 m. Zona është e pasur me bimë endemike të cilët formojnë bashkësi (fitocenoza) të rralla bimore në kuadër të cilëve veçohen ato të karakterit subalpik dhe alpik.

Fitocenozat më të rëndësishme janë: Carex laevis-Helianthemum me reliktet glaciale Dryas octopetala, Linaria alpina (lloji tejet i rrallë), Sideritis scardica, Hieracium naegelianum supss. Lubotenicum, e cila ka rëndësi ndërkombëtare. Kë tu janë prezente edhe tjera si: Drypetum linnaeanae, Salicetum retusae reticulate, Trifolieto norici-Caricetum, Coccineo-Deschampsietum scardici, Ranunculetum crenati scardicum, Seslerietum comosae, Junipero-Bruchenthalietum, Cynosureto-Caricetum hirtae, Potentilio-Fumarietum bonapartei, Centaureo-Trifoliotum velenovsyi, Senecieto-Rumicetum alpine, Telekietum speciosae, Orphanideo-Cirsietum apoendiculati, Onobrychidi-Festucetum, Geranieto-Poetum violaceae etj.

Nga bimët e shumta endemike, të cilët ndikojnë në vlerat e jashtëzakonshme floristike të Lubotenit, veçohen: Achillea ageratifolia var aizooni, Scabiosa portae, Centaurea kosanini, Euphorbia glabriflora, Cirsium appendiculatum, Astrogalus vesicarius, Draba scardica, Genista hassertiana, Thlaspi bellidifolium, Salvia reinertii, Alysum cuneifolium, Salvia scardica, Alysum markgrafii, Thymus albanus, Dianthus microlepis, Thymus lykae, Dianthus scardicus, Plantago reniformis, Minuartia baldacii, Armeria canescens, Silene roemeri, Ranunculus millefoliatus, Silene sendtneri, Asperula dorfleri, Fumana bonapartei, Saxifraga sempervivum, Helianthemum balcanicum, Linaria peloponnesiaca, Convolvulus cochlearis, Melampyrum scardicum, Sedum flexuosum, Veronica satureiondes, Sedum serpentine, Viola aetolica, Knautia midzorendsis, Carex laevis, Lilium albanicum, Carex nigra, Crocus kosanini

Për shkak të kushteve të vështira (lartësia e madhe mbidetare dhe klima e ashpër arkto alpike) zona është e varfur me lloje të faunës. Kjo zonë kryesisht shfrytëzohet për kullotje të dhive të egra dhe nga shpendet grabiqar si shqiponja e përhimtë (Aquila crysaetos), skifteri i përhimtë (Falco peregrinus), shqiponja minjëgrënëse (Buteo Buteo) që këtë zonë e shfrytëzojnë për kërkim të ushqimit.

Dupnica dhe ujëmbledhësi i lumit Bukovë – gjendet në pjesën jugore të parkut dhe është zonë e maleve të larta të Sharrit në kufi me Maqedoninë. Me dy liqene të vogla - cirqe akullnajore dhe me ekosistem të veçantë natyrorë shtrihet në territor prej 484 ha.

Rajoni i burimit të Lumbardhit - shtrihet në pjesën jugore të parkut, në kufi me Maqedoninë, kah ajo qendrore me territor prej 304 ha. Hapësira e saj është e pasur me florë endemike dhe forma relievore glaciale. Burimi i lumit Lumbardh i Prizrenit dhe të dy liqenjtë (Liqeni i Epërm dhe ai i Poshtëm) që janë cirqe akullnajore përbëjnë pjesën qendrore të këtij Rezervati.

Klisura – Zona me sipërfaqe prej 104 ha e cila i përfshinë lokacionet Gryka dhe Pulan (Kokoshinje) shtrihet në pjesën perëndimore të parkut kombëtar, në afërsi të fshatit Gotovusha. Zona karakterizohet edhe me veçori të veçanta gjeomorfologjike

dhe peisazhore. Ekspozicioni i terrenit është verior dhe jugperëndimor, ndërsa lartësia mbidetare e zonës është prej 1100 deri 1500 m.

Zona e Grykës (Klisurës) karakterizohet me bashkësinë autohtone të reliktit terciar tisit (Taxus baccata) me ahun (Fagus mosaicae) Fageto - Taxetum baccata e cila shtrihet në lokalitetin Pulan (Kokoshinje). Tisi (dikur me lartësi deri 20 m) është lloji i vetëm halor në vendin tonë që zhvillohet, përveç me fara (gjenerative), edhe në mënyrë vegjetative.

Rëndësi të veçantë këtij rajoni i jep edhe prania e llojit endemorelikt ramonda e Natalisë (Ramonda nathaliae). Për identifikimin e plotë të vlerave floristike të kësaj zone duhet të vazhdohen hulumtimet.

Zona është e pasur me lloje të shumta të kafshëve të egra (mamalia) dhe shpendëve (ornitofauna), ndërsa më të rëndësishme janë: ariu i murrmë (Ursus arctos), kaprolli (Capreolus capreolus), dhelpra (Canis vulpes), derri i egër (Sus scrofa), macja e egër (Filis sylvestris), vjedulla (Meles meles), shqarthi i artë (Martes martes), fishnjari (Martes foina), lepuri (Lepus europeus), skifteri malor (Falco biarmicus), shqiponja minjngrënëse *(Buteo buteo),* huti pyjor etj.

Zona 1a (Koritniku) – Zona gjendet në pjesën veriperëndimore të territorit të komunës së Sharrit (Dragashit), në kufi me territorin e komunës së Prizrenit dhe me Republikën e Shqipërisë. Ajo ka një sipërfaqe prej 818 hektarësh. Në malet e larta me gur gëlqeror të Koritnikut ka habitate me një llojllojshmëri të madhe biologjike ku përfshihen sipërfaqja pyjore endemike me Pishën Boshnjake, një lloj vegjetacioni shumë i rrallë në Ballkan dhe tri lloje të vegjetacionit që janë të klasifikuar në Shtojcën 1 të Direktivës Europiane për Habitatet 92/43/EEC. (Së paku 44 bimë endemike ose shumë të rralla të Ballkanit janë të regjistruara në këtë moment.) Në këtë zonë gjenden edhe një habitat me një llojllojshmëri të madhe të fluturave (5 nën statusin e IUCN) dhe një habitat i dhive të egra, pastaj një pjesë e linjës(rrugës) së migrimit të arinjve dhe të rrëqebujve si dhe 15 specie të zogjve nga Shtojca 1 dhe Shtojca 2 të Direktivës Europiane për Habitatet.

Zona 1b – Kjo zonë pyjore me një sipërfaqe prej 123.16 hektarësh gjendet në veriperëndim të fshatit Restelicë dhe në jug të fshatit Krushevë Këtu është Bredhiku, një shpat i kthyer kah perëndimi me të vetmet "Pyje Helenike të ahut me Bredhin Bullgar",si lloje endemike të Ballkanit, në lartësi prej 1500m – 1580m dhe me një pyll me bredha (Abietum alba koritniensis) në lartësi prej 1100m – 1600m që e ndeshim vetëm në komunën e Sharrit (Dragashit). Të gjitha këto lloje të vegjetacionit janë të klasifikuar në Shtojcën 1 të Direktivës Europiane për Habitatet 92/43/EEC. Ky i fundit është shumë i rrallë dhe tipik për Malin Sharr. Pyjet janë habitate të rëndësishme të rrëqebullit dhe vend ku rriten arinjtë.

Zona 1c – Kjo zonë shtrihet në lindje dhe jug të fshatit Brod dhe përfshinë trevat e Zhuticës, Defit, Pesh/Mramorit, Shutmanit, Vracës, Rudokës dhe Cules. Zona ka një sipërfaqe prej 5057.39 hektarësh. Këtu kemi një kombinim të sistemeve të tokave nën ujë të ruajtura mirë duke përfshirë liqenet malore, rrjedhat e brendshme oligotrofike, moçalet, shkurret e ulta (Caricetum rostratae-vesicariae), kullotat e gjera, kaçubat apo/dhe vegjetacionin (bimësinë) barishtor dhe vegjetacionin madhështor të sipërfaqeve shkëmbore (të gjitha të klasifikuara në shtojcën 1 të Direktivës Evropiane për Habitatet 92/43/EEC). Momentalisht janë të regjistruara së paku 43 lloje bimore shumë të rralla ose endemike në Ballkan (një prej tyre është i klasifikuar në shtojcën 1 të Direktivës Evropiane për Habitatet 92/43/EEC). Këtu ka habitate të rëndësishme të insekteve ujore duke përfshirë mizën endemike të Gadishullit Ballkanik Limnephilus petri që është prezente vetëm në rrjedhën e epërme të lumit Brod dhe në Bullgari, pastaj llojllojshmëri të pasur të fluturave (22 nën status të IUCN ose të rralla). Kjo zonë është habitat i dhive të egra dhe pjesë e linjave apo rrugëve të migrimit të arinjve për dhe nga Maqedonia. Në të gjenden 23 specie të zogjve nga Shtojcat 1 dhe 2 të Direktivës Evropiane për Habitatet 92/43/EEC dhe formacione shkëmbore me habitate ku rritet Shqiponja e Artë.

Koncepti i zhvillimeve të ardhshme konsiston që:

- Ndikimi i njeriut në rezervatet e natyrës të jetë shumë i kufizuar. Zona që përbëhet nga rezervatet strikte të natyrës duhet të ruhet në mënyrë efektive me qëllim që të mbrohet nga çdo ndikim eventual i dëmshëm. Për këtë arsye duhet të insistohet në hartimin dhe zbatimin e "Rregullores për rendin e brendshëm të parkut"

- Kjo zonë duhet të ngelet natyrë e paprekur dhe shfrytëzohen vetëm për nevoja edukative - arsimore dhe hulumtuese - shkencore, nga vizitorë të ndryshëm që do të jenë nën mbikëqyrje të vazhdueshme.
- Në zonat buferike, deri në afërsi direkte të rezervateve, bëhet lidhja dhe ndërtohen nga materiali natyror shtigjet për ecje dhe ngritën punkte për grumbullim dhe vrojtim të vizitorëve.
- Shikuar nga aspekti ekonomik, vizitat e organizuara në rezervate dhe në zonat e propozuara për rezervate do të sjellin përfitime ekonomike.

3.2.2. Zona e dytë e mbrojtjes

Zona e menaxhimit aktiv, paraqet zonën me shtrirje më të madhe territoriale me 40311.9 ha (75.4%), e cila kryesisht është e dedikuar për shfrytëzim të kujdesshëm të hapësirës dhe vlerave ekzistuese. Kjo zonë është pak sa më e shlirë, në aspektin e mbrojtjes, nga ajo e para, ku faktori njeri mund të ketë ndikim mirëpo të kontrolluar. Prandaj, administrimi, menaxhimi dhe kontrolli i shfrytëzimit dhe zhvillimit duhet në parim t'i caktohet autoritetit të parkut – drejtorisë së parkut, përderisa të ardhurat duhet të përdoren për investime në mirëmbajtje dhe në dobi të vetë parkut. Sa i përket shfrytëzimit të resurseve, si të bimëve mjekuese etj, ky autoritet, duhet që së bashku të punojë dhe veprojë me institucionet gjegjëse qeveritare, shkencore dhe prodhuese (farmakologjike, tregtare dhe bujqësore) për mënyrën e shfrytëzimit dhe të rikultivimit tyre.

Konkretisht, sipas këtij koncepti kemi të bëjmë me zonën për të cilën aktivitetet e ndaluara dhe të lejuara duhet të rregullohen me planin menaxhues për parkun kombëtar. Me këto dokumente përcaktohen rregullat dhe masat për mbrojtje, zhvillim dhe shfrytëzim të pyjeve, kullosave, bimëve dhe kafshëve. Përveç tyre hyjnë edhe kullosat e shndërruara në livadhe e që së bashku përbëjnë pjesë të pejsazheve natyrore të Parkut. Poashtu me këtë menaxhim përcaktohet edhe mënyra e kontrollit si dhe masat për zhvillime të mëtejme ndaj kullotjes së bagëtive, kullotjes së bletëve dhe nxjerrjes së mjaltit, vjeljes së frutave të imta dhe bimëve mjekuese nëpër periudha të caktuara kohore gjatë vitit.

Koncepti i zhvillimit të ardhshëm hapësinor në këtë zonë synon:

- Mbrojtjen e mjedisit dhe të biodiversitetit në parkun kombëtar siq janë: mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale, mbrojtja e pyjeve nga insektet e dëmshëm dhe sëmundjet, mbrojtja e bimëve endemike, mbrojtja e kafshëve të rrezikuara nga zhdukja, ripyllëzimi, monitorimi efikas për shfrytëzimin e resurseve dhe elementeve natyrore (pyjeve, lumenjve, kullosave e livadheve, ajrit, ujit dhe tokës).
- Zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të parkut. Këto objektiva janë: shfrytëzimi i planifikuar dhe i kontrolluar i lëndës drusore për industrinë e përpunimit të drurit dhe regjim të caktuar i grumbullimit të fryteve të imta malore. Planifikim dhe menaxhim efikas në shfrytëzim me regjim të caktuar të bimëve mjekuese për industrinë farmaceutike;
- Kullotjen e kontrolluar të bagëtisë, shfrytëzimi i kontrolluar i llojeve bimore e gjithashtu edhe rritjen (mbajtjen) e kontrolluar të llojeve të veçanta të kafshëve. Rritja e bimëve mjekësore dhe luleve është e rëndësishme edhe për bletarinë, prodhimin e mjaltit dhe produkteve tjera bletare.
- Aktivitetet që lejohen janë të limituara dhe kryesisht ndërlidhen me rekreacionin, sportin dhe me punët për rregullimin e shtigjeve të skijimit, shtigjeve për shetitje me punkte për çlodhjen e vizitorëve. Poashtu propaganda efektive turistike për veçoritë dhe kapacitetet turistike të parkut
- Punët në avancimin e sistemeve për transportin e turistëve nga vendet më të ulëta në ato më të larta. Kjo do të thotë se në këtë zonë mund të rregullohen shtigjet e skijimit, të instalohen ski liftat, teleferikët dhe të ndërtohen rrugët që shpiejnë deri tek sistemi i ski liftave dhe teleferikëve.
- Moslejimi i ndërtimit të objekteve të banimit dhe të ngjashme me përjashtim të sistemeve për transportin e turistëve nga lartësitë më të ulta në ato më të larta.

3.2.3. Zona e tretë e mbrojtjes

Zona e shfrytëzimit të qëndrueshëm, është zonë e cila në aspektin territorial me 3769.81 ha (7.1%) paraqet zonën me sipërfaqe më të vogël, ku aktivitetet janë më të lirshme por

gjithnjë të bazuar në shfrytëzim të qëndrueshëm. Kjo zonë i përfshinë të gjitha sipërfaqet barishtore dhe gurore të cilat nuk kanë resurse natyrore dhe vlera të veçanta të biodiverzitetit. Në këtë zonë, përveç aktiviteteve që lejohen në zonën e dytë, lejohet edhe shfrytëzimi i kontrolluar i tokës bujqësore dhe aktiviteteve të ngjashme dhe me një plan - program specifik për çështje sanitare lejohet edhe gjuetia e kontrolluar e llojeve të caktuara të kafshëve dëm-shkaktuese.

Hapësira e parkut me karakteristikat dhe me kusht të mbrojtjes së resurseve, baraspeshës së zhvillimeve dhe ruajtjes së vlerave mjedisore mundëson dhe është potencial për zhvillim të: turizmit malor; sportiv**;** dimëror/veror; shëndetësor; eko turizmi; turizmi rural dhe kulturor; hulumtues dhe shkencor; turizmi kongresjen; alpinizmi; turizmi çiklistik etj. Në zonën për shfrytëzim të qëndrueshëm do të hyjnë edhe nënzonat me karakteristika specifike si vendbanimet turistike me kampingje dhe vendpikniqe, zona të rekreimit, të skijimit, etj. Janë identifikuar disa hapësira që i plotësojnë kriteret e një zone të tillë si:

- Guri i Dellocit dhe Gradaci në territorin e KK Suharekë (në veri të parkut);
- Prevalla dhe Shtëpia e Malorëve (pjesa lindore e parkut), Shtëpia e Malorëve mbi Skorobisht (në veri të parkut) dhe Guri i Zi mbi Struzhë (pjesa qendrore e parkut) në territorin e KK Prizren;
- Nënahishte (në lindje të parkut) në territorin e KK Kaçanik
- Zona afër Zaplluxhës, në juglindje të saj (pjesa qendrore e parkut) në territorin e komunës së Sharrit.
- Zona afër Restelicës, në jug-perëndim të saj (në jug të parkut) në territorin e komunës së Sharrit.
- Hapësira për realizimin e "Projektit për Zhvillimin e Qendrës Turistike Brezovica"

Këtu, në parim, tentohet që parku të vizitohet prej sa më shumë vizitorëve dhe në mënyrë të organizuar. Të gjitha aktivitetet ekonomike duhet të administrohen dhe menaxhohen me shumë kujdes nga autoriteti i parkut, në mënyrë të planifikuar dhe të ndarë në përgjegjësi dhe etapa të cilat specifikohen me planin menaxhues për parkun.

Koncepti kryesor i zhvillimit dhe shfrytëzimit të parkut kombëtar për këtë zonë nënkupton ato zhvillimet të cilat mundësojnë zhvillimin e turizmit si veprimtari më e preferuar ekonomike. Sa i përket vendosjes së tij, në rrugë të mbarë, në të njëjtën kohë është sfidë e madhe por edhe paraqet mundësi dhe potencial të theksuar për zhvillim të qëndrueshëm.

Banimi apo zhvillimet në kuptimin e ndërtimeve janë sfida më e madhe gjatë hartimit të Planit Hapësinor për PK "Sharri". Me banim nënkuptojmë - zonat e shtëpive të vikendit, sanatoriumeve, hoteleve dhe objekteve përcjellëse brenda parkut. Në park janë parashikuar katër zona të banimit, zona afër Gurit Dellocit, në Prevallë, në Brezovicë dhe nën Luboten zona e quajtur Nënahishte (Shih hartën e zonimit).

Duke pasur plotësisht parasysh procesin e veqantë të cilit i nënshtrohet "Projekti për Zhvillimin e Qendrës Turistike Brezovica", koncepti për këtë zonë, brenda parkut, lejon ndërtim të objekteve të cilat janë të mirëseardhura në krijim të pejsazhit të ri dhe në funksion të zhvillim të qëndrueshëm. Gjithmonë në funksion të mbrojtjes së vlerave natyrore të parkut, pas përshpejtimit të procesit të privatizimit të kapaciteteve hoteliere ekzistuese, së pari bëhet përzgjedhja e vend-lokacionit për zhvillim, për të cilën ipen kushtet e ndërtimit me parametrat për:

- Planifikim detal urbanistik - arkitektonik dhe menaxhim efikas i zhvillimit në zonat banimore – hoteliere - turistike (si hotele, apartamente, vikend shtëpi, kamp shtëpiza etj);
- Objekte dhe hapësira të nevojshme rekreative, sportive, shërbyese, tregtare, komerciale dhe infrastrukturë sociale si dhe ofrim i kushteve për investime të reja në kapacitetet rekreative përmes partneritetit publik - privat;
- Objekte, hapësira dhe pika hyrëse - kontrolluese, dhe në shërbim të vizitorëve (marketingut dhe informimit si edhe për ndalim-freskimin dhe pushimin e vizitorëve) dhe nga grumbullimi efikas i taksave në funksion të parkut;
- Objekteve përcjellëse, linjave dhe pikave të infrastrukturës teknike si rrugët, shtigjet, trafostacionet, antenat difuzive, bazat e teleferiqeve, ujësjellësit dhe kanalizimit e të ngjashme.

3.2.4. Zona e ndikimit reciprok (vendbanimet përreth parkut)

Zona e ndikimit reciprok është zona në mes të vet parkut kombëtar dhe vendbanimeve përreth tij e cila për nga funksioni paraqet zonën më të afërt dhe më me ndikim të ndërsjellë. Për nga aspekti i shtrirjes, kjo zonë konsiderohet edhe zonë e parë mbrojtëse ose buferike për të gjithë parkun dhe mund të ketë ndikim shumë pozitiv në park. Parashihet që për atë pjesë të vendbanimeve, ku ndikimi është shumë më i lartë si në Mushetisht, Delloc, Skorobisht, Gornjasella, Sevce, Struzha, Zaplluxhë, Pllajnik, Radeshë, Leshtan, Brod, Restelicë, Rapçë, Buçe dhe Brezne të hartohet plan i zhvillimit të turizmit rural me dobi për të dyja palët.

Përpjekjet do të orientohen në rritjen e kapaciteteve për buajtje, në zhvillimin e artizanateve, punën e përditshme në fermë dhe në prodhimet ekologjike blegtorale, jeta në fshat dhe natyrë, në ruajtjen e kuzhinës së veçantë tradicionale, në mirëmbajtjen dhe zhvillimin e arkitekturës autoktone dhe në aktivitete tjera të ngjashme.

Në njërën anë, do të krijohen kushte që vizitorët e parkut kombëtar para se të hyjnë në të, të përjetojnë mjediset dhe vlerat tradicionale, me shumë interes ekonomik dhe shumë të kërkuara, sidomos nga turistë jo-vendor dhe sipas trendit të ri botëror. Kurse, në anën tjetër, mundëson organizimin e ekonomive lokale, në bashkërenditje me ato familjare dhe të amvisnive, për përfitime shtesë nga shërbimet e ofruara turistike. Kjo varet dhe mundësohet nga bashkëpunimi i popullatës vendore me autoritetet turistike si dhe atë të parkut por edhe nga niveli i ofertimit dhe shërbimit të ofruar.

Me konceptin, mbështetje vendbanimeve përreth parkut, mendohet në përparimin e mundësive të tyre në ofrimin e shërbimeve për vizitorët e parkut. Këtu parashihet, që VB në afërsi direkte me parkun, por edhe si zona rurale, të jenë në funksion të parkut dhe me potencialet e tyre të ndikojnë në zhvillim të turizmit rural dhe ekoturizmit. Për të zhvilluar këtë koncept, nevojitet një bashkëpunim ndërinstitucional nga të gjithë sektorët të të dyja niveleve ashtu edhe angazhim dhe bashkëveprim i popullatës me partneritetin publik-privat për realizimin e kësaj përkrahjeje në:

- Zhvillimi i planifikuar dhe kontrolli i zhvillimeve për zona banimore, të përcaktuara me plan hapësinor,
- Përcaktimi dhe definimi i qartë i kufijve për zonat e banimit (Shih hartën, zonat e kaltra);
- Ngritja e kualitetit të jetës në zona banimore (infrastrukrë, shërbime publike, shëndetësore, edukativo-arsimore);
- Mbështetja e vendbanimeve përreth parkut dhe popullatës vendase në ruajtjen e peizazhit specifik rural të vendbanimit/fshatit, kulturës së banimit dhe punës për ofrimin e kushteve për turizëm fshatar dhe eko-turizëm (Shih hartën, fshatrat përreth);

- Mbështetja e vendbanimeve përreth parkut dhe popullatës vendase në ofrimin e prodhimeve tradicionale vendore (blegtorale dhe bujqësore etj);
- Mbështetja për ofrimin e ofertës turistike për turizëm fshatar dhe ekoturizëm, në mënyrë të organizuar nga ana e agjencive të specializuara;
- Krijimi i rrjetit funksional të mobilitetit (linjave lokale dhe ndërurbane mes parkut dhe qendrave përreth).



3.3. Infrastruktura teknike në park


"Parku i Llojllojshmërisë", siç e kemi quajtur Parkun Kombëtar "Sharri" duhet të jetë i rregulluar ashtu që të mund të pranojë numër të caktuar të vizitorëve. Me qëllim të funksionimit sa më të mirë, me strukturën përmbajtësore si dhe infrastrukturë e shërbime të nevojshme, duhet të jetë i përgatitur dhe i hapur për të gjitha kategoritë e vizitorëve. Duhet gjithashtu të jetë i rregulluar në atë mënyrë që t'u mundësojë vizitorëve përjetimet e pejsazheve dhe bukurive tjera natyrore, deri në atë masë që mos të shqetësohet, rrezikohet apo shkatërrohet mjedisi.

Ky koncept parasheh, që në aspektin e infrastrukturës dhe shërbimeve teknike, të siguroj qasje sa më të mirë të nivelit ndërshtetërore, ndërkomunale si dhe ndërmjet vendbanimeve tjera jashtë dhe brenda parkut. Çfarëdo lloj shtrirje e infrastrukturës dhe shërbimeve teknike, qofshin ato të shprehura si pika, koridore apo hapësira territoriale, nuk guxon të ndodhë në zonën e parë dhe të dytë mbrojtëse brenda territorit të parkut. Në rastin kur kjo ndodh, atëherë duhet konsideruar që, gjithsesi ka të bëjë me zonë të tretë mbrojtëse brenda kufirit ose të katërt apo jashtë kufirit të Parkut.

3.3.1. Infrastruktura rrugore dhe transporti

Në mënyrë që të kemi një qasje sa më të lehtë mobiliteti, në hapësirën e parkut kombëtar duhet të investohet në ngritjen e nivelit të infrastrukturës rrugore. Për shkak të shfrytëzimit të potencialeve dhe mundësive reale, për përfitime të dyanshme (të ndërsjellta), në mes të parkut dhe vendbanimeve (pjesëmarrëse të drejtpërdrejta në park) rreth tij, duhet të ekzistojnë lidhje të mira rrugore.

Bazuar në këtë koncept dhe me qëllim të zhvillimit turistik dhe të zonave rurale, duhet të sigurohet qasja solide dhe jo e tepruar, përmes zhvillimit të rrjetit të rrugëve dhe shërbimeve të mira automobilistike. Fillimisht, përkujdesi bie, në rregullimin dhe ndërtimin e rrugëve automobilistike sipas kategorive dhe në bazë të ndërhyrjes në park. Së pari duhet bërë zgjerimet, rregullimet, asfaltimet dhe mirëmbajtjen e atyre ekzistuese. Përderisa, lidhjet apo ndërtimet e rrugëve të reja, të parapara janë: ajo ndër-rajonale (apo ndërshtetërore) Prizren - Tetovë; ndër-komunale Shtërpcë - Suharekë (Therandë) si dhe ato rurale (ndërmjet vendbanimeve përreth parkut si dhe ato deri në qendrat turistike në funkcion të pushimit, rekreimit dhe rehabilitimit shëndetsor jashtë dhe në mbrendinë e tij).



Nga të dhënat e marra prej komunës së Shtërpces, përveç përmirësimit të lidhjeve rrugore të të gjitha vendbanimeve të kësaj komune, parashihet edhe ndërtimi i një linje hekurudhore - turistike. Kjo hekurudhë e elektrifikuar do të kalonte nëpër vendbanimet përreth parkut duke filluar në fshatin Brod e deri në fshatin Sevce, me disa degë të saj që do të dërgonin vizitorët deri tek lokalitetet apo qendrat ku gjenden teleferikët dhe ski-ashensorët. Në këtë rast kostoja e transportit të udhëtarëve do të ishte më e ultë, në krahasim me transportin automobil-listik, por

edhe më i pastër ekologjikisht. Mirëpo, për realizimin e këtij projekti, për prodhimin e energjisë së lirë elektrike nga disa hidrocentrale të vogla, nevoitet që së pari të bëhet studimi i arësyeshmërisë (fizibilitetit).

Shtigjet për këmbësorë, që shpiejnë deri tek vendet në park që janë me interes të vizitohen (qoftë për kënaqësinë e shijimit të pejsazhit, rekreimit apo për nevoja edukative-arsimore dhe hulumtuese-shkencore), duhet të rregullohen nga materialet natyrore dhe kjartë të shenjëzohen e të përmbajnë informacionin e duhur.

Linjat e rregullta të transportit publik duhet të vendosen si në rrugët rajonale ashtu edhe në ato lokale. Nga këto linja duhet të mbulohen vendbanimet përreth parkut që janë më afër rrugëve regjionale e poashtu edhe lokalitetet ku do të ketë ndërtime në funksion turizmit. Me përjashtim të qendrave me vikend shtëpi private, në asnjë lokalitet tjetër të parkut, me qëllim të ruajtjes së natyrës nga parkingjet e tepërta, nuk duhet të shkohet me vetura private por vetëm me autobusë. Natyrisht kjo nuk vlen për veturat që kalojnë tranzit nëpër park.

Në afërsi të lokaliteteve (qendrave) rekreative–sportive, aty ku vlerat natyrore janë më të vogla, parashihen të ndërtohen shtigje për skijim. Këtu shtrohet nevojë, e instalimit të mekanizmave dhe mjeteve (teleferiqeve dhe skiashensorëve), për transportin e vizitorëve, nga këto qendra turistike deri tek pikat apo majat nga ku ata lëshohen. Përpos ngritjeve të qendrave të reja, edhe në ski qendrën ekzistuese Molika afër Brezovicës, duhet akoma të ngritën kapacitete të mëtejshme të infrastrukturës për transportin e skiatorëve.

3.3.2. Infrastruktura e energjetikës

Objektet hoteljere, banimore, infrastrukturore etj. ekzistuese dhe që do të ndërtohen në hapësirën e parkut nacional dhe përreth parkut shtrojnë nevojën e sigurimit të energjisë së nevojshme elektrike për furnizimin e tyre. Kjo mund të realizohet me ngritjen e mëtejshme të kapaciteteve dhe të infrastrukturës së energjetikës që nënkupton përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, trafostacioneve, por ndoshta edhe prodhimit të energjisë elektrike duke shfrytëzuar lumenjët si Lumbardhi i Prizrenit dhe Lepencin.

Paraprakisht është e nevojshme të bëhet një studim që të konstatohet se cila është levërdia dhe ku janë lokacionet më të përshtatshme për ndërtimin e këtyre mini hidrocentraleve. Këtu duhet të kihet kujdes maksimal që e tërë veprimtaria njerëzore që kryhet në parkun kombëtar me qëllim të sigurimit të energjisë elektrike, mos të ketë ndikim negativ në florën dhe faunën e parkut. Zgjedhja e lokacioneve duhet të jetë e tillë që mos të ketë prerje të pyllit dhe cenim të habitateve të parkut kombëtar.

3.3.3. Infrastruktura ujore

Është e kuptueshme se nuk mund të ketë ofertë të mirë turistike nga zonat e caktuara të parkut dhe nga vendbanimet përreth tij nëse infrastruktura ujore nuk është zhvilluar në përputhje me nevojat. Prandaj është e nevojshme që të gjitha objektet banimore, hoteljere e shërbyese në park dhe në vendbanimet përreth parkut, duhet të jenë të lidhur në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit të ujërave të zeza. Lokalitetet që ndodhen brenda parkut nacional, por edhe vendbanimet në afërsi direkte të parkut, sot furnizohen me ujë nga burimet e ujit nëntokësor që janë në territorin e parkut. Është e nevojshme të hulumtohen burime të reja të ujërave nëntokësor në mënyrë që furnizimi me ujë të përmirësohet, mirëpo duhet të shikohet edhe mundësia e krijimit të ndonjë liqeni artificial në lokacionin që i plotëson kushtet.

Me përjashtim të vendbanimeve të shpërndara, të gjitha vendbanimet kompakte përreth parkut kombëtar duhet të lidhen në rrjetin e kanalizimit të ujrave të zeza.

Meqenëse për parkun kombëtar kërkohet mbrojtje sa më e madhe e mundshme nga ndotja siq mund të jetë edhe ndotja e ujërave të parkut dhe të vendbanimeve përreth tij me ujera të zeza, është e nevojshme që këto ujra të trajtohen në mënyrë të duhur që kjo ndotje të mos ndodhë.

3.3.4. Telekomunikacioni

Rritja e ofertës turistike të parkut kombëtar dhe e vendbanimeve në afërsi direkte të tij, përveç tjerash kushtëzohet edhe me zhvillimin e telekomunikacionit në këto hapësira. Kjo do të thotë se në të ardhmen e afërt duhet të investohet që në këto hapësira të avancohet telefonia mobile, të ngritët niveli i zhvillimit të telefonisë fikse, të sigurohet Interneti dhe të zhvillohen shërbimet postare.

3.4. Njohja ndërkombëtare

Njohja e Parkut Kombëtar "Sharri" nga mekanizma ndërkombëtarë për mbrojtjen e natyrës dhe për turizmin është parakusht dhe/ose i paraprinë dhe mundëson një propagandë efikase për parkun. Për më shumë, kjo njohje nga këto institucione dhe hyrja në listën e parqeve botërore, vetvetiu informon çdo kënd në botë për resurset dhe veçoritë natyrore dhe gjeo-fizike të parkut.

Kjo sa i përket zhvillimit ekonomik, është një hap përpara në propagandimin ndërkombëtar për vlerat e parkut, përderisa ratifikimi i konventave mjedisore mundëson dhe garanton mbrojtjen në vazhdimësi të vlerave specifike të parkut. Për këtë shkak duhet angazhuar të gjithë rol-luajtësit që puna e tyre të orientohet dhe sa më shpejt të arrihet:

- Njohja ndërkombëtare e parkut nga institucionet ndërkombëtare; IUCN, WTO.
- Ratifikimi i konventave ndërkombëtare (RIO, Kyoto, ESPOO, Llugano etj) dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga konventat;
- Propagandimi i vlerave natyrore, peisazhore e turistike të parkut;
- Formimi i organeve ndërshtetërore që koordinojnë bashkëpunimin;
- Konkurrimi për fondet evropiane me projekte të përbashkëta të Kosovës dhe Maqedonisë për zonën ndërkufitare të malit Sharr.





IV STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

4. STRATEGJIA DHE VEPRIMET PËR ZBATIM

Ndikimi hapësinor i realizimit dhe mosrealizimit të strategjisë

Plani hapësinor i Parkut Kombëtar „Sharri" përmban strategjinë me të cilën duhet të arrihen synimet dhe objektivat për parkun të përcaktuar gjatë një procesi planifikues në të cilin kanë qenë të përfshirë të gjithë përfaqësuesit relevant duke filluar nga sektorët e ndryshëm të Qeverisë së Kosovës e deri tek qytetari i rëndomtë.

Pse është përpiluar plani hapësinor, rrjedhimisht pse janë përcaktuar synimet dhe objektivat për parkun? Përgjigjja e shkurtër por gjithëpërfshirëse në këtë pyetje do të ishte se kjo është bërë me qëllim që parku të mbrohet dhe të zhvillohet në pajtim me nevojat për mbrojtje dhe zhvillim.

Nëse strategjia me të cilën mendohet se do të arrihen synimet dhe objektivat, të cilët konsistojnë në mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut në pajtim me nevojat nuk do të realizohej, është e kuptueshme që mbrojtja dhe zhvillimi i parkut nuk do të mund të arrihej.

Çka nëse nuk bëjmë asgjë!

Më konkretisht çka do të ndodhte shikuar nga aspekti i mbrojtjes së parkut? - Nëse do të vazhdonte të realizohej skenari i trendit apo të themi se do të realizohej një „strategji" alternative, - ta quajmë "strategji e mosbërjes asgjë"- ku zhvillimet që ndodhin në hapësirën e parkut nuk janë të bazuara në plan, biodiversiteti dhe vlerat natyrore të parkut do të dëmtoheshin. Pjesa e strategjisë që i dedikohet mbrojtjes së parkut parasheh aktivitete me të cilat pamundësohet hyrja e pakontrolluar në rezervatet e natyrës që i ka parku, pamundësohet prerja ilegale e pyjeve dhe çfarëdo forme e cenimit të specieve stenoendemike dhe endemike të florës, specieve endemike të faunës, pastaj pamundësohen ndërtimet dhe intervenimet tjera të pakontrolluara në zona të caktuara të parkut, merren masa të veçanta kundër sëmundjeve të bimëve dhe kafshëve, kundër insekteve dëmtues dhe masa kundër erozionit.

Shikuar nga aspekti i zhvillimit të parkut - pjesa e strategjisë që i dedikohet zhvillimit, parasheh aktivitete që janë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të parkut. Kjo nënkupton një zhvillim ekonomik që është në funksion të mbrojtjes, ruajtjes së parkut dhe të rritjes së mirëqenies së banorëve që janë në mënyrë direkte apo indirekte të lidhur me parkun. Kjo pjesë e strategjisë parasheh kryesisht aktivitete për zhvillimin e turizmit dhe të infrastrukturës së nevojshme teknike për funksionimin e normal të parkut. Zhvillimi i turizmit, në masën më të madhe, nënkupton shfrytëzimin e parkut nga popullata. Njerëzit atje shijojnë bukuritë e parqeve, pushojnë, rekreohen, argëtohen dhe rehabilitohen. Plani hapësinor e planifikon zhvillimin e turizmit në Parkun Kombëtar "Sharri" në mënyrë që të arrihet një zhvillim turistik, i cili do të gjeneronte mjete financiare që do të shfrytëzoheshin për mbrojtjen dhe ruajtjen e vlerave dhe e fundit, të mos lejohet një zhvillim stihik i tij - zhvillim i kapaciteteve turistike në zonat ku një gjë të tillë e ndalon plani. Nëse nuk do të ndërmarrim asgje do të vazhdoj ngarkimi i parkut me kapacitete të paqëlluara, të cilat të gjitha së bashku për emërues kanë dëmtimin e parkut.

Infrasturktura teknike duhet të jetë në mbështetje të plotë të zhvillimeve të përgjithshme që ndodhin në park. Koordinimi në mes të këtij sektori me sektorët tjerë është i domosdoshëm. Në mosrealizimin e këtij koordinimi do të ndodhë që kapacitetet turistike nuk do ta kenë mbështetjen e duhur të infrastrukturës dhe si pasojë do të vështirësohej funkcionimi i tyre. Kjo do të sillte rënien e interesit të tyre karshi turistëve që për rrjedhojë do të zvogëlohet numri i turistëve e më këtë edhe të hyrat financiare që janë të domosdoshme për funksionimin normal të parkut.

Strategjia e propozuar është përgjigje e të gjitha problemeve të cekura më lartë. Padyshim se vazhdimi me këto zhvillime negative do të rrezikonte ekzistencen e një pasurie të rrallë mjedisore dhe ajo që është më e rëndësishmja dhe që ndikon më së shumti - imazhi ynë në botë sa i përket mjedisit dhe trajtimit të tij. Ky imazh githësesi se do të ndikojë në mënyrë direkte në humbjen e donatorëve potencial si dhe përfshirjen e Kosovës në projekte rajonale që për temë kanë trajtimin e qështjeve mjedisore.

4.1. Strategjia e zhvillimit dhe menaxhimit mjedisor

Hartimi i pjesës së strategjisë dhe veprimeve për zbatim për PK "Sharrl", do të thotë dhënje e përgjegjes në pyetjen si të arrihen objektivat?

Strategjitë janë pako të përbëra nga politikat, masat, aktivitetet, projektet konkrete me anën e të cilave tentohet të arrihen synimet dhe objektivat e parapërcaktuara.

Për shkak të shfrytëzimit të tij të shumëllojshëm, Parkun Kombëtar "Sharri" e kemi quajtur "Parku i llojllojshmërisë". Veprimtaritë e planifikuara në park duhet të kenë dimensionin e shtrirjes së tyre hapësinore. Në mënyrë që parku të ruhet, mbrohet dhe shfrytëzohet mirë, kusht i domosdoshëm është menaxhimi efikas, domosdoshmëria e hartimit të menjëhershëm të planit menaxhues për autoritetin e drejtorisë së Parkut Kombëtar "Sharri".

Për arritjen e Synimit 1 nga Vizioni, trajtojmë veç e veç aktivitetet dhe masat që duhet ndërmarrë për secilin objektiv si më poshtë:

Synimi 1. Administrim i plotë dhe menaxhim efikas i Parkut Kombëtar "Sharri"

Objektivat:

1. Funkcionimi i një trupi të vetëm ligjor dhe përgjegjës për menaxhimin e parkut
2. Hartimi i planit menaxhues për territorin e parkut
3. Administrimi efikas dhe shtrirja e autoritetit të parkut

Përmes këtij synimi tentohet të arrihet një administrim i plotë dhe menaxhim efikas i Parku Kombëtar "Sharri". Kjo nënkupton organizimin e mirëfillt institucional dhe ligjor të autoritetit të parkut si dhe menaxhimin efikas me të gjitha resurset duke përfshi mbrojtjen, ruatjen dhe shfrytëzimin racional.

S1.O1. Funkcionimi i një trupi të vetëm ligjor dhe përgjegjës për menaxhimin e parkut

Përmes këtij objektivi tentohet të arrihet definimi i qartë i kompetencave në menagjimin e parkut kombëtar. Të gjitha përgjegjësitë duhet ti ketë një trup i vetem (Drejtori e Parkut) për menagjim me tërë territorin e parkut dhe me të gjitha resurset që disponon ky park kombëtar. Për ta realizuar këtë objektiv kërkohen këto aktivitete dhe angazhime:

- **Shtrirja e autoritetit të Drejtorisë në të gjithë territorin e Parkut duke përfshirë edhe territorin e Komunës së Shtërpcës**

Vazhdimisht të bëhen konsultime me strukturat në Shtërpc me qëllim të inkuadrimit të tyre në kuadër të një drejtorie të vetme që do të funksionojë si autoritet i parkut kombëtar. Pas arritjes së një marrëveshjeje kërkohet funksionimi i zyrës (njësisë së PK) në Shtërp, poashtu edhe në komunat tjera pjesëmarrëse.

- **Nënshkrimi i një memorandumi bashkëpunimi**

Ky bashkëpunim në mes MMPH-së, DP, APK-së, SHPK-së, Gjykatave, Shoqatave ekologjike dhe asaj të gjuetareve bëhet me qëllim të përkrahjes së drejtorisë së parkut në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive që ka në mbrojtjen dhe menaxhimin e parkut.

- **Hartimi i planit të punës dhe zbatimi i tij deri në hartimin e planit menagjues**

Drejtoria e parkut kombëtar kërkohet që ta hartojë një plan të punës për vitin 2013 dhe sipas nevojës edhe për vitin 2014 në përputhje me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri" me qëllim të krijimit të një baze të qëndrueshme në lidhje me menaxhimin dhe mbrojtjen e parkut kombëtar. Ai plan duhet të zbatohet sipas çdo viti deri në hartimin e planit menaxhues, kur autoriteti i parkut do të ketë dokumentin e duhur afat gjatë për të vazhduar punën në mbrojtje dhe menaxhim të parkut.

S1.O2. Hartimi i planit menaxhues për territorin e Parkut Kombëtar "Sharri"

- **Hulumtime mbi të gjitha karakteristikat biologjike, kulturore e socio-ekonomike si dhe të faktoreve abiotik**

Përcaktimi detaj i veçorive dhe llojllojshmërisë së florës dhe të faunës, karakteristikave kulturore dhe socio-ekonomike të parkut, faktorëve fiziko gjeografik dhe elementeve tjera me rëndësi;

- **Konsultimet publike**

Mbajtja e konsultimeve publike me të gjitha grupet e interesit si dhe përfshirja e tyre në procesin e hartimit të planit menaxhues. Ndërmarrja e një fushate të gjerë dhe gjithëpërfshirëse në sensibilizimin e opinionit mbi rëndësinë e planit menaxhues si dhe mbrojtjen dhe menaxhimin efikas të resurseve të parkut kombëtar. Përgatitja e strategjisë për komunikim dhe bashkëpunim me të gjitha grupet e interesit si dhe involvimi i aksionareve.

- **Pregatitja e standarteve, regjimit të monitorimit, konditat dhe rekomandimet si dhe aktivitetet konkrete**

Duhet të përgatiten të gjitha standardet që duhet të respektohen mbi zonat e mbrojtura (parqet nacionale), të hartohet një strategji e qartë dhe konkrete mbi regjimin e monitorimit mbi mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të resurseve të parkut, të përshkruhen rekomandimet detaje si dhe aktivitetet konkrete për periudha afat shkurta dhe afatgjata.

- **Trajnimet dhe veprimet për zbatimin e planit**

Gjatë hartimit të planit vazhdimisht duhet mbajtur trajnime për stafin e drejtorisë së parkut dhe kyçen e tyre në projekt me qëllim të aftësimit të tyre që në të ardhmen ata të jenë në gjendje të bëjnë edhe revidime eventuale sipas nevojës. Gjithashtu të jenë të gatshëm për zbatimin e mirëfilltë të këtij plani, ku është e nevojshme që të përgatiten të gjitha veprimet për zbatim.

S1.O3. Administrimi efikas dhe shtrirja e autoritetit të parkut

- **Objektet e autoritetit të parkut**

Organi institucional që do të merret me mbrojtjen dhe menaxhimin e parkut kombëtar do ta ketë objektin qendror në Prizren, në pjesën periferike të qytetit të Prizrenit në rrugën Prizren – Reçan drejt hyrjes në park te gryka e Lumbardhit të Prizrenit. Aty do të jetë administrata qendrore e autoritetit të parkut dhe strukturat udhëheqëse. Poashtu do të formohen edhe 4 njësi tjera në komunat ku shtrihet territori i parkut kombëtar me qëllim të kontrollit të plotë mbi tërë territorin e parkut. Këto njësi do të themelohen në komunën e Suharekës, Shtërrpcë, Kaçanikut dhe Dragashit. Secila njësi do ta ketë udhëheqësin e vetë dhe zyrtarë tjerë sipas nevojës.

- **Kontrollat, mbikqyrja dhe taksat**

Autoriteti i parkut do ti ketë zyrtaret e vetë në të gjitha pikat kontrolluese në hyrje – daljet e parkut kombëtar. Gjithashtu do të bëjë kontrolla të vazhdueshme dhe mbikëqyrje të rregullt në të gjitha aspektet e shfrytëzimit të resurseve të parkut duke tentuar të vej nën kontroll ç'do shfrytëzim ilegal dhe të kundërligjshëm. Në anën tjetër është e nevojshme që të hartohet një çmimore e detajizuar mbi të gjitha aspektet e shfrytëzimit të lejuar në park si dhe për gjobat që duhet paguar në rastet e shfrytëzimeve ilegale dhe degradimeve eventuale nga individ të caktuar.

- **Hartimi i një organogrami të ri**

Me shtrirjen e autoritetit të parkut në tërë territorin si dhe me statusin e ri (të veçantë) duhet hartuar një organogram të ri për autoritetin e parkut dhe aprovimin e tij nga Ministria. Ky organogram duhet të jetë i përshtatshëm në kushtet e reja të funksionimit të parkut ku do të ketë një përbërje të plotë në numër të punëtoreve dhe kualifikimet profesionale adekuate.

- **Paisjet e nevojshme për punë**

Duhet paisur të gjitha objektet (objektin qendror dhe njësit administrative) inventarin e nevojshëm zyrtar, uniforma zyrtare, armë për vetëmbrojtje gjatë aktiviteteve në terren, stimulime për punë jashtë orarit të punës, si dhe pagesë të veçantë për rrezikshmëri në orar të punës në terren.

Shtjellimi i strategjisë së zhvillimit hapësinor është tematik (mjedisi, zhvillimi ekonomik e social dhe infrastruktura), elaborim i mënyrës së arritjes së synimeve dhe të objektivave ndarazi. Duke u nisur nga koncepti për rregullimin dhe zhvillimin hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri" e bazuar fillimisht në mbrojtjen e vlerave natyrore, peisazhore dhe gjeografike për të vazhduar me shfrytëzimin e saj si resurs rekreimi, turistik, hulumtues e shkencor të përcjellur me infrastrukturë fizike adekuate për të mundësuar arritjen e të dyja synimeve madhore, mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut.

Synimet kryesore që mundësojnë krijimin e barazpeshës në mes të mbrojtjes së përhershme adekuate mjedisore dhe mënyrës së shfrytëzimit të resurseve natyrorë. Me këtë, njëherit përcaktohen mundësitë e shfrytëzimit dhe organizimit si dhe kahjet e zhvillimit në park.

Mbrojtja e PK "Sharri" konsiston në mbrojtjen e të gjitha elementeve mjedisore (tokës, ajrit dhe ujit) por edhe ato peisazhore, kategorive, me përmbajtje gjeologjike, gjeomorfologjike, speleologjike dhe hidrologjike, të biodiversitetit.

Komponentë e rëndësishme është vetëdijësimi gjithpërfshirës kampanjat e vetëdijësimit që nga institucionet shkollore e deri tek ato vendimmarrëse duke mos anashkaluar edhe popullatën e gjithpërfshirë (si të atyre të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe pjesëmarrësve të kohëpaskohshëm indirektë). Informimi në vend dhe me kohë për zonat e mbrojtura të parkut, për resurset natyrore dhe gjeomorfologjike që gjinden në të, ashtu edhe për aktivitetet e ndaluara dhe të lejuara në favor të mbrojtjes, ruajtjes dhe shfrytëzimit tyre është me rëndësi të posaçme.

Aktualisht bëhet shenjëzimi në shërbim të informimit për funksion të kufizimit të zonave strikte, informimit dhe kontrollit rigoroz mbrenda këtyre zonave. Më tej, në rast të keqtrajtimit dhe shqetësimit të florës dhe faunës, përcaktohen edhe masat ndëshkuese për ata që mbledhin, gjuajnë apo tregëtojnë me këto resusrse të rralla. Këtu, përveç ndalimit të gjuetisë, për qarkullim të lirshëm të kafshëve, vendosen masat mbrojtëse përgjatë rrugëve, për të evituar rrezikun që paraqitet për jetët e tyre. Në këto raste, në vende të caktuara parashihen ndërtimi i urave dhe tuneleve/nënkalimet dhe mbikalimet, gjersa vendosen gardhe ose rrjeta mbrojtëse përgjatë koridoreve rrugore, hekurudhore, elektrike me largëpërques, për ashensorë me binarë, për teleferiqe me tërheqje, rreth antenave difuzive etj.

Në përgjithësi, në aspekt të mbrojtjes së mjedisit të shëndoshë dhe resurseve natyrore, caktohen masa mbrojtëse dhe ndëshkuese, për vendosjen e mbikqyrjes në tërë territorin e parkut. Fillimisht, vendoset kontroll i veçantë ndaj prerjes ilegale të pyjeve, për prerjet fito-sanitare, si në ato për shkak të sëmundjeve ashtu edhe për rrallimet e nevojshme tek pyjet jo të zhvilluara siq duhet.

Në kuadër të mbrojtjes dhe zhvillimit të parkut, ndikim dhe rol të rëndësishëm kanë edhe vet banorët gjegjësisht vendbanimet në park dhe përreth tij, duke u mbështetur në mënyrë adekuate për të pranuar, konsideruar zhvilluar dhe përdorë afërsinë me parkun për të mbrojtur dhe përfituar ekonomikisht, gjithmonë në dobi të mbrojtjes së tij.

Nga këtu të rikujtojmë synimin e dytë tek vizioni, pra

Synimi 2: Mbrojtje, ruajtje dhe shfrytëzim i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në park dhe vendbanimet përreth

Objektivat:

1. Vetëdijësimi dhe informimi për parkun kombëtar;
2. Mbrojtje e pyjeve nga faktorët natyror dhe antropogjen;
3. Mbrojtje dhe ruajtje e biodiversitetit të parkut;
4. Monitorim për mbrojtje dhe shfrytëzim të resurseve natyrorë në park;
5. Sigurimi i ekzistencës fizike dhe ruajtja e autenticitetit të plotë të zonave dhe objekteve të TK;
6. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zonat dhe objektet e TK;
7. Vetëdijësimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore (TK);.
8. Bashkëpunimi ndërinstitucional i nivelit qendror dhe lokal;
9. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë shpirtërore

Në vazhdim, për arritjen e këtij synimi nga kaptina e vizionit, po trajtojmë masat dhe aktivitetet adekuate në mbrojtje dhe zhvillim të parkut sipas objektivave specifike veç e veç të shtjelluara.

S2.O1. Vetëdijësimi dhe informimi për parkun

Në përgjithësi është më se e domosdoshme të bëhet vetëdijësimi dhe informimi në kohë e gjithpërfshirës, i popullatës dhe institucioneve, mbi rolin, rëndësinë dhe përfitimet nga Mali Sharr i shpallur park kombëtar. Vazhdimësia e këtij procesi, është me rëndësi për trendet e zhvillimeve si në arenën kombëtare, rajonale ashtu edhe atë ndërkombëtare, veçananërisht për popullatën që 'bashkëjeton me parkun', jeton në vendbanimet brenda dhe në afërsi të parkut. Procesi i informimit duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes krijimit, ngritjes dhe funkcionalizimit të sistemit të informimit. Ky sistem konsiston në informim global (gjithpërfshirës dhe ndodh para ardhjes në park) dhe në atë të çastit (më i hollësishëm dhe ndodh me arritje në park). Për realizimin dhe të kuptuarit më të lehtë të informatës, janë dhënë edhe shenjat apo simbolet, të cilat vehen varësisht nga përmbajtja e parkut.

Aktivitetet për përmbushjen e objektivit për vetëdijësim dhe informim për parkun:

- Përgaditja e media-marketingut për Parkun Kombëtar "Sharri";
- Pregaditja e programit arsimor medial për mbrojtje të mjedisit, resurseve natyrore dhe pejsazhore;
- Hartimi i temës metodike – pedagogjike si pjesë e lëndëve nëpër shkolla fillore dhe të mesme;
- Hartimi dhe publikimi i hartave, broshurave, fletëpalosjeve, reklamave etj, si dhe shpërndarja e tyre;
- Organizimi i ekskurzioneve edukative dhe arsimore për rëndësinë e parkut;
- Organizim dhe prezencë, e personave për shpjegim (ciceronëve) dhe materialeve të shtypura informative me simbole, në pikat hyrëse-kontrolluese;
- Vendosja e shenjave dhe simboleve nga MMPH, të ndërtuara nga materialet natyrore dhe sipas standardeve, për informim para hyrjes në zona të mbrojtura;
- Pregaditje dhe senzibilizim të banorëve të vendbanimeve në park dhe përreth tij mbi ruajtjen e mjedisit, pejsazhit, traditës dhe zhvillimit të ardhshëm turistik sipas trendeve të reja.
- Hartimi i Udhëzimit Administrativ – Rregullores:
  - për rendin e mbrendshëm – mbi lejimin dhe ndalimin e aktiviteteve si dhe gjobat ndaj prodhuesit, ndërtuesit dhe ndotësit (personat fizik dhe juridik) mbrenda dhe perreth parkut;
  - mbi normat dhe rregullat e mirësjelljes;
  - mbi pregaditjen dhe kontrollin e planeve rregullative
  - mbi kushtet e lejimit dhe mbikqyrjen e ndërtimeve për zonën e III-të dhe të IV-rt të zhvillimit.

S2.O2. Mbrojtje e pyjeve nga faktorët natyror dhe njerzor (prerjet, sëmundjet, zjarret, ortiqet dhe erozionet)


Në bazë të analizave të gjendjes ekzistuese të parkut, lidhur me faktorët që rrezikojnë dhe në të mirë të mbrojtjes dhe zhvillimit të parkut ipen masa, veprime dhe aktivitetet në favor të përkujdesit dhe mbrojtjes ndaj pyjeve të rrezikuara.

Pra, nxirren masat për administrim të plotë të parkut, për vëzhgim dhe informim efikas si në paralajmërimin e menjëhershëm për rrezikun ashtu edhe në parandalimin dhe ndërmarrjen e aktiviteteve ndaj tyre.

Aktivitetet për arritjen e objektivit janë:

- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit për mbrojtjen e pyjeve në mes të MMPH/AMMK/DP, APK, SHPK dhe gjykatave komunale (Komunat pjesëmarrëse në PN);
- Hartimi i UA nga MMPH për ndalimin e menjëhershëm të prerjes ilegale të pyjeve si dhe rritjen e tarifave ndëshkimore për shfrytëzuesit ilegal të resurseve natyrore në park (bazuar në ligjin për mbrojtjen e natyrës, neni 41, paragrafi 5);
- Rritja e numrit të rojeve si dhe përmirësimi i kushteve dhe paisjeve të nevojshme për vrojtim, telekomunikim, mbrojtje dhe lëvizje;
- Ndërtimi shtigjeve, pengesave dhe pritave me qëllim të mbrojtjes së pyjeve nga zjarri, prerjet, erozioni dhe orteku;
- Prerja e kontrolluar fito-sanitare, me rastin e përkujdesjes ndaj zhvillimit të pyjeve, përveç në zonën e parë strikte;
- Identifikim i vendeve në zonën e dytë për rrallime, pyllëzime, ripyllëzime dhe ndërtim të pritave me qëllim të mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve.





▶ Harta: Strategjia e zhvillimit mjedisor

S2.O3. Mbrojtje dhe ruajtje e biodiversitetit të parkut

Mbrojtja e llojllojshmërisë biologjike, e sidomos e bimëve dhe kafshëve të rrezikuara, është me interes të ruajtjes së trashëgimisë globale natyrore në përgjithësi dhe asaj kombëtare në veçanti. Në mënyrë që ky objektiv të arrihet, përveç formave të përshtatshme informuese dhe prezantuese përmes botimeve shkencore, xhirimeve dhe fotografive elektronike, broshurave, fletushkave, panove dhe tabelave me vendndodhje dhe shkaqe të rrezikut të potencuar.

Aktivitete tjera të propozuara janë edhe:

- Hulumtimi, evidentimi dhe inventarizimi i bimëve sipas llojit dhe familjes, me përcaktimin e arealit tyre
- Hartimi dhe publikimi atlasit botanik të parkut
- Hulumtimi, evidentimi dhe inventarizimi i kafshëve sipas llojit dhe familjes, me përcaktimin e arealit tyre
- Hartimi dhe publikimi atlasit zoologjik të parkut
- Përpilimi i "Librit të kuq" të florës dhe faunës
- Përpilimi hartës me specie endemike, habitate të rrezikuara si dhe arealet e llojeve dhe familjeve më të rëndësishme bimore dhe shtazore

S2.O4. Mbrojtje, monitorim dhe shfrytëzim racional të resurseve të parkut;

Krijimi i një ambienti të volitshëm për mbrojtje, monitorim dhe shfrytëzim të resurseve mjedisore dhe atyre natyrore arrihet përmes një menaxhimi efikas të parkut, ndarja e kompetencave apo përgjegjësive për përkujdesje më të madhe, vëzhgim më efikas, lajmërim dhe ndërmarrje të menjëhershme të masave, aktiviteteve dhe veprimeve adekuate.

Aktivitetet me shumë rëndësi, për zonën e parë (mbrojtje rigoroze) dhe zonën e II-të dhe të III-të në aspekt të mbrojtjes, monitorimit dhe shfrytëzimit racional të resurseve, janë të specifikuara si në vijim:

- Hartimi i planit menaxhues të parkut;
- Memorandum mirëkuptimi për koordinim të veprimeve në mes institucioneve kompetente monitoruese DP, AMMK, IHMK dhe IKShP;
- Ndërtimi i stacionit hidrometeorologjik nga MMPH (në bashkëpunim dhe përgjegjësi të Drejtorisë së parkut dhe IHMK);
- Përpilimi i kornizës, për raportime vjetore, mbi gjendjen mjedisore;
- Ndërprerja e menjëhershme e aktiviteteve të gurëthyesve në kudër të parkut dhe të atyre në afërsi direkte të tij;
- Definim i pejsazheve natyrore në park;
- Hartim i kornizës, për shfrytëzim të kontrolluar dhe racional të resurseve mbrenda parkut (të tokës bujqësore, kullosave, livadheve, fryteve malore dhe bimëve mjekuese si dhe trupave ujore sipas planit menaxhues);
- Evidentim dhe kontrollim i krerëve blegtoral mbrenda kufinjëve të parkut si dhe pregaditja e taksave stimuluese për sektorin privat në zhvillim të blegtorisë dhe të prodhimtarisë ekologjike;
- Ripyllëzimi i sipërfaqeve tokësore që janë nën ndikimin e erozionit me shkallë të fortë dhe shumë të fortë në zonën e dytë dhe të tretë të mbrojtjes, në ato sipërfaqe ku lejon konfiguracioni i terrenit (sip. janë të identifikuara në hartën e erozionit).
- Ndërtimi i pritave me material natyror në pjesët ku erozioni shkakton dëme të të mirave materiale (tokës bujqësore, kullosave, infrastrukturës fizike) si dhe mënjanon rrezikun e madh nga ortiqet eventuale;
- Sigurimi i inspektimit dhe monitorimit gjatë ndërtimeve dhe në mbrojtje të elementeve mjedisore (ajrit, ujit dhe tokës) tek qendrat dhe pikat e urbanizuara (largim i mbeturinave, trajtim i ujrave të zeza etj)

S2.O5. Sigurimi i ekzistencës fizike dhe ruajtja e autenticitetit të plotë të zonave dhe objekteve të TK

Ky objektiv nënkupton ruajtjen e zonave dhe objekteve të trashëgimisë kulturore nga dëmtimi fizik apo shkatërrimi, si dhe ruajtjen e autenticitetit të tyre gjatë intervenimit në to. Aktivitetet e nevojshme për arritjen e këtij objektivi janë:

- Definimi i zonave me TK (arkeologjike, arkitekturore, të luajtshme,shpirtërore dhe peisazhet) si dhe definimi i zonave mbrojtëse, duke i'u referuar Ligjit për TK dhe Ligjit për ZVM;
- Digjitalizimi i objekteve dhe monumenteve me status të përkohshëm dhe të përhershëm si dhe kontrrollimi i gjendjes së tyre fizike në periudha të caktuara , që do të realizohen nga organet përgjegjëse të përcaktuara nga MKRS;
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore (arkeologjike, arkitekturore, të luajtshme,shpirtërore dhe peisazhet) në Planet e nivelit local si: PZHK, PZHU dhe PRrU-në që përfshinë zonën me trashëgimi kulturore, ku njëherit do të bëhet kontrrollimi i zhvillimeve të ardhshme në këto zona.
- Hartimi i planeve të konservimit dhe menaxhimit për zonat me trashëgimi kulturore;
- Ndërtimet moderne nuk duhet të kenë ndikime përqarëse, komerciale dhe uniforme, por ato duhet të inkorporohen, harmonizohen me të vjetrën dhe t'a pasurojnë edhe më shumë trashëgiminë kulturore

S2.O6. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zonat dhe objektet e TK

Objektivi i radhës nënkupton sigurimin e qasjes së lehtë deri tek zonat dhe objektet e trashëgimisë kulturore e poashtu edhe ndriçimin e tyre. Ky objektiv mund të arrihet duke i realizuar aktivitetet si:

- Ndërtimi i rrugëve, shtigjeve dhe parkingjeve të nevojshme të cilat shpiejnë gjer te objektet dhe zonat me TK;
- Vendosja e paneleve informuese (shenjave) në zonat dhe objektet me TK;
- Sigurimi i ndriçimit të zonave me TK

S2.O7. Vetëdijësimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore

Me këtë objektiv tentohet që përmes vetëdijesimit dhe informimit për rolin dhe rëndësinë e TK të rritet interesimi dhe të shtohen aktivitetet e shoqërisë në të mirë të trashëgimisë kulturore. Aktivitetet me të cilat do të mund të arrihej ky objektiv janë:

- Inkorporimi i TK në planprogramet shkollore;
- Specializimi i kuadrove në sfera të caktuara për trashëgimi kulturore;
- Aftësimi i ciceronëve për TK në nivel lokal dhe qendror;
- Pregatitja e hartave, broshurave, fletëpalosjeve etj. për monumente dhe tërësi të TK dhe TN

S2.O8. Bashkëpunimi ndërinstitucional i nivelit qendror dhe lokal

Kur dihet rëndësia që ka bashkëpunimi në mes të institucioneve të nivelit qendror dhe atyre të nivelit lokal për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, ky na del si një objektiv i pashmangshëm që të arrihet. Aktivitetet me të cilët tentohet që objektivi të arrihet do të ishin:

- Mbështetje nga ana e nivelit shtetëror mbi rëndësinë dhe rolin e TK, përmes politikave zhvillimore, që do të jenë bazë për arritjen e qëllimit tonë që është mbrojtja e TK nga degradimi i vazhdueshëm.
- Realizimi i projekteve të përbashkëta duke i harmonizuar detyrat dhe obligimet që dalin nga institucionet e veçanta;
- Respektimi i hierarkisë ndërinstitucionale, gjithmonë me përmbushjen e kërkesave me qëllim të zhvillimit të planifikuar dhe të qëndrueshëm

S2.O9. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë shpirtërore

Trashëgimia shpirtërore si formë e shprehjes kulturore të traditave popullore, zakoneve, gjuhës, festave, ritualeve, valleve, muzikës, këngëve etj. paraqet identitetin e kësaj ane dhe njëkohësisht identitetin gjithkombëtar. Meqenëse identiteti kombëtar duhet të ruhet, arritja e këtij objektivi është e

domosdoshme dhe kjo do të mund të bëhej përmes aktiviteteve në vazhdim:

- Shumëzimi dhe ruajtja në arkiva dhe biblioteka e librave ekzistues ku flitet për traditat dhe zakonet popullore në territorin e komunës;
- Hulumtimi në terren për traditat dhe zakonet popullore në territorin e komunës dhe dokumentimi në bazë të rezultateve të hulumtimit;
- Promovimi i kësaj lloj trashëgimie në mediat e shkruara dhe ato elektronike dhe relizimi i emisioneve dokumentare televizive për traditat dhe zakonet popullore në territorin e komunës;
- Ruajtja e audio dhe video incizimeve dhe realizimi i incizimeve të reja të valleve dhe muzikës popullore duke e kultivuar traditën dhe autenticitetin e tyre

Në - Shtojca 3 - në mënyrë të detajuar janë paraqitur të gjitha aktivitet që duhet të ndërmerren për arritjen e kësaj strategjie.



Foto: Peisazh natyror nga malet e Sharrit

4.2. Strategjia për Zhvillim ekonomik

Strategjia e zhvillimit ekonomik e PK "Sharri", bazohet në konceptin hapësinor të parkut, mbrojtjen e parkut si dhe zhvillimet e mundshme të bazuara në standardet ndërkombëtare të shfrytëzimit të parkut për industri të turizmit. Zhvillimi në park do të jetë i orientuar dhe i planifikuar për zonat të cilat lejojnë dhe mundësojnë këtë zhvillim të qëndrueshëm të paraparë edhe me përfshirjen e zonave/vendbanimeve përreth parkut, të cilat do të jenë në funksion të parkut[27].

Zhvillimet do të orientohen përmes dokumentit të planit hapësinor të parkut, përderisa përmes menaxhimit efikas të parkut, Autoritetit të parkut si dhe instancave komunale do t'u mundësohet monitorimi dhe kontrolli i zhvillimeve.

Zhvillimi i sektorit të turizmit do të thotë arritje e synimit për rritjen e numrit të vizitorëve në park, me qasjen e qëndrimit sa më të shkurtër brenda parkut.

Me këtë strategji janë përcaktuar zonat për ofrim të turizmit të quajtura sipas nomenklaturës së propozuar me këtë plan hapësinor për të cilat parashihet hartimi i planeve rregulluese (Zona/Vendbanim me potencial për turizëm fshatar – ekologjik; Qendër turistike; Vendbanim turistik, Qendër e skijimit; Qendër shëndetësore dhe Kampe turistike),

Për ruajtjen e vlerave dhe veçorive të PK "SharrI" do të iniciohen marrëveshje për bashkëpunim ndërkufitar mes Kosovës, Maqedonisë dhe Shqipërisë sa i përket planifikimit të zhvillimeve të përbashkëta, kapaciteteve për turizëm rekreativ, shëndetësor, ekologjik, fshatar etj.

Strategjia e zhvillimit ekonomik për PK "Sharri" arrihet përmes tri synimeve dhe objektivave të tyre, të përmbledhura si në vijim:

S3. Ndikimi pozitiv i ndërsjellë mes parkut dhe vendbanimeve brenda dhe përreth tij

- Zhvillime të planifikuara dhe kontroll të zhvillimeve për zonat brenda dhe përreth parkut;
- Bashkëpunim ndërkomunal për zhvillim rural në mes të komunave në të cilat shtrihet PN "Mali Sharr",
- Mbështetje vendbanimeve përreth parkut për të ofruar ofertë turistike; ofrimin e eko - prodhimeve tradicionale dhe marketingun e tyre,
- Ofrim të shërbimeve publike cilësore për banim të përkohshëm brenda parkut dhe në vendbanimet përreth parkut,
- Vetëdijësim për ruajtjen e kulturës tradicionale të komuniteteve që jetojnë në zonat përreth parkut, veprimtaritë që ndikojnë në zhvillimin e eko-turizmit,

S4 : Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i parkut

- Partneritet publiko-privat për ofrim të kushteve për investime të reja në kapacitetet rekreative,
- Ngritje të objekteve përcjellëse kontrolluese dhe afariste në funksion të parkut,
- Përfitime nga shfrytëzimi ekologjik i parkut,
- Plotësim të planprogrameve arsimore për Industrinë e turizmit.

S5: A) Park i njohur dhe i pranuar në aspekt ndërkombëtar; B) Bashkëpunim ndërkufitar dhe ndërkombëtar në mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut

- Propagandim të vlerave natyrore, pejzazhore e turistike të parkut;
- Ratifikim të konventave ndërkombëtare (RIO, Kyoto, ESPOO, Llugano etj) dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga konventat,
- Bashkëpunim për PK "Sharri" në mes të Kosovës dhe shteteve fqinje si dhe me shtetet në rajon e më gjërë,
- Konkurrim për fondet ndërkombëtare me projekte të përbashkëta të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë për zonën ndërkufitare të malit Sharr.

Në vazhdim janë elaboruar synimet, objektivat e zbërthyera në masa, aktivitete dhe projekte:

[27] Sipas mendimit të Federatës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Natyrës (e cila vepron si agjencion në kuadër të UNESCO-së), sipas të cilës duhet shfrytëzohen kapacitetet jashtë zonës së parkut gjithmon atëherë kur kushtet mundësojnë

S3. Ndikimi pozitiv i ndërsjellë mes parkut dhe vendbanimeve brenda dhe përreth tij

Zonat përreth parkut duhet të jenë në funksion të parkut. Ky parim është në pajtim me mendimin e Federatës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës (në kuadër të UNESCO), sipas të cilës duhet të shfrytëzohen kapacitetet jashtë zonës së parkut gjithmonë kur kushtet mundësojnë.

Për mbrojtje dhe zhvillim të parkut, rol të veçantë ka popullata vendore e vendbanimeve brenda dhe në afërsi të parkut, e cila duhet të pranojë parkun si të tyren, duhet të informohet dhe vetëdijesohet për mundësitë e ngritjes së mirëqenies së tyre, përfitimeve ekonomike. Angazhimi i popullatës në veprimtari për përfitime ekonomike, do të ndikon në parandalimin e shpërnguljes nga vendbanimet rurale. Në këtë mënyrë këta banorë të këtyre vendbanimeve do të kenë përgjegjësinë e mbrojtjes, zhvillimit të parkut dhe zhvillimit të vendbanimeve të tyre.

Ndikimi pozitiv i vendbanimeve për rreth parkut do të fuqizohet përmes bashkëpunimit ndër komunal në mes të komunave në të cilat shtrihet parku kombëtar. Me bashkëpunim të mirëfillltë ndër komunal nënkuptohet zgjidhja e prioriteteve të përbashkëta zhvillimore të komunave fqinje. Do t'i kushtohet rëndësi përmirësimit të kushteve infrastrukturore në vendbanimet brenda dhe rreth parkut, vetëdijesimit të popullatës për ruajtjen e vlerave natyrore e kulturore, duke përmbushur kërkesat dhe nevojat e vizitorëve, bazuar në trende dhe praktika të mira në botë.

Për të arritur këtë synim duhet përmbushur objektivat e definuar si:

S3.O1. Zhvillimet e planifikuara dhe kontroll të zhvillimeve për zonat brenda dhe përreth parkut;

Me planifikim dhe kontroll të zhvillimeve tentohet që në përgjithësi të arrijmë shfrytëzimin racional të hapësirës me mbështetje infrastrukturore të nevojshme për zhvillime të parapara.

Për t'u arritur ky objektiv janë paraparë këto projekte/aktivitete si dhe masa:


- Hartimi i planit menaxhues për PK "Sharri"
- Hartimi i planeve rregulluese urbane për qendrën turistike në Brezovicë,
- Hartimi i planeve rregulluese urbane për qendrën turistike në Prevallë,
- Hartimi i planeve rregulluese urbane për qendrën turistike-shëndetësore në Maqurishtë - Gradac/Suharekë,
- Hartimi i planeve rregulluese urbane për qendrën turistike Guri i Zi/Dragash,
- Identifikimi dhe adoptimi për bujtina i staneve, për ofrim të eko- turizmit, turizmit shëndetësor dhe agro- turizmit,
- Hartimi i planeve rregulluese urbane për vendbanimet përreth parkut (Gornja Selë, Brezovicë, Zaplluzhë, Skorobishtë, Restelicë dhe Brod)
- Monitorimi dhe kontrolli i zhvillimeve sipas planeve rregulluese urbane brenda parkut,
- Monitorimi dhe kontrolli i zhvillimeve sipas planeve rregulluese urbane jashtë parkut,

S3.O2. Bashkëpunimi ndërkomunal për zhvillim rural në mes të komunave në të cilat shtrihet parku

Ky objektiv ndihmon në identifikimin e problemeve dhe mundësive zhvillimore të përbashkëta fqinjësore, përzgjedhjen e masave dhe veprimeve për t'u bashkërenditur drejt zhvillimit të zonave rurale që kufizohen me parkun dhe kanë ndikim në të.


Ky objektiv arrihet përmes:

- Krijimi i trupit koordinues në mes të komunave fqinje për përcaktimin e caqeve të përbashkëta zhvillimore (përbërë nga zyrtarë komunal dhe shoqërisë civile),
- Harmonizimi i planeve zhvillimore komunale të dy komunave që shtrihen pranë parkut përmes planeve të përbashkëta rregulluese për zonat rurale fqinje me interes reciprok.



▶ Harta: Zona e Prevalles

Plani rregullues për zonën e Prevallës - është mundësi e mirë që kjo zonë të plotësohet edhe me përmbajtje të reja. Në këtë mënyrë do të krijohen kushte për një zgjidhje të re urbane për gjithë zonën në fjalë (me sip. të përbashkët rreth 30 Ha). Kufiri i treguar në hartë është i caktuar në bazë të gjendjes në terren, i cili padyshim se duhet ti nënshtrohet matjeve precize në terren.



▶ Harta: Zona e Brezovices

Në foton e mësipërme tregohet kufiri i zonës së banimit në Brezovicë e cila është vetëm një pjesë e qendrës turistike Brezovica, në të cilën është e përfshirë edhe: qendra e skijimit dhe vet fshati. Kufiri i paraqitur në hartë mbulon sipërfaqen prej afërsisht 75 Ha dhe sipas gjendjes momentale në terren, duhet në mënyrë urgjente të përgatitet plani rregullues urban. Matjet gjeodezike do ta përcaktojnë saktësisht kufirin dhe sipërfaqen e zonës. Projekti i përmendur më herët për ndërtimin e një qendre të re të skijimit afër Brezovicës, si pjesë të veten duhet ta ketë edhe planin rregullues urban.

S3.O3. Mbështetje vendbanimeve përreth parkut për të ofruar ofertë turistike; ofrimin e eko - prodhimeve tradicionale dhe marketingun e tyre

Zhvillimi i turizmit fshatar ofron mundësi për përfitime ekonomike të komunitetit, i cili do të promovojë dhe plasojë prodhimet tradicionale të bulmetit, mishit, pemëtarisë, mjaltit dhe bimëve shëruese, pastaj punimet artizanale prej druri, pëlhurave etj. Në fillim këto aktivitete do të jenë plotësim i të hyrave materiale për disa nga banorët, ndërsa më vonë edhe burim kryesor i të ardhurave.

Për të arritur deri te një zhvillim i tillë është parashikuar:

- Vetëdijesim i banorëve, bazuar në praktika të mira në rajon dhe botë, për përfitimet e mundshme nga menaxhimi ekologjik i parkut; përfshirë mundësinë e vizitave jashtë vendit,
- Organizim i trajnimeve për trajtimin e mundësive dhe rëndësisë së eko prodhimeve në industrinë e turizimit sot; mbështetje organizimit për standardizim të artikujve ushqimor dhe artikujve tjerë artizanal me tiketë karakteristike -logo të PK "Sharri"; Hartimi i broshurës me prodhimet tradicionale të këtyre zonave për të reklamuar prodhimet unike me logon e parkut dhe kualitetin e prodhimit,
- Ofrim i lehtësimeve në tatime për stimulimin e banorëve në involvimin në industrinë turistike për të ndikuar në ofertën turistike lokale,
- Mbështetje në themelim të ndërmarrjeve të vogla për industri turistike,[28]
- Mbështetje në themelim të fermave për rritjen dhe kultivimin e qenit të "Sharrit" ,

[28] Hartimi i projekteve për kualifikimin e banorëve në ofrimin e shërbimeve turistike, të mikpritjes dhe informatave për vendosje në bujtina dhe aktivitete tjera të mundshme si vjelja e pemëve, konservimi i perimeve, përgatitja e bulmetit, angazhimi në bletari, aktivitete në hapësira të hapura si: shëtitje, biçiklizëm, vrapim, lojna tradicionale, etj).

S3.O4. Vetëdijësim për ruajtjen e kulturës tradicionale të komuniteteve që jetojnë në zonat përreth parkut, veprimtaritë që ndikojnë në zhvillimin e ekoturizimit

Me këtë objektiv tentohet të arrihet ruajtja dhe kultivimi i vlerave tradicionale dhe kulturore të komuniteteve të shumëllojshme për-rreth parkut, të cilat do të shtojnë atraktivitetin e vetë parkut dhe numrin e vizitorëve.

Ky objektiv arrihet përmes:

- Mbështetje në angazhim të OJQ-ve për vetëdijësim të popullatës në ruajtjen e vlerave tradicionale folklorike karakteristike të komuniteteve që jetojnë pranë parkut,
- Organizim i aktiviteteve të lira nëpër shkolla për shoqëri kulturo artistike, karakteristike të komuniteteve,
- Mbështetje në hapjen e punëtorive me veprimtari artizanale.

S4. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i parkut

Me këtë synim tentohet arritja e zhvillimit të parkut, në kuptim të mbrojtjes së mjedisit, mirëqenies sociale dhe përfitimeve ekonomike nga vetë parku, të mjaftueshme për vetë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e parkut dhe kontribuuese për ekonominë kosovare. Mënyra më e qëndrueshme dhe gjithë përfshirëse e shfrytëzimit të parkut për përfitime ekonomike është turizmi, me të gjitha karakteristikat e tij që nxit dhe stimulon sektorë tjerë (bujqësia, blegtoria, infrastruktura, shërbimet sociale) të cilat së bashku ndërtojnë sistemin e qëndrueshëm të industrisë së turizmit .

Ky synim do të arrihet përmes objektivave:

S4.O1. Partneriteti publiko-privat për ofrimin e kushteve për investime të reja në kapacitetet rekreative,

Me këtë objektiv tentohet të krijohen kushtet e nevojshme për joshjen e investitorëve vendor dhe ndërkombëtar të investojnë në zhvillimin e kapaciteteve turistike. Me krijimin e kushteve do të përcaktohen kompetencat dhe obligimet e investitorit, do të mundësohet mbarëvajtja e privatizimit të kapaciteteve ekzistuese dhe investimeve të reja kapitale.

Ky objektiv arrihet përmes këtyre masave / projekteve / aktiviteteve:

- Mbështetje ligjore për partneritet publiko-privat,
- Dhënia me kontratë e qendrave turistike (Infrastrukturë dhe hotele) për investime dhe shfrytëzim të kapaciteteve për kohë të caktuar,
- Zhvillimi i qendrës turistike në Brezovicë sipas planeve rregullues,
- Ndërtimi i qendrës turistike sportive në Prevallë, sipas planit rregullues,
- Ndërtimi i qendrës turistike shëndetësore në Muqirishtë-Suharekë, sipas planit rregullues,
- Ndërtimi i qendrës turistike sportive "Guri I Zi" - Dragash, sipas planit rregullues.
- Përshpejtimi i privatizimit të kapaciteteve në Brezovicë që janë jashtë Hapësirës për Zhvillimin e Projektit Brezovica,

S4.O2. Ngritja e objekteve përcjellëse, kontrolluese dhe afariste në funksion të parkut

Me këtë objektiv tentohet të arrihet plotësimi i nevojave për shërbime kontrolluese të hyrje daljeve, në dhe prej parkut, objekteve tjera të vogla përcjellëse në shërbim të vizitorëve, informim dhe komunikim, tregti për konsum të shpejtë, etj. Me këtë objektiv parku do të jetë më i kontrolluar, më joshës dhe më pranë vizitorëve, përderisa të ardhurat do të shfrytëzohen përpjesëtimisht për mbrojtjen dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të parkut.

Ky objektiv do të arrihet me këto masa/veprime/aktivitete:

- Ngritja e ndërtesës së autoritetit të parkut brenda parkut.
- Organizimi i pikave kontrolluese në hyrje–daljet e parkut, (grumbullimin e taksave hyrëse, të cilat do të kategorizo-hen sipas llojit të shfrytëzimit të parkut me vendosjen e rampave dhe objekteve për kontroll/informim të vizitorëve dhe lëvizjeve të automjeteve. Pikat kontrolluese do të përmbajnë në afërsi edhe parkingje sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare. Në kuadër të taksave do të parashihet edhe taksa ekologjike. Janë paraparë 9 hyrje në park, prej të cilave 3 janë kryesore:
  - **H1** në drejtimin Prizren–Prevallë ku parashihet të vendoset Autoriteti Qendror i Parkut
  - **H2** në drejtimin Shtërpce-Prevallë ku do të vendoset një zyre e administratës së parkut
  - **H3** në drejtimin Brezovicë-Shtëpia e Stojkut ku do të vendoset një zyre e administratës së parkut

  Punket tjera ndihmëse janë:
  - **H4** në drejtimin Shtërpce –Vërbeshticë;
  - **H5** në drejtimin Suharekë –Delloc;
  - **H6** në drejtimin Zaplluzhë – Guri Zi;
  - **H7** në drejtimin Kaçanik – Ahishtë;
  - **H8** Brod në drejtim te malit Çule
  - **H9** Restelicë drejtim të malit Karpa

- Ngritja e objekteve të vogla për shërbime bankare dhe postare, shitore të suvenirave, agjensione për marketing dhe informim për shërbime akomoduese.
- Ngritja e Qendrës së Natyrës, muzeut dhe kopshtit botanik, hapësirave për hulumtim, (ekspozimi i llojeve të bimëve dhe shtazëve në hapësirat e parkut kombëtar me karakter kulturor, edukativ dhe hulumtues. Vendi më i përshtatshëm për këtë kopsht - muze do të jetë në afërsi të ndërtesës së autoritetit të parkut).

S4.O3. Përfitime nga shfrytëzimi ekologjik i Parkut

Me këtë objektiv arrihet kontrolli i shfrytëzimit të livadheve për blegtori dhe të bimëve, në mënyrë ekologjike dhe të organizuar sipas etapave kohore sezonale dhe sipërfaqeve të destinuara, për nevoja të hulumtimeve shkencore dhe përfitimeve ekonomike. Kjo për më tepër rezulton në mbrojtjen e parkut, shfrytëzimin e bimëve, peizazhit dhe arritja e përfitimeve ekonomike për parkun.

Ky objektiv arrihet me këto masa/veprime/projekte /aktivitete:

- Hartimi i udhëzimit administrativ/rregullores për shfrytëzimin e sipërfaqeve të parkut për kullosa, mbledhjen e frutave të imta dhe bimëve mjekuese, mënyrën e dhënies së lejeve për vizitat e grupeve hulumtuese - shkencore dhe kalkulimi/vendosja e çmimit për shërbime të tilla.
- Caktimi i zonave, sipërfaqeve dhe afateve kohore për shfrytëzim të mundshëm për kullotje të bagëtisë dhe mbledhje frutash të imta, bimëve mjekuese dhe bimëve për hulumtime-shkencore,
- Organizimi dhe menaxhimi i shtigjeve për vizita të organizuara hulumtuese-shkencore.

S4.O4. Plotësimi i plan-programeve arsimore për industrinë e turizmit

Me këtë objektiv tentohet të arrihet involvimi i popullatës lokale në përgatitjen e kuadrove me kualifikime përkatëse për të krijuar strategji zhvillimore për turizëm dhe të menaxhojë zhvillimin e të mirave nga industria e turizmit fshatar, ekologjik, shëndetësor, rekreativ etj.

Ky objektiv arrihet përmes masave:

- Plotësimi i planprogrameve arsimore në arsimin e mesëm të orientuar dhe atë profesional, për komunat për rreth parkut,



- Plotësimi i plan programeve arsimore në arsimin e lartë, fakultete dhe shkolla të larta për turizëm apo edhe specializime në këtë fushë, për ngritjen e cilësisë dhe zhvillimit të turizmit në Kosovë.

S5: A) Park i njohur dhe i pranuar ndërkombëtarisht B) Bashkëpunimi ndërkombëtar e ndërkufitar në mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut

Me këtë synim tentohet të arrihet njohja dhe pranimi i PK "Sharri" nga organizatat ndërkombëtare për mbrojtjen e trashëgimisë natyrore dhe Organizata Botërore për Turizëm, duke bërë propagandimin e vlerave natyrore, peizazhore dhe turistike të parkut, ratifikimin e konventave mjedisore dhe përmbushjen e obligimeve nga to. Me njohjen ndërkombëtare të parkut do të ofrohen mundësitë për inicimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në mes të PK"Sharri" me parqet në rajon dhe në botë.

Pasi mali Sharr shtrihet në territorin e tri shteteve, zhvillimi i qëndrueshëm i tij varet nga ruajtja, mbrojtja dhe zhvillimi i resurseve natyrore nga të gjitha anët e kufirit. Zhvillimin hapësinor të parkut duhet bazuar në gjetjen e koncepteve të përbashkëta dhe harmonizimin e strategjive nacionale; thithjen e fondeve të alokuara nga BE për favorizimin e bashkëpunimit ndërkufitar.

Ky synim do të arrihet përmes objektivave:

S5.O1. Propagandimi i vlerave natyrore, pejzazhore e turistike të parkut;

Me këtë objektiv tentohet të arrihet informim sistematik për vlerat natyrore dhe menaxhimin ekologjik të parkut; informim për kapacitetet rekreative të parkut, me qëllim të propagandimit të vlerave të parkut, joshjen e vizitorëve.

Ky objektiv arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve;

- Hartimi i hartave, broshurave dhe video klipeve, për vlerat dhe kapacitet turistike të PK "Sharri",
- Distribuimi i materialit propagandistik për PK "Sharri" përmes:
    - Mediave lokale dhe ndërkombëtare;
    - Agjencioneve turistike të vendit dhe të huaja;
    - Ambasadave të Republikës së Kosovës,
    - Avio kompanive që kanë destinim Kosovën,
    - Pjesëmarrje aktive nëpër konferenca ndërkombëtare për turizëm, mbrojtje të mjedisit.

S5.O2. Ratifikimi i konventave ndërkombëtare (RIO, Kyoto, ESPOO, Llugano etj) dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga konventat;

Me këtë objektiv tentohet të arrihet ruajtja, mbrojtja e vlerave të parkut si dhe zhvillimi i tij duke i respektuar kriteret e përcaktuara me normat ndërkombëtare. Me nënshkrimin e konventave ndërkombëtare për mjedis, mundësohet edhe pranimi nga organizatat botërore për mbrojtjen e mjedisit dhe të turizmit etj.

Ky objektiv arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve:

- Inicimi dhe përshpejtimi i procesit të ratifikimit të konventave nga ana e MMPH/Qeverisë së Kosovës,
- Përshpejtimi i procesit të ratifikimit përmes involvimit të organizatave mjedisore ndërkombëtare, zyrave ndërlidhëse dhe ambasadave që veprojnë në Kosovë.
- Aplikimi për njohje në organizatat ndërkombëtare si: IUCN, ËTO etj;

S5.O3. Bashkëpunimi për PK "Sharri" në mes të Kosovës dhe shteteve fqinje si dhe me shtetet në rajon e më gjërë

Me këtë objektiv tentohet të arrihet hapja e perspektivave në thithjen e përvojave të suksesshme për eko-menagjim të PK "Sharri" sipas standardeve bashkëkohore. Me themelimin e organeve kompetente të bashkëpunimit do të krijohen mundësitë e shkëmbimit të përvojave dhe përsosjen e metodave në mbrojtjen dhe zhvillimin e resurseve natyrore në kontekst rajonal dhe global.

Ky objektiv arrihet përmes masave/projekteve/aktiviteteve:

- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërkomunal mes komunave/vendbanimeve në Kosovë dhe Maqedoni që tangjentojnë Malin Sharr, për mbrojtje dhe zhvillim te

ndërsjellë; Formimi i organizmave ndërkomunal që iniciojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin ndërkufitar;

- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit ndërkufitar mes Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e maleve të Sharrit – Formimi i organizmave ndërshtetëror që iniciojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin ndërkufitar;
- Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit mes Kosovës dhe shteteve në rajon për shkëmbim përvojash në mbrojtjen dhe zhvillimin e parqeve nacionale.

S5.O4. Konkurrimi për fondet ndërkombëtare me projekte të përbashkëta të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë për zonën ndërkufitare të malit Sharr

Me këtë objektiv tentohet të arrihet themelimi i mekanizimit për bashkëpunim ndërkufitar, në nivelin qendror dhe atë lokal nga të dy anët e kufirit. Në këtë mënyrë do të bëhet zbutja e barrierave ekzistuese dhe ngritja e nivelit të vetëdijes për nevojën e shpalljes park nacional të Malit Sharr nga ana Maqedonisë. Me shpallje park nacional të Malit Sharr nga ana e Maqedonisë, do të mundësohej planifikimi i përbashkët i parkut nga të dyja anët e kufirit, përfitimet do të jenë të shumëfishta.

Rëndësia çdo ditë e më e madhe e komponentës mjedisore, krahas komponentës ekonomike dhe sociale për zhvillim të qëndrueshëm, implikon domosdoshmërinë e trajtimit reciprok të zonave ndërkufitare malore[29]. Komisioni Evropian, në kuadër të zgjerimit të BE, themeloi instrumentin e posaçëm financiar të njohur Neighbourhood Program – Programi i Fqinjësisë së mirë, për mbështetje iniciativave tej-kufitare kudo në regjionet fqinje të BE. Përmes Programit te Fqinjësisë së mirë u ofrohet të gjitha palëve të bashkëpunimit (si shteteve anëtare të BE sikurse edhe shteteve të regjioneve fqinje), asistencë të barabartë si nga përzgjedhja e projekteve deri te implementimi dhe menaxhimi i tyre. (në Kosovë, koordinimi i iniciativave ndërkufitare është kompetencë e Zyrës për Bashkëpunim Ndërkufitar në kuadër të MAPL);

Me implementimin e Bashkëpunimit Ndërkufitar, KE tenton të kontribuojë në zhvillimin policentrik dhe të balancuar të Evropës duke i eliminuar dallimet e mëdha ekonomike, sociale e mjedisore në të. Për këtë arsye Kosova dhe shtetet tjera në zhvillim janë në pozitë të përshtatshme për të përfituar nga instrumentet financiare të Bashkëpunimit Ndërkufitar në përmbushjen e kritereve drejt anëtarësimit më të shpejtë në BE.

- Harmonizimi i strategjive zhvillimore lokale të komunave / vendbanimeve në zonat kufitare për identifikimin dhe zgjidhjen e prioriteteve drejt zhvillimit rural ndërkufitar,
- Hartimi rregulloreve për menaxhim ekologjik të parkut duke i harmonizuar masat e mbrojtjes efikase të resurseve natyrore ndërkufitare
- Ndërtimi i qendrës së përbashkët për monitorimin e dhe vlerësimin e ndikimit në mjedis,
- Hartimi i projektit të përbashkët për ofrimin e kushteve për qarkullimin ndërkufitar në shfrytëzimin e kapaciteteve turistike të Brezovicës dhe P.Shapkës njëkohësisht,
- Mbështetje ndërshtetërore në themelimin e grupimit (klaster) të ndërmarrjeve që që do të vepronin nën logon e përbashkët me të cilën mund të plasojnë eko-prodhimet e tyre në tregjet Evropiane dhe më gjerë, (ndërmarrje që funksionojnë të varura njëra nga tjetra për shkak të veprimtarive reciproke: Menaxhimi i kullosave; rritja dhe kultivimi i bagëtive; grumbullimi i rendimenteve dhe distribuimi i tyre në industritë përkatëse; përpunimi i bylmetit, mishit dhe leshit, themelimi i trupit koordinues për marketing dhe plasim të prodhimeve, organizimi i kurseve të përbashkëta kualifikuese për aftësimin e popullatës lokale sipas nevojave të tregut të punës nga të dy anët e kufirit).

Në - Shtojca 3 - në mënyrë të detajuar janë paraqitur të gjitha aktivitet që duhet të ndërmerrën për arritjen e kësaj strategjie.

[29] Ky fakt mund të ilustrohet me hipotezën : "Si mund ta planifikojmë zhvillimin e qëndrueshëm vetëm brenda njërës ane te kufirit nëse nuk dihet shkalla e ndotjes dhe llogaritet në respektimin e parametrave për ndikimin mjedisor nga ana tjetër e kufirit të parkut nacional".

4.3. Strategjia për zhvillimin e infrastrukturës fizike

Zhvillimi i infrastrukturës fizike është njëri prej synimeve për Parkun Kombëtar "Sharri". Zhvillimi i njërës nga komponentat e infrastrukturës fizike, ai i infrastrukturës së transportit do të kontribuojë në qasshmërinë dhe lëvizshmërinë e vizitorëve dhe punëtorëve në park, përderisa zhvillimi i komponentës tjetër, i infrastrukturës së energjetikës, do të mundësojë furnizimin e rregullt me energji elektrike. Zhvillimi i infrastrukturës ujore mundëson furnizimin e rregullt me ujë të kapaciteteve të parkut, largimin e ujrave të zeza, eliminimin apo zvogëlimin e dukshëm të ndotjes së ujrave të parkut. Zhvillimi i telekomunikacionit mundëson komunikimin e rregullt për dhe prej parkut.

Për parkun janë identifikuar disa objektiva dhe aktivitete për arritjen e këtyre objektivave e që lidhen me synimin për zhvillimin e infrastrukturës. Objektivat dhe aktivitetet janë ndarë në grupe sipas komponentave që mbulojnë.

Politikat në favor të arritjes së këtyre objektivave janë:

- Krijimi i kushteve për zhvillimin e transportit multimodal në të gjitha zonat e Kosovës në përgjithësi dhe në zonat me potencial për turizëm, pushim, rekreim dhe rehabilitim në veçanti;
- Stimulimi i zhvillimit të turizmit në zonat me potencial për këtë zhvillim;
- Krijimi i kushteve për zhvillimin e postës dhe telekomunikacionit në të gjitha zonat e Kosovës në përgjithësi dhe në zonat me potencial për turizëm, pushim, rekreim dhe rehabilitim në veçanti;
- Krijimi i kushteve për integrimin informativ të Kosovës në rajon dhe më gjerë;

Synimi 6: Zhvillimi i infrastrukturës fizike;

Objektivat:

- Qasja e mirë përmes rrugëve dhe shtigjeve në të gjitha zonat e parkut që janë me interes të vizitohen;
- Sigurimi i transportit publik dhe vendparkimeve të nevojshme;
- Sigurimi i transportit të skiatorëve deri tek pikat nga të cilat e fillojnë lëshimin;
- Sigurimi i furnizimit të rregullt të parkut dhe vendbanimeve përreth tij me energji elektrike;
- Zhvillimi i sistemit publik të ujësjellësit dhe kanalizimit në park dhe vendbanimet rreth tij;
- Zhvillimi i shërbimeve postare dhe të telekomunikacionit në tërë parkun dhe në vendbanimet rreth tij;
- Menaxhimi efikas i mbeturinave;

4.3.1. Transporti dhe infrastruktura e tij

Njëra prej komponentave të infrastrukturës fizike është infrastruktura e transportit. Objektivat që kanë të bëjnë me transportin dhe infrastrukturën e tij janë dhënë në vazhdim:

S6.O1. Qasje e mirë përmes rrugëve dhe shtigjeve në të gjitha zonat e parkut që janë me interes të vizitohen

Ky objektiv do të thotë përmirësim dhe zhvillim i infrastrukturës së transportit (rrjetit rrugor dhe hekurudhor) në territorin e parkut dhe rreth tij. Aktivitetet që duhet të ndërmerren për arritjen e këtij objektivi janë:

- Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë;
- Asfaltimi i rrugës R118 në segmentin Delloc – Vërbeshticë;
- Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidh lokacionin Moqurishte në veri të Parkut Nacional (komuna Therandës) e ku do të ketë ndërtime në funksion të pushimit, rekreimit dhe rehabilitimit shëndetësor me rrugën R118;

- Ndërtimi i rrugës automobilistike në relacionin Drajkovc – Firajë – Brod;
- Asfaltimi i rrugës lokale nga kryqëzimi me rrugën R115 deri tek fshati Pllanjan;
- Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë fshatin Zapllugjë (komuna e Sharrit) me lokacionin në afërsi ku do të ndërtohet qendra rekreative sportive dhe më tutje me Maqedoninë;
- Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë fshatin Restelicë me Mavrovën në Maqedoni;
- Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë fshatin Restelicë me fshatin Brod (komuna e Sharrit);
- Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë fshatin Orçushë me Kuksin në Shqipëri;
- Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë lokacionin Nënahishte(komuna e Kaçanikut), ku do të ketë ndërtime në funksion të pushimit dhe rekreimit, me rrugën regjionale R116;
- Realizimi i studimit për arësyeshmërinë e ndërtimit të hekurudhës në relacionin Brod–Sevce (komuna Shtërpces);
- Ndërtimi i hekurudhës së elektrifikuar në relacionin Brod – Sevce(nëse rezultati i studimit do ta arësyetonte) me degët e saj që shkojnë deri tek lokacionet ku ndodhen pikënisjet e ski liftave dhe teleferikëve,
- Ndriqim publik, sinjalizimi i rrugëve dhe mirëmbajtja e tyre nëpër vendbanime,
- Vendosje të shenjave për informim dhe orientim

S6.O2. Sigurimi i transportit publik dhe vendparkimeve të nevojshme

Arritja e këtij objektivi do të rezultonte me qasje më të lehtë drejt, prej dhe nëpër park, konditë kjo për rritjen e numrit të vizitorëve të parkut dhe të rrethinës së tij (jo të gjithë vizitorët kanë automjete private), do të mundësojë qasje në transport një komuniteti më të gjërë dhe në veçanti për vendbanimet përreth parkut, përmirësim i kualitetit të jetesës. Vendosja e këtyre linjave do të japë alternativa të reja për vizitë parkut, do të joshë më shumë vizitorë me shfrytëzim të transportit publik në vend të veturave private, që si rezultat do ta ketë nevojën më të vogël për hapësira parkimi, më pak ndotje. Aktivitetet e nevojshme për arritjen e këtij objektivi janë:

- Vendosja e linjës në relacionin Doganaj–Shtërpce–Prevallë–Prizren;
- Vendosja e linjës në relacionin Therandë–Mushtisht–Delloc–Vërbeshticë–Shtërpce;
- Vendosja e linjave të rregullta për tek qendrat rekreative sportive dhe rehabilituese brenda dhe jashtë parkut;
- Vendosja e linjës në relacionin Doganaj–Brod–Firajë–Drajkovc–Gotovushë;
- Vendosja e linjës në relacionin Prizren–Reçan–Nebregoste;
- Vendosja e linjës në relacionin Prizren–Reçan–Pllanjan;
- Vendosja e linjës në relacionin Prizren–Reçan–Drajçiq;
- Vendosja e linjës në relacionin Prizren–Reçan–Gornje Sello;
- Vendosja e linjës në relacionin Doganaj–Shtërpce–Sevce;
- Vendosja e linjës në relacionin Doganaj–Biti e Poshtme– Biti e Epërme;
- Vendosja e linjës në relacionin Sharr–Brod (komuna e Sharrit);
- Vendosja e linjës në relacionin Sharr–Restelicë;
- Ndërtimi i vendparkimeve në hyrje-daljet e parkut;
- Ndërtimi i vendparkimeve në Shtërpce, Brezovicë, Sevce, Delloc, Gornje Sello, Mushnikovë, Reçan, Brezne, Pllajnik, Restelicë dhe Brod (komuna e Sharrit);

S6.O3. Sigurimi i transportit të skiatorëve deri tek pikat nga të cilat e fillojnë lëshimin

Arritja e këtij objektivi do të thotë mundësi më shumë për skijim, nivel më i lartë i turizmit rekreativ dimëror, më shumë të ardhura. Aktivitetet e nevojshme që duhet të ndërmerren në mënyrë që ky transport të sigurohet janë:

- Aktivizimi i teleferikëve dhe ski liftave ekzistues që janë jashtë funksionit dhe ndërtimi i të rinjve në qendren turistike ne Brezovicë sipas planeve te miratuara ne kuadër të projektit të partneritetit publiko privat "Projekti për Zhvillimin e Qendrës Turistike Brezovica";

4.3.2. Infrastruktura e energjetikës

S6.O4. Sigurimi i furnizimit të rregullt të parkut kombëtar dhe të vendbanimeve rreth tij me energji elektrike

Arritja e këtij objektivi është në funksion të zhvillimit të infrastrukturës së energjetikës, e cila konsiston në aktivitetet si në vazhdim:

- Realizimi i një studimi me parashikimin për sasinë e energjisë elektrike të nevojshme për furnizimin e parkut dhe të vendbanimeve rreth tij për 10 vjetët e ardhshme; burimet alternative të energjisë.
- Realizimi i një studimi për levërdinë e ndërtimit të minihidrocentraleve në lumenjtë Lepenc, Lumbardhi i Prizrenit, Restelicë dhe Brod (komuna e Sharrit);
- Ndërtimi i minihidrocentraleve të lartpërmendur;
- Rekonstruktimi i trafove ekzistues;
- Vendosja-instalimi i trafove të rinj;
- Rekonstruktimi i largpërçuesve që vijnë në park nga Prizreni dhe Ferizaj;

4.3.3. Infrastruktura ujore

S6.O5. Zhvillimi i sistemit publik të ujësjellësit dhe kanalizimit në park dhe në vendbanimet rreth tij

Arritja e këtij objektivi do të përmirësojë kualitetin e jetës dhe mundësojë zhvillimet e ardhshme turistike në park. Këto aktivitete janë:

- Realizimi i studimit për sasinë e ujit të pijshëm të nevojshëm për furnizimin e parkut dhe të vendbanimeve rreth tij gjatë 10 vjetëve të ardhshëm; kanalizimit të ujrave të zeza në park dhe vendbanimet rreth tij;
- Realizimi i studimit për burimet e ujrave nëntokësor që figurojnë në librin e kadastrit (libri i ka të dhënat për këto burime), në mënyrë që të konstatohet se cilat nga këto burime do të mund të shfrytëzoheshin për furnizimin e parkut dhe të vendbanimeve rreth tij me ujë të pijshëm; Hulumtimi i burimeve të reja të ujrave nëntokësor;
- Realizimi i studimit të arësyeshmërisë për krijimin e liqeneve në Semajë, Brod (komuna e Shtërpces) dhe Reçan që do të furnizonin me ujë të pijshëm kapacitetet e parkut kombëtar dhe vendbanimet rreth parkut;
- Ndërtimi i sistemeve publik qendror të ujësjellësve dhe kanalizimeve me kapacitet në bazë të parashikimit nga studimi i lartpërmendur që do të furnizonin me ujë të pijshëm kapacitetet (përmbajtjet) e parkut kombëtar por edhe vendbanimet rreth tij nga burimet e ujërave nëntokësor apo nga liqenet artificial të krijuar;
- Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujërave të zeza dhe i kolektorëve që mbledhin ujërat e zeza dhe i dërgojnë deri tek impianti

4.3.4. Telekomunikacioni

S6.O6. Zhvillimi i postës dhe telekomunikacionit në parkun kombëtar dhe në vendbanimet rreth tij

Arritja e këtij objektivi do të avansojë infrastrukturën teknike, përmes aktiviteteve në vazhdim:

- Mbulimi i tërë hapësirës së parkut dhe të vendbanimeve rreth tij me valët e telefonisë mobile;
- Vendosja e antenave nga operatori i telefonisë mobile në vendet e çveshura nga pyjet, jashtë rezervateve strikte natyrore;
- Monitorimi në vendosjen e antenave të telefonisë mobile;
- Lidhja e objekteve banimore dhe publike në parkun kombëtar në rrjetin e telefonisë fikse dhe në Internet.
- Vendosja e punkteve postare në të gjitha qendrat rekreative, rehabilituese të parkut dhe në vendbanimet përreth parkut.

4.3.5. Infrastruktura për menaxhimin e mbeturinave


S6.O7. Menaxhimi efikas i mbeturinave

Me këtë objektiv tentohet të arrihet plotësimi i nevojave të përgjithshme të shërbimeve në ngritjen e kualitetit të jetës në radhë të parë si dhe të cilësisë së ofertës turistike.


Ky objektiv është paraparë të arrihet përmes masave dhe projekteve/aktiviteteve:

- Caktimi i përgjegjësisë për mbledhjen e mbeturinave kompanisë-ve për shërbime publike,
- Organizim për grumbullimin e mbeturinave të forta, vendosja e shportave të mbeturinave në pika të caktuara në park dhe në vendbanimet rreth tij
- Ndërtimi i deponisë së mbeturinave në lokacionin e caktuar jashtë parkut kombëtar;
- Caktimi i gjobave për mosrespektim të rregullores për hudhje të mbeturinave në vende të caktuara.

Në Shtoja 3 në mënyrë të detajuar janë paraqitur të gjitha aktivitet që duhet të ndërmerrën për arritjen e kësaj strategjie.



▶ Harta: Strategjia e zhvillimit të infrastrukturës



▶ Harta Strategjia e zhvillimit të përgjithshëm

Lista e projekteve prioritare për Parkun Kombëtar "Sharri"						
	Projektet/ aktivitetet	**Akteret vendimmarres**	**Përgjegjësit për hartim dhe zbatim**	**Burimi financiar**	**Afati kohor**	**Çmimi në Euro**
1	Hartimi i Udhëzimit Administrativ për Normat, Standardet dhe Rregulloret brenda Parkut Kombëtar Sharri"	MMPH	DMM, DP, Inspektorët	BKK	2013	5,000
2	Hartimi i Planit Menaxhues të Parkut Kombëtar "Sharri"	MMPH	DMM, DP	BKK, donatorët	2014	1,800,000
3	Vendosja e tabelave informative orjentuese	MMPH	DP	BKK, donatorët	2013	15,000
4	Vendosja e pikave kontrolluese hyrje - dalje në Parkun Kombëtar "Sharri"	MMPH/DP	MMPH /KK	BKK, donatorët	2013	50,000
5	Ndërtimi i Zyrës Qendrore të Autoritetit të Parkut Kombëtar "Sharri" në Prevallë; organizimi i 4 njësive të tjera komunale	MMPH/DP	DP, DMM, kuvendet komunale	BKK, donatorët	2014	150,000
6	Furnizimi i rojeve të PK "Sharri" me paisje për vëzhgim, telekomunikim, mbrojtje dhe lëvizje	MMPH	DP	BKK, donatorët	Në vazhdimësi	30,000
7	Hartimi i PRRU - Qendra Turistike "Brezovicë"/Shtërpce	MMPH, KK Shtërpce	DP, KK Shtërpce	BKK donatorët	2014	50,000
8	Hartimi I PRRU - Qendra Turistke "Prevallë"/Prizren	MMPH, KK Prizren	DP, KK Prizren	BKK	2014	50,000
					Totali	**2,150,000**

V DISPOZITAT PËR ZBATIM



5. Dispozitat për zbatim

5.1. Dispozitat e përgjithshme

Me Planin Hapësinor të Parkut Kombëtar „Sharri" (në tekstin e mëtejmë: Plani) definohen: caqet e rregullimit (planifikimit) të territorit (hapësirës), organizimi dhe destinimi i hapësirës (territorit), kushtet dhe masat e shfrytëzimit, rregullimit dhe mbrojtjes së parkut.

- Plani Hapësinor për PK „Sharri" mbulon periudhën kohore prej minimum dhjetë viteve nga aprovimi përfundimtarë në Kuvendin e Kosovës
- Rishikimi i Planit bëhet në cdo pesë vjet por mund të bëhet edhe në bazë të kërkesave për ndryshime në terren.
- Përgjegjës për revidimin e Planit është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
- Plani është përpunuar në pajtim me konventat dhe parimet ndërkombëtare për planifikim dhe mbrojtje të mjedisit.
- Plani është përpunuar në përputhje me Ligjin për Planifikim Hapësinor dhe Ligjin për Mbrojtje të Natyrës.
- Me dispozitat për zbatim të planit definohen mënyra e rregullimit dhe destinimit të hapësirës dhe regjimit të mbrojtjes, ndërtimit dhe rregullimit në territorin (sipërfaqen) e parkut.
- Në pajtim me ligjet në fuqi, kushtet dhe kriteret e ndërtimit dhe shfrytëzimit të parcelave që ndodhen brenda zonës së tretë të parkut mund të përcaktohen edhe në kuadër të procesit të partneritetit publiko privat për ndërtimin dhe zhvillimin e qendrave turistike në zonën e tretë.
- Të gjitha planet tjera të nivelieve më të ulta me ndikim në territorin e parkut, i nënshtrihen Planit Hapësinor për PK „Sharri".

5.2. Masat për aplikimin e planit

- Institucioni publik „Drejtoria e Parkut Kombëtar „Sharri" (në vazhdim: drejtoria e parkut), menaxhon me territorin e parkut.
- Drejtoria e parkut, në kuadër të veprimtarisë së vet stimulon (nxitë) krijimin e përmbajtjeve natyrore-shkencore, kolekcioneve etnografike, kopshtit botanik, nxitë hulumtimet shkencore dhe udhëheq punën edukative-

arsimore me të rinjë gjatë ekskurzioneve të prirë nga ekspertë profesional.

- Drejtoria e parkut, nxitë apo stimulon revitalizimin e vendbanimeve rurale dhe ndihmon kyqjen e banorëve autokton në ofertat e nduarnduarta turistike të parkut, në pajtim me orientimet e këtij Plani.
- Drejtoria e parkut në përkujdesje ndaj mbrojtjes dhe mirëmbajtjes së parkut mban dokumentet (kronikën) e parkut e cila përmban kryesisht të dhëna mbi faktorët natyrorë, llojin dhe vëllimin e punimeve në park, gjendjen dhe ndryshimet në florë dhe faunë, qarkullimin pikniko – turistik, organizimin dhe drejtimin e faktorëve tjerë domethënës për parkun.
- Planet Zhvillimore të komunave pjesëmarrëse (Prizren, Suharekë, Shtërpcë, Kaçanik dhe Dragash) duhet të përshtaten me këtë Plan.

5.3. Rregullimi i hapësirës

Me plan definohen caqet dhe detyrat për mbrojtje dhe rregullim të parkut dhe ate:

- në ruajtje të karakteristikave natyrore dhe balancit të ekosistemeve pyjore dhe veçorive hidrologjike në formën burimore ose të hasur (takuar),
- në të mundësuarit e shfrytëzimit të hapësirës së parkut për qëllime shkencore, edukative-arsimore, kulturore dhe rekreative – turistike,
- në të mundësuarit e ruajtjes dhe revitalizimit të vendbanimeve rurale.

5.4. Rezhimi i mbrojtjes, ndërtimit dhe rregullimit të hapësirës

- Në zonën e parë të mbrojtjes nuk lejohet të bëhet kurrfarë intervenimi nga njeriu.
- Në park ndalohen çfarëdo ndryshimesh në kundërshtim me këtë plan, ndryshime që prekin bashkësitë e pyjeve, majat e maleve dhe ujërrjedhat.
- Duhet të largohen trungjet e rrëzuar me qëllim të aftësimit të shtigjeve të këmbësorëve.
- Në afërsi të rrugëve automobilistike, mund të lejohet rritja e pyjeve dhe largimi i trungjeve për shkaqe estetike dhe peisazhore dhe për shkaqe sigurie të mbrojtjes së pyjeve.
- Kositja e livadheve është e obliguar në disa sipërfaqe, për shkak të mbrojtjes së livadheve me florë dhe vegjetacion specifik dhe për shkak të mundësisë së të ushqyerit të kafshëve të egra. Mënyra dhe rezhimi i kositjes do të specifikohet me plan menaxhues të parkut.
- Në afërsi të zonës së parë të mbrojtjes (rezervateve strikte) është i ndaluar çfarëdo ndërtimi përveç: rrugëve, shtigjeve, tabelave informative dhe strehimet për vizitorë.
- Shtëpitë e malorëve duhet të ruhen, mund të adaptohen apo edhe rekonstruktohen atëherë kur ato nevojiten të kryhen, gjegjësisht ridestinim i objektit.
- Zona e dytë dhe e tretë e mbrojtjes, janë zona me regjime të ndryshme të mbrojtjes. Diferencat e rezhimit të mbrojtjes brenda parkut, nga ato më rigorozet deri te ato më të lirat do t'a përcjellin këtë llojllojshmëri, ndërkaq rregullimi i tërësishëm i hapësirës do të arrihet, organizohet dhe formohet në atë mënyrë që të mos rrezikohet natyra dhe themelet e vlerave të saja.
- Në zonën e dytë dhe të tretë të mbrojtjes është e lejuar prerja sanitare e pyjeve. Duhet pasur kujdes në pjesët ku është i shprehur orteku në masë më të madhe.
- Banimi në park dhe VB jashtë parkut kanë regjim më të lirë të mbrojtjes që mundëson mbrojtjen dhe revitalizimin e tyre në raport me destinimin e hapësirës (bujqësi tradicionale, turizëm fshatar).
- Ndërtimi në VB, të cilat është paraparë dhe planifikuar të jenë fshatra turistik, pra me rëndësi të veçantë, përcillet në pajtueshmëri me kahjet e Planit për ndërtim.
- Në zonat e ndërtimit në park, lejohet përveç rekonstruimit të objekteve të banimit ekzistues edhe ndërtimi i objekteve të reja në pajtim me kahjet e zhvillimit të planit rregullativ të zonave të parapara për ndërtim.
- Nuk është i lejuar asnjë ndërtim i objekteve me karaktere të ndryshme, përveç atyre të cilat janë të parapara me Plan.

- VB përreth parkut duhet përmbajtur karakterit ekzistues, me përmbajtje të fshatit turistik.
- Duhet të parashihet vizitë e kufizuar në rezervatin strikt të Rusenicës, me qëllim të ruajtjes së qetësisë së Rrëqebullit si pjesë kryesore e rezervatit, e cila do të specifikohet me plan menaxhues të parkut.
- Burimet ujore mbrohen me masat për vizita të kufizuara, në pajtueshmëri me kompetentët e parkut.
- Me qëllim të kryerjes së funksionit të tyre, rrugët në park duhet të ruhen dhe kur është e nevojshme, të riparohen
- Shtigjet e malorëve janë me dimensione të ndryshme (0.8-1.5m').
- Të gjitha komunikimet e këmbësorëve rregullohen dhe shënohen në mënyrë të veçantë mvarësisht nga destinimi i tij.
- Në zonën e tretë mbrojtëse mund të ndërtohen objektet e infrastrukturës turistike: rrugët, shtigjet, shenjat informuese, kiosqet informuese, strehim për vizitorë, objektet e vogla shërbyese dhe hapësirat për piknik.
- Rregullimi i pyjeve duhet të jetë në pajtueshmëri me legjislacionin adekuat Ligji për pyje, Ligji për mbrojtjen e natyrës, Ligji për mbrojtjen e mjedisit dhe me planin menaxhues të parkut.
- Programi i mbrojtjes dhe përparimit të pyjeve duhet të jenë në pajtueshmëri me kriteret e menaxhimit të parkut.
- Në pronat private të parkut të cilat janë të mbuluara me pyje, janë të lejuara prerjet sanitare (për ngrohje dhe ndërtim) pra për nevojat e banorëve të atyre pronave.
- Në zonën e parkut mbrohen të gjitha llojet e kafshëve.
- Në zonën e parkut mbrohen të gjitha bimët autoktone e veçanërisht llojet endemike të saj.
- Të gjitha punët elektrodistributive, rrjetit të telefonisë, ujësjellësit dhe kanalizimit, duhet të vendosen nëntokë, përgjatë trasesë së rrugëve.
- Burimet të cilat shfrytëzohen për ujësjellës lokal, mbrohen me masa për shfrytëzim të kufizuar të tyre.
- Mbrojtja e tokës nga ndotja prej ujërave të zeza nga derdhjet lokale, mbrohen me një kontrrollë të vazhdueshme dhe sanim në pajtim me normat ekologjike pozitive.

5.5. Rezhimi i shfrytëzimit të hapësirës

- Në zonën e parkut ndalohet çfarëdo eksploatimi ekonomik natyror, derisa lejohet vetëm përjetimi i perceptimit të tërësisë natyrore dhe për qëllime shkencore, edukative dhe turistike e rekreative.
- Në VB rurale në mënyrë të veçantë u lejohet përtrirja e banimit fshatar tradicional duke e përfshirë eko-turizmin.
- Në parkun kombëtar ndalohen të gjitha aktivitetet e gjuetisë.
- Peshkimi është rreptësishtë i ndaluar në Lumbardhin e Prizrenit dhe në lumin Lepenc.
- Në park janë të ndaluara aktivitetet e vjeljes së bimëve e sidomos atyre që kanë karakter endemik.

5.6. Planifikimi dhe banimi

- Komunat obligohen të hartojnë planet rregulluese urbane për vendbanimet në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri", dhe para aprovimit të tyre duhet të marrin pëlqimin nga MMPH.
- Në rastet kur ekzistojnë planet rregulluese urbane për vendbanimet brenda parkut (qendra skitare e Brezovicës, Prevalla), duhet të bëhet rishikimi/revidimi i tyre duke u bazuar në PH të Parkut Kombëtar "Sharri" dhe para aprovimit të marrin pëlqimin nga MMPH, përderisa për lokalitetet e planifikuara për zhvillim (Maqurishtë, Delloc - S.Rekë, Gurri i Zi – Dragash, Ahishtë-Kaçanik Brezovicë - Shtërpc), duhet të hartohen planet rregulluese urbane bazuar në PH të Parkut Kombëtar "Sharri".
- Për fshatrat përreth parkut të parapara për zhvillim të turizmit fshatar, komunat gjegjëse obligohen të hartojnë plane rregulluese urbane.

- Vetëm volumi i objektit është në pronësi të shfrytëzuesit, e tëra përreth është hapësirë e parkut,
- Nuk lejohet ndërtimi i rrethojave për përkufizimin e parcelës,
- Në zonën e parkut nuk është i lejuar ndërtimi i objekteve të reja të banimit përpos në zonën e paraparë për ndërtim në kuadër të vendbanimeve (Brezovicë - Shtërpce, Prevallë - Prizren, Maqurishtë, Delloc - Suharekë, Guri i Zi – Dragash, Ahishtë - Kaçanik).
- Dizajni i kompleksëve turistike –hotele apo fshatra turistik, duhet t'i përshtatet pejsazhit natyror –rrethues.
- Për projekte si psh. ski liftet, teleferikët, fshatrat turistik dhe komplekset e hoteleve, investitori duhet ta bëjë raportin e VNM-së (Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis). Ky raport duhet t'i nënshtrohet procesit të konsultimit publik.
- Për dhënien e lejeve për shfrytëzim të lokacionit, duhet paraprakisht të punohet projekti ideor për tërë parcelën (shtëpinë e banimit, objektet ndihmëse, planin dhe mënyrën e gjelbërimit).
- Pjesë integrale e dokumentacionit është edhe incizimi gjeodezik për arsye të konfirmimit të gjendjes fillestare të saktë, vendndodhjes dhe madhësisë së parcelës dhe objekteve në të. Rekomandohet përpjesa e incizimit kadastral gjeodezik 1:200 deri 1:1000.
- Ndërtimi zbatohet bazuar në dispozitat tekstuale dhe grafike të këtij plani hapësinor dhe planit rregullues urban.
- Në kuadër të zonës së planifikuar për ndërtime, në vendbanime në park dhe përreth parkut, planifikohet ndërtimi i objekteve për banim të përzier (banim, turizmi fshatar, tregtia etj) dhe bujtinave individuale me qëllim të turizmit fshatar sipas kritereve:
- Ngastra ndërtimore apo parcela nuk guxon të jetë më e madhe se 500m^2.
- Sipërfaqja e ndërtuar e parcelës duhet të jet 20% nga sipërfaqja e përgjithshme e ngastres.
- Lartësia maksimale e objekteve P+1 (Përdhesa+kati) apo Su+P (suteren plus përdhesa).
- Në vendbanime, në rastet e rindërtimit nuk lejohet ndryshimi i gabariteve në kundërshtim me planin rregullues urban.
- Lejohet përdorimi i materieleve të gurit, drurit dhe tullave.
- Kulmi është dyujorësh, më ramje prej 30 - 60 shkallë, me strehë të mbështjellur me dërrasa, shindër apo ndonjë material modern nga të gjitha anët.
- Në infrastrukturën ekzistuese të ujësjellësit është i mundur rekonstruimi.
- Largimi i ujërave të zeza zgjidhet individualisht për çdo objekt me gropa septike të padepërtueshme nga ujërat apo me kanalizim lokal me pastrimin biologjik.
- Lokacionet e përmbajtjeve turistike duhet të jenë larg zonave strikte të mbrojtjes me qasje të planifikuar dhe kontrolluar në aspekt të tejkalimit të kapaciteteve dhe dëmtimeve të mjedisit.
- Lokacioni i kompleksëve turistike nuk duhet të jetë në zona ku shërbimet themelore të infrastrukturës (furnizimi me ujë dhe kanalizimi, largimi i mbeturinave, furnizimi me energji, telekomunikimet dhe infrastruktura tjetër e nevojshme), janë në një largësi të madhe.
- Në zonën e shkallës së dytë të mbrojtjes, mund të ndërtohen objekte të infrastrukturës turistike: rrugët, shtigjet, shenjëzimet, kiosqet për informim, strehimore për turistët, objekte te vogla të shërbimeve: tregti, hotelieri dhe hapësira për piknik.
- Në vendbanimet përreth parkut mund të rekonstruohen dhe zëvendësohen në kuptim të përmirësimit të kushteve të jetës dhe të punës, sikurse që janë ripërtërirja e amvisnive fshatare, të bujqësisë tradicionale për involvim në turizëm fshatar.
- Rekonstruimi i objekteve individuale dhe të amvisnisë, duhet të nënshtrohen dispozitave të njëjta si të ndërtimeve të reja.
- Në kontekst të rekonstruimit të objekteve ekzistuese të banimit dhe të amvisnisë, është i mundur shndërrimi i destinimit në funksion të parkut kombëtar dhe/ose për nevoja të turizimit fshatar. Objektet ekzistuese mund të

rekonstruohen dhe zëvendësohen në pajtim me normat e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, të cilat nënkuptojnë përdorimin e materialeve dhe formësimit të hapësirave në mënyrë tradicionale autoktone duke ruajtur pejzazhet burimore.

- Me rekonstruim sipas dispozitave nënkuptohet: Rindërtim i objektit të banimit; Rindërtimi i objektit të shtallës, Rindërtimi i pjesës konstruktive të vjetër të objektit; Adaptimi dhe rindërtimi i hapësirave sanitare; Ndërtimi i gropës septike të padepërtueshme; Riorganizim funksional i brendshëm i objektit të banimit; Riorganizim funksional i pjesëve ndihmëse të objektit të banimit, amvisnisë,
- Ndërtimi i shtallave dhe objekteve/vendndalesa apo strehë për vizitorë lejohet përdorimi i konstrukcioneve mbajtëse dhe kulmit nga druri, dërrasat dhe kulmit të mbuluar me shindër.
- Në zonën e planifikuar për ndërtime të vendbanimit nuk lejohet objekteve shumëkatëshe. Lejohet vetëm ndërtimi i objekteve individuale në disa raste edhe të objekteve dyshe.
- Objektet e reja duhet të jenë të projektuara në pajtueshmëri me traditën, me përdorimin e dimensioneve dhe përdorimit të materieleve tradicionale.
- Objektet në parim duhet të ndërtohen me kulme dyujore dhe vetëm për objekte publike shumë ujorëshe.
- Në ngastrat ndërtimore përskaj objekteve të banimit mund të ndërtohen objekte përcjellëse (garazha, kthina për drurë, kuzhina verore, kthina ndihmëse për vegla dhe përgatitje bulmeti, shtalla, kotec etj.)
- Furnizimi me ujë të pijshëm bëhet përmes ujësjellësit lokal, të cilës i lejohet rekonstruimi.
- Ujërat e zeza kolektohen veçmas për çdo objekt, përmes gropave septike të padepërtueshme apo me kanalizim lokal me trajtim/pastrim biologjik.

5.7. Objektet publike

- Të gjitha objektet publike mund të rekonstruohen në gabaritin dhe formën arkitektonike ekzistuese, bazuar në projektin ideor të hartuar dhe të aprovuar.
- Për objekte hotelerike (Breza, Narcis, Molika, Lahor), pushimoret (e Pensionistëve, e Pinonierëve, e Ish Sigurimit, Elektrokosovës, Shkollës së skijimit, Ekonomisë së Gjuetisë, Shtëpia e Gurit) nevojiten impiante specifike për ujërat e zeza të cilat do të lëshohen më pastaj në natyrë të pastruara në mënyrë biologjike.

5.8. Hapësirat e lira

- Çdo intervenim në dëm të natyrës, pejzazhit, rrjedhës së lumit, shfrytëzimit të burimti të ujit, do të ndëshkohet sipas dispozitave të Planit Menaxhues për Parkun Kombëtar „Sharri" dhe deri atëherë sipas „Vendimit të MMPH për keqpërdoruesit e resurseve natyrore të parkut".
- Rrugët, rrugicat dhe shtigjet mund të rekonstruohen duke respektuar veçoritë pejzazhore dhe reljefore të terrenit, të cilat janë ekskluzivisht për kryerjen e funskioneve themelore të parkut. Tek rekonstruimet rrugore duhet të preferohen sipas nevojës mure mbrojtëse. Shtresa përfundimtare duhet të jetë në materiale natyrore dhe vetëm në raste të posaçme me shtresë të asfaltit.
- Për arsye estetike-pejzazhore dhe arsye të sigurisë, mbrojtjes së pyjeve, përskaj qarkullimeve rrugore caktohet shiriti mbrojtës prej 30m nga të dy anët në të cilat mund të kryhen punët e kultivimit pyjor në të cilën hiqen drurët e sëmurë.
- Tek rekonstruimet e shtigjeve brenda parkut duhet të i'u përmbahemi mënyrës tradicionale të punës së shtigjeve, sikurse edhe përshtatjes për mbrojtjen e vlerave dhe karakterit burimor të pejzazhit natyror.
- Të gjitha shtigjet duhet të jenë të shënuara në mënyrë funksionale me informata dhe shenja.
- Në vendet e rrezikuara të gjitha shtigjet duhet të jenë të siguruara.

- Vendlokimi për pikniqe lejohet vetëm në vendet e përcaktuara për këtë qëllim.
- Në vend pikniqet lejohet vendosja e bankave dhe tavolinave nga druri i gdhendur.
- Pas çdo ndërtimi duhet të rregullohet rrethina, mbjellja dhe kultivimi i gjelbërimit, bazuar në pejzazhin autokton.
- Përmbajtjet turistike duhet të plotësohen me pyrgje të mbikqyrjes, tabela informuese, shtigje dhe përmbajtje të tjera në lidhje me mbrojtjen e botës bimore dhe shtazore – biodiversitetin ekzistues.

5.9. Dispozita për rregullimin e kampeve

Me këto dispozita përshkruhet rregullimi i kampeve me kushtet dhe shërbimet e nevojshme.

Kampet janë bashkësi funksionale të rregulluara, të vendosura sipas Planit Hapësinor të PK "Sharri" në vendbanime turistike dhe qendra turistike, të cilat ofrojnë kushte për vendosje të mysafirëve në hapësirat e jashtme me autoshtëpiza dhe tenda, duke plotësuar nevojat elementare dhe shërbimet tjera për pushim dhe rekreim.

Vend-kampingu është hapësirë në të cilën parcelat mund të dimensionohen si të veçanta dhe të grupuara. Çdo parcelë duhet të ketë qasje direkte në rrjetën e furnizimit të paktën me energji elektrike e në disa raste edhe me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimt.

- Hapësira e nevojshme për organizimin e kampingut mund të përfshijë 10% të sipërfaqes së planifikuar për zhvillim (zona e tretë);
- Për një njësi parcele në kamp duhet sigurohet minimum 60m²;
- Shërbime tjera përcjellëse: ndriçimi i vendit të kampit, sanitariet e përbashkëta me garderoba, gropa septike për ujrat e zeza, hapësirat higjienike (për pastrimin e rrobave, enëve, etj), depo ushqimore, depo për rekuizita tavolina, karriga, shtretër mobilë dhe rekuizita sportive); hapësirat rekreative të hapura ose të mbyllura (fushë tenisi, pishinë, futboll, volejboll, basketboll, ping-pong, etj).
- Hapësirat (ndërtesat) përcjellëse të kampit duhet të jenë njëkatëshe dhe më kulme dy ujore, me lartësi 4,5m´ nga pika më e ulët e terrenit (prej kuotës më të ulët deri te maja e kulmit); Është i obligueshëm përdorimi i materialeve natyrore (guri, druri,) dhe përshtatja me konfiguracion të terrenit, duke i ruajtur vlerat e pejsazhit të zonës;
- Recepcioni duhet të jetë në brendi të kampit /ose para hyrjes në kamp, me shërbime përcjellëse për komunikim, marketing. Në kamp mund të parashihen edhe objekte tjera të shërbimeve të ndryshme (tregtare, furnizuese dhe shërbyese restorane, nevoja të tjera të domosdoshme, si; njësi postale, bankomat, etj)
- Kampet duhet të kenë rrethoja të sigurta dhe natyrale; Kampet duhet të kenë qasje në infrastrukturë të jashtme rrugore dhe në afërsi të recepcionit (brenda ose jashtë kampit) të kenë parkingun.
- Rrugët brenda kampit duhet të mundësojnë qasjen e automjeteve dhe këmbësorëve deri te njësia e vendparkimit. Rruga kryesore lidh të gjitha rrugët anësore në drejtim të recepcionit dhe me infrastrukturën jashtë kampit;
- Furnizimi me ujë dhe kujdesi për largimin e ujërave të zeza.- Kampet duhet të jenë të furnizuara me ujë të pijshëm; të furnizuar nga rrjeti publik ose ndonjë burim tjetër i kontrolluar. Largimi i ujrave të zeza duhet të sigurohet me sistem të mbyllur jashtë zonës në pajtueshmëri me norma dhe standarde për parqe nacionale. Grumbullimi dhe largimi mbeturinave duhet të bëhet rregullisht nga hapësirat e kampit.
- Furnizimi me energji elektrike. - Kampet duhet të kenë kyqje në rrjetin publik ose burim tjetër alternativ për energji elektrike. Rrugët kryesore si dhe rrugët tjera të cilat çojnë te restorani, përmbajtjet e objekteve shërbyese dhe sanitare duhet të jenë të ndriçuara;
- Sigurimi i ngrohjes.- Ngrohja është e obligueshme: në recepcion, hapësira sanitare dhe në hapësirat në të cilat qëndrojnë mysafirët (brenda afatit tetor – maj).

- Lidhjet telefonike dhe interneti - Kampet duhet të jenë të lidhura në rrjetin telefonik dhe të telefonisë mobile si dhe lidhja e internetit.
- Sigurimi i kampit - Kampi duhet të përmbajë shenjat orientuese për hyrje-dalje nga kampi në raste të rrezikut; Në kampe duhet të sigurohen mjetet për dhënien e ndihmës së parë; Kampet duhet të kenë dalje ndihmëse në rastë rreziku.
- Hapësirat sanitare në kampe të përbashkëta - janë hapësirat për higjienë personale të musafirëve si hapësira të përbashkëta, në të cilat vendosen elemente sanitare dhe njësitë e tyre:
- Sanitariet për femra - parahyrja, duarlarëse me pasqyra, toalete me duarlarës, garderoba me kaseta personale dhe tush-kabina;
- Sanitariet për meshkuj. - parahyrja, pisoarët, duarlarës me pasqyra, toaletet me duarlarës, garderoba me kaseta personale dhe tush-kabinat;
- Sanitariet për fëmijë, me dimensionime adekuate. – parahyrja, duarlarës, toaletet, hapësirat e garderobës dhe banjot me tush apo vaskë;
- Sanitariet për prsona me aftësi të kufizuara, me qasje të lehtë sipas dimensioneve të standardizuara dhe paisjeve të nevojshme. – duarlarës me pasqyrë, toaleti dhe tush-kabina.
- Njësitë e veçanta të përbashkëta – hapësirat për larjen e enëve, hapësirat e ftohta për ruajtjen e ushqimit dhe frigoriferët, utiliti i përbashkët (larja, tharja dhe hekurosja e rrobave), hapësirat për higjienë të kafshëve shtëpiake.

5.10. Infrastruktura

Kushtet për përcaktimin e rrjetit të sipërfaqeve të korridoreve, traseve telekomunikuese, rrjetit të infrastrukturës së energjetikës dhe rrjetit të infrastrukturës ujore

- Gjërësia e shtigjeve për këmbësorë në Park duhet të jetë maksimum 1.5 metra;
- Shtigjet për këmbësorë duhet të ndërtohen me gurë;
- Në vendet e duhura përgjatë shtigjeve për këmbësorë, duhet të vendosen tabelat me informatat e nevojshme për vizitorët;
- Ndalohet çfardo ndërtimi në sipërfaqet në të cilat ky plan hapësinor e parasheh ndërtimin e rrugëve të reja automobilistike(regjionale dhe lokale) dhe në sipërfaqet e brezave mbrojtës të këtyre rrugëve;
- Ndalohet çfardo ndërtimi në sipërfaqet e brezave mbrojtës të rrugëve ekzistuese(regjionale dhe lokale) brenda në park dhe në vendbanimet përreth tij;
- Brezi mbrojtës rrugor paraqet sipërfaqen në të dy anët e rrugës regjionale dhe lokale. Gjërësia e këtij brezi në rrugët regjionale dhe lokale të parkut kombëtar duhet të jetë minimum 10 m' në njërën anë dhe 10 m' në anën tjetër të rrugës;
- Ministria e Infrastrukturës (MI) është kompetente për rrugët regjionale, prandaj ndërtimi i këtyre rrugëve realizohet me lejen dhe nën mbikqyrjen e kësaj ministrie;
- Qeveritë komunale janë kompetente për rrugët lokale në territoret e komunave të tyre, prandaj ndërtimi i këtyre rrugëve realizohet nën mbikqyrjen e organeve kompetente komunale;
- Gjatë ndërtimit të rrugëve regjionale dhe lokale duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike (gjërësia, pjerrtësia, shtresat dhe trashësia e tyre) për ndërtimin e tyre, rregulla të cilat i ka nxjerrë MI. Gjatë ndërtimit të hekurudhës së elektrifikuar, poashtu duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike për ndërtimin e saj;

- Përgjatë rrugëve regjionale dhe lokale të Parkut dhe të vendbanimeve përreth tij duhet të vendosen të gjitha shenjat e nevojshme të komunikacionit;
- Për çdo qasje me rrugë nga lokacionet ku do të ketë ndërtime me dedikim të caktuar, në rrugët regjionale, duhet të merret leja nga MI;
- Peshat dhe dimensionet e automjeteve që qarkullojnë nëpër rrugët regjionale dhe lokale të Parkut, duhet të jenë në pajtueshmëri me rregullat e veçanta lidhur me këtë që i ka nxjerrë MI;
- Qarkullimi i automjeteve për transportin e mallrave në rrugët regjionale dhe lokale të parkut duhet të jetë nën monitorimin e pandërprerë të organeve të parkut në mënyrë që të parandalohet transporti eventual i masës drusore dhe produkteve të tjera të parkut që janë marrë ilegalisht;
- Transportin e udhëtarëve deri tek lokacionet e ndryshme brenda parkut, pastaj transportin tranzit nëpër park dhe atë deri tek vendbanimet përreth, mund ta bëjnë vetëm operatorët e liçencuar të transportit. Liçencimi bëhet nga MI;
- Në mënyrë që transporti i udhëtarëve të jetë sa më i sigurtë, automjetet transportues që i posedon operatori i transportit, duhet t'i plotësojnë të gjitha kushtet teknike që i ka përcaktuar MI;
- Gjatë ndërtimit të parkingjeve duhet të respektohen rregullat mbi kriteret teknike për ndërtimin e tyre, rregulla të cilat i ka nxjerrë MI;
- Numrin e parkingjeve dhe vendin e tyre të saktë në hapësirë e përcakton plani rregullativ për zonën e caktuar. Në vazhdim janë dhënë disa standarde për numrin e nevojshëm të parkingjeve:
- Shërbime – 1 vendparkim(VP) për 3 të punësuar;
- Restorante – 1 VP për 1 tavolinë;
- Hotele – 1 VP për 1 dhomë;
- Zyre – 1 VP në 75m² btto zone;
- Dyqane – 1 VP në 50m² btto zone Gjatë projektimit, ndërtimit dhe vënjes në shfrytëzim të teleferikëve duhet që respektivisht të zbatohen dhe të plotësohen në tërësi rregullat teknike për teleferikë dhe kërkesat që gjenden në udhëzimin administrativ të nxjerrë nga ministri i Ministrisë së Tregëtisë dhe Industrisë;
- Ekipet profesionale që do t'i realizojnë studimet dhe hulumtimet të cilat janë paraparë me strategjinë për zhvillimin e infrastrukturës teknike duhet t'i plotësojnë kushtet:
- Të kenë përgatitjet adekuate profesionale(shkollimi adekuat);
- Të kenë përvojë në studime të natyrës së njëjtë nga e kaluara
- Nuk mund të fillojë ndërtimi i asnjë minihidrocentrali pa patur paraprakisht studimin me të cilin do të: arsyetohet ai ndërtim, argumentohet se ndërtimi i tij është i levërdishëm dhe caktohen lokacionet e sakta të ndërtimit;
- Ndërtimi i kapaciteteve të reja prodhuese - minihidrocentraleve duhet të bazohet në procedurat e autorizimit ose procedurat e tenderimit, pas të cilave ndërmarrja e energjisë, fituese e tenderit, do të pajiset nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me lejen e ndërtimit dhe me liçencën që nevojitet për kryerjen e aktivitetit, pra prodhimit të energjisë elektrike;
- Ndërtimi i pendës për formimin e liqenit nuk mund të fillojë pa patur paraprakisht studimin me të cilin do të: arsyetohet ai ndërtim, argumentohet se ndërtimi i tij është i levërdishëm dhe caktohen lokacionet e ndërtimit;
- Për ndërtimin e pendës së lartpërmendur në territorin e një komune, duhet të merret leja nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor;
- Pendat projektohen, ndërtohen dhe shfrytëzohen sipas dokumentacionit të paraparë teknik, të hartuar në pajtim me aktin nënligjor të cilin e nxjerrë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor(MMPH);
- Nëse studimi e arsyeton ndërtimin e pendës, lokacioni ku do të formohej liqeni, duhet të ruhet për këtë qëllim që do të thotë se duhet të ndalohet çfardo ndërtimi në të;



- Për ndërtimin e sistemeve publike të ujësjellësve dhe kanalizimeve të ujrave të zeza, duhet të merret leja nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor;
- Për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujrave të zeza dhe të kolektorëve që mbledhin këto ujra, duhet të merret leja nga Autoriteti Rajonal i Pellgut Lumor;
- Operatori i telefonisë mobile nuk mund të fillojë veprimtarinë e vet në park (fillimisht vendosja e antenave dhe pastaj shërbimet e telefonisë) pa patur liçencën për këtë e të cilën e lëshon Autoriteti Rregullator i Telekomunikacionit (ART);
- Përveq liçencës që merret nga ART, për vendosjen e antenave në terren, operatori i telefonisë mobile duhet të marrë edhe pëlqimin mjedisor nga MMPH.
- Nuk lejohet që antenat të vendosen në rezervatet strikt të natyrës dhe as të prehet pylli që ato të vendosen;
- Në mënyrë që të mund të ushtrojë veprimtarinë e vet në park dhe në vendbanimet rreth tij, ofruesi i shërbimeve të telefonisë fikse(kompania publike apo private) duhet të jetë i pajisur me liçencë nga ART;
- Në mënyrë që të mund të ushtrojë veprimtarinë e vet në park dhe në vendbanimet rreth tij, operatori i shërbimeve postare duhet të jetë i pajisur me liçencë nga Ministria e Infrastrukturës;
- Të drejtën për ndërtimin e deponisë së mbeturinave dhe për administrimin me mbeturinat në park dhe në vendbanimet rreth tij, e kanë vetëm operatorët për administrimin e mbeturinave që janë të pajisur me liçencë nga MMPH;
- Me rastin e zgjedhjes së lokacionit ku do të ndërtohet deponia e mbeturinave duhet të përmbushen kriteret për zgjedhjen e lokacionit që janë përcaktuar me aktin nënligjor nga Qeveria e Kosovës, por gjithësesi lokacioni duhet të jetë jashtë territorit të parkut kombëtar;
- Të gjitha ndërmarrjet ndërtimore që do të ndërtojnë në territorin e parkut kombëtar dhe në vendbanimet përreth tij duhet të jenë të liçencuara
- Në rrugën Brezovicë-Prevallë-Prizren, brenda kufirit të parkut shpejtësia e automjeteve duhet të jetë e kufizuar me qëllim të mbrojtjes së ndikimit në mjedis dhe të rregullohet konform mbrojtjes së mjedisit. Të shikohet mundësia që rruga të përdoret vetëm për nevoja të bartjes së pasagjerëve e jo edhe automjeteve të rënda.
- Të gjitha rrugët në park që përdoren për mjete motorike përparësi duhet të kenë lëvizja e këmbësorëve andaj edhe rregullat për shpejtësi të automjeteve të analizohen dhe të vendoset regjimi i shpejtësisë.
- Shtigjet malore të planifikuara dhe ato ekzistuese përveç që mund të përdoren për ecje ato mund të përdoren edhe për qarkullimin e biçikletave.
- Lëvizja e mjeteve fluturuese është e ndaluar përveç në rastet kur drejtoria e parkut e sheh të arsyeshme në bazë të ligjeve ne fuqi.
- Në brendi të parkut në zonat e mbrojtura, numri i vizitorëve duhet të jetë i limituar.
- Në çdo pikë hyrëse në park të vendosen tabelat me madhësi standarde dhe të përshkruhet rruga dhe pika ku mund të arrihet.

Pjesëmarrësit në hartimin e Planit

Hartues: Instituti për Planifikimin Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Qeveria e Kosovës

Luan Nushi, Faton Deva, Elvida Pallaska, Arbën Rrecaj, Festa Nela, Besim Gollopeni, Shpend Agaj, Nexhmije Kamberi, Zana Mehmeti, Riza Murseli, Mimoza Kallaba dhe Ismail Gagica e Hazer Dana (ish zyrtarë të IPH-së),

Pjesmarrës në Grupet Punuese Ndërministrore – GPN dhe të tjerë përgjegjës për fusha të vecanta

MMPH: Ilirjana Mejzini, Hidajete Zhuri, Adnan Elshani, Vjollca Puka, Abdurrahman Vërbovci, Lendita Radoniqi, Xhavit Mala, Shefket Vranovci, Sabit Restelica, Fadil Bajraktari, Ylber Sherifi, Miradije Gërguri, Gani Berisha, Merita Dalipi, Adem Iberhysaj, Leonora Rraci, Manduha Gojani, Agron Millaku, Sylë Tahirsylaj.
MTI: Avdi Krasniqi, Mensur Azemi, Bedri Millaku, Merita Fetahu
MI: Naser Zhjeçi, Kamer Shabanaj, Agim Kukaj
MKRS: Fitim Arifi
MBPZHR: Fahrije Tolaj, Tahir Ahmeti, Hetem Abazi, Bajram Batusha, Hysen Abazi, Tahir Halitaj
MAP: Imer Hajdini
MEM: Lulzim Korenica, Shahin Llalloshi, Bashkim Pllana.

Pjesëmarrësit nga komunat

Prizren: Refki Muzbegu, Zana Shtoka-Belloda,
Suharekë: Isuf Hajdaraj, Nexhmije Loshi-Durmishi, Sadri Emerllahu, Hanife Alimusaj
Dragash: Hasan Dishallari, Irfan Ibrahimi, Florim Krasniqi,
Kaçanik: Enver Zharku, Fatos Hoxha,

Ekspertët e pavarur dhe bashkëpunëtorë të jashtëm

Asllan Pushka, prof. Dr. (Katedra e Gjeografisë –UP); Vahdet Pruthi, prof. Dr. (Katedra e Gjeografisë – UP); Esat Hoxha, prof. Dr. (Katedra e Biologjisë – UP); Tefik Basha, prof. Dr. (Katedra e Gjeografisë – UP); Ruzhdi Pllana, prof. Dr. (Katedra e Gjeografisë – UP); Esat Dauti, prof. Dr. (Katedra e Biologjisë – UP); Zeqir Veselaj, prof. Dr. (Katedra e Biologjisë – UP); Avni Hajdari, Mr. (Katedar e Biologjisë - UP); Behxhet Mustafa, Prof. Dr. (Katedra e Biologjisë – UP).

Grupi punues për Zonimin e Parkut Kombëtar "Sharri"

Afrim Berisha, AMMK; Fadil Bajraktari, AMMK; Ylber Sherifi, AMMK; Qenan Maxhuni, AMMK; Elez Krasniqi, AMMK; Xhavit Mala, DPN; Nail Kryeziu, DPN; Faton Deva, IPH; Ismail Gagica, IPH; Arbën Rrecaj, IPH, Shpend Agaj, IPH;

Përgatitja teknike: INSTITUTI PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

LITERATURA DHE BURIMET


1. AMMK/IKMN, Raporti i gjendjes se natyrës 2006-2007, Prishtinë 2008.
2. Behxhet Mustafa & Esat Hoxha, Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura, Prishtinë 2004.
3. Croatia – National Report, Seminar on the role of ecosystems as ëater suppliers, Geneva 13-14 December 2004.
4. DPNMSH, Përshkrimi i veçorive natyrore të territorit të KK Dragash të propozuar për shpallje si park nacional në kuadër të parkut nacional MSH, me 25.01.2007.
5. Draft document, Northumberland national Park, Local Development Frameëork, Local Development Scheme 2004 – 2007, Northumberland national Park Authority, England 2004.
6. Enti Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës, Arsyeshmëria shoqërore e shpalljes së pjesës së Malit Sharr në KSA të Kosovës për park nacional, Prishtinë, 1982
7. Zavod za prostorno planiranje, Republika Hrvatska, Ministarstvo Zastite Okolisa i Prostornog Uredenja, Prostorni Plan Nacionalnog Parka Paklenice, Zadar,1999.
8. Institut for Ecological and Regional Development, Spatial Information Systems for National Park Regions (NPIS) in the Central European Space (CES) – GIS – Concepts for monitoring and managing national park regions, Department of Geosciences University of Dresden, Dresden Germany
9. Instituti i Kosovës për mbrojtjen e natyrës, Biodiversiteti i territorit të komunës së Dragashit, Prishtinë, 2007.
10. International Survey on Nature Parks in Europe, Annex 9.1 Questionnaire, Federation of German nature Parks and EUROPARC-Federation.
11. KK.SHterrpcë, Plani hapësinor i komunës së Shtërpces,2005
12. MMPH, Plani i Kosovës për veprim në mjedis 2006-2010, Prishtinë, 2006.
13. MMPH/IKMN, Vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës, Prishtinë, 2005.
14. Pravilnik o razvrstavanju, minimalnim uvjetima i kategorizaciji smestajnih objekata, kampova iz skupine "Kampovi i druge vrste objekata za smestaj", Ministarstvo turizma Hrvatske, Narodne Novine 49/03, Zagreb 2003.
15. UNEP IE/WTO, Guidelines of Development of national Parks and Protected Areas for Tourism, 1992.
16. UNEP, Ecotourism, Principles, practices & Policies for sustainability, The International Ecotourism Society, Burlington, USA, 2002.
17. Zavod za prostorno planiranje, Republika Hrvatska, Ministarstvo Zastite Okolisa i Prostornog Uredenja, Prostorni Plan Nacionalnog Parka Risnjak, Rijeka, 2001.
18. UNDP, Draft Plani Zhvillimor Komunal i Dragashit
19. Shumica e fotove dhe materialeve filmike të prezantuara, janë origjinale dhe të realizuara në terren nga zyrtarët e IPH-së.

Falënderim

Në emër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Institutit për Planifikim Hapësinor, falënderojmë të gjithë pjesëmarrësit, institucionet publike, private, shoqërinë civile si dhe organizatat e ndryshme të cilët na ndihmuan me të dhëna, informacione dhe përvojën e tyre deri në realizimin final të Planit Hapësinor të Parkut Kombëtar "Sharri".

PARKU KOMBËTAR "SHARRI"

PLANI HAPËSINOR



Dokument i hartuar nga
Instituti për Planifikim Hapësinor
në bashkëpunim me strukturat relevante
të sektorëve të Qeverisë së Kosovës,
qeverive komunale dhe strukturave dhe
niveleve të ndryshme të shoqërisë kosovare.

Qeveria e Kosovës
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
Instituti për Planifikim Hapësinor

Prishtinë
Tetor, 2013

Shtojca 1.

Numri i llojeve të shpendëve në territorin e parkut

EMRI SHKENCOR	EMRI NË SHQIP
ACCIPITRIDAE	
Aquila chrysaetos	Shqiponja e maleve
Aquila heliaca	Shqiponja perandorake
Circaetos gallicus	Shqiponja e gjarpërinjëve
Nephron percnopterus	Seronio i bardhë
Buteo buteo	Shqiponja minjëngrënëse
Buteo rufinus	Huta bishtbardhë
Pernis apivoris	Huta grenxangrënëse
Hieraetus fasciatus	Shqiponja bishtvizuar
Hieraetus pennatus	Shqiponja e vogël
Accipiter gentilis	Gjeraqina
Accipiter nisus	Gjeraqina?
Accipiter brevipes	Gjeraqina këmbëshkurtër
Milvus milvus	Huta bishtgërshërë e kuqërreme (kaqabeti)
Milvus migrans	Huta e zezë bishtgërshërë
Gyps fulvus	Shkaba (coftinari kokëbardhë)
Aegypius monachus	Shkaba e zezë
Gypaetos barbatus	Shkaba mjekëroshe
Circus cyaneus	
Circus macrourus	Shqipja e stepave
Circus pygargus	Shqipja e balltaqeve
FALCONIDAE	
Falco peregrinus	Skifteri i përhimë
Falco subbuteo	Skifteri i dallëndysheve
Falco biarmicus	Skifteri i mesdheut
Falco vespertinus	Skifteri këmbëkuq
Falco naumanni	Fajkoi thonjëbardhë
Falco tinnunculus	Fajkoi i kuq
Tetrastes bonasis	Pula e pyjeve
Alectoris graeca	Thëllëza gurore
Perdix perdix	Thëllëza fushore
Coturnix coturnix	Shkurtëza
Phasianus colchius	Fazani
Tetrao urogallus	Pula e egër e madhe
CHARADRIDAE	
Eudromias morinellus	
Vanellus vanellus	
SCOLOPACIDAE	
Tringa hypoleucos	
Scolopax rusticola	Pulëdushku
LARIDAE	
Larus ridibundus	Pulëbardhë
Larus argentatus	
COLUMBIDAE	
Columbo livia	Pëllumbi i egër i shpellave
Columbo oenas	Pëllumbi i egër i zgavrrave
Columbo palumbus	Pëllumbi kreshtor
Streptopelia decaocto	Kumria
Streptopelia turtur	Turtullesha
CUCULIDAE	
Cuculus canorus	Qyqja
STRIGIDAE	
Otus scops	Huti i vogël
Bubo bubo	Huti i madh(bufi)
Asio otus	
Athene noctua	Kukuvajka
Strix aluco	Huti i pyjeve
Strix uralensis	Huti i uralit
Glaucidium passerinum	Kukuvajka e vogël
TYTONIDAE	
Tyto alba	Kukuvajka
CAPRIMULGIDAE	
Caprimulgus europeus	Dallëndyshja e natës(shpatorja)
APODIDAE	
Apus apus	Dejka
Apus mebla	Sorra e madhe
ALCEDINIDAE	
Alcedo athis	Sqepgjata peshkatar (nori)
UPUPIDAE	

Upupa epops	Pupëza
MEROPIDAE	
Merops apiaster	Bletari
CORACIDAE	
Coracias garrullus	Korbi i artë
PICIDAE	
Dryocopus martius	Qukapiku i zi
Picus canus	Qukapiku i përhimë
Picus viridis	Qukapiku i gjelbër
Dendrocopos syriacos	Qukapiku sirian
Dendrocopos major	Qukapiku i madh laraman
Dendrocopos medius	Qukapiku mesatar
Dendrocopos leucotos	Qukapiku laraman i pyllit
Dendrocopos minor	Qukapiku i vogël
Picoides tridactylus	Qukapiku me tre gishta
Junx torquilla	Qafëdredhësi
ALAUDIDAE	
Eremophila alpestris	Laureshe me brirë
Caladrella cinerea	
Melanocorypha calandra	Laureshë e madhe
Lullula arborea	Laureshë e pyjeve
Galerida cristata	Laureshe me kaqubëz
Alauda arvensis	Laureshe e fushës
HIRUNDINIDAE	
Hirundo rustica	Dallëndyshe e fshatit
Hirundo rupestris	Dallëndyshe e brigjeve,malore
Hirundo daurica	Dallëndyshe
Delichon urbica	Dallëndyshe e qytetit
MOTACILLIDAE	
Anthus trivialis	Bishtundesja pyjore
Anthus pratensis	Bishtundesja e fushave
Anthus spinoleta	Bishtundesja malore
Anthus campestris	Drenja e fushës
Motacila alba	Trinka e bardhë
Motacilla cinerea	Trinka malore
CINCLIDAE	
Cinclus cinclus	Mullinja e ujit

TROGLODYTIDAE	
Troglodytes troglodytes	Cicamiu
PRUNELLIDAE	
Prunella modularis	
Prunella collaris	Dredhësi i alpeve
SYLVIDAE	
Sylvia communis	Kaqubari gushan
Sylvia curruca	Kaqubari
Sylvia atricapilla	Kaqubari kokëkuq
Phyloscopus collybita	Fishkëlluesi i thjeshtë
Phylloscopus sibilatrix	Bilbili pyjor
Phylloscopus bonelli	Fishkëllënjes gushëbardhë
MUSCICAPIDAE	
Muscicapa striata	Mizëngrënësja e përhimë
Ficedula hypoleuca	Mizëngrënësja e larme
Ficedula albicollis	Mizëngrënësja qafëbardhë
Ficedula parva	Mizëngrënësja e vogël
TURDIDAE	
Saxicola torquata	Barishtorja kokëzezë
Saxicola rubetra	Barishtorja e rëndomtë
Monticola solitarius	
Monticola saxatilis	Mullibardha e egurëve
Oenanthe oenanthe	Bardhoshja e rëndomtë
Oenanthe hispanica	Bardhoshja mediteranike
Phoenicurus ochruros	Bishtkuqja e zezë
Phoenicurus phoenicurus	Bishtkuqja e rëndomtë
Erithacus rubecula	Gushëkuqi
Luscinia megarhynchos	Bilbili i randomët
Turdus merula	Mëllinja e zezë
Turdus torquatus	Mullizeza malore
Turdus pilaris	Mullibardha
Turdus philomelos	
Turdus viscivorus	Mullibardhe
AEGITHALIDAE	
Aegithalos caudatus	Trishtili bishtgjatë
PARIDAE	
Parus ater	Trishtili i bredhit



Parus major	Trishtili i madh
Parus caeruleus	Trishtili i kaltër
Parus cristatus	Trishtili buzaq
Parus montanus	Trishtili kokëzi
SITIDAE	
Sita euro pea	Sqepadri
TICHODROMADIDAE	
Tichodroma muraria	Zvarritësi krahëkuq
CERTHIIDAE	
Certhia familiaris	
Certhia brachydactyla	
REMIZIDAE	
Remiz pendulinus	Cinka e bardhë (kolovatësi)
ORIOLIDAE	
Oriolus oriolus	benga
LANIIDAE	
Lanius excubitor	Larashi i madh i përhimë
Lanius collurio	Larashi kurrizkuq
CORVIDAE	
Garrulous glandarius	Sojka,grifsha
Nucifraga caryocatctes	Gala e lajthive(arrathyes)
Pica pica	Laraska
Pyrrhocorax pyrrhocorax	Stërqoka sqepkuqe
Corvus corax	Korbi
Corvus frugilegus	Korbi sqepbardhë
Corvus cornix	Korbi i bardhë
Corvus monedula	Gala,sorra,qava
STURNIDAE	
Sturnis vulgaris	Gargulli
PASSERIDAE	
Passer montanus	Harabeli i malit
Passer hispaniolensis	Harabeli spanjoll
Passer domesticus	Harabeli shtëpiak
Petronia petronia	Harabeli i gurëve
FRINGILLIDAE	
Fringilla monTifringilla	Borsi
Fringilla coelebs	Borsi i rëndomtë
Carduelis carduelis	Feraku
Carduelis chloris	Verduni
Carduelis spinus	Cerla dimërake
Pyrrhula pyrrhula	Gushëkuqi
Cocothraustes cocothraustes	Sqeptrash
Acanthis cannabina	
Serinus serinus	Kanarinë e verdhë
Loxia curvirostra	Sqepkryqi
EMBERIZIDAE	
Emberiza calandra	Cerla e zakonshme
Emberiza cia	Fuga malore
Emberiza citrinella	Fuga verdhoshe
Emberiza cirlus	Fuga gushëzezë
Emberiza melanocephala	
Emberiza hortulana	Cerla e kopshtit

Shtojca 2.

Vlerësim mbi resurset natyrore dhe biodiversitetin në Komunën e Dragashit.

Veçoritë dhe vlerat natyrore e gjeografike në territorin e propozuar për park kombëtar në Komunën e Dragashit[30]

Hapësira territoriale që i takon Komunës së Dragashit e cila propozohet të hyjë në kuadër të Parkut Kombëtar "Sharri" gjendet në pjesën jugore të Kosovës përkatësisht në pjesën lindore, jugore dhe perëndimore të kësaj komune dhe me territorin e parkut kombëtar ekzistues formon tërësinë me vlera të njejta natyrore në kuadër të parkut të ardhshëm.

Shtrirja territoriale e kësaj zone, përgjatë kufirit shtetëror të Kosovës me Maqedoninë dhe Shqipërinë, me sipërfaqe prej përafërsisht 20.000 – 25.000 ha, nga e cila mbi 90 % i takon pronës shoqërore. Pjesa më e ulët e territorit është afro 700 m lartësi mbidetare dhe gjendet në grykën e lumit të Pllavës në zonën kufitare me Shqipërinë ndërsa majat më të larta janë: Vraca 2582 m dhe Koritniku 2395 m.

Nëpërmes këtij territori, kalon rruga Prizren-Dragash-Restelicë-Strezimir (kufiri me Maqedoninë), fushës së Radikës e cila lidhet me rrugën Gostivar-Mavrovë-Dibër-Ohër, ndërsa është planifikuar të ndërtohet edhe rruga Prizren-Zaplluzhë-Tetovë. Këto dy segmente rrugore janë me rëndësi për zhvillimin e turizmit tranzitor nëpër territorin e propozuar për park kombëtar.

Veçoritë pejsazhore - Hapësirat në këtë pjesë paraqesin tërësinë tejet të rëndësishme pejsazhore të cilën e karakterizojnë një sërë lokalitetesh me bukuri të rralla natyrore: lugina, lumenj, liqene, pastaj sipërfaqet e mbuluara me pyje, livadhe dhe kullosa.

Këtu gjenden sipërfaqet më të bukura të livadheve dhe kullosave malore në Kosovë të cilat mbulojnë pjesën më të madhe (afro 90 %), prej të cilave ka edhe bimë endemike dhe relikte.

Biodiversiteti - Bota bimore dhe shtazore dhe vlerat tjera te natyrës në përgjithësi paraqesin burim potencial për zhvillimin e aktiviteteve edukative-arsimore-shkencore dhe kërkimore-hulumtuese për vizitorët e ndryshëm.

Këtu janë prezent llojet e bimëve që i takojnë elementeve floristike: mezofile, kserofile, frigorifile dhe arko-alpike në kuadër të cilave rëndësi të veçantë kanë bimët endemike.

Pjesa e maleve e cila lidhet me malin e Koritnikut paraqet një zonë me vlera të rralla natyrore dhe konsiderohet si rezervat për disa lloje të bimëve.

Llojet drunore - Llojet drunore që marrin pjesë në përbërjen e pyjeve janë: ahu (Fagus moesiacae), bredhi (Abies alba), panja gjethërrumbullakët (Acer obtusatum), panja gjethërrapi (Acer pseudoplatanus), bungu (Quercus petrea), qarri (Quercus cerris), shkoza e zezë (Ostya carpinifollia), shkoza e bardh (Carpinus orientalis), qershia e egër (Prunus avium), mështekna (Betula pendula). Llojet tjera drunore të rralla janë: panja malore (Acer heldreichii), tisi (Taxus bacata), lajthia e arushës (Corilus collurna).

Duhet theksuar se bashkësia bimore e dioskorës me shkozën (Dioscoro-Carpinetum orientalis), si lloj i rrallë dhe endemike, gjendet në pjesën kufitare të Dragashit me Prizrenin, pra në veriun e kësaj komune. Në pjesët e pjerrëta te Koritnikut është prezent lloji apo bashkësia bimore e lajthisë me mëllënzën (Colurno-Ostryetyum) dhe sipërfaqet më të mëdha të pyjeve të rrobullit (Pinetum heldreichii)

Fauna - Territori i komunës së Dragashit është i pasur në pikëpamje faunistike, në të janë prezente llojet e veçanta të shtazëve të cilat janë të përhapjes së ngusht por edhe llojet e përhapjese së gjërë. Sipas disa hulumtimeve të bëra në territorin e komunesë së Dragashit, fauna e këtij rajoni është e njejtë me faunën e Parkut Kombëtar "Sharri": Peshqit (Pisces), Ujëtokësorët (Amphibia), Zvaranikët (Reptilia), Gjitarët (Mamalia), Insektngrenës (Insektivora), Brejtës (Rodentia), Mishengrenës (Carnivora), Jopërtypesit, Ripërtypesit dhe

[30] Bazuar në materialet: "Përshkrimi I veçorive natyrore të territorit të KK Sharrit të propozuar për shpallje si Park Nacional në kuadër të PN 'Mali Sharr'", MMPH - Drejtoria e Parkut Nacional, janar 2007 dhe "Biodiversiteti i territorit të komunës së Sharrit (Dragashit)", MMPH - Instituti për Mbrojtjen e Natyres shkurt 2007,



Shpendët. Rajoni i komunës së Dragashit është i veçant edhe për kultivimin dhe ruajtjen e Pastorit Ilir i njohur ndryshe edhe si Qeni i Sharrit ose Deletari Ilir.

Rol të veçant në formimin e racës së Deletarit Ilir-Illyrian Shepherd – Qeni i Sharrit kanë luajtur masivet e larta malore që kufizonin kryqëzimin me llojet e tjera të qenëve. Është shumë e nevojshme një mbrojtje ligjore e këtij pastori për të ruajtur vazhdimësinë e kësaj race autentike shqiptare.

- Lumenjtë dhe proskat e komunës janë shumë të pasur me trofta malore.

- Shpatijet e fshatit Brod janë të pasur me derra të egër, lepuj, dhelpra dhe me shtazë të tjera të gjuetisë.

Vlerat e përmendura natyrore, posaqërisht vargmalet paraqesin potencial të mirë për zhvillimin e turizmit por edhe të blegëtorisë e kullosave në këtë rajon, por mungesa e infrastrukturës, mjeteve materiale dhe projekteve ka penguar zhvillimin e kapaciteteve turistike në këtë komunë. Stazat ekzistuese të cilat përdorin blegtorët për bagëtite e tyre paraqesin mundësi reale për zhvillimin e alpinizmit, ecjes në natyrë dhe të shëtitjes malore me biçikleta.

Territori i komunës së Dragashit ka predispozita për zhvillimin e disa llojeve të turizmit:

si atij edukativ, rekreativ dhe sportiv (dimëror e veror), të gjuetisë dhe peshkimit, malor, fshatar dhe tranzitor.

Zonat ku mund të zhvillohet turizmi i sporteve dimërore në komunën e Dragashit janë: Zaplluzha, Radesha, Brodi dhe Restelica. Përveq këtyre terreni përreth liqenit të Breznes, i cili ka sipërfaqe prej afro 2 ha, paraqet vend ideal për turizem dimëror.

Lumenjtë më të mëdhenjë, janë të vetmet burime, që karakterizohen, me sasi të ujit gjatë tërë vitit janë: lumi Plava i cili buron në afërsi të Gurit të Zi, në përbërje të të cilit bashkohen edhe lumi i Radeshkës dhe lumi i Brodit si dhe lumi i Restelicës i cili buron nën majen e Vracës dhe përbëhet nga një numër i madh i burimeve dhe përroskave. Të dy lumenjët derdhen në Drinin e Bardhë dhe i takojnë pellgut të detit Adriatik.

Në këtë territor gjenden edhe disa liqene të përkohshëm (Liqeni i Shutmanit, Liqeni i Defos etj) të cilët formohen nga shkrirja e borës, ndërsa gjatë verës në periudhat kur mungojnë të reshurat shpesh herë thahen. Liqeni më i rëndësishëm është ai i Breznës i cili gjendet nën malin Koritnik (afër fshatit Brezne) në lartësi mbidetare prej 935m.

Nga territori i komunë së Dragashit zonat të cilat propozohet të hyjnë në kuadër të PK "Sharri" janë:

- Guri i Zi – Tereni i skijimit
- Rajoni i Brodit – Rezervat natyror (dhia e egër – Rupicapra - rupicapra)
- Rajoni i Restelicës – Zonë ku gjenden pejsazhet e bukura si dhe liqene me mbi 2000 m lartësi mbidetare
- Bredhiku – Pyjet e pastra të bredhit (Abietum alba)
- Koritniku – Pyjet e pastra të rrobullit (Pinetum heldreichii)

Shtojca 3.

Tabela e aktiviteteve

Synimi 1 Administrimi i plotë dhe menaxhimi efikas i Parkut Kombëtar „Sharri"							1,983,000
Objektivi	Aktiviteti/ Masa/ Projekti		Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi finansiar	Çmimi në €uro
S1O1. Funksionimi i një trupi të vetëm ligjor dhe përgjegjës për menaxhim	A1	Shtrirja e autoritetit të Drejtorisë në të gjithë territorin e Parkut duke përfshirë edhe territorin e Komunës së Shtërpcës	MMPH – komunat	DPK	*	MMPH	30,000
	A2	Nënshkrimi i një memorandumi bashkëpunimi (MMPH, DPN, SHPK, Gjykata, APK, Shoqata ekologjike, Gjuetareve, blegtorve etj.)	MMPH	DPK	*	MMPH	3,000
	A3	Hartimi i planit të punës dhe zbatimi i tij deri në hartimin e planit menaxhues	DPK	DPK	*	MMPH	
S1O2. Hartimi i Planit Menaxhues për territorin e Parkut Kombëtar "Sharri"	A1	Hulumtime mbi të gjitha karakteristikat biologjike, kulturore e socio-ekonomike si dhe të faktorëve abiotik	MMPH	MMPH, DPK, Institucionet shkenc.	**	MMPH - Donatorë	1,700,000
	A2	Konsultimet publike	MMPH	DPK	**	MMPH - Donatorë	10,000
	A3	Pergatitja e standarteve, regjimit të monitorimit, konditat dhe rekomandimet si dhe aktivitetet konkrete	MMPH	DPK	**	MMPH - Donatorë	50,000
	A4	Trajnimet dhe veprimet për zbatimin e Planit	MMPH	DPK	**	MMPH - Donatorë	40,000
S1O3. Administrimi efikas dhe shtrirja e autoritetit të parkut	A1	Objektet e autoritetit të parkut	MMPH	DPK	*	MMPH	100,000
	A2	Kontrollat, mbikqyrja dhe taksat	MMPH	DPK	*	MMPH	20,000
	A3	Hartimi i një organogrami të ri	MMPH	DPK	*	MMPH	
	A4	Paisjet e nevojshme për punë	MMPH	MMPH, DPK	*	MMPH	30,000
	A5	Konsultimet dhe analizat e komenteve të grupeve të ndryshme të interesit	DPK, IPH, AKMN	DPK, IPH, AKMN	*		
	A6	Futja e ndryshimeve eventuale në projekt propozimet e planit hapësinor dhe planit menaxhues të parkut.	DPK, IPH, AKMN	DPK, IPH, AKMN	*		
	A7	Aprovimi dhe zbatimi i planit hapësinor dhe planit menaxhues të parkut	Kuvendi i Kosovës	MMPH, DPK	**		

Synimi 2 Mbrojtja, ruajtja dhe shfrytëzimi i trashëgimisë natyrore dhe kulturore në park dhe në vendbanimet përreth							973,750
Objektivi	Aktiviteti/ Masa/ Projekti		Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi finansiar	Çmimi në €uro
S2O1. Vetëdijësim dhe informim për Parkun Kombëtar "Sharri"	A1	Pregatitja e marketingut për mediat e shkruara dhe elektronike mbi PK "Sharri"	MMPH/DP, Zyra e informimit	Zyra për Informim/ MMPH	*	BKK	8,000
	A2	Hartimi i temës metodike – pedagogjike si pjesë e lëndëve nëpër shkolla fillore dhe të mesme	MMPH, MAShT	MAShT, UP	*	BKK	5,000
	A3	Hartimi dhe publikimi i hartave, broshurave, fletëpalosjeve, reklamave si dhe kalendarit për vizita turistike	MMPH/ DP, AKMM, DMM, MBPZhR/APK	MMPH/DP	**	BKK	30,000
	A4	Aftësim i personave për shpjegim (ciceronëve) në 2 pikat kryesore hyrëse-kontrolluese të parkut	MMPH/DP, AKMM, MTI/DT, MKRS/DK	DP	**	BKK	10,000
	A5	Organizimi i ekskurzioneve 163orte163l163r – arsimore për rëndësinë e parkut kombëtar	MAShT / Drejtoritë komunale të Arsimit	Masht, DP	**	BKK	
	A6	Sigurimi dhe vendosja e shenjave dhe simboleve për informim dhe orientim të ndërtuara nga materialet natyrore dhe sipas standardeve	MMPH/AKMM, DP	DP	*	BKK	50,000
	A7	Pregaditje e programit për senzibilizim të banorëve të VB në park dhe përreth tij mbi ruajtjen e mjedisit, pejsazhit, traditës për zhvillim të ardhshëm turistik	MTI/DT, MMPH/DP,AKMM, MKRS/DK	DP, OJQ-të dhe Komunat përkatëse	**	BKK, sek. Privat dhe Donatorët	50,000
	A8	Ndërtimi 163ort qendrave hyrëse kryesore në park (Prevallë, Shtërpcë) dhe tri sekondare (Suharekë, Dragash dhe Kaçanik) si dhe në kuadër të hyrjeve kryesore të jenë të ekspozuara pasuritë e florës dhe faunës të PK "Sharri"	MMPH/DP	DP	**	BKK	450,000
	A9	Hartimi i udhëzimit 163orte163l163rative – "Rregullores për rendin e brendshëm të Parkut Kombëtar "Sharri" mbi: - lejimin dhe ndalimin e aktiviteteve si dhe gjobat ndaj prodhuesit, ndërtuesit dhe ndotësit (personat fizik dhe juridik) mbrenda dhe perreth parkut; - normat dhe rregullat e mirësjelljes; - pregaditjen dhe kontrollin e planeve rregullative dhe - kushtet e lejimit dhe mbikqyrjen e ndërtimeve për zonën e III-të mbrojtjes dhe të ndikimit reciprok	MMPH/DMM, AKMM, DP, DPH, IPH	DP, Inspektor.	*	BKK	5,000

S2O2. Mbrojtje e pyjeve nga faktorët njerëzor dhe natyrorë	A1	Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit për mbrojtjen e pyjeve në mes të MMPH/MBPZHR, SHPK dhe Gjykatave komunale (Komunat pjesëmarrëse në PK)	MMPH/MBPZHR, DP, APK, SHPK, Gjykatat komunale – Prizren, Shtërpce, Suharekë, Kaçanik	MMPH/DP, APK, SHPK, Gjykatat komunale – Prizren, Shtërpce, Suharekë, Kaçanik	**	MMPH	1,500
	A2	Hartimi i UA nga MMPH për ndalimin e menjëhershëm të prerjes ilegale të pyjeve si dhe rritjen e tarifave ndëshkimore për shfrytëzuesit 164orte164l të resurseve natyrore në park (bazuar në ligjin për mbrojtjen e natyrës, neni 41, paragrafi 5)	MMPH	DP	*	MMPH	500
	A3	Rritja e numrit të rojeve si dhe përmirsimi kushteve dhe paisjeve të nevojshme për vëzhgim, telekomunikim, mbrojtje dhe lëvizje	MMPH/DP, APK	DP	**	MMPH/BKK	66,000
	A4	Ndërtimi shtigjeve, pengesave dhe pritave me qëllim të mbrojtjes pyjeve nga zjarri, prerjet, erozioni dhe orteku;	MMPH/DP,	DP	**	BKK	10,000
	A5	Prerja e kontrolluar fito-sanitare, me rastin e përkujdesjes ndaj zhvillimit të pyjeve, përveç në zonën e parë strikte	DP, APK	DP, APK	***	BKK	
	A6	Identifikim i vendeve në zonën e dytë për rrallime, pyllëzime, ripyllëzime dhe ndërtim të pritave me qëllim të mbrojtjes dhe zhvillimit të pyjeve	DP, AKP	Ekspertët e pylltarisë	*	BKK	
S2O3. Mbrojtje dhe ruajtje e biodiversitetit	A1	Hulumtimi, evidentimi dhe inventarizimi i llojit të bimëve me përcaktimin e arealit tyre	DP, Universiteti Dega e Biologj. AKMM	Grupi i ekspertëve	***	BKK	70,000
	A2	Hartimi dhe publikimi atlasit botanik të parkut	DP, Universiteti Dega e Biologj. AKMM	Grupi i ekspertëve	*	BKK	30,000
	A3	Hulumtimi, evidentimi dhe inventarizimi i llojit të kafshëve e sidomos atyre endemike me përcaktimin e arealit tyre	DP, Universiteti Dega e Biologj. AKMM	Grupi i ekspertëve	***	BKK	70,000
	A4	Hartimi dhe publikimi atlasit zoologjik të parkut	DP, Universiteti Dega e Biologji. AKMM	Grupi i ekspertëve	**	BKK	30,000
	A5	Përpilimi i "Librit të kuq" të florës dhe faunës	MMPH	Grupi i ekspertëve	**	BKK	20,000
	A6	Përpilimi hartës me specie endemike, habitate të rrezikuara si dhe arealet e llojeve dhe familjeve më të rëndësishme bimore dhe shtazore	MBPZHR/APK, DP		**		
S2O4. Monitorim për mbrojtje dhe shfrytëzim të	A1	Hartimi i planit menaxhues për parkun kombëtar	MMPH	DPK	**	BKK	-
	A2	Memorandum mirëkuptimi për koordinim të punëve në mes të institucioneve relevante monitoruese: DP, IHMK, AKMM dhe IKSHP	MMPH, MSh	DP, AKMM, IHMK dhe IKShP	**		2,500

resurseve natyrore në park	A3	Ndërtimi i një stacioni hidrometeorologjik	MMPH	DP, IHMK	**	BKK	60,000
	A4	Përpilimi i kornizës për raportime vjetore mbi gjendjen mjedisore	DP	DP	***	MMPH	2,250
	A5	Ndërprerja e menjëhershme e aktiviteteve të gurëthyesve në kudër të parkut dhe të atyre në afërsi direkte të tij.	MMPH	DP	*	MMPH	
	A6	Definimi i pejsazheve natyrore në park.	AKMM, ekspert. IPH, DP	DP	*	MMPH	3,000
	A7	Hartimi i kornizës, për shfrytëzim të kontrolluar dhe racional të resurseve mbrenda parkut: tokës bujqësore, kullosave, livadheve, fryteve malore dhe bimëve mjekuese si dhe trupave ujore sipas pl. Menaxhues	DP, AKMM, IPH, APK,sektori privat	DP	**	BKK	
	A8	Evidentimi dhe kontrrolimi i krerëve blektoral mbrenda kufijve të parkut si dhe prergatitja e taksave stimuluese për sektorin privat;	MMPH	DP, DU	***		
	A9	Ripyllëzimi i sipërfaqeve tokësore që janë nën ndikimin e erozionit me shkallë të 165orte dhe shumë të 165orte në zonën e dytë dhe të tretë të mbrojtjes, në ato sipërfaqe ku lejon konfiguracioni i terrenit (sip. Janë të identifikuara në hartën e erozionit).	MMPH/DM, AKMM, DP, DU MBPZHR/APK, MEF	DP,AKMM	***	BKK	
	A10	Ndërtimi i pritave me material natyror në pjesët ku erozioni shkakton dëme (tok. Bujq. Kullosave, infrastr. Fizike) si dhe mënjanon rrezikun e madh nga ortiqet eventuale;	MMPH/DU, DP, AKMM	DP,AKMM	***	BKK	
	A11	Sigurimi i inspektimit dhe monitorimit gjatë ndërtimeve dhe në mbrojtje të elementeve mjedisore tek qendrat dhe pikat e urbanizuara (largim i mbeturinave, trajtim i ujrave të zeza etj)	MMPH	MMPH	***		
S2O5. Sigurimi i ekzistencës fizike dhe ruajtja e autenticitetit të plotë të zonave dhe objekteve të TK	A1	Definimi i zonave me TK (arkeologjike, arkitekturore, të luajtshme,shpirtërore dhe peisazhet) si dhe definimi i zonave mbrojtëse, duke i'u referuar Ligjit për TK dhe Ligjit për ZVM;	MKRS, IPH, DU të komunave përkatëse	MKRS, DU të komunave	**	BKK dhe ndonjë projekt nga jashtë	
	A2	Digjitalizimi i objekteve dhe monumenteve me status të përkohshëm dhe të përhershëm si dhe kontrrollimi i gjendjes së tyre fizike në periudha të caktuara , që do të realizohen nga organet përgjegjëse të përcaktuara nga MKRS;	MKRS, IPH/MMPH	MKRS, IPH	***	BKK	
	A3	Përfshirja e trashëgimisë kulturore (arkeologjike, arkitekturore, të luajtshme,shpirtërore dhe peisazhet) në planet e nivelit lokal si: PZHK, PZHU dhe PRrU-në që përfshinë zonën me trashëgimi kulturore, ku njëherit do të bëhet kontrrollimi i zhvillimeve të ardhshme në këto zona.	DU të komunave përkatëse	DU të komunave përkatës	proces	BKK	
	A4	Hartimi i planeve të konservimit dhe menaxhimit për zonat me trashëgimi kulturore;	MKRS, Qendrat Rajonale për TK	MKRS, Qendrat Rajonale për TK	proces	BKK, Donatorë	

	A5	Ndërtimet moderne nuk duhet të kenë ndikime përqarëse, komerciale dhe uniforme, por ato duhet të inkorporohen, harmonizohen me të vjetrën dhe t'a pasurojnë edhe më shumë trashëgiminë kulturore	KK të komunave	DU të komunave	proces	Sektori privat dhe shoqëror	
S2O6. Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme për zonat dhe objektet e TK	A1	Ndërtimi i rrugëve, shtigjeve dhe parkingjeve të nevojshme të cilat shpiejnë gjer te objektet dhe zonat me TK;	MI, MKRS, Komunat përkatëse	Komunat përkatëse	***	BKK	
	A2	Vendosja e paneleve informuese (shenjave) në zonat dhe objektet me TK;	MKRS, MMPH, Komunat	Komunat	**	BKK	
	A3	Sigurimi i ndriçimit të zonave me TK;	KEK, MKRS, Komuna	KEK, Komuna	***	BKK	
S2O7. Vetëdijësimi dhe informimi mbi rolin dhe rëndësinë e trashëgimisë kulturore	A1	Inkorporimi i TK në planprogramet shkollore;	MASHT, MKRS	MASHT	***	BKK	
	A2	Specializimi i kuadrove në sfera të caktuara për trashëgimi kulturore;	Qeveria e Kosovës, MKRS,	MKRS	***	BKK, Donatorë	
	A3	Aftësimi i ciceronëve për TK në nivel lokal dhe qendror;	MKRS, Komunat, MA	MKRS dhe Komunat	***	BKK	
	A4	Pregatitja e hartave, broshurave, fletëpalosjeve etj. për monumente dhe tërësi të TK dhe TN	MKRS, MMPH/IPH, DU të komunave	MKRS, Komunat	***	BKK, Donatorë	
S2O8. Bashkëpunimi ndërinstitucional i nivelit qendror dhe lokaL	A1	Mbështetje nga ana e nivelit shtetëror mbi rëndësinë dhe rolin e TK, përmes politikave zhvillimore, që do të jenë bazë për arritjen e qëllimit tonë që është mbrojtja e TK nga degradimi i vazhdueshëm;	Qeveria e Kosovës , MKRS	MKRS, Komunat	**	BKK	
	A2	Realizimi i projekteve të përbashkëta duke i harmonizuar detyrat dhe obligimet që dalin nga institucionet e veçanta;	MKRS, Komunat	DU të komunave	proces	BKK	
	A3	Respektimi i hierarkisë ndërinstitucionale, gjithmonë me përmbushjen e kërkesave me qëllim të zhvillimit të planifikuar dhe të qëndrueshëm	MKRS, MMPH, Komuna	MKRS, Komuna	proces	BKK	
S2O9. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë shpirtëror	A1	Shumëzimi dhe ruajtja në arkiva dhe biblioteka e librave ekzistues ku flitet për traditat dhe zakonet popullore në territorin e komunës;	MKRS, Arkiva e Kosovës dhe Arkivat komunale	Arkiva e Kosovës dhe Arkivat komunale	***	BKK	
	A2	Hulumtimi në terren për traditat dhe zakonet popullore në territorin e komunës dhe dokumentimi në bazë të rezultateve të hulumtimit;	MKRS, Komuna	Muzeu Etnologjik i Kosovë dhe ato komunale	***	BKK	

	A3	Promovimi i kësaj lloj trashëgimie në mediat e shkruara dhe ato elektronike dhe relizimi i emisioneve dokumentare televizive për traditat dhe zakonet popullore në territorin e komunës;	MKRS, Mediat e shkruara dhe elektronike, Komunat	MKRS, Mediat, Komunat	proces	BKK	
	A4	Ruajtja e audio dhe video incizimeve dhe realizimi i incizimeve të reja të valleve dhe muzikës popullore duke e kultivuar traditën dhe autenticitetin e tyre	MKRS, Komunat, Mediat elektronike	MKRS, Komunat, Arkivat	***	BKK	

Synimi 3 **Zhvillimi i infrastrukturës fizike**							**56,395,000**
Transporti dhe infrastruktura e tij							**35,800,000**
Objektivi	Aktiviteti/ Masa/ Projekti		Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi finansiar	Çmimi në €uro
S3O1. **Qasja e mirë përmes rrugëve dhe shtigjeve në të gjitha zonat e parkut kombëtar dhe në afërsi të tij e që janë me interes të vizitohen** (Aktivitetet përmes të cilave tentohet të arrihet ky objektiv dhe objektivat tjerë, janë dhënë në kolonën përkatëse)	A1	Ndërtimi i shtigjeve për këmbësorë	MI, MMPH	Komunat respektive	**	BKK	3,300,000
	A2	Asfaltimi i rrugës R118 në segmentin Delloc - Vërbeshticë	MI, MMPH	MI	***	BKK	5,000,000
	A3	Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë lokacionin Gradac në veri të Parkut Nacional (komuna e Therandës) e ku do të ketë ndërtime në funksion të pushimit, rekreimit dhe rehabilitimit shëndetësor me rrugën regjionale R118	MI, MMPH, KK.Suharekë	MI, KK Suharekë	***	BKK	1,400,000
	A4	Ndërtimi i rrugës automobilistike në relacionin Drajkovc - Firajë - Brod	MI, MMPH, KK. Shtërpce	MI, KK. Shtërpce	*	BKK	3,400,000
	A5	Asfaltimi i rrugës lokale nga kryqëzimi me rrugën R115 deri tek fshati Pllanjan	MI, MMPH, KK. Prizren	MI, KK. Prizren	**	BKK	1,100,000
	A6	Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë fshatin Zapllugjë (komuna e Sharrit) me lokacionin Guri i Zi në afërsi (këtu do të ndërtohet qendra rekreative sportive) dhe më tutje me Maqedoninë	MMPH, MI, KK. Dragash	MI, KK. Dragash	**	BKK	1,900,000
	A7	Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë fshatin Restelicë me Mavrovën në Maqedoni	MMPH, MI, KK. Dragash	MI, KK. Dragash	**	BKK	
	A8	Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë fshatin Orçushë me Kuksin në Shqipëri	MMPH, MI, KK. Dragash	MI, KK. Dragash	**	BKK	
	A9	Ndërtimi i rrugës automobilistike që lidhë lokacionin Nënahishte (komuna e Kaçanikut), ku do të ketë ndërtime në funkcion të pushimit dhe rekreimit, me rrugën regjionale R116	MI, MMPH, KK. Kaçanik	MI, KK. Kaçanik	***	BKK	1,700,000

	A10	Realizimi i studimit për arësyeshmërinë e ndërtimit të hekurudhës në relacionin Brod - Sevce (komuna e Shtërpces)	MI, MMPH, KK. Shtërpce	KK. Shtërpce, donatori	***	BKK - 50%, donatori 50%	
	A11	Ndërtimi i hekurudhës së elektrifikuar në relacionin Brod – Sevce(nëse rezultati i studimit do ta arësyetonte) me degët e saj që shkojnë deri tek lokacionet ku ndodhen skiliftat dhe teleferikët	MI, MMPH, KK. Shtërpce	KK. Shtërpce, investitori privat, kreditori	***	BKK-30%, invest. Privat 40%, kredi e jashtme-30%	18.000.000
S3.O2. Sigurimi i transportit publik dhe vendparkimeve të nevojshme	A1	Vendosja e linjës në relacionin Doganaj – Shtërpce – Prevallë – Prizren	MI	MI	*	BKK	
	A2	Vendosja e linjës në relacionin Therandë – Mushtisht - Delloc – Vërbeshticë – Shtërpce	MI	MI	***	BKK	
	A3	Vendosja e linjave të rregullta për tek qendrat rekreative sportive dhe rehabilituese brenda dhe jashtë parkut	MI	MI	***	BKK	
	A4	Vendosja e linjës në relacionin Doganaj - Brod - Firajë - Drajkovc - Gotovushë	MI	MI, KK. Shtërpce	*	BKK	
	A5	Vendosja e linjës në relacionin Prizren - Reçan - Nebregoste	MI	MI, KK. Prizren	**	BKK	
	A6	Vendosja e linjës në relacionin Prizren - Reçan - Pllanjan	MI	MI, KK. Prizren	**	BKK	
	A7	Vendosja e linjës në relacionin Prizren - Reçan - Drajçiq	MI	MI, KK. Prizren	**	BKK	
	A8	Vendosja e linjës në relacionin Prizren - Reçan - Gornje Sello	MI	MI, KK. Prizren	*	BKK	
	A9	Vendosja e linjës në relacionin Doganaj - Shtërpce - Sevce	MI	MI, KK. Shtërpce	*	BKK	
	A10	Vendosja e linjës në relacionin Doganaj - Biti e Poshtme - Biti e Epërme	MI	MI, KK. Shtërpce	**	BKK	
	A11	Vendosja e linjës në relacionin Sharr–Brod (komuna e Sharrit)	MI	MI, KK. Sharr	*	BKK	
	A12	Vendosja e linjës në relacionin Sharr–Restelicë	MI	MI, KK. Sharr	*	BKK	
	A13	Ndërtimi i vendparkimeve në hyrje - daljet e parkut	MMPH, komunat respektive	Komunat respektive	**	BKK	
	A14	Ndërtimi i vendparkimeve në Shtërpce, Brezovicë, Sevce, Delloc, Gornje Sello, Mushnikovë, Reçan, Brezne, Pllajnik, Restelicë dhe Brod (komuna e Sharrit)	MMPH, komunat respektive	Komunat respektive	**	BKK	

	A15	Negocijimi dhe kontraktimi me pronarët e tokave ku do të bëhen vendparkimet	Komunat respektive	Komunat respektive	**	BKK	
S3O3. Sigurimi i transportit të skiatorëve deri tek pikat nga të cilat lëshohen	A1	Aktivizimi i teleferikëve dhe ski liftave ekzistues që janë jashtë funksionit dhe ndërtimi i të rinjve në qendren turistike ne Brezovicë sipas planeve te miratuara ne kuadër të projektit të partneritetit publiko privat "Projekti për Zhvillimin e Qendrës Turistike Brezovica"	Qeveria e Kosovës	Qeveria e Kosovës, investitori privat	**	Partneritet publik-privat	
Infrastruktura e energjetikës							20,595,000
S3O4. Sigurimi i furnizimit të parkut dhe të vendbanimeve rreth tij me energji elektrike	A1	Realizimi i një studimi me parashikimin për sasinë e energjisë elektrike që do të jetë e nevojshme për furnizimin e parkut dhe të vendbanimeve rreth tij gjatë 10 vjetëve të ardhshëm	MMPH, MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK, donatori	**	BKK - 50%, donatori - 50%	45,000
	A2	Caktimi i ekipit profesional apo institucionit adekuat që do ta realizonte studimin e lartpërmendur	MMPH, MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK, donatori	*		
	A3	Realizimi i një studimi për levërdinë e ndërtimit të minihidrocentraleve në lumenjt Lepenc, Lumbardhi i Prizrenit, Restelicë dhe Brod (komuna e Sharrit)	MMPH, MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK, donatori	**	BKK - 50%, donatori - 50%	540,000
	A4	Caktimi i ekipit profesional apo institucionit adekuat që do ta realizonte studimin për levërdinë e ndërtimit të minihidrocentraleve në lumenjt Lepenc, Lumbardhi i Prizrenit, Restelicë dhe Brod.	MMPH, MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK, donatori	*		
	A5	Ndërtimi i minihidrocentraleve të lartpërmendur pasi të jenë caktuar lokacionet më të përshtatshme dhe vënja në funksion e hidrocentralit të Dikancit	MMPH, MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK, kreditori	***	BKK - 20%, kredi e jashtme - 80%	20,000,000
	A6	Rekonstruktimi i trafove ekzistues	MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK	**	BKK	
	A7	Përcaktimi i numrit, në bazë të parashikimit të nevojave për energji elektrike dhe i lokacioneve ku do të vendosen trafostacionet e rinj	MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK	**	BKK	
	A8	Vendosja-instalimi i trafove të rinj	MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK	***	BKK	

	A9	Rekonstruktimi i largpërçuesve që vijnë në park nga Prizreni dhe Ferizaj	MZHE, komunat respektive	MZHE, komunat respektive, KEK	**	BKK	
Infrastruktura ujore							
S3O5. Zhvillimi i sistemit publik të ujësjellësit dhe kanalizimit në park dhe në vendbanimet rreth tij	A1	Analizimi shkencor i burimeve të ujrave nëntokësor që figurojnë në librin e kadastrit(libri i ka të dhënat për këto burime), në mënyrë që të konstatohet se cilat burime do të mund të shfrytëzoheshin për furnizimin e parkut dhe të vendbanimeve rreth tij me ujë të pijshëm	MMPH, Komunat respektive	MMPH, komunat, komp. ujës donatori	**	BKK 50%, donatori 50%	
	A2	Hulumtimi i burimeve të reja të ujrave nëntokësor	MMPH, Komunat respektive	MMPH, kom. kom. ujës ,dona.	***	BKK - 50%, donatori - 50%	
	A3	Caktimi i ekipit profesional apo institucionit adekuat për analizimin shkencor të burimeve të njohur të ujrave nëntokësor si dhe hulumtimin dhe gjetjen e burimeve të reja të ujrave nëntokësor	MMPH, Komunat respektive	MMPH, komunat, komp. ujës donatori	**		
	A4	Realizimi i një studimi që do të tregonte se në cilin nga lokacionet Semajë, Brod dhe Reçan do të ishte i arësyeshëm krijimi i liqenit që do të furnizonte me ujë të pijshëm kapacitetet e parkut kombëtar dhe VB rreth tij;	MMPH, Komunat respektive	MMPH, komunat, komp. ujës donatori	**	BKK - 50%, donatori - 50%	
	A5	Caktimi i ekipit profesional apo institucionit adekuat që do ta bënte studimin e arësyeshmërisë së ndërtimit të ndonjë pende për akumulacion ujor(liqe)	MMPH, Komunat respektive	MMPH, komunat, kom. ujës, donatori	*		
	A6	Ndërtimi i pendës dhe punët tjera të nevojshme për krijimin e liqenit në njërin apo më shumë nga lokacionet e lartpërmendur nëse studimi tregon se krijimi i liqenit është i arësyeshëm	MMPH, komunat respektive	MMPH, komunat, kom. ujës, donatori	***	BKK - 20%, kredi e jashtme - 80%	
	A7	Realizimi i një studimi me parashikimin për sasinë e ujit të pijshëm që do të jetë e nevojshme për furnizimin e parkut dhe tëVB rreth tij gjatë 10 vjetëve të ardhshëm dhe poashtu për kapacitetet e nevojshme të sist. publik të kanalizimit të ujrave të zeza në park dhe në VB rreth tij	MMPH, komunat respektive	MMPH, komunat, kom. ujë, donatori	**	BKK - 50%, donatori - 50%	
	A8	Caktimi i ekipit profesional apo institucionit adekuat për realizimin e studimit të lartpërmendur për ujin e pijshëm dhe kanalizimin e ujrave të zeza	MMPH, komunat respektive	MMPH, komunat, kom. ujës, donatori	*		
	A9	Ndërtimi i sistemeve publik të ujësjellësve me kapacitet në bazë të parashikimit nga studimi i lartpërmendur që do të furnizonin me ujë të pijshëm kapacitetet (përmbajtjet) e PK por edhe VB rreth tij nga burimet e ujrave nëntokësor apo nga liqenet artificial të krijuar	MMPH, komunat respektive	MMPH, komunat, kom. ujës, inv. privat, kreditori	***	BKK - 30%, inv. privat - 40%, kr.e jashtme - 30%	
	A10	Ndërtimi i sistemeve publik të kanalizimit të ujrave të zeza në park dhe në vendbanimet rreth tij me kapacitet në bazë të parashikimit nga studimi i lartpërmendur	MMPH, komunat respektive	MMPH, komunat, komp. ujës invest. pr.	***	BKK - 50%, in. privat - 50%	

	A11	Ndërtimi i impiantit për pastrimin e ujrave të zeza dhe i kolektorëve që mbledhin ujrat e zeza dhe i dërgojnë deri tek impianti	MMPH, komunat respektive	MMPH, komunat, kom ujës, inv. pr. kreditori	**	BKK - 30%, inv. privat - 40%, kr. e jashtme - 30%	
Telekomunikacioni							
S3O6. Zhvillimi i postës dhe telekomunikacionit në park dhe në vendbanimet rreth tij	A1	Mbulimi i tërë hapësirës së parkut kombëtar dhe të vendbanimeve rreth tij me valët e telefonisë mobile	MMPH, MI, komunat respektive	MMPH, MI, komunat, kompania publike, inv. privat	*	Kompania publike ose investitori privat	
	A2	Vendosja e antenave nga operatori i telefonisë mobile në vendet e çveshura nga pyjet, jashtë rezervateve strikte natyrore	MMPH, MI, komunat respektive	MMPH, MI, komunat, kompania publike, inv. privat	*	Kompania publike ose investitori privat	
	A3	Caktimi i ekipit të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që do ta monitoronte vendosjen e antenave të telefonisë mobile	MMPH, komunat respektive	MMPH, komunat respektive	*	BKK	
	A4	Lidhja e të gjitha objekteve publike të banimit në parkun kombëtar në rrjetin e telefonisë fikse dhe në Internet brezgjërë dhe zgjerimi i rrjetit të shërbimeve fikse në vendbanimet rreth parkut	MI, komunat respektive	MI, komunat, kompania publike, inv. privat	***	Fondi për Shërbime Universale, Kompania publike ose investitori privat	
	A5	Vendosja e punkteve postare në të gjitha qendrat rekreative, rehabilituese të parkut dhe në vendbanimet përreth parkut që do të frekuentohen nga turistët	MI, komunat respektive	MI, komunat, kompania publike	***	Kompania publike - - PTK	
Infrastruktura për menaxhimin e mbeturinave							
S3O7. Menaxhimi efikas i mbeturinave	A1	Vendosja e shportave të mbeturinave në pika të caktuara në park dhe në vendbanimet rreth tij	MMPH, komunat respektive	Komunat respektive	*	BKK	
	A2	Ndërtimi i deponisë së mbeturinave në lokacionin e caktuar jashtë parkut kombëtar	MMPH, komunat respektive	MMPH, komunat, investitori privat,	**	BKK - 50%, in. privat - 50%	
	A3	Caktimi i punëtorëve me detyrë të gjobitjes së atyre që hudhin mbeturinat jashtë vendeve të caktuara	MMPH, komunat respektive	Komunat respektive	**		

Synimi 4 Ndikimi pozitiv i ndërsjellë mes parkut dhe vendbanimeve brenda dhe përreth tij							2,260,000
Objektivi	Aktiviteti/ Masa/ Projekti		Akterët vendimmarrës	Përgjegjës për zbatim	Afati kohor	Burimi finansiar	Çmimi në €uro
S4O1. Zhvillimet e planifikuara dhe kontroll të zhvillimeve: a për zonat brenda dhe për rreth parkut	A1	Hartimi i planit menaxhues për parkun kombëtar	MMPH/DP	DP	*	MMPH, IJ	150,000
	A2	Hartimi i PRRU - planeve rregullues urban për qendrën turistike në Brezovicë	MMPH/DP, KK Shtërpce	DP, KK Shtërpce	*	BKK	50,000
	A3	Hartimi i PRRU - planeve rregullues urban për qendrën turistike në Prevallë	MMPH/DP, KK Prizren	MMPH/DP KK Prizren	*	BKK	50,000
	A4	Hartimi i PRRU - planit rregullues urban për qendrën turistike shëndetësore në Maqurishtë – Suharekë	MMPH/DP, KK Suharekë	MMPH/DP KK Suharekë	*	BKK	30,000
	A5	Hartimi i PRRU - planit rregullues urban për qendrën turistike "Guri I Zi" - K Dragash	MMPH/DP, KK Dragash	MMPH/DP KK Dragash	*	KK, IP	60,000
	A6	Hartimi i PRRU - Planit rregullues urban për qendrën turistike "Ahishtë" - Kaçanik	MMPH/DP, KK Kaçanik	MMPH/DP KK Dragash	*	KK, IP	60,000
	A7	Identifikimi dhe adoptimi për bujtina i staneve, për ofrim promovimi të eko- turizmit, turizmit shëndetësor dhe agro- turizmit në park	MMPH/DP	DP	*	BKK,IP	200,000
	A8	Hartimi i planeve rregulluese urbane për vendbanimet përreth parkut si pjesë e planeve zhvillimore komunale dhe në harmoni me PH PK "Sharri" " Gornjaselle, Brezovice, Sevce, Struzhë, Skorobishtë, Zaplluzhe, Restelicë dhe Brod (komuna e Sharrit)	KK	KK	*	BKK	
	A9	Monitorimi dhe kontrollimi i zhvillimeve sipas planeve rregulluese urbane brenda parkut,	MMPH/DP	DP,KK	***	BKK	
	A10	Monitorimi dhe kontrollimi i zhvillimeve sipas planeve rregulluese jashtë parkut,	KK	KK	***	BKK	
S4O2. Bashkëpunimi ndërkomunal për zhvillim rural në mes të komunave ne të cilat shtrihet PK "Sharri"	A1	Krijimi i trupit koordinues në mes të komunave fqinje për përcaktimin e caqeve të përbashkëta zhvillimore (përbërë nga zyrtarët komunal të komunave dhe përfaqësues të shoq. civile)	KK, MAPL	KK, MAPL	**	BKK	50,000
	A2	Harmonizimi i PZHK të katër komunave në të cilat shtrihet PK përmes planeve të përbashkëta rregulluese për zonat rurale fqinje me interes reciprok	KK, MAPL	KK, MAPL	*	BKK	250,000

S4O3. Mbështetje vendbanimeve përreth parkut për të ofruar ofertë turistike; ofrimin e eko - prodhimeve tradicionale dhe marketingun e tyre,	A1	Vetëdisimi i banorëve, bazur nga shembujt në rajon dhe botë, për përfitimet e mundshme nga menxhjimi ekologjik i parkut; përfshirë mundësin e vizitave jashtë vendit	KK, MASHT, MTI/DT, MKRS, MBPZHR, MMPH, MAPL	OJQ	*	BKK	200,000
	A2	Organizimi i trajnimeve për eko prodhime, të standardizuara dhe artikuj tjer artizanal me tiketë karakteristike - llogo të PK "Sharrl"; me të cilat do të hartohet broshura me prodhimet tradicionale të këtyre zonave për të reklamuar prodhimet unike me logon e parkut dhe kualitetin e prodhimit,	KK, MASHT, MKRS, MBPZHR, MMPH, MAPL	OJQ	**	BKK	400,000
	A3	Ofrimi i lehtësimeve në tatime për stimulimin e banorëve në involvimin në industri turistike për të ndikuar në ofertën turistike lokale,	MEF,KK	KK	*	BKK	
	A4	Themelimi i ndërmarrjeve të vogla për industri turistike	MTI, MKRS, MBPZHR	KK	***	IP, IJ	
	A5	Krijimi i fermave për rritjen dhe kultivimin e qenit të "Sharrit	MBPZHR, KK	MBPZHR, KK	*	IP, IJ, BKK	60,000
	A6	Mirëmbajtja e rrugëve, shtigjeve për ecje, kopshteve, livadheve dhe hapësirave bujqësore në vendbanimet përreth parkut	KK	KK, SP	***	BKK	
S4O4. Vetëdijësimi për ruajtjen e kulturës tradicionale të komuniteteve që jetojnë në zonat përreth parkut, veprimtaritë që ndikojnë në zhvillimin e eko-turizmit	A1	Angazhimi i OJQ ve në vetëdijesimin e popullatës për ruajtjen dhe prezantimin e vlerave tradicionale folklorike karakteristike të komuniteteve .	MKRS, KK	OJQ	*	BKK, IJ	150,000
	A2	Organizimi i aktiviteteve të lira nëpër shkolla për shoqëri kulturore artistike karakteristike të komuniteteve	MASHT, MKRS, KK	KK	***	BKK, IJ	50,000
	A3	Mbështetja në hapjen e punëtorive me veprimtari të artizanaleve	MKRS, MEF, MTI, MAPL, KK	OJQ	**	BKK, IJ, IP	500,000

Sinimi 5 **Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik i parkut**							**860,000**
S5O1. Partneriteti publiko-privat për ofrimin e kushteve për investime të reja në kapacitetet rekreative	A1	Mbështetja ligjore për partneritet publiko privat	MTI	KK	*	BKK	
	A2	Dhënia me kontratë për investime në qendrat turistike (Infrastruktur dhe hotele) dhe shfrytëzim të kapaciteteve për kohë të caktuar sipas marrëveshjes,	MTI, KK, DP	KK, DP	***	IP, IJ	
	A3	Zhvillimi i qendrës turistike në Brezovicë sipas planeve rregullues	Qeveria e Kosovës	Qeveria e Kosovës, investitori privat	**	PPP	
	A4	Ndërtimi i qendës turistike sportive në Prevallë, sipas planit rregullues	KK, MTI, MMPH	KK, DP	**	IP, IJ	
	A5	Ndërtimi i qendës turistike shëndetësore në Maqurishtë – Suharekë, sipas planit rregullues	KK, MTI, MMPH	KK, DP	**	IP, IJ	
	A6	Ndërtimi i qendës turistike sportive "Guri i Zi" - Dragash, sipas planit rregullues	MTI, KK, MMPH	KK	**	KK, IP	
	A7	Përshpejtimi i privatizimit të kapaciteteve në Brezovicë që janë jashtë Hapësirës për Zhvillimin e Projektit Brezovica	AKP, MTI	AKP	*		
S5O2. Ngritja e objekteve përcjellëse, kontrolluese dhe afariste në funksion të parkut	A1	Ngritja e ndërtesës së autoritetit të parkut brenda në park	MMPH/DP	MMPH/DP	*	MMPH	200,000
	A2	Organizimi i pikave kontrolluese në hyrje – daljet e parkut	MMPH/DP	MMPH/DP	*	MMPH	60,000
	A3	Ngritja e objekteve të vogla për shërbime bankare dhe postare, shitore të souvenirave, agjencone për marketing dhe informim të shërbimeve akomoduese.	MMPH/DP	MMPH/DP	*	IP,IJ	100,000
	A4	Ngritja e qendrës së natyrës, muzeut dhe kopshtit botanik, hapësirave për hulumtim	MMPH/AKMM	MMPH/ AKMM	**	BKK	500,000
S5O3. Përfitimet nga shfrytëzimi ekologjik i parkut	A1	Hartimi i udhëzimit administrativ/rregullores për shfrytëzimin e sipërfaqeve të parkut për kullosa, mbledhjen e frutave të imta dhe bimëve mjekuese, mënyrën e dhënies së lejeve për vizitat e grupeve hulumtuese - shkencore dhe kalkulimi i kostove për shërbime të tilla.	MMPH, MPBZHR,	MMPH/DP	*	BKK	
	A2	Caktimi i zonave, sipërfaqeve dhe afatet kohore për shfrytëzim të mundshëm për kullotje të bagëtisë dhe mbledhje frutash të imta, bimëve mjekuese dhe bimëve për hulumtime-shkencore,	MMPH, MPBZHR,	MMPH/DP	*	BKK	
	A3	Organizimi dhe menaxhimi i shtigjeve për vizita të organizuara hulumtuese- shkencore.	MMPH/DP	MMPH/DP	*	BKK	
S5O4. Plotësimi i plan programeve	A1	Plotësimit të plan programeve arsimore në arsimin e mesëm të orientuar dhe atë profesional, për komunat për rreth parkut	MASHT, KK	KK	*	BKK	

arsimore për Industrinë e turizmit	A2	Plotësimit të plan programeve arsimore në arsimin e lartë, fakultete dhe shkolla të larta për turizëm apo edhe specializime në këtë fushë, për ngritjen e cilësisë dhe zhvillimit të turizmit në Kosovë.	MASHT, KK	KK, UP	*	BKK	
Synimi 6 **a) Park i njohur dhe i pranuar në aspekt ndërkombëtar;** **b) Bashkëpunim ndërkombëtar dhe ndërkufitar në mbrojtjen dhe zhvillimin e parkut**							**8,570,000**
S6O1. Propagandimi i vlerave natyrore, pejzazhore e turistike të parkut;	A1	Hartimi i hartave, broshurave dhe video klipeve ,për vlerat dhe kapacitet turistike të PK "Sharri",	MMPH, MTI/DT,		*	BKK	50,000
	A2	Distribuimi i materialit propagandistik për PK "Sharri" përmes : Mediave lokale dhe ndërkombëtare; Agjencioneve turistike të vendit dhe të huaja; Ambasadave të Republikës së Kosovës, Avio kompanive që kanë destinim Kosovën,	MTI, MMPH, MKRS,	MTI, MMPH, MKRS,	*	BKK	500,000
	A3	Pjesëmarrje aktive nëpër konferenca ndërkombëtare për turizëm, mbrojtje të mjedisit.	MTI, MMPH, MKRS, MPBZHR, ZKM, AIE, MAPL	MTI, MMPH, MKRS, MPBZHR, ZKM, AIE, MAPL	***	BKK	600,000
S6O2. Ratifikimi i konventave ndërkombëtare (RIO, Kyoto, ESPOO, Llugano etj) dhe përmbushja e obligimeve që dalin nga konventat;	A1	Inicimi dhe përshpejtimi i procesit të ratifikimit të konventave nga ana e MMPH ,Qeverisë së Kosovës,	MTI, MMPH, MKRS, MPBZHR, ZKM, AIE, MAPL	MTI, MMPH, MKRS, MPBZHR, ZKM, AIE, MAPL	*	BKK	
	A2	Përshpejtimi i procesit të ratifikimit përmes involvimit të organizatave mjedisore ndërkombëtare, Zyrave Ndërlidhëse dhe Ambasadave që veprojnë në Kosovë	MTI, MMPH, MKRS, MPBZHR, ZKM, AIE, MAPL	MTI, MMPH, MKRS, MPBZHR, ZKM, AIE, MAPL	*	BKK	50,000
	A3	Aplikimi për njohje në organizatat ndërkombëtare si: IUCN, WTO etj;	MTI, MMPH, MKRS, MPBZHR, ZKM, AIE, MAPL	MTI, MMPH, MKRS, MPBZHR, ZKM, AIE, MAPL	**	BKK	100,000
S6O3. Bashkëpunimi për PK "Sharri" mes Kosovës dhe shteteve fqinje si	A1	Nënshkrimi i një memorandumi të bashkëpunimit ndërkomunal mes komunave/vendbanimeve në Kosovë dhe Maqedoni që tangjentojnë Malin Sharr, për mbrojtje dhe zhvillim te ndërsjelltë – Formimi i organizmave ndërkomunal që iniciojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin ndërkufitar;	MAPL dhe Kuvendet e Komunave kufitare	MAPL dhe Kuvendet e Komunave kufitare	*	IJ, BKK, BiFYRoM, IP,	10,000

dhe me shtetet në rajon e më gjërë,	A2	Nënshkrimi i një memorandumi të bashkëpunimit ndërkufitar mes Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e maleve të Sharrit – Formimi i organizmave ndërshtetëror që iniciojnë dhe koordinojnë bashkëpunimin ndërkufitar;	MAPL, ZKM, AIE	MAPL, ZKM, AIE	*	BKK	10,000
	A3	Nënshkrimi i një memorandumi të bashkëpunimit mes Kosovës dhe shteteve në rajon për shkëmbim përvojash në mbrojtjen dhe zhvillimin e parqeve nacionale	MAPL, ZKM, AIE	MAPL, ZKM, AIE	*	BKK	50,000
S6O4. Konkurrimi për fondet ndërkombëtare me projekte të përbashkëta të Kosovës, Shqipërisë dhe Maqedonisë për zonën ndërkufitare të malit Sharr.	A1	Harmonizimi i strategjive zhvillimore lokale të komunave / vendbanimeve në zonat kufitare për identifikimin dhe zgjidhjen e prioriteteve drejt zhvillimit rural ndërkufitar	MAPL dhe Kuvendet e Komunave kufitare	MAPL dhe Komunat kufitare	*	IJ, BKK, BiFYRoM, IP,	100,000
	A2	Hartimi rregulloreve për menagjim ekologjik të parkut duke i harmonizuar masat e mbrojtjes efikase të resurseve natyrore ndërkufitare	MMPH, MAPL dhe të Maqedonisë	MMPH, MAPL dhe Maqedonisë	**	IJ, BKK, BiFYRoM, IP,	200,000
	A3	Zgjërimi dhe zhvillimi i infrastukturës ekzistuese ndërkufitare duke respektuar kriteret bashkohore mjedisore për lidhjen rrugore te Dragash – Tetove	MMPH, MI, MAPLdhe të Maqedonisë	MMPH, MI, MAPL,Maqedonisë	**	IJ, BKK, BiFYRoM, IP,	1,500,000
	A4	Ndërtimi i qendrës së përbashkët për monitorim dhe vlerësim të ndikimit në mjedis	MMPH, MPBZHR, MAPL	MMPH, MPBZHR, MAPL	***	IJ, BKK, BiFYRoM, IP,	400,000
	A5	Hartimi i projektit të përbashkët për ofrimin e kushteve për qarkullim ndërkufitar për shfrytëzim të kapaciteteve turistike të Brezovicës dhe P.Shapkës njëkohësisht.	MAPL, KK Tetovës, Shterpces, MTI, MMPH,	MAPL, KK Tetovës, Shterpces, MTI, MMPH,	***	IJ, BKK, BiFYRoM, IP,	1,500,000
	A6	Mbështetje ndërshtetërore në themelimin e grupimit (klaster) të ndërmarrjeve që do të vepronin nën logon e përbashkët me të cilën mund të plasojnë eko-prodhimet e tyre në tregjet Evropiane dhe më gjerë	MTI, MMPH, MPBZHR, MAPL dhe të Maqedonisë	MTI, MMPH, MPBZHR, MAPL	***	IJ, BKK, BiFYRoM, IP,	2,000,000
	A7	Inicimi i projektit të përbashkët për hulumtim dhe prodhim të mundëshem ekologjik te energjisë me erë, asaj solare dhe bio-energjise.	MAPL, MEM, MMPH dhe Ministritë relevante të Maqedonisë	MAPL, MEM, MMPH Minist. releva.Maqedonisë	***	IJ, BKK, BiFYRoM, IP,	1,500,000
						Totali:	68,085,000

Afati kohor: * Afat shkurtë (deri në 2 vjet); ** Afat mesëm (2-5 vjet); *** Afat gjatë (mbi 5vj)

Një pjesë e qmimeve e prezantuara është kalkuluara në bazë të informatave të marra nga burimet përkatëse, ndërsa një pjesë tjetër e tyre është vlerësim i nxjerrë nga trendet e zhvillimit të aktiviteve përkatës. Totali prezanton shumën e të gjitha aktiviteteve për të cilat e kemi të kalkuluar çmimin.

Shtojca 4.

Hartat